

TERRORIZMI SI SFIDË GLOBALE. ASPEKTE JURIDIKE DHE KRAHASUESE TË TIJ

Fatos Hasani

Dorëzuar
Universitetit Europian në Tiranë
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkencat Juridike, me profil e Drejtë Penale, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Ilirjan Mandro

Numri i fjalëve: 72.205

Tiranë, Maj 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj me përgjegjësi se ky punim është autorial, i cili nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar asnjëherë i tëri. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Me respekt

Fatos Hasani

ABSTRAKT

Terrorizmi dita ditës po konsiderohet një sfidë bashkëkohore e sigurisë, si në nivel mbikombëtar ashtu edhe në nivel kombëtar. Sulmet e 11 Shtatorit të vitit 2011 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës sollën padyshim një ndryshim të rëndësishëm dhe thelbësor në konceptimin e tij dhe amendime të ndryshme ligjore në të gjitha nivelet. Padyshim që dhe aktet e mëvonshme me natyrë terroriste, po të së njëjtës natyrë kanë sjellë ndryshime thelbësore në rende të ndryshme ligjore dhe kanë kontribuar në rimodelimin e strategjive, koncepteve dhe politikave të sigurisë. Këto ndryshime padyshim që kanë vlerë të studiohen dhe të sillen në vëmendjen e juristëve ditët e sotme. Studimi synon në radhë të parë studimin e fenomenit, studimin e legjislacionit ndërkombëtar, atij rajonal dhe kombëtar, hulumtimin e problematikave themelore në kuadër të sanksionimit dhe procedimit të veprave penale kundër terrorizmit. Duke hulumtuar mbi terrorizmin, sjelljet, legjislacionin ndërkombëtar, praktikat dhe vendimet gjyqësore kemi dalë në disa konkluzione lidhur me përshtatshmërinë e legjislacionit tonë me atë mbikombëtar, në veçanti me atë të Bashkimit Europian; kemi evidentuar ndryshimet dhe mangesitë, nevojat e përmirësimit të sigurisë kombëtare dhe propozimet për ndryshime dhe përmirësime.

Fjalet kyce: terrorizëm, siguri kombëtare, strategji, akte terroriste.

ABSTRACT

Terrorism has become a major concern in today world. It is considering a contemporary challenge of security, at the international level and at national level as well as. The Attacks on New York on September 11, 2001 not only inflicted thousand of casualties and significant economic damage, bur also marked the beginning of a new era of terror in which counter-terrorism has become one of the highest priorities for international institutions and national goverments. Obviously that have also contributed to remodel stradegies, policies and security concepts. These changes undoubtely have been studied and it is important to bring them into the nowadays intention of lowyers. As a result many goverments reacted not only by limiting civil rights and individuar freedoms but also by raising their budgets for anti-terror spending. Terrorsim is stated one of the main challenges to global security.

International legislation, partices and court decisions have come to same conclusions regarding the adequoncy of our legistlation with the supranational in particular of the EU and changes we have identified gaps, needs to improve national security and proposals for changes and improvements.

Key words: terrorism, national security, terrorism acts etc.

DEDIKIM

Këtë punim doktore ia dedikoj *Familjes sime*

Lista e shkurtimeve

BE: Bashkimi European (European Union)

KE: Komisoni European (European Commission)

KE: Keshilli i Europes (European Council)

ECSC: (European Coal & SteelCommunity)

KE: Komuniteti European (European Community)

PE: Parlamenti European (European Parliament)

EEC: (European Economic Community)

ESS: Strategjia Europiane e Sigurise (European Security Strategy)

R&D: Kerkim&Zhvillim (Research and Development)

CS&FP: (Common Security & Foreign Policy)

CSF: (Community Support Frameworks)

UN: Organizata e Kombeve te Bashkuara (United Nations)

OECD: Organizata per Bashkepunim Ekonomik dhe Zhvillim (Organization for Economic Cooperation & Development)

B.B.R.K: Berthamore, Biologjike, Radiologjike, Kimike

FP: Program Mbeshtetje (Framework Program)

STS: Studime Shkencore dhe Teknologjike (Science and Technology Studies)

ICT: Teknologjia e Informatikes dhe Komunikacionit (Information and Communication Technologies)

CS&FP: Politikat e perbashketa te Jashtne dhe te Mbrojtjes (Common Security & Foreign Policy)

AEC: Atomic Energy Commission (USA)

AIA: Aircraft Industries Association

ARPANET: Advanced Research Projects Agency Network

BRITE: Basic Research in Industrial Technologies

CEA: Commissariat à l'Energie Atomique

CEN: Comite Europeen de Normalisation

CETS: Conférence Européene de Télécommunications par Satellites

CGEA: Community General Export Authorisation

CIA: Central Intelligence Agency

CNES: Centre National d' Etudes Spatiales

CoCoM: Coordinating Committee for Multilateral Export Controls

COTS: Commercial-off-the-Shelve

CREST: Comite de la Recherche Scientifique et Technique

CSES: Centre for Strategy and Evaluation Services

DARPA: Defense Advanced Research Projects Agency

DHS: Department of Homeland Security

DLR: Deutsches Zentrum fur Luft- und Raumfahrt

DUAP: Dual Use Applications Program

ECU: European Currency Unit

EDA: European Defense Agency (Agjensia Europiane e Mbrojtjes)

ELDO: European Space Vehicle Launcher Development Organization

ERA: European Research Area (Hapësira Europiane e Kërkimit)

ERC: European Research Council (Këshilli European i Kërkimit)

ERDA: European Research and Development Agency

ESA: European Space Agency

ESCD: Emerging Security Challenges Division, (NATO)

ESF: European Science Foundation

ESPRIT: European Strategic Programme for Information Technologies

ESRAB : European Security Research Advisory Board (Bordi Europian i Kerkimeve per Sigurine)

ESRIF : European Security Research and Innovation Forum

ESRP : European Security Research Programme (Programi Kerkimor Europian per Sigurine)

ESRO: European Space Research Organization

EUROCONTROL: European Organisation for the Safety of Air Navigation

EUREKA: European Research Coordinating Agency

MIT: Massachusetts Institute of Technology

NASA: National Aeronautics and Space Agency

NRL: Naval Research Laboratory (SHBA)

NPL: National Physical Laboratory (Angli)

NI: National Intelligence

NIH: National Institutes of Health (Instituti Kombëtar i Shëndetësisë, SHBA)

NIS: National Innovation Systems (Sistemi Kombëtar i Inovacionit)

NSC: National Security Council (Këshilli Kombëtar i Sigurisë,SHBA)

NSF: National Science Foundation (Fondacioni Kombëtar i Shkencës,SHBA)

OSRD: Office of Scientific Research and Development (Shërbimi i Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit, SHBA)

PASR: Preparatory Action on the Enhancement of the European Industrial Potential in the Field of Security

SARS: Severe Acute Respiratory Syndrome

SI: Systems of Innovation (Sisteme Inovacioni)

SRAB: Security Research Advisory Board (Këshilli për Studimin për Sigurinë)

TRP: Technology Reinvestment Program

VLSI: Very Large Scale Integration

PËRMBAJTJA E LËNDËS

DEKLARATA E AUTORËSISË.....	I
ABSTRAKT.....	II
ABSTRACT.....	III
DEDIKIM.....	IV
Lista e shkurtimeve.....	V
TABELA E PËRMBAJTJES.....	VI

KAPITULLI I:- HYRJE DHE BAZIMI TEORIK

1.1. Hyrje.....	1
1.2. Objekti i studimit.....	2
1.3. Qëllimi dhe rëndësia e punimit.....	3
1.4. Metodologjia dhe metodat e kërkimit.....	4
1.5. Hipoteza dhe Pyetjet kërkimore.....	6
1.5.1. Hipotezat e studimit.....	6
1.5.2. Pyetjet kërkimore.....	7
1.6. Kufizimet e punimit.....	7
1.7. Përmbledhja dhe struktura e studimit.....	8

KAPITULLI II: TERRORIZMI NË KËNDVËSHTRIMIN HISTORIK. ZHVILLIMI I TIJ NË KOHË.

2.1. Fenomeni i terrorizmit, një vështrim i përgjithshëm dhe një udhëtim në kohë.....	12
2.2. Zhvillimi i konceptit të terrorizmit deri në ditët e sotme.....	15

2.3. Dallimi i “terrorizmit“ dhe “akteve terroriste“ nga “terrori“.....	20
2.4. Terrorizmi Islamik.....	24
2.4.1. Karakteristikat e terrorizmit islamik.....	32
2.4.2. Subjektet që kryejnë aktet terroriste/sulmet vetëvrasëse.....	32
2.4.3. Debatet bashkëkohore mbi aktet terroriste islamike.....	36

KAPITULLI III: TERRORIZMI, KUPTIMI I FENOMENIT DHE TENTATIVAT PËR NJË PËRKUFIZIM JURIDIK UNIK

3.1. Hyrje.....	44
3.2. Koncepti juridik i terrorizmit.....	49
3.3. Nevoja e domosdoshme e përkufizimit të terrorizmit.....	53
3.4. Përkufizimi juridik i gjithëpranuar mbi terrorizmin.....	58
3.5. Dallimi ndërmjet akteve terroriste dhe akteve të dhunshme me qëllim vetëvendosjen.....	60
3.6. Terrorizmi shtetëror. Debatet aktuale në Kombet e Bashkuara.....	62
3.7. Dallimi ndërmjet “terrorizmit shtetëror“ dhe “State sponsorship of terrorism“.....	64
3.7.1. Praktika ndërkombëtare.....	65
3.8. Dallimi ndërmjet akteve terroriste dhe krimeve politike.....	67

KAPITULLI IV: AKTET NË NIVEL NDËRKOMBËTAR QË JANË MIRATUAR ME QËLLIM LUFTËN NDAJ TERRORIZMIT. ANALIZË JURIDIKE.

4.1. Hyrje.....	74
-----------------	----

4.2. Aktet ndërkombëtare të miratuara në gjirin e Kombeve të Bashkuara që kanë të bëjnë me aspekte të veçanta të luftës ndaj terrorizmit.....	75
4.2.1. Konventat ndërkombëtare të miratuara nga institucionet e specializuara të OKB-së.....	77
4.2.1.1 Konventat “Kundër rrëmbimit të pengjeve”, “Kundër parandalimit të krimeve, kundër personave ndërkombëtarisht të mbrojtur përfshirë agjentët diplomatik”. Çështja e lëvizjeve çlirimtare.....	81
4.2.1.2. Konventa Ndërkombëtare “Për parandalimin e atentateve me eksploziv”, Konventa “Për parandalimin e financimit të terrorizmit”.....	85
4.2.2. Konventat me karakter Rajonal.....	87
4.2.2.1. Konventat e miratuara në Europë.....	87
4.2.2.2. Konventat e miratuara në Shtetet Amerikane.....	87
4.2.2.3. Konventat Rajonale që dallojnë terrorizmin nga luftërat për liri.....	88
4.3. BE-ja dhe Terrorizmi.....	89
4.3.1. Strategjia Evropiane e Sigurisë dhe dokumenta të tjerë publike.....	97
4.4. Raste praktike të aplikimit të konventave ndërkombëtare me fokus aktet terroriste.....	106
4.4.1. Çështja Yunis.....	108
4.4.2. Çështja Georgesku.....	109
4.4.3. Çështja S.H.T.....	110
4.4.4. Çështja Ekanayake.....	110
4.5. Praktika e disa shteteve.....	111

KAPITULLI V: ASPEKTE TË VEÇANTA TË LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT. NJË VËSHTRIM KRAHASUES I KUADRIT LIGJOR TË MBROJTJES NGA TERRORIZMI NË SHTETE TË NDRYSHME

5.1. Hyrje.....	115
5.2. Siguria ndërkombëtare para dhe pas 11 shtatorit të 2001-it.....	116
5.3. Koncepti i Sigurisë.....	122
5.4. Teknologjia, aleate e Sigurisë dhe e luftës kundër Terrorizmit.....	133
5.4.1. Siguria, Terrorizmi dhe Politika Teknologjike.....	138
5.4.2. Mekanizmat e furnizimit dhe prokurimeve, specifikimet teknike, teknologjike dhe Politika industriale	150
5.5. Një vështrim krahasues i kuadrit ligjor të mbrojtjes nga terrorizmi në shtete të ndryshme.....	155
5.5.1. Rasti i SHBA-ve.....	155
5.5.2. Rasti i Mbretërisë së Spanjës.....	165

KAPITULLI VI. SHQIPËRIA DHE TERRORIZMI

6.1. Hyrje.....	167
6.2. Trajtimi ligjor sipas të drejtës penale shqiptare.....	170
6.2.1. Analizë e dispozitave të Kodit Penal shqiptar.....	176
6.2.2. Analizë e Ligjit Nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.....	188
6.2.3. Analizë e Projekt Ligjit Nr. “Për kontrollin kufitar”.....	190
6.3. Subjekti që ushtron terrorizëm dhe dallimi nga kriminelitë politik.....	192
6.4. Depolitizimi i terrorizmit.....	197

6.4.1. Depolitizimi i përgjithshëm.....	199
6.4.2. Depolitizimi specifik.....	199
6.5. Aktet terroriste në Shqipëri, një realitet apo propagandë mediatike? Raste studimore te perfshirjes se shtetasve shqiptare ne aktet terroriste.....	200

KAPITULLI VI: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

7.1. Konkluzione.....	208
7.2. Rekomandime.....	216
BIBLOGRAFIA.....	219

KAPITULLI I:- HYRJE

1.1. Hyrje

Lindja e fenomenit të terrorizmit dhe zhvillimi i tij në kohë kanë qenë dhe janë objekt i studimeve dhe diskutimeve të shumta. Vlefshmëria e teorive të krimit politik, kriminelit politik, konceptit të terrorizmit dhe terroristit dhe definimi i tij etj., konfirmohen dhe në ditët e sotme, pasi shërbejnë si referencë e diskutimeve të shumta jo vetëm për ligjshmërinë e metodave dhe strategjive të luftës kundër fenomenit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut por dhe si referencë në kuadër të vendimarrjes legislative. Në shumë raste komuniteti ndërkombëtar ka theksuar , se e dënon ashpër terrorizmin, me të gjitha format dhe mënyrat që ai shfaqet.

Edhe pse ka patur përpjekje të shumta, në jurisprudencën ndërkombëtare nuk gjen një përkufizim të pranuar botërisht për sa i përket terrorizmit. Ky fenomen është studjuar shumë në shkencat e sjelljes dhe shkencat shoqërore. Megjithatë studimi i këtij fenomeni edhe në shkencat juridike ka rëndësinë e vet. Studjuesit e shumtë, edhe pse nuk e kanë dhënë një përkufizim të saktë të terrorizmit, kanë specifikuar cilat janë karakteristikat e veçanta si dhe kanë specifikuar kur legjitimohet përdorimi i disa formave të dhunës në rrethana të vecanta dhe se kur ky përdorim në këto rrethana nuk duhet të konsiderohet si terrorizëm. Pra, së pari kanë bërë dallimin midis *akteve terroriste dhe veprimeve dhe akteve të dhunshme për vetëvendosje*.

Termi ''terrorizëm'', si praktikë, është përdorur së pari nga udhëheqësit Jakobinë të periudhës 1793-1794, ndërsa si një fenomen modern, është shfaqur në Europë kryesisht nga vitet 1970 në formën e *terrorizmit kundër shtetit* (Loverdos 1987: 91-109). Shtetet, përmes agjensive të tyre qeveritare, si dhe në kuadër të të drejtës

ndërkombëtare, në veçanti, kanë detyrimin për të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të gjithë individëve brenda juridiksionit të tyre, nga terrorizmi, si pjesë e detyrimeve të tyre pozitive për garantimin e së drejtës për jetën, së drejtës për integritet fizik dhe të tjera liri themelore të njeriut¹. Rrjedhimisht, ato duhet të përqëndrohen tek parandalimi i terrorizmit duke respektuar të drejtat e njeriut dhe shtetin ligjor (OSBE/ODIHR, 2007). Të gjitha aktivitetet terroriste, gjithsesi duhet t'i nënshtrohen gjykimit të drejtë dhe dënimit të merituar nga e tërë bashkësia ndërkombëtare. Komuniteti ndërkombëtar ka theksuar në një sërë rastesh, se e dënon me forcë terrorizmin, me të gjitha format dhe mënyrat që ai manifestohet, nga kushdo dhe kudo dhe për çfarëdo qëllimi, si një ndër kërcënimet më serioze të paqes dhe sigurisë në mbarë botën.

1.2. Objekti i studimit

Fenomeni i terrorizmit ndërkombëtar ka rifilluar të diskutohet dhe t'i interesojë komunitetit ndërkombëtar pikërisht pas ngjarjeve të 11 Shtatorit në SHBA. Interesi përkon pikërisht me nevojën e këtij komuniteti për të marrë masa që t'i parandalojë ato. Objekti i këtij studimi do të jetë fillimisht çështja e shumë diskutuar mbi përkufizimin juridik të terrorizmit ndërkombëtar. Në këtë drejtim të përkufizosh termin e terrorizmit ndërkombëtar ka rëndësi të veçantë pasi vëmendja është përqëndruar te aktet e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara me qëllimin final për të parandaluar dhe frenuar autorët e akteve terroriste. Sa i takon shteteve objekti i studimit do të përqëndrohet te masat kufizuese të lirisë personale të individëve duke dalë jashtë

¹Shih për më shumë në lidhje me këtë argument *Countering Terrorism, Protecting Human Rights: A Manual* [Lufta kundër terrorizmit, Mbrojtja e të drejtave të njeriut: Manual] (Varshave: OSBE/ODIHR, 2007), <http://www.osce.org/odihr/29103>, aksesuar në datë 2.01.2015.

kornizave të së drejtës ndërkombëtare me qëllim përforecimin e sigurisë përball situatës urgjente të shkaktuar nga terrorizmi ndërkombëtar. Po ashtu objekti i këtij studimi do të jetë edhe debati i ngritur si në nivel ndërkombëtar ashtu e në nivel kombëtar e rajonal se cilat akte dhe veprime duhet të konsiderohen terroriste. Pra, në mënyrë specifike do të trajtohet analiza juridike e fenomenit duke përfshirë këtu edhe dallimin që ekziston ndërmjet akteve terroriste të individëve që sponsorizohen nga shteti ose terrorizmi shtetëror. Pikërisht kjo është arsyeja që komuniteti ndërkombëtar pati një përçarje të shteteve perëndimore me shtetet aziatike sidomos me shtetet afro-aziatike dhe arabe të cilët mendonin të përfshinin në terrorizmin shtetëror edhe aktet agrasive të bëra nga vetë shteti nëpërmjet organeve të tij.

Pikërisht këtu është diskutuar edhe një arsye tjetër e këtij debati e shfaqur pikërisht nga shtetet afrikane e aziatike për të mos ngatëruar aktet terroriste me aktet e popujve që në mënyrë legjitime në bazë të së drejtës ndërkombëtare luftojnë për vetëvendosje. Gjithsesi studimi ynë do të fokusohet përgjithësisht mbi çështjen e terrorizmit të shkaktuar nga individët ose grupe individësh.

1.3. Qëllimi dhe rëndësia e punimit

Siç dihet tashmë studimi i terrorizmit është shumëdimensional. Kjo kuptohet fare lehtë pasi këtij fenomeni mund ti qasemi nëpërmjet disiplinve të ndryshme. Po ajo që na intereson në këtë punim doktoral është trajtimi juridik që i bëhet këtij fenomemi. Qëllimi i këtij studimi është studimi dhe hulumtimi shkencor i fenomenit të terrorizmit sidomos përgjatë dekadës së fundit, pasi ai duket se po përqendrohet në lidhjen gjithnjë e më të fortë të terrorizmit me gjeopolitikën dhe mënyrën sesi shtetet po reagojnë ndaj tij, duke e përdorur shpeshherë për të promovuar ose për ligjur interesat e tyre të politikës së

jashtme me natyrë gjeopolitike apo dhe ekonomike.

Kjo pasqyrohet jo vetëm në doktrinat e sigurisë kombëtare dhe politikës së jashtme të shteteve të mëdha, si Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, Kina apo Rusia, por edhe kur shqyrtohen shtete me komponentë më të vegjël fuqie, si ato të Lindjes së Mesme apo dhe disa vende të Ballkanit, të cilët janë përfshirë në analizën tonë të dimensioneve që ka marrë terrorizmi dhe lufta ndaj tij. Në këtë kuadër, ky punim bëhet i rëndësishëm si në kuadrin e një vlere të shtuar për studimet e terrorizmit, akteve terroriste dhe karakteristikat e tij, ashtu sikurse trajtimi juridik i këtij fenomeni nga pikëpamja juridik dhe sigurisë ndërkombëtare në mjedisin akademik shqiptar, ashtu dhe përmes ofrimit të një perspektive të re të interpretimit të dukurisë së terrorizmit ndërkombëtar dhe reagimit ndaj tij të shteteve anëtare të BE-së dhe nga ana tjetër edhe të Shqipërisë.

Rëndësia e këtij studimi del në pah duke parë vëmendjen në rritje që po i kushtohet terrorizmit ndërkombëtar si nga aktorët shtetërorë ashtu dhe studiuesit e shkencave politike, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe sidomos të shkencave juridike.

1.4. Metodologjia dhe metodat e kërkimit

Në zhvillimin e kësaj teze kam përdorur disa metoda shkencore, të cilat konsistojnë në studimin e fenomenit të terrorizmit në dimensionet e evoluimit të tij në kohë, dhe në një epokë tashmë ku teknologjia ka arritur përmasa të mëdha dhe është bërë pjesë e pandashme e jetës sonë të përditshme dhe bazike për të.

Për të realizuar këtë punim doktoral jam bazuar në një metodologji të caktuar dhe në disa metoda me karakter shkencor.

Metodologjia: Hulumtimi ka kalaur në disa etapa kryesore. Fillimisht kam bërë seleksionimin e literaturës bazë të detyrueshme që kanë trajtuar fenomenin e terrorizmit

dhe si dhe një pjesë të mirë të literaturës që e trajton këtë fenomen nga pikpamja juridike. Ky lloj seleksionimi ka qenë i detyrueshëm pasi një pjesë e mirë e punimeve e trajtojnë këtë si fenomen me qasje sociale. Pjesa më e madhe e literaturës është në gjuhë të huaj pasi në literaturën shqiptare punimet janë shumë të pakta.

Më pas është ndërtuar përmbajtja e temës dhe në funksion të secilës pjesë është ngritur hulumtimi. Ky punim është pasuruar sidomos me raste të veçanta pasi janë sjellë rastet e akteve terroriste në vende të ndryshme. Në fund janë dhënë kokluzionet dhe rekomandimet që i kemi menduar të përshtatshme për këtë disertacion.

Metodat shkencore të përdorura në këtë studim janë: metoda historike, analitike, përshkruese, krahasuese dhe statistikore, që këto të fundit janë ndërthurur dhe gërshetuar, besoj në harmoni me njëra-tjetrën në çështjet e trajtuara në këtë tezë.

Metoda historike është përdorur për të pasqyruar lindjen e fenomenit dhe zhvillimin evoluiv të tij deri në ditët e sotme si dhe procesin e përqasjes konceptuale dhe legjislativ të fenomenit të terrorizmit.

Metoda analitike bazohet në analizën e thellë filozofike, referuar shkrimtarëve të shumtë dhe studiuesve të shkencave të sjelljes njerëzore si dhe të shkencës juridike.

Metoda përshkruese e përdorur në punimin e kësaj teze kishte si qëllim identifikimin e realitetit terrorist dhe zhvillimit të tij, ndihmën e padiskutueshme që ofrojnë në përpjekjet kundër fenomenit shkencat dhe teknologjia si dhe rëndësinë e veçantë të një definimi konceptual të terrorizmit dhe aktit terrorist.

Metoda krahasuese është përdorur për të vënë përballë sanksionimet ligjore në kuadër kombëtar dhe ndërkombëtar bazuar në perceptime të ndryshme për fenomenin, nga koha e lindjes se tij krahasuar me nevojat e luftës kundër fenomenit si ai zhvillohet në kohët moderne.

Metoda statistikore është përdorur për të dhënë fakte dhe shifra në lidhje me vendimarrjen politike dhe strategjinë e ndjekur për luftën kundër terrorizmit gjatë epokës së pas sulmeve terroriste në SHBA deri në ditët e sotme.

1.5. Hipoteza dhe Pyetjet kërkimore

Në një punim doktoral janë shumë të rëndësishme pyetjet kërkimore të ngritura, me qëllim që t'i jepet përgjigje gjatë gjithë studimit nëpërmjet argumentave. Po ashtu rëndësi të veçantë në arkitekturën e studimit ka dhe hipoteza ose hipotezat në varësi të studimit dokotral. Evidentohet tashmë një intensitet i veprimit terrorist, i përqëndruar tashmë në një front të vetëm, atë kundër perëndimit, interesave të tij gjeopolitik dhe ekonomik kudo që ndodhen dhe asaj çfarë ai përfaqëson.

1.5.1. Hipotezat e studimit

Hipoteza kryesore e këtij punimi doktoral është

Lufta kundër terrorizmit mbetet vërtet një nga sfidat reale dhe të vështira me të cilat përballen shtetet dhe në menyrë të veçantë vendet anëtare të Bashkimit European dhe përpjekjet për ta minimizuar atë bien ndesh me zhvillimet e fundit teknologjike si dhe me mbështjetjen/sponsorizimin dhe njohjen e këtij fenomeni nga vete shtetet prej së cilës vijnë individët që kryejnë aktet terroriste.

Hipoteza 1

Shqipëria nuk hyn në listën e atyre shteteve që janë objekt i akteve terroriste dhe “furzinues” të mirefillte të grupeve/individëve/materialeve për kryerjen e akteve terroriste, edhe pse kohët e fundit vërehet një tendencë (minimale) në rritje.

Hipoteza 2

Aktualisht janë të përcaktuar vetëm elementët thelbësorë të terrorizmit. Një përkufizim juridik mbi aktet terroriste përsëri ende nuk mund të jepet pasi mungon dakordësia e të gjitha shteteve.

1.5.2. Pyetjet kërkimore

Lufta kundër terrorizmit zhvillohet bazuar në një strategji tashmë që ka përqsasje në teknologjitë e reja të aplikueshme. Ndikimi i kësaj teknologjie në zhvillimin e fenomenit në forma të ndryshme nga ato tradicionalet por dhe në parandalimin e tij, absolutisht që nuk mund të mohohet. Mbi këto premisa janë ngritur në këtë studim doktoral disa pyetje kërkimore të cilave kërkohet tu jepet një përgjigje.

Pyetjet kërkimore të ngritura në këtë studim janë:

1. Cili është kuptimi dhe përkufizimi juridik i akteve terroriste? A kemi arritur në një definicion unik për terrorizmin?
2. Cilat janë karakteristikat e terrorizmit? Cilët janë individët/grupet e individëve që përfshihen në terrorizëm dhe si cilësohen ata nga pikëpamja penale?
3. Cilat janë aktet juridike në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe europian që rregullojnë aspektet e luftës ndaj terrorizmit?
4. Cilat janë disa nga rastet konkrete të terrorizmit në vendet e Bashkimit Europian? Çfarë tregojnë ato?
5. Si trajtohet lufta ndaj terrorizmit në vendin tonë? A kemi një kuadër ligjor të përshtatshëm dhe bashkëkohor? A ka nevojë për rregullime dhe përmirësime të mëtejshëm të këtij legjislacioni?

1.6. Kufizimet e punimit

Kuptohet që në një punim doktoral, sidomos i kësaj natyre, ka edhe kufizime. Ato lidhen në radhë të parë me objektin e studimit. Fusha e studimit mbi terrorizmin është shumë e gjerë dhe si rrjedhojë është e vështirë të fokusohesh vetëm në disa elemente. Gjithsesi, kufizimi kryesor në këtë punim doktoral mbetet literatura. Burimet e studimit janë vetëm literaturë e huaj, pasi librat në gjuhën shqipe për këtë studim nuk ka shumë. Edhe artikuj shkencorë në këtë fushë janë të pakta. Për këtë arsye, ashtu siç u shpjegua edhe tek metodologjia, në punim jam bazuar në literaturë të huaj.

Vështirësia qëndron gjithashtu edhe në faktin se shumë studime që janë bërë mbi terrorizmin fokusohen shumë mbi fenomenin, pra nga shkencat sociale dhe shkencat humane, dhe vetëm një pjesë e tyre i trajton problemet nga pikepamja juridike. Ky ka qenë gjithashtu një kufizim tjetër që është kapërcyer gjithsesi me gjetjen e literaturës së përshtatshme.

Një kufizim tjetër në këtë punim doktoral janë rastet nga praktika. Shumë raste studimore që janë marrë në shqyrtim në punim i referohen atyre akteve terroriste që kanë ndodhur në shtetet anëtare të Bashkimit Europian. Një mundësi referimi për individët të cilët janë gjykuar nga gjykatat tona për bashkëpunim në akte terroriste nuk kam mundur t'i sjell për arsye se këto vendime nuk janë vendime të formës së prerë, pra janë ende në proces.

1.7. Përmbledhja dhe struktura e studimit

Ky punim doktoral është i artikuluar në shtatë krerë.

Kreu i parë përmban të gjithë elementët thelbësorë të kapitullit hyrës, pra rëndësinë dhe qëllimin e studimi, arsyen e përgjedhjes së temës dhe vendet e marra në analizë. Në të përfshihen gjithashtu saktësimi i metodologjisë dhe metodave të kërkimit, duke

analizuar në mënyrë përmbledhëse secilën prej tyre. Pjesë e këtij kreu janë gjithashtu hipotezat e studimit dhe pyetjet kërkimore mbi të cilat ngrihet ky studim, si dhe kufizimet e punimit, së bashku me përmbledhjen e strukturën e punimit doktoral.

Kreu i dyte trajton fenomenin e terrorizmit, një veshtrim i përgjithshëm dhe në kohë si dhe zhvillimin e konceptit të terrorizmit deri në ditët e sotme. Po ashtu në këtë kreje një vëmendje e veçantë i është kushtuar dallimit ndërmjet “terrorizmit” dhe “akteve terroriste” nga “terrori”. Pjesë e këtij kreu të dyte është edhe analiza e terrorizmit Islamik i cili ka marrë një rëndësi të veçantë në këtë dekadën e fundit; jepen karakteristikat e terrorizmit islamik, identifikimi i subjekteve potenciale që kryejnë aktet terroriste dhe sulmet vetëvrasëse. Në përfundim të këtij kreu janë dhënë edhe disa argumenta mbi bebatet bashkohore mbi aktet terroriste islamike

Kreu i tretë titullohet “Terrorizmi, kuptimi i fenomenit dhe tentativat për një përkufizim juridik unik” dhe është një nga krerët më të rëndësishëm të punimit. Fillimisht është trajtuar koncepti juridik i terrorizmit dhe është vënë theksi sidomos tek nevojat e domosdoshme të përkufizimit të terrorizmit, pasi siç dihet sidomos në kuadër të Kombeve të Bashkuara debati midis shteteve ka qenë i fortë pikërisht për kuptimin juridik dhe përkufizimin e saktë të terrorizmit dhe akteve terroriste. Në këtë kreje, sidomos është dhënë përkufizimi juridik aktual dhe i gjithëpranuar mbi terrorizmin me të gjitha elementet e tij përberës. Po ashtu në këtë kreje është trajtuar në një paragraf të veçantë dallimi ndërmjet akteve terroriste dhe akteve të dhunshme me qëllim vetëvendosjen, dallimi ndërmjet akteve terroriste dhe krimeve politike si dhe terrorizmi shtetëror. Debatet aktuale në Kombet e Bashkuara janë pjesë e këtij kreu lidhur me terrorizmin shtetësor dhe sponsorizimin që i bëjnë vetë shtetet terrorizmit. Pra, në këtë

drejtim është trajtuar edhe dallimi ndërmjet “terrorizmit shtetëror” dhe “State sponsorship of terrorism”. Në fund është sjelle edhe praktika nderkombetare.

Kreu i katërt trajton aktet nderkombetare të miratuara në gjirin e Kombeve të Bashkuara që kanë të bëjnë me aspekte të veçanta të luftës ndaj terrorizmit. Konventat nderkombetare të miratuara nga institucionet e specializuara të OKB-së, si p.sh., Konventat “Kundër rrembimit të pengjeve”, “Kundër parandalimit të krimeve, kundër personave nderkombëtarisht të mbrojtur përfshirë agjentët diplomatik”. Çështja e levizjeve çlirimtare. Konventa Nderkombetare “Për parandalimin e atentateve me eksploziv”, Konventa “Për parandalimin e financimit të terrorizmit”, Konventat me karakter Rajonal, Konventat e miratuara në Europë Konventat Rajonale që dallojnë terrorizmin nga luftrat për liri. Pjesë e këtij kapitulli është edhe trajtimi i terrorizmit në vendet e Bashkimit Europian, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë tek traktatet e BE-së dhe Strategjia Evropiane e Sigurisë dhe dokumentet publike. Ky kre përmban edhe raste praktike të aplikimit të konventave nderkombetare me fokus akte terroriste si çështja *Yunis* çështja *Georgesku* çështja *S.H.T.*, çështja *Ekanayake* etj.

Kreu i pestë trajton aspekte të veçanta të luftës kundër terrorizmit. një vështrim krahasues i kuadrit ligjor të mbrojtjes nga terrorizmi në shtete të ndryshme si për shembull siguria ndërkombëtare para dhe pas 11 shtatorit të 2001-it, koncepti i sigurisë dhe zhvillimet e tij bashkëkohore. Një pjesë e rëndësishme e punimit fokusohet tek Teknologjia që konsiderohet një aleatë e sigurisë dhe e luftës kundër terrorizmit. Po ashtu, pjesë përberëse e këtij kreu janë mekanizmat e furnizimit dhe prokurimeve, specifikimet teknike, teknologjike dhe politika industriale. Pjesa e fundit e kapitullit i dedikohet një vështrimi krahasues i kuadrit ligjor të mbrojtjes nga terrorizmi në shtete të ndryshme si SHBA-ja, Mbretëria e Spanjës etj.

Kreu i gjashte titullohet Shqipëria dhe Terrorizmi. Qellimi i këtij kapitulli është që të tregojë nëse terrorizmi është pjesë edhe e vendit tonë. Këtu është bërë trajtimi ligjor sipas të drejtës penale shqiptare, një analize e dispozitave të Kodit Penal shqiptar, cilët janë subjektet që ushtrojnë terrorizëm dhe dallimi midis këtyre të fundit dhe kriminelit politik. Është trajtuar gjithashtu depolitizimi specifik dhe i përgjithshëm i terrorizmit. Një vend të veçantë zë edhe paragrafi i parafundit që titullohet Aktet terroriste në Shqipëri, një realitet apo propagandë mediatike?. Me këtë është dashur të tregohet që vendi ynë nuk përfshihet në mënyrë të drejtpërdrejtë në akte terroriste edhe pse kohët e fundit ka një tendencë në rritje të personave që rekrutohen për në vendet myslimane me qëllim final marrjen pjesë në aktet terroriste. Në funksion të kësaj shërben edhe paragrafi i fundit i cili sjell pikërisht disa raste studimore të përfshirjes së shtetasve shqiptarë në aktet terroriste.

Kreu i shtatë përmban konkluzionet dhe rekomandimet. Në fund të këtij punimi është paraqitur literatura (Bibliografia) e cila ka shërbyer për kryerjen dhe finalizimin e këtij studimi.

KAPITULLI II: TERRORIZMI NË KËNDVESHTRIMIN HISTORIK. ZHVILLIMI I TIJ NË KOHË.

2.1. Fenomeni i terrorizmit, një vështrim i përgjithshëm dhe një udhëtim në kohë

Termi "*terrorizëm*" i jep konceptit dimensione të rëndësishme historike, që do të thotë se koncepti, në udhëtimin në kohë, ka qenë dhe do të jetë subjekt i një ridefinimi të vazhdueshëm. Lehtësia me të cilën ky term është përdorur mund të na tregojë dhe një herë se sa të brishtë janë kufijtë e tij konceptual, brenda të cilëve mund të përmblihen, natyrisht, të gjitha fenomenet autoritare ngado që ato vijnë dhe nga kushdo që ato ushtrohen. Pra, së pari, percaktimi i konceptit të terrorizmit në rrjedhën e tij historike dhe, së dyti, kufijtë konceptual të tij, bëjnë paraprakisht të pamundur çdo përpjekje për një përkufizim të veçantë që aspirojmë të arrijmë². Pra, këtu qëndron vështirësia e parë për përdorimin e termit "terrorizëm" në ligjin penal që kërkon sa më pak të jetë e mundur, kushte të ndjeshëm ndaj vlerësimeve kontradiktore, nga ana zbatuesit të tij³. Nëse, natyrisht, termat si "terrorizëm" nuk do të mund të pranoheshin nga rregullimi ligjor penal (*nëse nuk qartësohej*), të parashikohej si vepër penale, kjo nuk do të thoshte se do të ishin automatikisht të përjashtuara nga interesi i shkencës penale. Nga momenti që, në zhvillimin e një praktike të veçantë agresore, çënohen të drejta dhe liri të njeriut, është e natyrshme që të kërkohej nga shkenca penale, ekzistenca ose jo e kritereve të qëndrueshëm të kësaj sjelljeje "penale" që përbëjnë, për fillimet e tij, një krim të ri, ose një tip të ri veprash penale ose një formë e re e ndaluar e organizatave të reja (*përveç atyre të neneve 333 dhe 333/a të Kodit Penal*) etj. Por cilat nga të gjitha veprat penale, që

²G.Paschos në përpjekje përjasheje me një pasqyrë hyrëse të fenomenit të autoritarizmit shtetëror, vëren: "Konceptet në të cilat kondensohet një proces historik i gjerë, shumë kompleks dhe kontradiktor, nuk është mundur që të përkufizohen përfundimisht në një term letrar të qartë dhe përmbledhës." "Autoritarizmi Shtetëror", fq.1.

³ Këtë vlerësim nuk e pranon ligjvënësi shqiptar, kur bën fjalë për vepra me qëllime terroriste në nenin 230 të K.Penal.

klasifikohen aktualisht me këtë term, zgjidhen si "*terrorizëm*"? Nga studimi i fenomenit "*terrorizëm*" në dimensionet historike (*natyrisht në fazat kryesore, për shkak se një rekord i detajuar historik do të zhvendoste objektin e kësaj teze*), do të nxireshin në dritë ata elementë që do të mund të përshkruanin me korrektesë dhe që do të bazonin propozimin për vlerësimin e tij nga pikëpamja e interesit të shkencës penale. Cila është pika historike e startimit të terrorizmit, si mund që të arrihet vija ndarëse si një kufi vizual në kohë që do të lejojë studimin e rrugëtimit të fenomenit në kohë dhe të transformimeve të njëpasnjëshme brenda kontekstit historik?

Kuptimi fillestar i termit të *con* në Revolucionin Francez të shekullit të 18-të, si vijën kufitare të kërkuar (T.M. Thomson, 1975:105)⁴. Termat "terror", "terrorizëm" janë përdorur për herë të parë në debatin politik të kohës⁵. Përhapja e "terrorit" në vitet 1792-1796 në forma të ndryshme, e lehtëson përkufizimin konceptual të fenomenit politik të "terrorizmit", krahasuar me fenomene të ngjashme (*lufta guerile urbane dhe e zonave rurale, reagimet arrogante të fituesit në një luftë, reagimet masive popullore etj*). Bëhet fjalë kryesisht për terrorin që përhap një pjesë e turmës revolucionare në Paris kundër përkrahësve të burgosur dhe përfaqësuesve të regjimit të mëparshëm (*ancien regime*), me inkurajimin dhe pjesëmarrjen e matur të grupimit politik që për disa muaj do të merrte në duart e tij pushtetin (*Jakobinët*) gjithashtu dhe për dy fazat e "terrorizmit

⁴Vihet re këtu se historiografia e caktuar ka krijuar një tendencë për të mos marrë parasysh faktin e padiskutueshem dhe paradoksal se "nena" "e demokracisë borgjeze (të drejtat e njeriut, parlamentarizëm etj) është, si ne France dhe ne Angli, terrorizmi. Do të mund të studiohej shembulli anglez, si i mëparshëm, por perzgjidhet francezi pasi dhe shtrirja e fenomenit të terrorizmit ishte e tillë, gjithashtu dhe kompleksiteti që njohu e bëjne me përfaqësues të denjë për objektin e këtij artikulli.

⁵Nuk janë me shumë historianët e mëvonëshëm që me këtë term perceptuan dhe reflektuan mbi segmente të vecanta të revolucionit, se sa vete protagonistet e tij. Si shembull paraqes këtu në një ekstrakt nga fjalimi i Robespierre në Konvencionale të 1794/05/02: "Në qoftë se baza legjitimuese e një qeverie popullore në kohë paqeje është virtyti, gjatë revolucionit është njëkohësisht edhe virtyti edhe terrori. "Virtyti pa të cilin terrori është shkatërrimtar, terrori pa të cilin virtyti është i pafuqishëm." Shih. në lidhje me këtë argument T.M. Thomson, Rovespierre dhe Revolucionin Francez ", Botimet Galaxy, Athinë 1975, fq. 105.

shtetëror", si u quajt më vonë terrori i regjimit, dhe në fund, ushtrimi i qëllimshëm i terrorit nga lëvizja që u quajt "*Komploti i të barabartëve*" (Babeuf-Bouonarotti). Sigurisht, terrorizmi i periudhës së Revolucionit Francez, periudhës 1970-1980, terrorizmi pas sulmeve të 11 shtatorit, përfaqëson teorike dhe përballja ligjore e të cilit na intereson, i përketin periudhave të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë dhe për këtë arsye çdo analogji do të ishte e gabuar. Nuk mund të mos merret parasysh se me revolucionin francez u inagurua sidoqofte një qasje e re për proceset dhe sjelljet sociale dhe politike, të kohës⁶, (psh. te feja ose në disa virtyte), Por, besimet fetare nuk janë më të pranueshme si bazë legjitimuese dhe pikë startimi i diskursit dhe veprimit politik (Lutaud; 1973). Kështu, lokalizimin e kufirit kohor për studimin e fenomenit që na intereson, në shekullin e 18-të, dhe më konkretisht në revolucionin Francez, behet në përpjekje për të tërhequr përmes historikut të konceptit të dhëna dhe elementë të dobishëm për të mundësuar përfaqësim me realitetin (I. Manoledaki;1980, 76).

⁶Shih mendime të ngjashme, të I. Manoledaki, "Hyrje në Shkencë", Observer 1980, fq. 76, A. Manidakis, "Marksizmi dhe e Drejta", ribotim i " O Politis ", Athinë 1978, fq.12. .Papachristou, "Marksizmi dhe e Drejta", Observer, 1984, fq. 56, A. Rolin, , "Les infractions politiques" R.D.I. 1883, fq. 421-422, A. Capt, "Les crimes politiques", B.U.R.S, 1924, fq. 260. Karakteristike për atë që është mbështetur këtu, është referenca te monarkët e shekullit të 16-të. Bazë legjitimore p.sh. për vrasjen e një tirani, ofronte dogma fetare dhe kështu diskursi ligjor dhe politik kërkonte prova për të legjitimuar marrëdhëniet ndërmjet mësimëve të fesë së krishterë dhe të veprës penale që shprehte "Të drejtën hyjnore" (TOC O. Jaque Clément që ekzekuton Henri III-të, pretendonte një vizion në të cilën Perëndia e urdhëron për të kryer vrasjen dhe ndërkohë shumë ndjekes e pranojnë legjitimitimin e aktit të tij dhe e shenjtërojnë atë. Shih te L.Proal, "La criminalité politique", F. Alcan, Paris 1908, fq . 31-34). Karakteristike janë ato cfare mbështeten nga La Boetie ("Discours sur la servituti volontaire", Bossard, Paris 1922, fq. 102), për "ndëshkime të veçanta që rezervon Zoti për tiranët". Shih gjithashtu Lutaud"De révolutions d'Angleterre a la révolution française" A Martimus Nijhoff, La Haye 1973, C. Dispot.. Sigurisht ky nuk është një diferencim i papritur, nga revolucioni, ndryshimi i procedurave të legjitimitetit të fjalës dhe operacionit politik. Proceset teorike dhe praktike kishin nisur (shih. G.Pasko, "Demokracia politike dhe pushteti social. Parimi demokratik dhe legjitimiteti politik" Observer 1979, fq. 165-173).

Historiografia e zgjedhur mbulon një gamë të madhe të qëndrimeve ndaj ngjarjeve të Revolucionit Francez dhe përzgjedhja është bërë mbi fakte dhe konsiderata sipas nevojave të kësaj teze⁷.

2.2. Zhvillimi i konceptit të terrorizmit deri në ditët e sotme

Koncepti i terrorizmit, sic u përmend, i detyrohet shumë Jakobinëve gjatë Revolucionit Francez. Terrorizmi i Jakobinëve⁸ (1793-1794) starton në kohën e revolucionit me largimin e drejtuesve të fraksionit Giron me marrëveshjen konvencionale (1793/06/02) dhe duke përfunduar me arrestimin e Robespierre nga anëtarët e Thermidor 9-të (1794/07/27). Analiza mund të përmblihet si më poshtë: në radhë të parë zgjedhja e dhunës si një mjet për të krijuar kushte që do të lejojnë funksionimin e asaj që përcaktohet, në terma politik të shekullit të 20-të, *'ndërhyrja e shtetit në sferën⁹ e shoqërisë civile'* (A. Manitakis, 1981, 155) së dyti, për të adresuar

⁷ Ka një sere autoresh që e kanë trajtuar kete fenomen. Ketu mund te permendim T. M. Thompson, A. Moroua, "Historia e Francës", bot. Icarus 1956, fq.96-99, G. Michelle, "Historia e Revolucionit Francez ", 4 vëllime, bot. ESTIA, Athinë 1969. Michelet shkroi historinë e revolucionit francez në 1847-1853. Ai kishte mundësi të përfshinte materiale të përpunuara dhe një numër të dëshmimeve të personave të cilët kishin një pjesëmarrje aktive në ngjarjet e viteve 1789-1794. A. Soboul, "Les sans-culottes parisiens en l'an II" Seuil" 1968. Në faqet 5-21 pasqyrohet një listë e pasur literature. Në debatin për "L'Héritage Jacobin" në revistën Le Débat, nr. 13 e vitit 1981, GALLIMARD. Gjithashtu M. Ozouf, "Fortune et infortune d'un mot", fq. 28-39, F. Furet, " La Revolution sans la Terreur ", fq. 40-54, me një paraqitje të rëndësishme të historiografisë referuar Jakobinëve, M. Agulhon, " Plaidoyer pmar lesjacobins ", fq. 55-65. Shih gjithashtu D. Guerin, "La Revolution française et nous", Maspero 1976, dhe "La lutte des classes", 1945, G. Lefevre, "La revolution française", PUF. 1368, F. Furet et D. Richelet, "La revolution française", marabut 1973, P.Gaxotte, "La revolution française", Librairie Arthème Fayond 1928, M. Dommaget, "La magji des égaux", Spartacos, tetor-nëntor 1964. Pjesë nga artikujt e Babeuf në gazetën e tij "Tribun du peuple" në botim të Union Générale des editions.

⁸ Për këtë periudhë shiko analizën e B.Moore, me titull "Pasojat sociale të revolucionit terrorist". Revolucionit Francez (1789-1799).

⁹ Një ndërhyrje e tillë zbatohet duke vendosur "çmim shitjeje maksimal të produkteve (maximum i famshëm), me çmime uniformë në të gjithë vendin dhe në fund të masave të kufizimit të pronësisë me anë të konfiskimit të pasurisë së fisnikëve në largim nga Franca (emigrantët) dhe shtetëzimi i pronës së kishës. Këto masa të zbatuara kundër pasurisë ishin të avancuara për kohën e tyre, dhe promovonin konceptin e kufizimit të pronës, mbështetur nëpërmjet teorisë dhe shkrimeve të J. J. Rousseau (Shih. "Kontrata sociale" , botimet Darius 1957). Në kundërshtim me perceptimin që lartësonte pronën private, Robespieri

nevojat e luftës që ishte duke u transformuar dhe zhvilluar paralelisht në një luftë civile dhe kërkoi me ngulm zgjimin e shpejtë të ndërgjegjes kombëtare të udhëheqjes së jakobinëve, dhe në fund, rreziku i kundër-revolucionit dhe nevojën për të konsoliduar një *pikë pa kthim*¹⁰. Karakteristike e kësaj periudhe të Revolucionit Francez ishin: a) ekzekutivi (Comité de Salut Public), i cili ushtronte në një farë mase funksione kryeministore nga Robespierre, ishte ai që vendosi drejtimin që do të ndiqte terrorizmi; b) mekanizmi shtetëror ishte i ngarkuar dhe realizonte zbatimin e vendimeve të ekzekutivit; c) Gjyqësori ishte në një linjë me pushtetin dhe miratonte vendimet e ekzekutivit. Gjykata kompetente për "krimet e ndjekësve të tiranisë" që u kthyen "kundër lirisë" së popullit francez, siç përcaktohet nga "ligji i të dyshuarve" të 17 shtatorit 1793, ishte Gjykata Revolucionare, e cila kishte seli në Paris, e ndarë në katër seksione. Në pjesën tjetër të vendit juridiksion kishin gjykatat penale që formoheshin si "revolucionare", ndërsa për zonat e luftës civile ishin kompetente "komisionet ushtarake" përkatëse.

"Krimet ekonomike" ishin objekt, në parim, i juridiksionit të Gjykatës Revolucionare, por në qoftë se pas hetimit të personalitetit të të akuzuarit gjendej se kishin të ngjarë të ishin të akuzuarit dhe kundërshtarë të revolucionit, atëherë, klasifikimi i tyre si "mbështetës të tiranisë" përthithnin krimet ekonomike dhe për këtë arsye, hynin brenda juridiksionit të Gjykatës Revolucionare. Një fenomen i ngjashëm i njëhësimit të krimit politik me atë ekonomik duket se u shfaq dhe në Bashkimin Sovjetik pas vitit 1918. Duket se ky identifikim është rezultat i përpjekjeve të fuqive revolucionare për të imponuar marrëdhënie të reja në sektorin e prodhimit (Erneud, 1925: 1925). Nëse shtohet këtu, me një kthesë përsëri në Francë, se për "krimet e

besonte se "... është e drejtë e çdo qytetari për të disponuar lirisht këtë pjesë të të mirave ligjore të garantuara me ligj", shih Michelet, vol.3, fq. 441-442.

¹⁰ "Point sans retour".

ndjekësve të tiranisë " me ligjin për Gjykatën Revolucionare, u përjashtua procesi hetimor, është e qartë se përse i përket rivalëve kryesorë të pushtetit politik, procesi para Gjykatës Revolucionare ishte pothuajse formal. Me nenin 13 të këtij ligji përcaktohet se ishte e mundur, me vendim të jurisë, të mos dëgjohen dëshmitarët dhe me nenin 16 nuk lejohet avokati mbrojtës i të akuzuarit, me arsyetimin se mjaftonte juria. Së fundi në qoftë se Gjykata Revolucionare e gjente të pandehurin fajtor, kishte vetëm një lloj dënimi për të, ai me vdekje. Megjithatë nuk duhet harruar se Gjykata Revolucionare kishte dhënë dhe një seri vendimesh pafajësie, gjë që të lë përshtypjen-shijen e dyshimit për imponimin e terrorit nga Jakobinët. Sipas *F. Furet* dhe *D. Richet*, Gjykata Revolucionare në muajt Maj - shtator 1793, liroi si të pafajshëm 194 të akuzuar dhe dënoi me vdekje 66 , ndërsa në muajt në tetor-dhjetor 1793 dha 176 dënime me vdekje dhe 19 vendime pafajësie. Gjatë Revolucionit Francez u zhvilluan në praktikë, hapat e parë të parlamentarizmit. Grupimet ishin thjesht vende ku mblidheshin ata që ndanin ide dhe pikëpamje politike të njëjta. Vetë Konvencionalja nuk operonte me një shumicë dhe pakicë të qëndrueshme. Nuk ekzistonin aleatë të fuqishëm. Çdo deputet (përfaqësues) i aftë, ishte në gjendje, herë pas here, të bëhej në një fazë, dhe rregullator kryesor i zhvillimeve politike. Si pasojë, ushtrimi i politikës qendrore ishte një çështje me përmasa dhe larmi të pafundme. Në qoftë se shtohet, nga njëra anë rrëzimi nga fronti i monarkun deri në formimin e Komitetit të Shpëtimit Publik ishte krijuar një "vakum" pushteti dhe fakti se Franca ishte në luftë, atëherë bëhet e qartë se pse u zgjodh dhe u projektua terrorizmi si e vetmja praktikë efiçente (sipas vlerësimit politik) politike. Por të gjitha arsyet historike që çuan në zgjedhjen e terrorizmit nuk mund të, mendoj se, justifikojne qëndrimin e Jakobinëve në këtë drejtim, imponimin me forcë, sa herë të kërkohej, i politikës së centralizuar ekonomike dhe sundimi autoritar i shtetasve, e

kombinuar me një politikë të pjesëmarrjes popullore. Populli, më parë në rolin e kritikut të drejtëpërdrejtë dhe faktorit rregullator e të zhvillimeve politike, tani spostohet në periferi të zhvillimeve dhe vendimarrjes, duke u shndërruar fjala e tij në një "opinion publik". Megjithatë, pjesëmarrja e tij ishte e nevojshme, kur duheshin materializuar në praktikë konceptime të Jakobinëve shumë vite më vonë, të tilla si arsimi publik, siguria sociale, vota e lirë. Pra, duke përjashtuar qytetarët francezë nga procesi politik, me asimilimin e të gjithë kundërshtarëve të Revolucionit dhe identifikimin me armikun e jashtëm, pushteti, në thelb, nuk mori në konsideratë zhvillimet politike si fillesat e një lufte politike brenda marrëdhënieve të veçanta të pushtetit, por duke ruajtur derivativin si ekskluzivitet të saj, i përshpejtoi ato duke përdorur instrumentin kryesor politik, atë të terrorizmit. Ushtrimi i terrorit ishte si duket një praktikë politike që siguronte tek pushteti ekzekutiv që ushtronte autoritet shtetëror, miratimin nga populli¹¹.

Po ashtu, një akt terrorizmi mund të kryhet në kontekstin e një lufte dhe mund të konsiderohet një shkelje e rëndë e ligjeve të luftës, si në rastet e krimeve të luftës gjatë Luftës së Dytë Botërore, apo të krimeve të luftës të kryera gjatë luftërave në ish-Jugosllavi. Koncepti i terrorizmit dhe si pasojë i grupit terrorist dhe aktit terrorist aktualisht nuk është mundur deri më sot për të përkufizohet me qartësi.

Në Bashkimin Evropian aktualisht jetojnë rreth 10 milionë myslimanë. Prej tyre në Francë jetojnë 5(pesë) milionë, në Britani të Madhe rreth 1.6 milionë, në Gjermani rreth 3.2 milionë, etj . Pas një të kaluarë të tillë historike, në të cilën kishte humbje dhe fitore, e sidomos pas vendosjes së protektorateve evropiane mbi shtetet e ndryshme

¹¹Kur ne flasim për grupime politike të asaj kohe, do të ishte gabim ti krahasojmë me formacionet moderne politike (partitë-sindikatat-shoqatat). Shih G .Pashos "Demokracia politike"1972. Pra, duke përjashtuar qytetarët francezë nga procesi politik, me asimilimin e të gjithë kundërshtarëve të Revolucionit dhe identifikimin me armikun e jashtëm, pushteti, në thelb, nuk mori në konsideratë zhvillimet politike si fillesat e një lufte politike brenda marrëdhënieve të veçanta të pushtetit, por duke ruajtur derivativin si ekskluzivitetin të saj, i përshpejtoi ato duke përdorur Instrumentin kryesor politik të terrorizmit.

muslimane, në tërë botën muslimane ishin paraqitur dy rryma politike, të cilat propagandonin kundër gjendjes së mjerë dhe poshtëruese në të cilën ishte katandisur populli arab dhe përgjithësisht ai musliman: Rryma e parë e përfaqësonte idenë e nacionalizmit arab propagandonte bashkimin e të gjithë popujve arabë në një shtet të ri dhe modern. Kjo ide u propagandua me zell nga ish-kryetari i Egjiptit Naser dhe nga disa qarqe zyrtare siriane dhe irakiane. Rryma e dytë ishte propaganduar nga *Vëllazërimi Mysliman* dhe disa organizata të tjera fundamentaliste islamike, të cilat e kishin refuzuar idenë panarabe madje edhe duke i akuzuar përfaqësuesit e saj si heretikë dhe në vend të saj kishin propaganduar mitin dhe ëndrrat e vjetra muslimane për bashkimin e të gjitha tokave të tyre në një shtet, i cili do të organizohet sipas parimeve fetare. Këto rryma politike në të gjitha shtetet muslimane kishin filluar të zhvillonin një propagandë të fuqishme kundër familjeve mbretërore arabe dhe shahut të Iranit, të cilat akuzoheshin për ligësi e tradhti kombëtare dhe fetare. Në rrethana të caktuara të jetës shoqërore, në të gjitha komunitetet njerëzore, që nga historia e lashtë dhe mitologjitë¹², madje dhe shkrimeve fetare kristiane, janë paraqitur gjithmonë njerëz të gatshëm për kryerjen e sulmeve vetëvrasëse ose si paraqiten në libra letrare dhe historikë si heronj që u sakrifikuan, sakrifikuan bijtë e tyre, sakrifikuan jetën e tyre ose tentuan të ndërmarrin këte akt etj. Në të kaluarën shqiptare kishte shumë raste të vdekjeve të heronjve me vetësakrifikim për një qëllim më të lartë si, p.sh., në historinë e re, rasti i Vojo Kushit

¹² Në kohën kur Zeusi ngritet kundër Titanit Kron për të vendosur rendin e ri, Titanët mbrojnë pushtetin e vjetër të Kronit, por Prometheu renditet në anën e Zeusit, ndonëse edhe vetë ka qenë Titan, sepse synonte rendin e ri dhe të drejtë të botës. Zeusin e ndihmoi me këshilla dhe me pjesëmarrje në luftë, po ashtu nxiste edhe hyjneshën e tokës, Gea, që t'i bashkohej Zeusit. Kur pas luftës së rëndë dhjetëvjeçare Zeusi fitoi, ndër të tjera edhe me ndihmën e tij, Prometheut nuk ia mbajti fjalën. Mirëpo, kjo Prometheun nuk e pengoi dhe as e frikësoi të bënte atë që besonte. Prej Zeusit ndahet pikërisht atëherë kur zoti suprem filloi që në mënyrë mbrutale e të vrazhdët ta përforcojë pushtetin e vet. U nda prej tij më vonë kur Zeusi vendosi që ta shfarosë racen e njerëzimit. Prometheu i ka dashur njerëzit dhe përpos kësaj i simpatizonte të dobtit dhe kështu vendosi që t'i shpëtojë me çdo kusht, madje edhe kur me këtë kundër vetes do ta nxiste edhe zemërimin e zotit suprem dhe do ta conte drejt një vdekje të sigurt dhe me shumë vuajtje.

etj. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, pilotët e aviacionit Japonez, kryenin sulme vetëvrasëse kundër objektivave amerikane dhe angleze dhe për këtë akt heroik ata quheshin si heronj të popullit. Gjatë viteve '70, taktikën e sulmeve vetëvrasëse kishin filluar ta përdornin edhe Armata Republikane Irlandeze dhe Tigrat Tamilë të Sri-Lankës. Gjithashtu edhe disa udhëheqës të Fraksionit të Armatës së Kuqe gjermane, e kishin zbatuar vetëvrasjen, si mjet të veprimit të tyre politik¹³.

2.3. Dallimi i „terrorizmit“ dhe „akteve terroriste“ nga „terrori“

Përpara se të arrijmë në një analizë të akteve terroriste dhe terrorizmit ilamik si dhe karakteristikat e tij, mendoj se është e nevojshme në këtë pikë të ndalemi tek dallimi që ekziston ndërmjet *terrorizmit* dhe *akteve terroriste* dhe *terrorit*.

Përgjithësisht në qarqe të ndryshme këto emra përdoren si sinonim i njëra tjetërës, por në kuptimin juridik duhet medoemos të bëjme këtë dallim. Duhet që në fillim të sqarohet së gjatë procesit të përqsjes të konceptit të terrorizmit kupton gjithkush, përveç vështirësive që vetë ky koncept përmban, dhe vështirësitë që rezultojnë nga përdorimi shpesh arbitrar dhe të pakujdesshëm i këtij termi (Nigro, 2005:25). Vërtetë, përdorim i përditshëm gazetaresk dhe politik i termit "terrorizëm", nuk ka si një pikë referimi, ose të paktën disa sqarime specifike, përkundrazi, me këtë përgjithësim dhe abstrakt, gazetaria dhe diskursi aktual politik, përkufizon një sërë aktesh, politike dhe jo vetëm, që dhe pse nuk kanë në përbërje të tyre elementë vepre penale (*nuk konsiderohen krime nga Kodi Penal*) në kuptimin e standardeve në ligjet penale) janë përsëri absolutisht të "padrejtë". Përmendet shpesh në shtypin e shkruar dhe viziv për

¹³Shtabi i Komandës së Përgjithshme Gjermane themeloi njësitin ushtarak Vetëflijimi. Anëtarë të këtij njësitit special ishin kryesisht oficerët e aviacionit gjerman, të cilët përgatiteshin për të ndërmarrë aksione vetëvrasëse kundër pozicioneve të caktuara ushtarake të forcave aleate. Burimi <http://www.uni.protokolle.de/Lexikon/Selbstmordattentat.html>, aksesuar ne date 4.11.2014.

"Terrorizmin" e udhëheqjes së çdo formacion politik ndaj të tjerëve apo edhe kundrejt anëtarëve të vet, terrorizmin e shkaktuar nga rritja e kriminalitetit në zonat urbane, terrorizmin ose narkoterrorizmin, si u përmend në rastin e sulmit me armë me pasojë vdekjen e një efektivit të Policisë së Shtetit në Qershor 2015, terrorizmin e "Brigadave të Kuqe", sjellja terroriste e disa oficerëve të vartësit të tyre, sjellja terroriste e punëdhënësit të punonjësit, sjellja terroriste e huliganeve në një stadium, në Greqi psh në periudhën 1967-1974, kur diktatura kishte karakterizuar si "terroriste" të gjitha praktikatat politike kundër saj, pavarësisht se kush i ushtronte dhe formës në të cilën shfaqeshin (P-Mathy 1974: 53)¹⁴. Përdoret pa kriter termi terrorizëm, që gjithsesi konceptualisht është shumë i diskutuar dhe përmban elementë perceptues negativ, dhe ndonjë herë bëhet për të karakterizuar veprimet autoritare të ndonjë kundërshtari ose jo politik duke lindur nevojën e domosdoshme për një përkufizim konceptual të "terrorizmit", sa kjo është e mundur (G.Paraskos,1983, 1)¹⁵.

Ngjarjet që çuan ligjvënësin kombëtar dhe organizatat ndërkombëtare në zhveshjen fenomenit të "terrorizmit" nga ndonjë element politik, nga dimensionet e tij historik dhe madje edhe dimensionet morale¹⁶ në mënyrë që të arrihet një mbrojtje

¹⁴ Në mbledhjen e U.L.B. me temë "Reflexions sur la definition du terrorisme", Bruksel 1974, Person.P-Mathy ("Formes nouvelles de la lutte- révolutionnaire et cooperation internationale dans le combat contre.révolutionnaire", fq. 53), shpjegon përdorimin e shpeshtë të termit në dëshirën e pushtetit ekzekutiv të shteteve, atëherë, të minimizojnë deri në zhdukje, të influencës së organizatave që në atë kohë i kundërviheshin politikave aktuale dhe rendit ligjor, duke bërë krahasime dhe me epokën e Luftës së Ftohtë, gjatë së cilës bëhej një përdorim i njëjtë abuziv dhe me termin, ose më saktë më ideologjinë komuniste, gjë që për këtë të fundit vazhdon edhe sot, pikërisht pa shkuar shumë larg, vec të shohim në vendin tonë se si termi ose fjala "komunizëm" anatemohet nga të gjitha palët politike si të jetë një fjalë e ndaluar.

¹⁵ Mbi të njëjtën problematikë, analizon dhe G.Paraskos, në përpjekjen e tij të përqsë fenomenin e përngjashëm të autoritarizmit shtetëror "Në politikën aktuale" dhe vecanërisht në propagandën partiake. Përkufizohet si autoritarizëm shtetëror një sërë konceptesh, perceptimesh e praktikash, fashizmi, diktaturat ushtarake, ndalimi me dhunë i tubimeve etj. Shiko "Autoritarizmi shtetëror në shoqëritë moderne", ribotim nga Trajnimi Modern, 1983, fq. 1.

¹⁶ Kujtojmë këtu thënien "Terrorizmi në asnjë rast nuk justifikohet", të Rezolutës me titull "Për luftën kundër terrorizmit", EEC 276, e datës 11.10.1982, fq 4.

efektive ndaj tij, janë të shumta. Natyrisht, paraqitja kritike e teksteve legislative të ndërmarra në kohë, dhe analiza e studimeve të cilat pasojnë aktet ligjore dhe marrveshjet kontraktuale, lejon që të arrijmë në përfundimin se kjo "zhveshje" politike nga elementët e lartpërmendur nuk ishte ndonjë produkt specifik i studimeve të karakterit social-politik ose historik¹⁷. Mendimi, që logjikisht pason, se që në vend të rezultatit të studimeve të shkencave të sociologjisë dhe shkencës politike, ligjvënësi kombëtar dhe ai ndërkombëtar, ka marrë parasysh vullnetin mbizotërues politik, bën të nevojshëm kërkimin e korrelacionit të rregullimeve ligjore specifike me realitetin social-politik, duke bërë gjithashtu të nevojshëm për këtë tezë, analizën që vijon. Së fundi, edhe në rastin e largimit nga logjika apo parametrat specifikë të legjislacionit të miratuar tashmë, një analizë e tillë është e domosdoshme për të gjithë që duan të eksplorojnë marrëdhëniet mes politikës dhe këtij fenomeni të krimit, tashmë, të "terrorizmit" në dimensionin penal të tij. Termat "terreur", "terrorisme" nxjerrin origjinën e tyre, si terma dhe nocione të politikës, gjatë Revolucionit Francez të shekullit të 18-të. Termi "terrorisire" është përdorur më parë nga Jakobinët, udhëheqësit e periudhës 1793-1794 dhe te ata gjendet në një farë mënyre dhe autorësia si dhe

¹⁷Kjo pikëpamje, për mungesën, e përputhjeve të mendimeve mbi dimensionet social-politike të fenomenit "terrorizëm", ka qenë shpesh e argumentuar në teorinë e së drejtës penale në vendet e BE-së, shih në Greqi p.sh. C.A. Magkaki, " Interpretim i ligjit 744 / 1978 "Mbi luftën kundër terrorizmit dhe mbrojtjen e demokracisë," Nr.B.,fq.1018, i cili thekson: "Koncepti i terrorizmit dhe si pasojë i grupit terrorist dhe aktit terrorist nuk është mundur deri më sot për të përkufizohet me qartësi të tillë, që të mos çënojë kufirin kushtetues të "papërcaktimit të një veprë penale-aoristias", dhe ndërkohë që ne të gjithë bashkë përkufizojmë me këtë term një fenomen kriminal të shoqërisë bashkëkohore, dhe e dallojmë në mendimet dhe analizat tona nga format e tjera të sjelljes kriminale, nuk është arritur deri në tani të përcaktohet me përafërsi përmbajtja semantike, kështu të përcaktohet dhe diferenca cilësore, e cila përcakton kufijtë konceptuale nga krimet e tjera ". Shih gjithashtu P. Mertens "L "introuvable" Acte de terrorizmit ", fq.32, ku duke iu referuar paqartësive konceptuale të termit "terrorizëm", e karakterizon si problematikë e vazhdueshme e legjislacionit...", dhe E. Davidit "Le terrorizmit en droit international", fq. 125-129, ku janë cituar dhe marrveshjet që bëjnë përdorim të termit "terrorizëm" dhe që duan të provojnë integrimin me shabllon në tekstet ligjore.

përdorimi i mëvonshëm në fjalorin politik¹⁸. Historiku i termit "terrorisme" imponohet në gjuhët evropiane të cilat kanë shprehjen e tyre përkatëse për të ilustruar atë kuptim si mësipër. Sigurisht gjuhët latine kanë një rrënjë të përbashkët. Në latinishte termi "terror" nuk është i lidhur me terminologjinë politike, por reflekton gjendjen e veçantë psikologjike dhe kjo shpjegon ngjashmërinë e fjalëve "terrorisme", "terrorism", "terrorismo" (Servier, 1974, 4). Por në gjermanishten, edhe pse kjo përfaqësohet nga fjalët *furcht* (frikë) dhe *schrecken* (terror), përdoret termi "terrorismus", gjë që nënkupton qartë se termi me historinë e tij etimologjike iu imponua asaj gjuhësore¹⁹. Në gjuhën greke, së paku në fjalorin zyrtar politik, termi nuk u mirëmbajt në etimologjinë e tij historike, por u përzgjodh për të përkufizuar fenomenin e "terrorizmit", si një term i cili në mënyrë të qartë nuk shpreh vetëm një gjendje psikologjike (*të tilla si "frikësoj", "tremb", kërcënoj*), por edhe diçka më shumë, një element subjektiv, një qëllim, një strategji (*nga ai që e ushtron*), që zbaton përmes terrorit (*imponim me anë të terrorit, dominimi përmes terrorit*).

Teorori ne nje kuptim me te gjere dhe bashkekohor eshte nje dhune me qellime politike qe ushtrohet kunder objektivave civile (jo ushtarake).

Ndërsa në Shqipëri, për termin "terrorizëm" fillimisht i referohem fjalorit shqip-shqip të Akademisë së Shkencave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, botim i vitit 1980, dhe ai definohej si "Zbatimi i dhunës së egër e të

¹⁸ Për herë të parë termi "terror", jo si nocion politik, gjendet i shkruar në një shkrim të shekullit të 14-të, të murgut Bercheure ose Bersuire. Shiko P.Wurth. La repression internationale du terrorisme, tezë doktorature, Imprimerie La Concorde, Lozan 1941, fq. 11.

¹⁹ Për këto komente etimologjike shiko L.Dispot, "La machine aterreur", Grasset-Fasquelle, Paris 1978, fq. 18-19. Një tjetër argument i përdorur nga Dispot për të provuar origjinën e termit tashmë politik, "terrorizëm" është fraza e Balzac në veprën e tij "paysans Les", ku duke përdorur "foljen" enterrorisant "unmotdutemps" lë të kuptohet se kjo është një neologjizëm. Shih gjithashtu për etimologjinë e termit Universalis, "Le terrorisme", J. Servier, "Leterrorisme", PUF, Paris 1979, fq. 4, dhe R.Gaucher, "Lesterroristes", Albin Michel, Paris, fq. 11.

pamëshirshme nga një regjim shtypës ose nga një organizatë reaksionare e kundërevolucionare ndaj popullit e ndaj kundërshtarëve të vet politikë, që arrin deri në asgjësimin fizik të tyre”. Kështu, përcaktohet akti terrorist si nocion i politikës së atëhershme, kurse në ditët e sotme, ky përkufizim jepet nga ligjvënësi penal, pikërisht në nenin 230 të Kodit Penal. Në këtë nen përkufizohet akti terrorist si: *Kryerja e veprave të mëposhtme, me qëllim përhapjen e panikut në popullatë ose për të detyruar organe shtetërore, shqiptare ose të huaja, të kryejnë ose të mos kryejnë një akt të caktuar, ose për të shkatërruar apo destabilizuar, në mënyrë serioze, struktura thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të shtetit shqiptar, të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare..*”. Më tej, ligjvënësi, pasi ka konsoliduar motivin e veprës penale të terrorizmit, në paragrafin e dytë të nenit, përkufizon dhe saktëson ato të mira ligjore dhe liri themeltare të cilat n.q.s., çënohen me qëllimin e identifikuar më lart, akti çënues konsiderohet si akt terrorist.

2.4. Terrorizmi Islamik

Shumë është përfolur e diskutuar mbi ekzistencën e terrorizmit islamik. A ekziston vërtet terrorizmi islamik apo abuzohet me nocionin në fjalë? A janë të bazuara lëvizjet e ndryshme terroriste në ideologjinë fetare islamike? A mund të identifikohet feja islame, si një fe që nxit dhunën dhe përhap terror?

Përgjigja e pyetjeve të parashtruara më lart është vërtet problematike por që imponohet vetvetiu, dhe si rrjedhojë filloi të diskutohej me një farë intensiteti më të lartë që nga koha kur grupi i studentëve iranianë sulmoi dhe për 14 muaj mbajti të

pushtuar Ambasadën Amerikane në Teheran.²⁰ Përgjigjet e këtyre pyetjeve janë të ndryshme dhe përgjigjet larmojnë përgjithësisht nga orientimi ideologjik i autorëve. Në këtë kontekst, politikanët dhe intelektualët e ndryshëm myslimanë kanë hedhur edhe idenë e një diskutimi të përbashkët lidhur me raportin e fesë islame me terrorizmin. Sipas tyre, konstatimi i njëanshëm i ekzistencës të “terrorizmit islamik”, ashtu si pranohet nga disa ideologë, politikanë e të tjerë, përëndimorë, për botën islame është jo vetëm i papranuar, por qëllimisht tendencioz dhe fyes.

Nga ana tjetër, autorë të ndryshëm përëndimorë e sidomos ata me origjinë izraelite, me shkrimet dhe diskutimet e tyre të shumta, janë përpjekur të identifikojnë terrorizmin e disa grupeve me përkatësinë etnike të këtyre të fundit që përkon realisht me kulturën dhe fenë islame. Në këtë drejtim, ata duke ofruar edhe shembuj të ndryshëm praktikë, kanë konstatuar se çdo politikë e bazuar në ideologjinë fetare islamike detyrimisht do të rezultojë me dhunë fizike dhe terror. Këtu, pa mbështetur as njërën dhe as tjetrën palë, përmend një shkrim të filozofit më të madh islam të shekullit XX, *Ajatollah Ruhollah Homeini*. Ky shkrim i titulluar “Feja islame nuk është religjion për pacifistë”, u botua në revistën “Kaschf al Asrar” (Çelësi i Fshehtësirave) në vitin 1942 në Qom dhe u ribotua më 1980 dhe në 1983 në Teheran²¹. Si në shkencën, ashtu edhe në praktikën bashkëkohore kriminalistike, mbretëron bindja se disa grupe dhe

²⁰ Më 04.11.1979 grupi i studentëve militantë islamikë sulmoi dhe pushtoi me pas Ambasadën Amerikane në Teheran. U rrëmbyer personeli i punësuar në ambasadë. Të gjitha përpjekjet diplomatike për lirim të këtij personeli dështuan. Pas afër 14 muajsh, kur në ShBA vinte në pushtet presidenti Regan (i cili gjatë fushatës zgjedhore kishte premtuar lirim, në rast nevojë edhe me dhunë, të personelit diplomatik amerikan), vet qeveria iraniane ndërmjetësoi me sukses në lirim të personelit diplomatik.

²¹ Feja Islame njihet dy lloje luftërash. E para, është Xhahadi (përpjekja – ose lufta e shenjtë), që zhvillohet në kushte të caktuara për okupimin e shteteve të tjera, ndërsa e dyta, është lufta për ruajtjen e pavarësisë së shteteve islame dhe mbrojtja e tyre nga armiku. Në predikimet e tyre, shenjtorët thonë se “Zhvillimi i Xhahadit ose i luftës së shenjtë për okupimin e vendeve të tjera është i domosdoshëm dhe duhet të fillojë menjëherë pas themelimit të shtetit islamik. Në krye të këtij shteti duhet të jetë imami ose personi civil nën komandën e tij”.... Pas themelimit të shtetit islamik, islami duhet t’i mobilizojë të gjithë burrat e aftë për luftë me qëllim të fillimit të okupimit të vendeve të tjera. Vetëm në këtë mënyrë mund të ndikohet në pranimin dhe respektimin e fesë islame në tërë botën.”

organizata terroriste janë të bazuara në ideologjinë fetare islamike dhe veprojnë në emër të dogmave të tyre fetare. Por, mes mendimtareve dhe fetareve muslymane dhe prej shumë prej tyre, kjo mohohet dhe luftohet me anë të fjalës së tyre. (Moloney, 2003,128)

Kjo mund të argumentohet edhe me faktin se mekanizmat e tillë terroristë, jo vetëm themelimin, por edhe arsyetimin e veprave të tyre kriminale, e bëjnë kryesisht duke interpretuar urdhëresa të ndryshme të Kuranit. Me gjithë argumentet e ofruara, këto bindje „perëndimore”, refuzohen kategorikisht nga opinioni publik, politikanët dhe shkencëtarët e botës islame. Me të drejtë, ata ngrenë pyetjen përse në qarqet politike dhe mendimtarë evropiano-perëndimorë dhe amerikanë, nuk përdoret nocioni ose termi *“terrorizmi katolik“* kur është fjala për organizatën terroriste IRA ose për disa organizata të tjera terroriste, që veprojnë në Amerikën Latine, të cilat kanë anëtarësi vetëm me individë të fesë katolike dhe vrasin ekskluzivisht qytetarë që i përkasin besimeve të tjera fetare? Këtu argumentohet, se jo vetëm Armata Republikane Irlandeze (IRA) (Moloney, 2003,119) dhe Shtegu i Ndriçuar në Peru, por asnjë organizatë tjetër terroriste, me anëtarësi të pastër katolike, nuk vepron në emër të katolicizmit, të paktën kur marrin përgjegjësinë e sulmeve terroriste. Si qëllim kryesor i referohen jo përkatësisë fetare të individëve ose qeverive që konsiderojnë fajtorë për realitetin që luftojnë, por politikave nacionale apo sociale që ndërmarrin këta të fundit. Kjo ndodh pasi mendohet se nuk kanë nevojë për një motivacion të tillë, të karakterit fetar. Ato janë organizata terroriste, të cilat veprojnë në bazë të ideologjive të ndryshme politike, e jo fetare, të cilat e zbatojnë dhunën terroriste si mjet strategjik për arritjen e qëllimeve të caktuara politike ose nacionale dhe pse jo dhe sociale. Në këtë drejtim, qëllimi i Armatës Republikane Irlandeze, ishte ribashkimi i Irlandës, ndërsa ai i Shtegut të Ndriçuar, ishte ndërrimi i sistemit shtetëror kapitalist në Peru, në një sistem socialist.

Me gjithë këto qëllime, organizatat e ndryshme terroriste islamike²² si, p.sh., Xhahadi Islamik²³, Hezb - Allah²⁴, HAMAS²⁵ dhe, së fundmi, Shteti Islamik-ISIS etj., i rekrutojnë anëtarët e tyre jo në emër të çështjes së tyre nacionale, por kryesisht në emër dhe në mbrojtje të parimeve dhe urdhëresave të fesë islame. Shumë mendimtarë perëndimorë fajësojnë për këtë një komunitet të tërë, dhe duke viktimizuar veten dhe shoqërinë, pjesë e të cilës janë, nuk bëjnë gjë tjetër veçse atë të cilën synojnë kundërshtarët e tyre, nxitjen e urrejtjes mes popujve dhe besimtarëve²⁶. Organizata ose grupe terroriste islamike nuk duhen kuptuar të gjitha lëvizjet, organizatat ose grupet terroriste me anëtarësi të pastër myslimane, por vetëm ato që janë të organizuara dhe që veprojnë në emër të interpretimeve të ndryshme (radikale) të mësimave të Islamit (Tacheri, 1993, 331).

Besoj se të gjithë këta subjekte terroriste që veprojnë nën *‘mburojën’* e islamit dhe shfrytëzojnë, për mua, kushtet ekonomiko-sociale dhe politike duke përdorur dhe rekrutuar individë të prejardhur nga shtresa të vecanta të shoqërisë si dhe nga familje në të cilat ka trokitur në derë një fatkeqësi për të cilën shkak është bërë një veprim apo akt

²²Ky term përdoret për të theksuar se vetvetiu është abuzues dhe tendencioz dhe i përdorur nga qarqet politike perëndimorë për të viktimizuar këta të fundit.

²³Përpyekja Islamike.

²⁴Partia e Allahut.

²⁵Lëvizja e Kryengritjes Islamike.

²⁶Duhet gjithsesi të behet dallimi që okupuesit islamikë nuk kanë asgjë të përbashkët me okupuesit e tjerë joislamikë. Këta të fundit, dëshirojnë ta okupojnë botën vetëm me qëllim të shkatërrimit të fesë islame, e cila realisht u shërben interesave të njerëzimit. Okupuesit joislamë, nëpërmjet pushtimit të botës dëshirojnë përhapjen e padrejtësive të liga, me qëllim të shfrytëzimit të lirë të epsheve të tyre jonormale seksuale. Ndërkaq, Islami dëshiron ta okupojë botën me një qëllim krejtësisht tjetër. Qëllim i Islamit është përhapja e vlerave të vërteta shpirtërore dhe krijimi i një drejtësie të tillë njerëzore, në të cilën do të përgatitet rruga për ardhjen e pushtetit të vërtetë të Allahut. Pra, lufta e shenjtë islamike është një luftë kundër të pafeve, është një luftë kundër perverzimit seksual perëndimor, është një luftë kundër shfrytëzimit të njeriut dhe kundër shkeljes së të drejtave dhe vlerave morale të tij, etj. Shih më shumë Amir Tacheri, *Morden für Allah, Terrorismus im Auftrag der Mullahs*, Aus dem Englischen von Agnes Beck, München 1993, f. 329 - 331.

politik prejardhur nga individë apo qeveri perëndimore kristiane apo filokristianoperëndimore, duhen dalluar qartë nga organizatat, grupet dhe lëvizjet e ndryshme militante që veprojnë edhe në vetë botën islame. Kriteri themelor për dallimin e tyre është qëllimi politik. Në bazë të këtij qëllimi mund të thuhet se Partia Komuniste e Kurdistanit, me gjithë faktin se ka si anetarë të saj, vetëm individë të besimit islam, konsiderohet si lëvizje nacionale çlirimtare, e cila vepron bazuar në ideologjinë komuniste me qëllim të çlirimit të kombit Kurd dhe themelimit të shtetit të Kurdistanit. Të njëjtën gjë mund të themi dhe për Organizatën për Çlirimin e Palestinës. Askush në botën perëndimore, madje as Izraeli zyrtar, nuk e ka konsideruar Organizatën për Çlirimin e Palestinës, si organizatë terroriste islamike. Ky vlerësim prej tyre duket se gjen mbështetje në faktin se shumë udhëheqës të saj, (si, p.sh., Dr. Georg Habash, kryetar i Frontit Popullor Palestinez, Gjeneral Dr. Vadi Hadad, Fuad Shemali themelues i Shtatorit të Zi, etj.) ishin të krishterë, por dhe nga fakti se qëllimi politik i Organizatës për Çlirimin e Palestinës, si ai deklarohej nga vetë organizata, ishte zgjidhja e çështjes kombëtare palestineze. Rrënjët e terrorizmit islamik dhe rrënjët historike të urrejtjes ekstremiste islamike ndaj botës perëndimore gjenden thellë në historinë e hershme të popujve evropianë dhe atyre arabë. Shumë pak qytetarë të Evropës janë të informuar lidhur me ngjarjet vendimtare që kanë ndikuar në tensionimin e përhershëm të raporteve në mes botës islame dhe asaj perëndimore. Në vitin 630, profeti Muhamet përmes propagandimit të një besimi luftarak, kishte arritur t'i bashkonte fiset e ndryshme arabe në një popull, i cili me fjalën e Allahut do ta vendoste pushtetin e vet islamik në tërë botën. Në bazë të një propagande të tillë, profeti Muhamet dhe pasardhësit e tij, vetëm brenda një shekulli kishin arritur t'i bënin arabët e islamizuar, sundues të një perandorie të madhe, e cila shtrihej në tërë territorin e Lindjes së Afërt, Persi, Indi, Afrikën Veriore

dhe në Azinë Jugore. Më vonë ishte pushtuar edhe Italia Jugore dhe Spanja, nga kishte filluar edhe marshimi nëpërmes Pirinejeve në drejtim të Francës. Kjo ngjarje historike është pjesë e kulturës myslimane. Pas kësaj disfate, në kulturën ekstremiste islamike është evidentuar dhe viti 905 si vit i luftës për mbrojtjen e *“tokave myslimane”*, mes të tjerave dhe Izraelit, Spanjës dhe Italisë Jugore (të pushtuara më parë), sipas dogmës, nga të pafetë. Në këtë kohë dhe mes disfatave të shumta arabe, bota islamike kishte qenë në kërkim të gjetjes së një udhëheqësi të ri, që do të ishte në gjendje t’i korrigjonte gabimet historike dhe kësaj t’i jepte një forcë të re me të cilën do të zbatohej urdhëresa e Allahut. Kështu, që nga ajo kohë e deri më tani, ideologjia radikale islamike në të gjitha periudhat e ngritjeve të shteteve të ndryshme myslimane, e kishte aktualizuar ëndrrën për pushtimin e Evropës. Në bazë të një ëndrre të tillë, në vitin 1638 në drejtim të Evropës kishin marshuar edhe forcat turke. Në kulturën ekstremiste të qarqeve të ndryshme islamike, kjo ngjarje është shënuar si depërtim i dytë i forcave myslimane në Evropë. Shkatërrimi i Perandorisë Osmane, që kishte filluar paralelisht me ngritjen e fuqive të ndryshme evropiane, për kulturën ekstremiste islamike ishte shumë i mundimshëm. Në vitin 1798, Napoleoni pa ndonjë vështirësi ushake kishte arritur pushtimin e tërë Egjiptit. Në vitin 1830, Algjeria ishte shndërruar në koloni të Francës, ndërsa Anglia i kishte vendosur nën kontroll të gjitha ujërat detare në Lindje të Afërt dhe bregdetin arab. Kështu, vetëm brenda disa dekadave, shtetet e krishtera, si Italia, Franca dhe Britania e Madhe, kishin arritur pushtimin dhe ndarjen e tërë rajonit të Gjirit Persik dhe Afrikës Veriore. Në këtë mënyrë ishin pushtuar dhe ndarë edhe shumë pjesë të Perandorisë Osmane. Të gjitha këto territore të pushtuara, përkatësisht myslimane, ishin vendosur nën administrimin e shteteve të ndryshme evropiane, me ndihmën e prijësve të ndryshëm myslimanë, të cilët që nga ajo kohë shpërbleheshin me tituj

tradicionalë evropianë, si “mbretër“ ose “princa“. Këta udhëheqës të rinj myslimanë, falë statusit të tyre të privilegjuar shumë shpejt kishin arritur të pasurohen. Sidomos, në Kohën e zhvillimit industrial dhe teknologjise modern, pas zbulimit të naftës dhe gjithmone e në rritje, kërkeses për energji që rrjedh nga hidrokarburet, pasuria e tyre arriti përmasa të mëdha. Me nocionin “udhëheqës ose aktivist politik islamik” kuptohen përfaqësuesit e një lëvizjeje politike, e cila është e bazuar në parimet fetare islamike. Në të gjitha sistemet politike të karakterizuara me lëvizje të tilla fetare dhe politike, ndarja e fesë nga shteti është i pothuajse e padukshme. Në një vështrim të parë mund të duket se islamizmin në këto vende nuk e predikojnë vetëm si fe, por dhe si një ideologji politike. Kuadri ligjor rregullues, është në harmoni të plotë (*kjo është e detyrueshme*) dhe sipas ligjeve fetare. Islamizmi, përdoret si ideologji politike, kur shihet e arsyeshme, për përfitime natyrisht të udhëheqësve fetarë që nuk janë vetëm të tillë pasi kanë dhe shumë pushtet ekzekutiv dhe legjislativ, në lëvizjet protestuese kundër qeverive dhe rregullimeve shteteve të ndryshme islamike, të cilat kudo sipas rastit , akuzohen si tiranë ose tradhtarë dhe fajësohen për problemet e shumta shoqërore. Në kuadër të zhvillimeve historike dhe lëvizjeve të tilla protestuese, lindi dhe ideologjia *fundamentaliste*. Në bazë të kësaj ideologjie, feja islame dhe besimtarët e saj janë në rrezik dhe shpëtimi i tyre mund të arrihet vetëm nga zbatimi i drejtë i parimeve fundamentale islamike në jetën shoqërore. Në këtë kuadër, rëndësi të veçantë ka Suna e Profetit (*Legjenda e Muhamedit*), ku bazohet dhe “E drejta Islame”. Pikërisht këtë shfrytëzojnë dhe qarqet e udhëheqësve dhe liderve fetare, pasi Sheriati nuk parashikon rregulla shoqërore të pandryshueshëm, të ngurtë, por është është një kod normash të përmbledhura, të sistemuara dhe të interpretuara gjatë shekujve²⁷.

²⁷Në të vërtetë kjo problematikë tashmë, është trajtuar që nga vdekja e Profetit Muhamed. Për këtë arsye,

Për dallim nga këto kuptime, *xihadi* kudo në botën islame ka kuptimin e *parimit etik të mobilizimit shpirtëror dhe të përpjekjeve për arritjen e një qëllimi të mirë dhe pozitiv*. Çdo person, i cili e praktikon xihadin quhet muxhahid (luftëtar i zotit). Ndërsa personi që nuk merr pjesë në këtë luftë të shenjtë identifikohet si Qa'idin (*ai që anashkalon këtë detyrim për besnikëri dhe jeton si parazit në shtëpi*). Sipas predikimeve të Islamit ekzistojnë dy lloje të xihadit: xihadi i vogël dhe xihadi i madh. Si xihadit të vogël quhet dhe lufta e armatosur, në rastet kur besimtari musliman lufton për lirinë fetare. Ndërsa, me fjalën xihad i madh (*djihad bi-n-nafs*) ana shpirtërore e njohjes dhe e zotërimit ose kontrollit të vetvetes. Sipas bindjeve të shumicës myslimane, me fjalën *xihad*, në radhë të parë, kuptohet njohja dhe zotërimi i vetvetes e pastaj zhvillimi i luftës për lirinë fetare. Në këtë kuptim dhe xihadizmi është shpjeguar si luftë e armatosur kundër të gjitha forcave, të cilat e pengojnë krijimin e shtetit islamik. Në vende dhe struktura të ndryshme shoqërore dhe qarqe politike me fjalën xihadizëm kuptohen kundërshtimi i stilit perëndimor të jetës. Komuniteti ndërkombëtar ka theksuar në një sërë rastesh se e dënon me forcë terrorizmin, me të gjitha format dhe mënyrat që ai manifestohet, nga kushdo dhe kudo dhe për çfarëdo qëllimi, si një ndër kërcënimet më serioze të paqes dhe sigurisë në mbarë botën²⁸. Po ashtu, komuniteti ndërkombëtar ka hedhur poshtë me forcë identifikimin e terrorizmit me çfarëdo kombësie, përkatësie fetare apo etnike. Terrorizmi është një ndër krimet më të rënda. Ai nuk mund dhe nuk duhet të lidhet në asnjë mënyrë me ndonjë kombësi, përkatësi fetare apo etnike.

pra interpretimit të shkrimeve të shenjta dhe më konkretisht për emërimin e Kalifit, pasardhësit të Muhamedit dhe përfaqësuesit të Allahut në toke, u ndanë myslimanët në Shiit dhe Sunit. Shiitët predikojnë dhe besojnë se zgjedhja e Kalifit u takon atyre si pasardhës të drejtëpërdrejtë të Muhamedit, ndërsa sunitët se Kalifi duhet zgjedhur nga rrethi më i gjerë i fisit të Muhamedit.

²⁸Asambleja e Përgjithshme e OKB-së "The United Nations Global Counter-Terrorism Strategy" [Strategjia globale e Kombeve të Bashkuara në luftën kundër terrorizmit], Dokumenti A/ RES/60/288, 2006, < <http://www.un.org/en/terrorism/strategy-counterterrorism.shtml>>.

2.4.1. Karakteristikat e terrorizmit islamik

Terrorizmi islamik mund të dallohet nga të gjitha format e tjera të *aktivitetit terrorist*, kryesisht në bazë të tri elementeve ideologjik. Terrorizmi islamik, teorikisht, refuzon të gjitha ideologjitë e tjera bashkëkohore. Ai, si i tillë, veten e konsideron të pashembullt dhe krejtësisht të veçantë nga të tjerët, të cilit nuk i ka mbetur gjë tjetër përveç arritjes së qëllimit të vet ose „vdekjes me shpatë në dorë. Qëllimi paresor i ‘terrorizmit islamik’ është rilindja islamike, e cila duhet të sjellë jo vetëm lirin e të gjitha territoreve myslimane nga ndikimet perëndimore, por edhe pushtimin e tërë rruzullit tokësor nga besimtarët e vërtetë të Allahut. Karakteristikë tjetër e terrorizmit islamik është prezantimi i tij si formë e luftës së shenjtë, e cila duhet të perfundojë me fitor të plotë. Në këtë drejtim, nuk bëhet dallimi në mes aktivitetit terrorist dhe formave të tjera të zhvillimeve luftarake. Elementi i tretë karakteristik i terrorizmit islamik është krijimi i rregullave të detyrueshme të sjelljes islame. Sipas këtyre rregullave, detyrim i çdo besimtari, është vrasja e armiqve të Allahut “*armiqtë tanë duhet të vriten, ndërsa të pafetë duhet ta zgjedhin vdekjen ose konverimin e tyre të detyrueshëm në myslymane*”.

2.4.2. Subjektet që kryejnë aktet terroriste/sulmet vetëvrasëse

Sipas studimeve të shumta dhe rezultateve të studimeve të ndryshme ndërkombëtare, mosha mesatare e aktorëve potencialë për kryerjen e sulmeve vetëvrasëse varion nga 12 deri në 20 vjeç. Në numrin më të madh të rasteve, persona të tillë e kanë një të afërm të tyre të dënuar politik, të plagosur ose të vrarë nga armiku dhe personalisht nuk kanë marrë pjesë në kryerjen e ndonjë aksioni të armatosur. Pikërisht kjo situatë shoqërore e personave të ndjeshëm dhe të rrahur me fatkeqësi brenda familjeve të tyre, ndikon në krijimin e ndjenjave mosvlerësuese dhe të turpfit si dhe bindjes së fuqishme për mundësinë e pastrimit të vlerave të tilla negative vetëm

nëpërmjet vetëflijimit për një çështje më madhore se vetë jeta e tyre. Nga ana tjetër edhe rrethanat objektive, si bindja e krijuar fetare, se vdekja martire shpërblehet me shkuarje të drejtpërdrejtë në parajsë dhe larjes se mëkateve të bëra, e sidomos respekti i lartë ndaj martirëve dhe familjeve të tyre, ndikojnë në marrjen e vendimit për vdekje martire. Në të gjitha komunitetet fetare, rrymat politike dhe shtresat shoqërore të popullit palestinez, martirët gëzojnë statusin e heronjve kombëtarë. Kështu, më 12.04.2002, për revistën arabe "Sayidati" kishte deklaruar edhe gruaja e kryetarit Arafat, Suha (*një palestineze e krishterë, e cila jeton në Paris*). Sipas saj, sulmet vetëvrasëse janë mjete dhe metoda legjitime të rezistencës kombëtare palestineze kundër okupatorit Izraelit. Në marrjen e vendimit për kryerjen e aksioneve vetëvrasëse pa dyshim ndikon edhe baza materiale. Sipas praktikës së organizatës islamike libaneze Hezb-Allah, HAMAS, ISIS, u ofrohet familjeve të martirëve shuma të rregullta materiale me vlerë nga qindra deri në 1000 dollare në muaj. Përveç kësaj ndihme të rregullt financiare, familjet e martirëve marrin edhe ndihmatë tjera të rregullta për ushqim, shkollim dhe veshmbathje. Pas vitit 2000, kur kishte filluar intensifikimi i sulmeve vetëvrasëse palestineze, Sadam Husein, rriti ndihmen financiare për familjet e martirëve palestinezë deri në 20.000\$. Të rekrutuarit nga ISIS në luftën në Siri, ndërmjet tyre dhe shumë shqiptarë dhe kosovarë²⁹, marrin një

²⁹ Luftës gati 4 vjeçare në Siri, me qëllim të rrëzimit të diktatorit Bashar Al Assad, i janë bashkangjitur edhe qindra shqiptarë. Me arsyetimin se feja myslimane kërkon përfshirje në Xhihad ose Luftë të Shenjtë, shqiptarë nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia po shpërngulen për në Siri, për të dalë në mbrojtje të fjalës së Allahut dhe njerëzve të pafajshëm. Aktualisht situata në Siri është e paqartë, media të ndryshme ndërkombëtare po raportojnë për luftëra për pushtet mes grupeve të ndryshme. Sipas Lavdrim Muhaxherit, i njohur si udhëheqës i luftëtarëve shqiptarë në luftën e Sirisë, arsyeja se pse janë ndarë në grupe të ndryshme është se grupet kanë interesa të ndryshme nga njëri-tjetri. "Disa grupe luftojnë për shtet islam e disa të tjerë për shtet demokratik, kurse populli është pro-shtetit islamik", tha Muhaxheri. Në një intervistë ekskluzive për Indeksonline, Muhaxheri tha se, numri i shqiptarëve që po marrin pjesë në këtë luftë është shumë i madh dhe se ata janë nga të gjitha anët. Në pyetjen se a ka rënë numri i pjesëmarrësve kosovarë në këtë luftë për shkak të vrasjeve të fundit të kosovarëve, Muhaxheri tha se pjesëmarrja përkundrazi është rritur ditëve të fundit. "Përkundrazi shumë e më shumë po

pagë fikse që arrin deri në 1500-2000 euro në muaj, të paguar në mënyre taktike, si dhe familjeve të tyre, nëq këta vriten në luftë, u sigurohet një pagesë shumë e mirë. Të gjitha këto informacione janë marra nga mediat shqiptare dhe të huaja falë dhe dëshmimeve të shumta të njerëzve të kontaktuar fillimisht për t'u rekrutuar. Procedura sekrete për rekrutimin e kandidatëve për martirë fillon zakonisht në shkolla, xhami dhe në qendra të tjera rinore. Sipas praktikës palestineze, personi i autorizuar për hulumtimin e kandidatëve potencialë së pari e identifikon rrethin e personave të rinj që manifestojnë elemente të dukshme emocionale dhe rrjedhin nga familjet e personave të persekutuar. Pastaj me këta persona, në mënyrë të lirë, spontane, të rastësishme dhe të paobliguar, fillohen bisedimet individuale lidhur me çështjet e ndryshme politike, qëllimet e armikut dhe efektet e sulmeve vetëvrasëse. Gjatë zhvillimit të këtyre bisedave duhej analizuar me kujdes të gjitha reagimet e bashkëbiseduesit. Pas përfundimit të bisedave të para, personi, i cili tregon interesim për vazhdimin e kontakteve dhe bisedave të tilla, hyn në

dëshirojnë të vijnë këtu për të marrë hakun e vllaznive dhe motrave myslimane, tha ai. Muhaxheri tha se, Qeveria e Kosovës nuk po bën asgjë për shqiptarët që po dhunohen e po vriten nga ushtria e Bashar Al Assad-it. Ai nuk u përgjigj në pyetjen se kush e bënë dhe si bëhet rekrutimi i kosovarëve për në Siri, sepse, sipas tij kjo pyetje nuk duhet t'iu bëhet muxhahidave por "spionave" të shtetit. Krejt në fund ai adresoi një pyetje për Qeverinë e Kosovës: "E kam një pyetje për qeverinë, ata që po mundohen me i ndalë rininë shqiptare me marrë pjesë në këtë luftë që për të ju ndihmuar të pafajshmëve, na tregoni neve se çfarë plane parandalimi keni vendosur për ata shqiptarë që po udhëtojnë për t'iu bashkuar kësaj ushtrie?" Disa muaj më parë, Bashkësia Islame e Kosovës, iu pati bërë thirrje të rinjve kosovarë t'i qëndrojnë sa më larg Sirisë dhe luftës që bëhet atje. Përmes një deklarate për media, ky institucion u ka bërë apel kosovarëve që aktualisht luftojnë në Siri në emër të fesë, që të kthehen menjëherë pranë familjeve të tyre. Sipas kësaj bashkësie fetare, shkuarja në Siri për të luftuar nuk ka asnjë lidhje me parimet fetare islame. Edhe Ministri i Jashtëm i Kosovës, Enver Hoxha, pati kërkuar masa ligjore që parandalojnë një pjesëmarrje të tillë. "Ajo, për të cilën ne kemi nevojë, është përtej situatës aktuale, rregullime ligjore që parandalojnë pjesëmarrjen e një qytetari të Kosovës në pjesë të ndryshme të botës në aktivitete luftarake dhe në këtë drejtim ka modele të ndryshme në pjesën perëndimore të botës", deklaroi Hoxha. Ende nuk dihet numri i saktë i shqiptarëve që po marrin pjesë në luftën e Sirisë, por është e ditur se deri më tani për lirinë e popullit sirianë kanë 10 shqiptarë, prej të cilëve 4 nga Kosova. /Indeksonline/. Burimi <http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmiID=82538>, aksesuar në datë 10.04.2015.

rrethin e ngushtë të kandidatëve potencialë për martirë. Në këtë fazë të procedurës rekrutuese, veprohet me shumë kujdes. Në qoftë se kandidati gjatë bisedave pasuese e lartëson vdekjen martire, ai parimisht duhet të këshillohet për t'u përmbajtur nga aksionet e tilla. Mirëpo, në qoftë se ai edhe pasi të jetë këshilluar vazhdon të këmbëngulë në vdekjen e vet martire, zgjidhet për misione te tilla. Menjëherë pas kësaj zgjedhje fillon faza e përgatitjes së kandidatit për vdekje martire. Gjatë kësaj faze të shkurtër përgatitore ftohen në ndihmë edhe predikuesit e ndryshëm fetarë, të cilët me shpjegimet e tyre duhet ta motivojnë dhe më tepër. Sipas praktikave të disa organizatave terroriste, para dërgimit të kandidatit në aksion vetëvrasës, bëhet dhe testimi përfundimtar i tij. Në të vërtetë, nëpërmjet kryerjes së një aksioni kundër objektivit, vlerësohet besnikëria dhe vendosmëria e kandidatit si dhe aftësia për ruajtjen e gjakftohtësisë gjatë aksionit në rrethana të vështira operationale. Në rast kalimi të kësaj prove, kandidati largohet nga familja dhe ditët e fundit të jetës i kalon në shoqëri me disa persona të zgjedhur të tij. Pastaj bëhet një ceremoni lamtumire dhe martirit të ardhshëm i shpjegohet mënyra e kryerjes së aksionit vetëvrasës. Elementi kryesor, që ndikon në mosparaqitjen e shenjave të dukshme të frikës ose nervozitetit, gjatë kryerjes së aksioneve vetëvrasëse, është vendosmëria e kandidatit për vdekje martire. Kështu, sipas dëshmitarëve izraelitë, sulmuesit e ndryshëm palestinezë gjatë kryerjes së aksioneve të tyre vetëvrasëse, në numrin më të madh të rasteve kishin qenë të veshur me rroba tradicionale izraelite, me uniforma të ndryshme policore ose me ato të ushtarëve izraelitë. Në këtë mënyrë, atentatorët duke e fshehur identitetin e tyre kishin arritur të depërtonin deri në thellesi të territorit izraelit dhe të jenë pikërisht aty ku duan të realizojnë sulmin, në vende të shumë populluara, tregtare apo fetare e tregtare, nëpër autobuza etj (Chopra, 2002, 25). Terrorizmi i organizatave me ideologji dhe bazë

islamike, e fitoi famën e vet e falë akteve të dhunës me anë të sulmeve vetëvrasëse, rrëmbimit të aeroplanëve, montimit të autobombave dhe përdorimit të mjeteve shpërthyes (Dershowitz, M. Alan, 2002, 56). Sidomos, zbatimi i taktikës së sulmeve vetëvrasëse, ishte ai që e bëri opinionin ndërkombëtar të mobilizohej më seriozisht në luftën kundër këtij fenomeni dhe të mendohej të gjente metodikën më efektive për këtë. Nuk është i bazuar në argumenta bindëse, madje mendoj se është shumë tendencioz, mendimi se sulmet vetëvrasëse, metoda e përdorur por jo e vetmja si metoda e zgjedhur për luftë, e grupeve terroriste në Lindjen e Mesme, janë produkt i ideologjisë islame ose të frymëzuara nga vepra të autorëve islamikë fetare apo ideolog politik.

2.4.3. Debatet bashkëkohore mbi aktet terroriste islamike

Brutaliteti i ekstremistëve në Lindjen e Mesme, bëhet nga xhihadistë që pretendojnë se kanë ngritur kalifatin e quajtur “Shteti Islamik”. Por për identifikimin e këtij organizimi po përdoren disa emra. Pas vrasjeve makabre me prerje koke, të shtetasve amerikanë dhe britanik, kryeministri David Cameron tha se Britania të angazhohet për ta shkatërruar ISIL-in. Në mënyrë të ngjashme, edhe presidenti amerikan Barack Obama, tha se, Shtetet e Bashkuara po përgatiten për të filluar sulmin ndaj ISIL. Të tjerët këtij grupi vazhdojnë t’i referohen si ISIS, duke shtyrë që shumë kompani botëore që mbajnë këtë emër, ta ndërrojnë atë. Grupi xhihadist vetën e deklaroi si “Shteti Islamik”. Heqja e kufijve politikë në Irak, Siri e rajon dhe krijimi i kushteve për dështimin e qeverive dhe për nxitjen e luftës civile sektare. Krijimi i Kalifatit Islamik, fillimisht do të përfshinte Irakun e Sirinë dhe më pas të zgjerohej edhe më shumë. Mobilizimi dhe sjellja e mbështetësve nga tërë bota për të luftuar së bashku dhe për t’u vendosur në territorin e kontrolluar prej tyre. E si rrjedhojë e kësaj të

zgjerohej pastaj edhe territori i kontrolluar prej ISIS-it dhe të fuqizohej lidhja me komunitetin e gjerë myslimanë, janë dhe disa prej objektivave që ISIS-i po mundohet t'i arrijë përmes fushatës ushtarake. Udhëheqësit e Shtetit Islamik janë vetshpallur si i vetmi autoritet legjitim që mund të udhëheqin xhihadin dhe përveç luftës kundër jomuslimanëve, si prioritet të tyre e propagandojnë dhe *pastrimin* e shoqërisë myslimane nga elementë jobesimtarë. Si shembull, marrim dhe konfliktin izraelito-palestinez, ku ISIS-i e vlerëson grupin e Hamasit si *renegatë* që nuk kanë autoritet legjitim të udhëheqin xhihadin dhe e vlerëson perpjekjen e Hamasit, si hapin e parë drejt konfrontimit me Izraelin. Burimi kryesor i financimit të ISIS në fillimet e tij, thuhet se kanë qenë fondet e pranuar nga individët e pasur të GCC-së (GCC-ja janë Këshilli për Bashkëpunim në Gjirin Persik). Në mediat e huaja shpeshherë është argumentuar se qeveritë e këtyre vendeve, sidomos Kuvajti, kanë bërë shumë pak për të parandaluar që këto fonde të arrijnë tek ISIS-i por dhe tek grupet e tjera radikale. Ndërkaq, besohet se këto fonde kanë arritur në qindra milionë dollarë. Por, me kontrollimin e shumë të territoreve në Siri dhe Irak, ISIS-i arriti dhe mundësinë për të vetëfinancuar operacionet e veta përmes reketimit, plaçkitjes së bankave dhe shitjes së burimeve natyrore si ato të shfrytëzimit ekonomik të puseve të naftës. Sipas të dhënave të inteligjencës irakiane, konsiderohet se ISIS ka asete që arrijnë vlerën e mbi 2 miliardë dollarëve dhe ato e bëjnë këtë grup xhihadist më të pasurin në botë. Nga aktiviteti plaçkitës i bankave në Siri, ISIS kishte arritur të mblidhte para të gatshme dhe asete në vlerë të 515 milionë dollarëve. Ndërsa, pas marrjes së Mosulit, kësaj shume i ishin shtuar edhe rreth 450 milionë dollarë të plaçkitura nga Banka Qendrore në këtë qytet, së bashku me sasinë e parave të gatshme dhe arit të plaçkitur në bankat e tjera. ISIS grumbullon para edhe nga prodhimi i naftës bruto dhe shitja e rrymës elektrike në veri të Sirisë. Një pjesë e rrymës

së gjeneruar mendohet se i shitet edhe qeverisë siriane. Në fund të vitit 2012, ISIS kishte arritur të merrte kontrollin e fushave të naftës në lindje të Sirisë. Ndërsa, në territoret e kontrolluara, ISIS është i përfshirë edhe në kontrabandimin e lëndëve të para, artefakteve arkeologjike, rrëmbimit, reketimit të biznesmenëve dhe tatimit të bizneseve të ndryshme që operojnë në territoret e tyre. Por, edhe pse në përqindje më të vogël, individë të pasur nga vendet e GCC-së vazhdojnë të financojnë aktivitetet e ndryshme të ISIS. Lufta në Siri filloi pa ISIS-in, por më vonë ky grup arriti të nxiste luftën në Irak për të destabilizuar vendin. Ndërkaq, ISIS synon të shkatërrojë në mënyrë permanente shtetin e Irakut që mos të ringrihet më. Kjo konsiderohet se është e rëndësishme për të mbrojtur kalifatin e tyre nga sulmet e jashtme. Ekspertët e sigurisë pretendojnë se ISIS nuk ka më shumë se 14 mijë luftëtarë në Irak dhe Siri (rreth 9 mijë veprojnë në Siri e rreth 5 mijë në Irak). Por, gjatë aksionit për marrjen e qytetit të Mosulit, rreth 800 pjesëtarë të këtij grupi kishin arritur të mposhtin dy divizione të ushtrisë irakiane, që arrinin në rreth 30 mijë trupa. ISIS vazhdon të ketë mbështetje të madhe nga konflikti në Siri, e cila ka rezultuar në numër të madh të rekrutëve, municion të sofistikuar dhe burime të tjera për operacionet në Irak. Kurse, paradat e terroristëve të ISIS-it kanë demonstruar se ky grup ka artileri edhe amerikane, mjete ushtarake të lëvizshme dhe pajisje të tjera. Në Irak, sipas ISIS ka kontrolluar qytetin Rutbah, Al-Qa'im, Rawa, Sharqat, Anah, Fallujah, Sulaiman Bek, Tikrit, Hawijah, Mosul, dhe Tal Afar, ku vlerësohej se popullsia e tyre arrin në rreth 3 milionë banorë. Ndërsa, qytetet siriane që kontrolloheshin nga ISIS janë Al Barakah, Al Kheir, Ar-Raqqah, Al Badiya, Halab, Idlib, Deir Al-Zawr dhe Hama. Por, cili është dallimi në mes të tre akronimeve të ndryshme, dhe pse secili prej tyre rezonon politikisht? Grupi militant është themeluar nga jordanezi Abu Musab al Zarqawi në vitin 1999, kur ai fillimisht ishte njohur si

Jama'at al-Tawhid wel Jihad (Dilip K. Das, Peter C. Kratcoski 2003, 67). Ajo më pas u bë i njohur si “Al-Qaeda në Irak”, duke u bërë pjesë e rrjetit të Osama bin Ladenit në tetor 2004. Që atëherë, ky grup ka operuar nën emra të ndryshëm, derisa kreu aktual saj, Ebu Bekr al-Bagdadi, më 29 Qershor 2014, zyrtarisht deklaroi se kishte krijuar një shtet islamik në të gjithë pjesët e Irakut të veriut dhe të Sirisë. Në arabisht, grupi është i njohur si Al-Dawla Al-Islamiya fi al Iraq Wa al Sham, apo Shteti Islamik i Irakut dhe al-Shamit. Termi “al-Sham” i referohet një rajoni që shtrihet nga Turqia jugore përgjatë Sirisë e deri në Egjipt (duke përfshirë edhe Libanin, Izraelin, territoret palestineze dhe Jordanin). Qëllimi i deklaruar i grupit ishte për të rivendosur një shtet islamik, apo kalifat, në gjithë këtë zonë. Termi standard anglez për këtë territor është “Levant”, e që është arsyeja kryesore pse Obama dhe Cameron e përdorin akronimin “ISIL”. Megjithatë, disa media amerikane pohojnë, duke iu referuar disa teorive konspirative, se presidenti Obama po përdor termin “ISIL” për të shmangur fjalën “Siri”, të cilën e simbolizon “S”-ja që qëndron te “ISIS”. Mediat thonë se kur flitet për “sulmet në Siri”, kjo konsiderohet si një situatë e ndërlikuar për SHBA-të, pasi Obama refuzoi të intervenonte në luftën civile atje kundër presidentit Bashar al-Asad.

Më poshtë vijon shpjegimi dhe analiza e tre shkurtesave, inicialeve të shtetit islamik: *Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë (ISIS)* Emri origjinal për grupin në arabisht ishte Al-Dawla Al-Islamiya fi al-Iraq wa al-Sham. Tri fjalët e para përkthehen si, Shteti Islamik i Irakut, ndërsa “al-Sham” i referohet Sirisë apo një rajoni të padefinuar rreth Sirisë.

*Shteti Islamik i Irakut dhe Levantit (ISIL)*_Rajonit të papërcaktuar rreth Sirisë historikisht i është referuar si Levant; ai përfshin Sirinë, Libanin, Izraelin dhe Palestinën

dhe Jordaninë. Ky emër tregon se militantët duan që territori i tyre i kontrollit do të duhet të shkojë përtej Irakut.

Shteti Islamik (IS) Grupi militant njoftoi në qershor se ata kishin larguar dy shkronjat e fundit të akronimit të tyre dhe në vend të kësaj duhet të quhet vetëm si Shteti Islamik. Megjithatë, në reagim ndaj kësaj myslimanët kryesorë kanë bërë thirrje që emri të ndryshohet për të dekurajuar njerëzit që të bashkohen me këtë grup. “Kjo nuk është as islame, e as nuk është një shtet. Grupi nuk ka të bëjë me myslimanët e vërtetë”, thuhet në letrën e nënshkruar nga Shoqëria Islamike e Britanisë dhe Shoqata e Avokatëve myslimanë, dhe të publikuar nga ‘The Independent’.

Në vitin 2014, grupi i Shtetit Islamik (IS) u shfaq si një nga grupet më të fuqishme xhihadiste, duke e rivalizuar edhe Al-Kaidën. Ekstremistët tashmë kontrolojnë territore të ndryshme nëpër Siri e Irak, dhe numërojnë aktualisht mijëra ushtarë, shumë nga ta edhe nga Evropa Perëndimore. Një koalicion kundër IS-it i udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka mobilizuar më shumë se 60 shtete, përfshirë dhe shtete arabe, kundër grupit. Megjithatë, muaj pas bombardimeve, militantët e IS-it ende janë duke kërcënuar se do të marrin edhe më shumë territore, dhe po vazhdojnë të tërheqin luftëtarë të huaj, dhe ekzekutojnë pengje nga Perëndimi, Siria e Iraku. Derisa kjo situatë kaotike ndryshon me shpejtësi, e bën shumë të vështirë parashikimin se çfarë mund të ndodhë në vijim, Radio Evropa e Lirë ka pyetur një numër të analistëve dhe ekspertëve të vlerësojnë se çfarë mund të pritet nga Shteti Islamik në vitin 2015.

IS është munduar të marrë më shumë territore në Irak dhe luftoi për të marrë në kontroll provincën Anbar. Shteti Islamik është “*i varur nga fitoret e njëpasnjëshme dhe marrjes së territoreve për të mbajtur bazën e tij*” dhe do të vazhdojë të shikojë për

“caqe dhe shanse” për të marrë Irakun dhe Sirinë, thotë analisti irakian me vendndodhje në Amerikë, Joel Wing. Në këto caqe përfshihet “provinca” e madhe e Irakut, Anbari, për të cilën liderët vendorë kanë bërë me dije se do të bie, nëse forcave të sigurisë së Irakut nuk do t’iu jepet më shumë ndihmë ushtarake nga qeveria irakiane dhe aleatet strategjik. Caleb Weiss, i cili shkruan në faqen e internetit “The Long War Journal”, thotë se provinca e Anbar-it do të vazhdojë të jetë çështje debatimi derisa IS mundohet të fitojë këtë terren. “Shteti Islamik tashmë kontrollon mbi 60 për qind të Ramadit (kryeqytetit të Anbar) dhe nëse forcat irakiane të sigurisë dhe aleatët Suni nuk marrin mbështetje efektive, unë mendoj se Anbari do të bjerë”, tha Weiss. Weiss thotë se ne mund të shohim Shtetin Islamik duke u bërë edhe më aktiv përgjatë kufirit të Irakut me Jordaninë. Udhëheqësit ushtarakë të koalicionit kanë raportuar shenja se sulmet ajrore të udhëhequra nga SHBA-ta kanë detyruar Shtetin Islamik të kalojë nga një ofensivë në një strategji mbrojtëse në Irak dhe në disa pjesë të Sirisë, sidomos në qytetin verior sirian, Kobani. Këto sulme duket se do të vazhdojnë, madje edhe mund të intensifikohen. Duke folur për liderët e koalicionit më 3 dhjetor, Sekretari amerikan i Shtetit John Kerry u zotua të vazhdojë fushatën kundër IS-it për “aq kohë sa ajo merr”, derisa presidenti francez Francois Hollande tha se Franca është e gatshme të marrë pjesë në po të njëjtat sulme. Analistët tërheqin vërejtjen se Perëndimit do t’i duhet të bëjë shumë më shumë gjatë vitit 2017, nëse ky koalicion dëshiron të ketë ndikim kundër Shtetit Islamik. Perëndimi nuk është “duke bërë asgjë pranë burimeve të mjaftueshme për të bërë një ndryshim të vërtetë”, thotë analisti Wing. “Tani për tani koalicioni është më shumë një telash sesa një ndryshim krijues në Siri dhe Irak”, thotë Wing thotë, duke vënë në dukje se IS ka qenë në gjendje të nisë sulme të mëdha kundër qyteteve të Irakut, pavarësisht sulmeve perëndimore. Megjithatë, SHBA nuk ka gjasa të dërgojë trupa

tokësorë për të luftuar kundër IS-it. Siç kishte thënë një ish-zyrtar i administratës më 3 dhjetor: “Presidenti [Obama] ka qenë i qartë dhe nuk ekziston skenari që trupat tokësore amerikanë të shkojnë atje”. Përveç sulmeve të vazhdueshme ajrore, ne gjithashtu mund të presim mbështetje në rritje nga Shtetet e Bashkuara për fiset sunite të Irakut të cilët janë në front në luftën kundër IS. Një dokument i Pentagonit i përgatitur për Kongres theksoi rëndësinë e mbështetjes së forcave fisnore sunite kundër IS, dhe tha se Shtetet e Bashkuara planifikojnë të shpenzojnë 24.1 milionë dollarë për armatosjen e tyre. Megjithatë, mbështetja e SHBA-së dhe shteteve që i kanë shpallur luftë ISIS, për këto fise duhet bëhet në një shkallë shumë më të lartë, pasi duke iu siguruar armatosje të mjaftueshme fiseve sunite do të sigurohet dhe çelësi për t’i mundur militantët e Shtetit Islamik në përpjekjet e ardhshme.

Rekrutimet do të vazhdojnë, sikurse edhe përpjekja për t’i ndaluar ato. Raportet e fundit thonë se IS ka hequr dorë nga masat e sigurisë për luftëtarët e huaj. Organizata gjithashtu është duke zgjeruar rrjetin e vet të kampeve të trajnimit në të gjithë Sirinë dhe ka vazhduar të tërheqë rekrutë përfshirë dhe gra nga Evropa Perëndimore, Azia Qendrore dhe Azia Juglindore. Për t’iu kundërvënë rekrutimeve, duhet të pritët të vlerësohen përpjekjet e shtuara nga qeveritë e ndryshme të botës për të dënuar shtetasit e tyre që udhëtojnë në Irak dhe Siri. Hapa të tillë tashmë janë marrë nga shumë vende. Kampet e trajnimit do të vazhdojnë të shpërndahen. Shteti Islamik do të vazhdojë të zgjerojë kampet e trajnimit në Siri dhe Irak, mes përpjekjeve të shtuara për të trajnuar fluksin e rekrutëve dhe luftëtarët ekzistuesë në ato vende. Koalicioni i udhëhequr nga SHBA-të duhet të marrë masa për t’u munduar të ngadalësojë këto përpjekje³⁰. Grupe

³⁰ Caleb Weiss, i cili bashkë me kolegun e tij Bill Roggio kanë numëruar në hartë 25 qendra trajnimi të IS-it në Siri e Irak, thotë se sulmet ajrore në këto kampe “mund të ndihmojnë të ndalojnë rekrutimet e IS-it”.

tjera xihadiste do t'i bashkohen IS-it. Nëse Shteti Islamik mund të vazhdojë me fitore në Siri dhe Irak, dhe në qoftë se ai do të vazhdojë me përpjekjet e shkëlqyera propagandistike, ndikimi i tij ka të ngjarë të përhapet në grupe më lokale, që do të zotohen për besnikëri ndaj Shtetit Islamik dhe liderit të tij, Abu Bakr al-Baghdadi³¹.

³¹ Grupet në vende si Sinai, Algjeria dhe Arabia Saudite tashmë janë betuar për besnikëri për Bagdadin, dhe ekspertë në Libi kanë paralajmëruar se qyteti lindor Derma po shfaqet si një fortesë e Shtetit Islamik. Më shumë grupe separatiste në Kaukazin Verior të Ruisë mund të zotohen për besnikëri ndaj IS-it, derisa ndikimi në rritje i grupit militant vazhdon të destabilizojë dhe fragmentojë kryengritjen në atë rajon.

KAPITULLI III: TERRORIZMI, KUPTIMI I FENOMENIT DHE TENTATIVAT PËR NJË PËRKUFIZIM JURIDIK UNIK

3.1. Hyrje

Lufta kundër terrorizmit në këto kohët e fundit po konsiderohet një nga sfidat më të mëdha, me të cilat përballet rendi ligjor. Terrorizmi është një ndër krimet të rënda. Ai nuk mund dhe nuk duhet të lidhet në asnjë mënyrë me ndonjë kombësi, përkatësi fetare apo etnike. Komuniteti ndërkombëtar ka theksuar në një sërë rastesh, se e dënon me forcë terrorizmin, me të gjitha format dhe mënyrat që ai manifestohet, nga kushdo dhe kudo dhe për çfarëdo qëllimi, si një ndër kërcënimet më serioze të paqes dhe sigurisë në mbarë botën³². Po ashtu, komuniteti ndërkombëtar ka hedhur poshtë me forcë identifikimin e terrorizmit me çfarëdo kombësie, përkatësi fetare apo etnike³³. Ndonëse në jurisprudencën ndërkombëtare nuk gjen ndonjë përkufizim të pranuar botërisht për sa i përket terrorizmit, për ta etiketuar një akt si “terrorizëm” do të thotë të vërtetosh jo vetëm që ai mbart disa karakteristika, por gjithashtu që nuk mund të përligjet nga asnjë konsiderate politike, filozofike, ideologjike, racore, etnike apo fetare³⁴. Megjithatë, ka një nocion të kontestuar, sipas të cilit legjitimohet përdorimi i disa formave të dhunës në rrethana të vecanta dhe se ky përdorim në këto rrethana nuk

³²Asambleja e Përgjithshme e OKB-së “The United Nations Global Counter-Terrorism Strategy” [Strategjia globale e Kombeve të Bashkuara në luftën kundër terrorizmit], Dokumenti A/RES/60/288, 2006, <http://www.un.org/en/terrorism/strategy-counterterrorism.shtml>, aksesuar në datë 03.06.2015.

³³OSBE Këshilli Ministror, “Charter on Preventing and Combating Terrorism” [Karta për parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit], Porto, 7 dhjetor 2002 <http://www.osce.org/odihr/16609>, aksesuar në datë 1.11.2014.

³⁴Shih p.sh., Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, “Declarations on Measures to Eliminate International Terrorism” [Deklarata për masat në lidhje me eliminimin e terrorizmit ndërkombëtar], Dokumenti A/RES/49/60, 1994, para. 1; dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së1373 (2001), para. 3, dhe 1566 (2004).

duhet të konsiderohet si terrorizëm³⁵. Për më tepër, një përkufizim më i gjerë nga ç' duhet i terrorizmit mund të shpërdorohet për të shtypur kundërshtimet paqësore dhe të paracaktoshë minimin e shoqërisë demokratike. Ndaj edhe përcaktimi i një përkufizimi të saktë mbi terrorizmin, përbën një element me shumë rëndësi në luftën me sukses kundër terrorizmit, duke garantuar përputhshmëri me sundimin e shtetit ligjor dhe me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kjo nuk ka të bëjë thjesht dhe vetëm me konotacionin politiko-moral të termit. Aplikimi i termit mbart gjithashtu implikime të rëndësishme, qoftë në kuadrin kombëtar, qoftë në arenën ndërkombëtare³⁶, për sa i takon p.sh, këndvështrimin ligjor për shkëmbimin e informacionit, garantimin e asistencës reciproke juridike, ngrirjes dhe konfiskimit të asetëve dhe ekstradimit. Teksa vendet e ndryshme mundohen të gjejnë mënyra për parandalimin me efikas të terrorizmit, po shtohen njëkohësisht përpjekjet për të kuptuar pse dhe kur individët kthejnë sytë nga terrorizmi, si ndodh kjo dhe mënyrat sesi kjo mund të parandalohet që në fillesat e veta. Terrorizmi ndodh në shumë kontekste të ndryshme dhe shpaloet në po aq forma. Ndër karakteristikat e zakonshme të tij përfshihen:

- rreziku (për jetën, shëndetin ose pronën);
- përpjekja për minimin e qëllimshëm të rendit kushtetues dhe qeverisjes demokratike, kryesisht përmes përpjekjeve për influencimin e politikave dhe hartuesve të ligjeve; dhe
- një përjasje pa dallim ndaj përzgjedhjes së objektivave, me qëllim mbjelljen e frikës dhe terrorit në popullatë.

³⁵Ka pasur shpesh një argument që përdorimi i dhunës, që përndryshe mund të konsiderohet si terrorizëm, është legjitim në ndjekje të vetë-vendosjes, pavarësisht apo si rezistencë ndaj pushtesit të huaj. Shih OSBE/ODIHR, Countering Terrorism, fq. 23.

³⁶Sipas kësaj logjike, Këshilli i Sigurimit i OKB-së, në rezolutën e vet nr. 1566 (viti 2004) përdor tre kriterë përmbledhës për të karakterizuar terrorizmin: (i) (synimi); (ii) qëllimi; dhe (iii) sjellja specifike.

Aktet terroriste janë veprime kriminale³⁷ dhe rrjedhimisht, janë pjesë e tagrit të sistemit të drejtësisë penale. Standardet e të drejtave të njeriut do të zbatohen pavarësisht nëse një incident i caktuar konsiderohet si akt terrorist apo nje vepër tjetër që hyn në kategorinë e krimeve të rënda.

Një zgjidhje në lidhje me vështirësinë për përkufizimin e terrorizmit mund të jetë dhe përqëndrimi tek parandalimi dhe/ose ndëshkimi i sjelljeve me natyrë të mirëfilltë terroriste. Ndonëse ende bashkësia ndërkombëtare nuk ka mundur të gjejë konsensus mbi definicionin e terrorizmit, është rënë dakord që disa akte përbëjnë akte terroriste³⁸.

Ato janë konkretisht:

- i. Vepra penale kundër civilëve, të kryera me synimin e shkakimit të vdekjes apo dëmtimeve të rënda trupore, apo rrëmbimet e personave,
- ii. Pavarësisht nëse është i motivuar nga konsiderata politike, filozofike, ideologjike, racore, etnike, fetare apo të ndonjë natyre të ngjashme, me qëllimin e provokimit të një gjendjeje terrori tek publiku i gjerë, tek një grup individësh, apo individë të vecantë, frikësimin e popullatës apo duke detyruar një qeveri apo organizatë ndërkombëtare të kryejë apo të mos kryejë një veprim; dhe:
- iii. vepra që përbëjnë krime nën dritën dhe sipas përshkrimit të konventave dhe protokolleve ndërkombëtare në lidhje me terrorizmin. Qasja përmbledhëse e aplikuar në rezolutën nr. 1566 për përkufizimin e terrorizmit³⁹ u mbështet nga Raportuesi i parë i

³⁷Këto krime si p.sh. (rrëmbimi/marrja peng e një avioni) tashmë janë objekt i 18 konventave dhe protokolleve ndërkombëtare të miratuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) apo agjencitë e saj.

³⁸Negociatat brenda OKB-së vazhduan për një projekt-konventë gjithëpërfshirëse mbi terrorizmin, ku do të përfshihej edhe një përkufizim mbi terrorizmin. Për më shumë informacion në lidhje më punën e komitetit të përkohshëm të ngritur nga Asambleja e Përgjithshme, Rezoluta 51/210, shih <<http://www.un.org/law/terrorism>>.

³⁹Rezoluta nr. 1566 (2004) miratuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, në takimin e vet nr. 5053, më 8 tetor 2004 (S/RES/1566 (2004), <[http://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/RES/1566\(2004\)](http://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/RES/1566(2004))>. Kjo rezolutë nuk është ligjrisht e detyrueshme.

Posacëm i Kombeve të Bashkuara për nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në përballjen me terrorizmin⁴⁰. Ai theksoi gjithashtu se, përkufizimet e legjislativioneve vendase, në lidhje me terrorizmin, mund të përfshinin me legjitimitet të plotë sjellje të tjera, në kombinim me dy kriteret e para, d.m.th., të synimit dhe qëllimit, të evidentuara në rezolutën nr. 1566. Terrorizmi dhe krimet që lidhen me atë, duhet të gjejnë shprehje të qartë në legjislativionin vendas, me saktësi, në mënyrë jodiskriminuese dhe pa prapaveprim. Ligjet dhe rregulloret përkatëse duhet të vihen në dispozicion të publikut të gjerë dhe duhet të zbatohen me përpikmëri dhe transparencë nga autoritetet publike, duke përfshirë policinë dhe gjyqësorin. Kjo do të përbënte një parakusht që njerëzit ta kuptonin ligjin dhe rrjedhimisht, të përshtatin sjelljen e tyre. Kjo është po kaq e rëndësishme për sigurimin e bazës për veprime efikase dhe të përgjegjshme kundër terrorizmit, duke përfshirë veprimet e ndërmarra nga policia, në përputhje me veprimin e shtetit ligjor dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Terrorizmi drejtuar kundër shtetit është shfaqur veçanërisht në format e mëposhtme:

- a) Si praktikë kundër regjimeve diktatoriale dhe synonte përmbysjen e tyre dhe riinstalimin e demokracisë apo në disa raste dhe zëvendësimin e një diktature nga një diktaturë tjetër. Ky këtu është rasti i vetëm që mund të pranohet nga fuqitë politike të Evropës Perëndimore, që terrorizmi mund të ketë dimensione politike dhe etike.
- b) Si praktika të separatizmit apo lëvizjeve fetare dhe politike që kanë për qëllim autonominë e zonave të veçanta ose krijimin e shteteve të reja⁴¹.

⁴⁰Raporti i Raportuesit të Posacëm të OKB-së mbi nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, në përballje me terrorizmin, Martin Scheinin, "Ten areas of best practices in countering terrorism" [Dhjetë fusha të praktikave më të mira në përballjen me terrorizmin], Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, seanca 16 e Këshillit të të drejtave të njeriut, 22 dhjetor 2010, Dokumenti A/HRC/16/51.

⁴¹ Separatistët Rus në Ukrainën juglindore gjatë luftës që akoma është në zhvillim në atë rajon, përkrahur nga Rusia, Grupet ekstremiste Cecene në Rusi, ISIS në lindjen e Mesme, ETA në Spanjë, IRA në Irlandë etj.

c) Si një propozim alternativ politik brenda demokracive, terrorizmi i zhvilluar kryesisht në vitet 1970 në Europë, ndonjëherë me shfaqje në dukje të aplikimit të metodës së dhunës së verbër ndaj qytetarëve të pafajshëm, nganjëherë si një praktikë që është pjesë e një plani afatgjatë për të përmbysur sistemin ekzistues social-politik dhe zëvendësimin nga një tjetër, te ideuar si më të drejtë dhe nganjëherë si diçka e kufizuar thjesht në ngacmimin e sistemit social-politik për të nxjerrë në sipërfaqe të metat dhe problemet që ky i fundit ka⁴². Në çdo rast dhuna e ushtruar është e përfshirë në një "*planifikimi strategjik*" të grupeve të organizuara, me një program të veçantë, që realizohet ekskluzivisht në fazë të parë, me përdorimin e dhunës. Nuk përjashtohen natyrisht dhe ndryshime në programe të këtyre organizatave me formën e përparësive, mjafton vetëm të ruhet karakteri mohues i sistemit aktual politikosocial. Në këtë formë të terrorizmit përfshihen edhe rrjetet ndërkombëtare terroriste që janë zhvilluar gjatë viteve të fundit, të cilat kanë anëtarësi të organizuar në shumë shtete dhe që zhvillojnë veprimtarinë e tyre kundër shumë vendeve të tjera. Këto rrjete me siguri që kanë mundësinë gjithmonë të përdorin instrumenta të tjerë alternativë në veprimtarinë e tyre terroriste, por duhet të karakterizohen me një tipar kryesor, atë të përdorimit të dhunës verbale për të zbatuar programin specifik politik të ndryshimit, ose për të sfiduar strukturat sociopolitike që zbatohen në të gjitha vendet kundër të cilave drejtohen. Këtu nënkuptohen rrjetet dhe organizata raciste apo te fanatikëve fetarë (radikalizmi ekstrem), nga momenti që i kundërvihen rendit kushtetues dhe lirive themelore të njeriut si baza e demokracive të konsoliduara.

d) Si terrorizëm i importuar, dmth kur në territore evropiane transportohen në formën e çështjeve të "terrorizmit të importuar" nënkuptohen cka kanë të bëjnë me vendet e treta.

⁴² Këtu bëhet fjalë për aktivitetin e organizatave terroriste si Armata e Kuqe në Gjermani, Armata e Kuqe në Itali ose 17 Nëntori në Greqi.

Fenomeni i "terrorizmit" në këtë formë paraqet veçori pasi nuk është i drejtuar kundër pushtetit shtetëror të vendit në të cilin manifestohet⁴³.

dh) Së fundmi, ne duhet të përmendim rastin e një terrorizmi të veçantë, ku kufijtë e tij përcaktohen midis hapësirës politike dhe ligjit penal. Është rasti i terrorizmit që nuk ushtrohet nga shteti, dhe as kundër tij, por që ka qëllim tjetër, dhe fillon t'i kundërvihet shoqërisë (*terrorizmi horizontal*), për të arritur pushtetin kryesisht për përfitime ekonomike. Këtu bën pjesë praktika e ndjekur nga shumë organizata kriminale të quajtura si "mafia" në Itali, "jakuza" në Japoni, etj., veprimtaria e të cilave nuk është e drejtuar kundër shtetit dhe as ka për qëllim përmbysjen e sistemit ekzistues ekonomik-sociopolitik, pasi pikërisht falë tij ato ekzistojnë, por duan të përfitojnë nga ky.

3.2. Koncepti juridik i terrorizmit

Koncepti i terrorizmit siç u përmend edhe më parë i detyrohet shumë Jakobinëve gjatë Revolucionit Francez⁴⁴. Lëvizja e Jakobinëve mbështeti demokracinë në formën e votës universale, si dhe në rëndësinë e saj të një shkalle të lartë në jetën publike dhe private. Kjo periudhë është ende e lidhur me dominimin e dhunës dhe terrorizmit, që ndoshta shpjegon universalisht shkaktimin e emocioneve negative që lidhen me këtë koncept. Me konceptin e terrorizmit janë zhvilluar shumë studime të natyrës së përgjithshme, të tilla si të Clutterback⁴⁵, të Crenshaw⁴⁶, të Hoffman⁴⁷, të Laquer⁴⁸, prej Kegley⁴⁹, prej Rubenstein⁵⁰, prej Sshlaghek⁵¹, të Wieviorka⁵². Teoria

⁴³ Rasti i Armenëve që jetonin në emigrim.

⁴⁴ Shiko më lart në KREUN I

⁴⁵ Clutterback, R., (1994), *Terrorism in an Unstable World*, Routledge

⁴⁶ Crenshaw, M., (botimi.), (1995), *Terrorism in Context*, Penn State University Press

⁴⁷ Hoffman, B., (1999), *Inside Terrorism*, Columbia University Press

⁴⁸ Laquer, W., (1999), *The New Terrorism: Fanaticism and the Arms of Mass Destruction*, Oxford University Press, & Laquer, W., (2003), *No End to War: Terrorism in the 21st Century*, Continuum International Publishing

moderne e terrorizmit shtrihet në një sërë analizash të rëndësishme, të tilla si të Adkinson etj⁵³, të Enders⁵⁴ dhe Merari⁵⁵. Disa studime të tjera shqyrtojnë marrëdhëniet mes ngjarjeve terroriste dhe konflikteve të tjera politike, të tilla si të O'Brien⁵⁶. Shumë monografi dhe koleksione artikujsh të ndryshëm analizuan format specifike të terrorizmit, si terrorizmi islamik⁵⁷. Gjithashtu edhe revista akademike kanë përfshirë në faqet e tyre analiza akademikësh që kanë të bëjnë me konceptin, si revista prestigjioze *Terrorism and Political Violence*, si dhe baza të dhënash si *International Terrorism: Attributes of Terrorist Events* dhe *The Rand-St Andrews Chronology of Terrorism*, te të cilat çdokush mund të referohet për një kronologji të sulmeve terroriste.

Komisioni i posaçëm i Departamentit amerikan të Drejtësisë, që në mes të viteve 1970-të vinte në dukje se: “Një problem themelor i kuptimit që ne kemi për terrorizmin është vetë përkufizimi i tij. [...] Mungesa e saktësisë në përdorimin e tij i ka shtyrë disa të besojnë se koncepti nuk mund të ketë një përkufizim konkret brenda një konteksti

⁴⁹Kegley, C.W., (2002), *The New Global Terrorism: Characteristics, Causes, Controls*, Prentice Hall

⁵⁰Rubenstein, R.E., (1988), *Alchemists of Revolution: Terrorism in the Modern World*, Basic Books

⁵¹Schlagheck, D.M., (1988), *International Terrorism: An Introduction to the Concepts and Actors*, Rowman & Littlefield

⁵²Wieviorka, M., (1993), *The Making of Terrorism*, University of Chicago Press

⁵³Atkinson, S.E., Sandler, T., Tschirart, J.T., (1987), Terrorism in a Bargaining Framework, *Journal of Law and Economics*, vepra. 30, nr. 1, fq. 1-21

⁵⁴Enders, W., Sandler, T., (1995), Terrorism. Theory and Application, te Hartley, K., Sandler, T., (botimi.), *Handbook of Defense Economics*, vol. 1, Elsevier, fq. 213-249, & Enders, W., Sandler, T., (1999), Transnational Terrorism in the Post-Cold War Era, *International Studies Quarterly*, vol. 43, nr. 1, fq. 145-167, & Enders, W., Sandler, T., (2000), Is Transnational Terrorism Becoming More Threatening, *Journal of Conflict Resolution*, vol. 44, nr. 3, fq. 307-332

⁵⁵Merari, A., (1993), Terrorism as Strategy of Insurgency, *Terrorism and Political Violence*, vol. 5, nr. 4, fq. 213-251

⁵⁶O'Brien, S.P., (1996), Foreign Policy Crises and the Resort to Terrorism, *Journal of Conflict Resolution*, vol., 40, fq. 320-335

⁵⁷Laqueur, W., (bot.), (2005), *Voices of Terror: Manifestos, Writings and Manuals of Al Qaeda, Hamas and Other...*, Reed Press, & Bascio, P., (2007), *Defeating Islamic Terrorism: The Wahhabi Factor*, Branden, & Perry, M., Negrin, H.E., (bot.), (2008), *The Theory and Practice of Islamic Terrorism: An Anthology*, Palgrave, & Springer, D.R., Regens, J.L., Edger, D.N., (2009), *Islamic Radicalism and Global Jihad*, Georgetown University Press, & Kepel, G., (2008), *Beyond Terror and Martyrdom: The Future of the Middle East*, Harvard Belknap.

normativ. [...] Pjesë e problemit është kategorizimi që ne i bëjmë atij si një aktivitet në thelb kriminal. Në fakt terrorizmi është në teknikë. [...] Terrori është një fenomen inatyrshëm; ndërsa terrorizmi është shfrytëzimi i vetëdijshëm i terrorit. Terrorizmi është imponues, i ideuar për të manipuluar vullnetin e viktimave të tij dhe audiencën më të gjerë. Vetë natyra e krimin prodhon një shkallë kaq të lartë frike, nëpërmjet aktit të kryerjes së veprës [...] ose nëpërmjet indiferencës që ky akt tregon për jetën njerëzore. Kjo frikë e tmerrshme përbën burimin e fuqisë së terroristit dhe i komunikon sfidën e tij shoqërisë”. (Hide, 2010: 12-13)

Në mënyrë të ngjashme, agjencitë qeveritare të sigurisë, të tilla si FBI dhe CIA-s publikojnë listat e organizatave politike të përfshira në akte terroriste dhe bashkangjitur vlerësimi i rrezikshmërisë së tyre. Me termin *terrorizmëm* nënkuptojmë përdorimin e dhunës për të arritur objektiva politike. Në komunitetin akademik është arritur dakordësia mbi kuptimin e termit në vija të përgjithshme (Schmid, 1992, 13). Përkundrazi, hartuesit e politikave nuk shqetësohen për rëndësinë e kuptimit-definimit të konceptit, sepse tashmë të gjithë janë koshient dhe njihet botërisht se për shkak të konflikteve ideologjike, linden pasoja të rëndësishme në praktikë. Me fjalë të tjera, ka mendime të ndryshme për atë se kur një akt i dhunshëm është një akt terrorist. Aktualisht prandaj nuk ka asnjë përkufizim të pranuar universalisht të terrorizmit, me pasojë vështirësi direkte për t'u përballur me të (Hide, 2010: 12-13). Në një analizë të literaturës ekzistuese vërehet se përkufizimet e konceptit të terrorizmit vijnë kryesisht nga tre grupime faktorësh. Në grupin e parë bëjnë pjesë organet e pushtetit dhe veçanërisht ato shtetërore. Në grupin e dytë institucione të ndryshme akademike dhe në grupin e tretë bëjnë pjesë ata që i përkasin këtij lloji të organizatave terroriste, dhe simpatizuesit e tyre. Grupi i parë, shteti, zakonisht përkufizon terrorizmin në një mënyrë

të tillë që të favorizojë politikat e tij, duke synuar parandalimin e sulmeve të cdo lloji të prejardhura nga ata që vlerëson si kundërshtarët e tij, duke krijuar përkufizime dhe miratuar ligjet pa i dhënë konsideratë dhe mundësisë se dhe vetë ai (shteti) është subjekt i mundshëm për të ushtruar terrorizëm. Një qeveri mundet pak a shumë, të konsiderojë apo definojë terrorizmin si dhunë kundër vetë asaj, pa marrë parasysh faktin se e njëjta lloj dhune mund të ushtrohet nga ajo. Grupi i dytë, komuniteti i hulumtimit akademik, ka një tendencë shqyrtimi të distancuar të çështjes dhe të një kompromisi, por gjithmonë, pa munguar mosmarrëveshjet. Së fundi, terroristët dhe përkrahësit e tyre, si dhe shteti, nuk e pranojnë në asnjë moment se ushtrojnë aktivitet të dënueshëm (*të padrejtë*) terrorist, dhe konsiderojnë (përveç shtetit) se e vetmja formë e terrorizmit që ekziston është ajo e veprimtarisë së gjerë shtetërore. Përfundimi nga ky konfrontim me temë kuptimin e konceptit (*definimit konceptual*) përmbledhet në frazën që ka prejardhur nga mendimet e të gjithë atyreve që janë përfshirë në analizën e fenomenit të terrorizmit: *one man's terrorist is another man's freedom fighter* – njëri është terrorist dhe tjetri lufton për liri. Një fenomen trishtues dhe rrjedhojë e progresit teknologjik është varësia e madhe e botës perëndimore ndaj teknologjisë. Çdo ndërprerje e progresit teknologjik apo shërbimeve të saj do të kishte efekte të pakëndshme mbi mënyrën e jetesës sonë. Varësia jonë nga sistemet kompjuterike për menaxhimin e shërbimeve publike, të rrjeteve të komunikimit dhe tregjeve të aksioneve, si dhe varësia jonë nga energjia e centraleve bërthamore, u jep terroristëve alternativën e zgjedhjes së objektivave dhe aftësinë të mundësojnë paralizimin e qendrave nervalgjike të rendit tonë shoqëror. Ky është objektivi i luftës. Në mënyrë të ngjashme, përparimet në teknologji lejuan grupet e trajnuara mbi teknologjinë, të cilat nuk kanë mjete të tjera për të arritur qëllimet e tyre, të jenë terroristë jashtëzakonisht efektivë. Teknologjia siguron

mjetet, armët dhe *çelësin* për të arritur suksesin. Avionët komercialë transportojnë pasagjerë (po ashtu dhe terroristët) në mbarë botën, por në të njëjtën kohë mund të rezultojnë dhe një mjet-armë vdekjeprurëse. Digat e Rezervuarve të ujit janë zona të akumulimit të ujit, për përdorim në të ardhmen, por mund të ndryshohet destinacioni funksional i tyre në një mjet shkatërrimi apokaloptik, duke i hapur dhe shkaktuar përmbetje të madha në zona urbane. Centralët bërthamore sigurojnë energji elektrike me kosto të lirë, por mund të rezultojnë dhe burim rreziku radioaktiv për dekada të tëra. Lista e përdorimeve të mundshme negative të sistemeve ekzistuese të teknologjisë është pothuajse e pakufizuar, dhe bazohet në dualitetin e përdorimit të teknologjisë.

3.3. Nevoja e domosdoshme e përkufizimit të terrorizmit.

Fenomeni i terrorizmit, ka ekzistuar për mijëra vjet dhe është një fenomen i njohur edhe në shumë pjesë të botës, po t'i referohemi atyre nga pikëpamja gjeografike. Dy ngjarje të rënda të kësaj periudhe që ndryshuan tërësisht perceptimin e fenomenit, për të zgjedhur dhe hartuar strategjitë dhe politikat parandaluese, ishin sulmet terroriste të 11 Shtator 2001 në Nju Jork⁵⁸ si dhe dërgesa e zarfeve postare me dioksid karboni që pasuan menjëherë pas kësaj⁵⁹. Sulme të tjera vijuese janë shënuar ndër vite, edhe në

⁵⁸ Në vjeshtën e 2001-it, sulmet terroriste në SHBA që mori përsipër AL KAIDA, zgjuan amerikanët dhe i bëne ata të vetëdijshëm për tashmë rrezikun real që i kërcënohej vendit të tyre nga terrorizmi. Për shumë vende dhe popuj të tjerë të botës, terrorizmi ishte një fenomen n.q.s., mund ta themi dhe kështu, më i njohur tashmë, për të vetmen arsye, se ata i kanë përjetuar pasojat e tij dhe janë përgjakur nga ky i fundit. Kjo është, për më tepër, një sjellje, një fenomen, një instrument dhe mjet ushtrimi presioni politik që ka ekzistuar për mijëra vjet.

⁵⁹ Theodore Kaczynski (*Unabomber*) dërgoi zarfe të mbyllur, me dioksid karboni, në adresë të disa profesorëve të universiteteve, të drejtuesit organizativë të disa kompanive të linjave transportuese ajrore dhe drejt objektivëve të tjere për një periudhë 20 vjecare. Aktet e Kaczynskit, të një të vetëquajtur "terroristi", ishin një shprehje e kundërshtisë të tij për rolin në rritje të teknologjisë moderne në jetën sociale dhe ndikimin e saj në shoqëri. Te Kaczynski ishte diagnostikuar "skizofreni paranojake" (*paranoid schizophrenia*) dhe, në 1998, ai u deklarua fajtor për shkelje të ligjeve federale që rregullonin sistemin postar amerikan duke përdorur lëndë shpërthyes në mënyrë të paligjshme.

kohët e fundit⁶⁰. Shkenecat humane dhe shkenecat sociale kanë kontribuar prej shumë kohë për të ndihmuar në: a) mbledhjen dhe analizën e të dhënave të dala nga shërbimet sekrete (*të dhëna të inteligjencës*), b) të kuptuarit e terrorizmit dhe zhvillimin e strategjive për të luftuar fenomenin (Paul K. Davis, et al. 2009, fq.78)

Debati mbi një përkufizim të terrorizmit, si në SHBA, ashtu edhe në kuadër të Bashkimit Europian (dhe shteteve anëtare), ka filluar të zhvillohet me intensitet të lartë kryesisht nga viti 2001. Baza ligjore ishte vendosur tashmë në Traktatin themelues të Bashkimit Evropian. Në nenin 29 të Traktatit i cili është përcaktuar si një nga objektivat e Bashkimit Europian për t'u siguruar qytetarëve një nivel të lartë sigurie brenda zonës së lirisë (hapësirës europiane), për t'u garantuar drejtësinë duke deklaruar se ky objektivi do të arrihet me anë të ndërveprimit të përbashkët mes Shteteve Anëtare në fushën përfshirëse të bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale. Parlamenti Europian miratoi në 2001/09/05 Rezolutën mbi rolin e Bashkimit Europian në luftën kundër terrorizmit, duke i bërë thirrje Këshillit për të përafuar dispozita legjislative për

⁶⁰ Një shembull tjetër është dhe John Salvi⁶⁰, një berber i papunë nga New Hampshire, i cili sulmoi dy klinika të planifikimit familjar në rrethinat e Bostonit dhe Brookline, duke lënë të vranë nga sulmi dy vetë dhe duke plagosur pesë të tjerë. Sulmet e Salvit ishin realisht mbështetja praktike e pikëpamjeve të tij kundër abortit (views antiabortion). Në gjyqin e tij, 1995-1996, mbrojti versionin e papërgjegjshmërisë penale, si instrument i vetëm i një mbrojtje ligjore gjatë procesit gjyqësor, për t'u përballur me akuzat për vrasje me paramendim (*first-degree murder*), por pa sukses, pavarësisht nga dyshimet e bazuara që vërtetnin një çrregullim psikotik (*psychotic disorder*) që përfshinte si pasojë iluzionet (*delusions*) në idenë e persekutimit të katolikëve nga ana e Masonëve (Freemasons) dhe të tjerët. Në shkurt të vitit 2010, Andrew Joseph Stack, rrëzoi me qëllim dhe vetëdije një aeroplan privat në ndërtesën e Inland Revenue (*Internal Revenue Service, IRS*) në Austin, Teksas⁶⁰, pasi më parë kishte djegur shtëpinë e tij. Agresori para se të kryente sulmin vetvrasës, la një shënim gjashtëfaqësh, duke shpjeguar në detaje se si sistemi i taksave e detyroi të ndërmerre kete akt, si mjete i vetëm dhe i fundit për të reaguar, akt që coi në vdekjen e tij dhe të një punëtori të pafajshëm 68 vjeçar. Në nëntor të vitit 2009, një doktor psikiatër ushtarak Nidal Hasan hapi zjarr në një qendër mjekësore të bazës ushtarake në Fort Hood, Teksas⁶⁰ ku vizitoheshin ushtarë amerikane të cilët me pas do të dërgoheshin me misione ushtarake në Irak apo Afganistan. Nga sulmi u vranë 13 vetë dhe u plagosën së paku 28 të tjerë. Gjatë gjykimit, i pandehuri u mbrojti me tezën e çrregullimit mendor. Hasani, një mysliman i cili mbante kontakt të rregullt me klerikët radikalë dhe pavarësisht pikëpamjeve të shprehura se lufta kundër terrorizmit ishte luftë kundër Islamit, do të dërgohej nga Ushtria Amerikane në Irak ose Afganistan. Nëse aktet e Kaczynski, të Salvi, Stack dhe Hasan duhet të kategorizohet si akte terroriste, pavarësisht shkallës së ndryshme të çrregullimit psikologjik apo diagnostimit mjekësor, është subjekt i polemikave të vazhdueshme mes qarqeve juridike.

themelimin e rregullave minimale në lidhje me elementët përbërëse të terrorizmit dhe të dënimeve. Këshilli miratoi në 2001/07/12, Vendimin Kuadër. Në vendimin e mësipërm, një numër konsiderueshem i krimeve të rënda të së drejtës penale tradicionale, si p.sh. cënimi i të drejtës së jetës me anë të një sulmi që mund të shkaktojë vdekjen, dëmtime serioze të integritetit fizik ose që shkaktojnë ose synojnë mosfunksionim normal të qeverisë së zgjedhur, dëmtime të infrastrukturës publike, sistemit të transportit, etj, përcaktohen si akte terroriste nga një element objektiv "rrethanat që mund mund të dëmtojë seriozisht një vend apo një organizatë ndërkombëtare" dhe një element subjektiv, qëllimi i autorit të aktit që s'është vecse a) përcjellja e ndjesisë së frikës dhe terrorit në një popullsi b) imponimi i paligjshëm kundrejt një qeverie apo një organizatë ndërkombëtare të kryejë apo të mos kryejë një veprim c) të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat politike, të minojë rendin kushtetues, sistemin ekonomik dhe të ndryshojë renditjen e vlerave dhe antivlerave në një sistem social të një vendi apo një organizatë ndërkombëtare. Rritja e terrorizmit, duke arritur kulmin me sulmin e 11 shtatorit të 2001-it në SHBA, krijoi nevojën e domosdoshme për masa më të rrepta dhe të studiuara për efikasitetin e tyre dhe për sigurinë e qytetarëve.

Nuk ka asnjë përkufizim të vetëm të terrorizmit që kap mënyrë adekuate konceptin.

Vihet në dukje se, në tërësi, përkufizimet e ndryshme të terrorizmit përfshijë të gjithë të njëjtët elementë "(a) përdorimin e shtrëngimit (*force*) ose dhunës (*violence*) (b) nga individë ose grupe (Michael B. Kraft and Edward Marks 2012, 209) (c) i cili është i drejtuar në drejtim të popullsisë civile (d) ka për qëllim që të ngjalli frikën (e) si instrument presioni kundër individëve ose grupeve individësh që të ndryshojnë qëndrimet politike apo sociale. Përkufizimi i terrorizmit në fakt ndryshon disi ndërmjet departamenteve qeveritare, në varësi të fokusit të detyrave të tyre. Për shembull,

Ministria e Drejtësisë (Departamentit të Drejtësisë Amerikane) [DOJ], e definon terrorizmin si *"përdorimin e paligjshëm të shtrëngimit ose dhunës kundër, personave apo pronës, për të frikësuar apo të detyruar një qeveri, popullsinë e qytetarëve ose ndonjë pjesë të saj, për të promovuar politikat ose objektivat sociale."* Qendra Kombëtare e Antiterrorizmit (NCTC) një qendër brenda Zyrës së Drejtorisë të Inteligjencës Kombëtare (National Intelligence), i themeluar më 27 gusht 2004 nga Amendamenti nr. 13 354, si një *"Qendër për planifikimin e përbashkët operacional dhe mbledhjes së informacionit, e drejtuar nga personel i përthithur nga shërbime të ndryshme shtetërore"*, në një përpjekje për të koordinuar dhe integruar mbledhjen dhe përpunimin e informacionit nga të gjitha shërbimet (Gregory F. Treverton 2009, 287). Në vitin 2004, u kodifikua në Ligjin për Reformën e Sektorit të Koleksionimit të Informacionit Sekret dhe Parandalimin e Terrorizmit (Intelligence Reform and Terrorism Prevention Act). NCTC e përkufizon terrorizmin si *"dhunë e paramenduar (premeditated) dhe e motivuar politikisht, ushtruar kundër objektivave civile, nga grupet nën-kombëtare (subnacionale) ose nga agjentë të fshehtë, që ka për qëllim manifestimin-deklarimin ose, fjalë për fjalë në përkthim, publikimin (pulicizing) e një qëllimi politik ose fetar"*. Megjithëse përkufizimet e DOJ-së dhe NCTC-së ndryshojnë në një farë mase, përfshijnë të dy të njëjtët elementë (a) një ose më shumë akte dhune, dhe (b) veprimtaria përqëndrohet në qëllime apo motive që fshihen prapa aktit apo akteve të dhunës, domethene pranojnë karakterin poliko-social të fenomenit. (Hoffman 2006, 28)

Këto përkufizime janë lehtësisht të përshtatshme në disa raste, por më vështirësi për t'u aplikuar kur shqyrtohet në detaje "qëllimi" dhe "motivi" (motivation). Në nivelin më të dukshëm, sulmet e 11 shtatorit në Nju Jork dhe Uashington ishin akte dhune me

motive social-politike, të kryera nga një grup njerëzish, të planifikuar dhe ekzekutuar nga një organizatë me misionin e vetëm, sulmet kundër Shteteve të Bashkuara dhe qytetarëve të këtij vendi. Linjat ndarëse ndërmjet terrorizmit iniciuar fale shtysave politike, sociale dhe fetare dhe krimeve dhe akteve të dhunës që rezultojnë të kryhen duke u justifikuar nga një ç'rregullim serioz psikologjik (*psychological, disturbance*) nuk janë gjithmonë të qarta. Dallimi i tyre është i bazuar kryesisht në gjetjen e motiveve të autorëve të krimit, të cilat mund të jenë të shumta në një rast të caktuar. Pyetjet që lindin natyrshëm janë. Çfarë ndodh kur motivet politike apo sociale të aktit të dhunës që burojnë kryesisht ose tërësisht nga diagnostikimi i një çrregullimi psikologjik? Për qëllim të të kuptuarit të fenomenit të terrorizmit, duhet që aktet e dhunës të këtij lloji të klasifikohen si akte terroriste apo si akte dhune të lidhura ngushtë me sëmundje mendore? Nga perspektiva e drejtësisë penale, ekzistenca e çrregullimit mendor ose stimujve temperamental (idiosyncratic), për mendimin tim, nuk ka gjasa dhe nuk duhet të ndikojë në përcaktimin e llojit të akuzës që do t'u artibuhet kryerësve të krimeve që parashikohen në përkufizimet e ligjit të terrorizmit si akte terroriste. Në raste të tilla, mbrojtja e të pandehurit mund të kërkojë deklarimin e papërgjegjshmërisë (*ose insanity defense*). Pyetja bëhet më e rëndësishme kur përpiqemi për të vërtetuar me saktësi prevalencën e terrorizmit dhe se çfarë duhet të bëjmë në lidhje me këtë problem, dhe kur ne vendosim se si ne duhet të vlerësojmë një ngjarje të caktuar. Dërgesa postare e zarfeve me dioksid karboni (Richard Jackson-Samuel Justin Sinclair 2012, 120), të cilat ekspertet u referohen si Amerithrax, vërtetojnë vështirësinë karakteristike të aplikimit të përkufizimit. Bruce Edwards Ivins, një hulumtues i lartë dhe oficer politik në Institutin e Kërkimeve Mjekësore të ushtrisë amerikane të Sëmundjeve Infektive (*Medical Research Institute*), është identifikuar si autor i vetëm i këtyre sulmeve.

Megjithëse motivet e tij kurrë nuk mund të qartësohen plotësisht, duket se një prej tyre ishte përpjekja për të promovuar punën e tij në lidhje me shpikjen e tij, të përmirësonte pozitën dhe reputacionin mes qarqeve shkencore që bënte pjesë dhe gjithashtu për të stimuluar financimin e projektit të tij (*biodefense*). Kjo duke shkaktuar frikë, duke përhapur terror mes popullatës në mënyrë që gjendja e krijuar të ndikonte në politikën e qeverisë. Sulmet ishin thjesht një akt kriminal i iniciuar nga agresori dhe që do t'i konsiderojmë si një veprim të paligjshëm, që mund të gjejë përshtatje dhe ngjan në një nga veprat penale “*tradicionale*” si p.sh., shantazhi, njëpërpjekje e dështuar, sipas pikëpamjes së agresorit, për të ndikuar në strategjitë dhe politikat qeveritare apo një produkt i ç'rregullimit mendor?

Përkundër mungesës së provave që do të vërtetonin hipotezën se Dr. Ivins ishte duke u përpjekur për të ndikuar një axhendë politike apo fetare, të paktën një nga qëllimet parësore, dukshëm, është shkaktimi i frikës mes popullatës civile dhe përpjekja për të ndikuar në politikën e qeverisë. Edhe në qoftë se sjellja e dr. Ivins mund të justifikohet në një farë mase nga një ç'rregullim psikologjik i mundshëm, i diagnostikuar dhe më parë, apo dhe hipotetik, ose dhe e shtyrë kjo sjellje agresore nga qëllimi për të arritur përfitime ekonomike personale, veprimet e tij plotësojnë, mendoj unë, përkufizimin e DOJ-së për aktet terroriste, por jo përkufizimin që jep NCTC, dhe duhet të ushtrohej ndjekja penale për akte terroriste në qoftë se i dyshuari nuk do të kishte kryer vetëvrasje para aktakuzës (Richardson 2007, 129).

3.4. Përkufizimi juridik i gjithëpranuar mbi terrorizmin

Siç e theksuam edhe më parë problemi kryesor juridik ka të bëjë me përkufizimin e saktë të “terrorizmit ndërkombëtar”. Pikërisht për këtë arsye ngrihen disa çështje të së

drejtës që parimisht duhet të gjejnë zgjidhje në përkufizimin juridik të këtij fenomeni. Tema është sa antike aq edhe aktuale: pikërisht ngjarje tragjike të 11 shtatorit ngriti pikëpyetje edhe debate nëse talebanët dhe jo vetëm ata duhet të konsiderohen terroristët. Sa i takon të drejtës ndërkombëtare kjo problematike është thelbësore pasi duhet të përcaktohet termi terrorizëm dhe kufijtë e fenomenit, pra dallimin nga vepra penale të tilla si vrasja, sekuestër, sekuestrim personi etj por mbi të gjitha me ato që njihen tashmë në të drejtën kombëtare dhe pikërisht nga e drejta kombëtare humanitare. Debati juridik ditët e sotme në gjirin e Kombeve të Bashkuara lidhur me përkufizimin juridik përqëndrohet në mënyrë esenciale te individët që kryejnë këto akte. Shtetet arabe dhe afro-aziatike kanë ngritur pretendimin që duhet të përjashtohen nga ky përkufizim ato akte të dhunshme që bëhen me qëllim të luftës për vetëvendosje ligjitimiteti i së cilës njihet nga e drejta ndërkombëtare. Analiza e të drejtës në fushën e terrorizmit ndërkombëtar ka për qëllim që të tregojë se ekziston një dallim ndërmjet akteve terroristeve dhe akteve të ndërmara nga *freedom fighters* në kuadër të luftës për vetëvendosje. Pikërisht këto debate e kanë bërë të pamundur që të arrihet në një dakordësi të përgjithshme dhe/ose universale për parashikimet dhe dispozita të akteve juridike ndërkombëtare dhe të ,masave për parandalimin dhe dënimin e terrorizmit ndërkombëtar nga njëra anë janë hartuar marrëveshje me karakter universal të cilat kufizohen vetëm në figura të veçanta të veprave penale që i asociohen terrorizmit, pra duke mos e përcaktuar në mënyrë të përgjithshme terrorizmin. Nga ana tjetër janë miratuar edhe akte me karakter rajonal të cilat edhe pse japin një përkufizim të fenomenit të linja të përgjithshme këto janë të kufizuara për sa i përket shtrirjes dhe pasojave juridike. Pra në lidhje me raportin që ekziston ndërmjet terrorizmit dhe luftës për vetëvendosje të popujve praktikant dhe zakonet ndërkombëtare përfshijnë konventa

me karakter universal të cilat janë pranuar me rezarva ose nuk janë mirëpritur nga shtetet arabe e afro aziatike. Në këto raste konventa të tilla nuk duhen të respektohen në rastet e luftës së vetëvendosjes së popujve. Edhe në rastet e konventave me karakter rajonal shtetet e sipërpërmendura edhe pse e dënojnë terrorizmin ndërkombëtar e dallojnë nga lufta për lirinë ndërkombëtare. Analiza që do t'i bëhet terrorizmit ndërkombëtar edhe çështjeve më të rëndësishme të tij në këtë punim doktoral, bëhet me qëllim që të jepen të gjitha pikëpamjet dhe kuptimi i terrorizmit ndërkombëtar por përsëri janë konventa dhe akte të cilat nuk e zgjidhin çështjen e përkufizimit juridik të terrorizmit ndërkombëtar të pranuar nga të gjithë shtetet.

Aktualisht të gjithë vendet e botës dënojnë terrorizmin dhe të gjitha llojet e akteve me qëllim terrorizmin dhe në kuadër të përkufizimit të saktë juridik të mirëpranuar në nivel botëror kanë pranuar të quajnë terrorizëm: *akte që kanosin ose janë rrezik për jetën, shëndetin ose pronën e individit ose përpjekjet për minimin e qëllimshëm të rendit kushtetues dhe qeverisjes demokratike, kryesisht përmes përpjekjeve për influencimin e politikave dhe hartuesve të ligjeve pa dallim ndaj përzgjedhjes së objektivave, me qëllim mbjelljen e frikës dhe terrorit në popullatë.*

3.5. Dallimi ndërmjet akteve terroriste dhe akteve të dhunshme me qëllim vetëvendosjen.

Debati rreth termit juridik të terrorizmit ndërkombëtar është përqëndruar esencialisht tek autorët e këtyre sulmeve. Ideja e terrorizmit edhe pse e lidhur me aksionin e shtetit, ka marrë në të drejtën ndërkombëtare bashkohore karakteristika të ndryshme, për të treguar aksione, autoret e të cilëve janë grupe private, por të

cilët në kontekstin e shteteve marrin rëndësi, në rastet kur shtetet veprojnë si mbështetës ose kur shtetet qëndrojnë neglizhente dhe nuk marrin masa për të eliminuar këto fenomene. Pra, duhet përcaktuar me saktësi se cilat janë aktet e kryera prej privateve dhe që konsiderohen si terroriste, dhe kjo vetë ka për të çuar drejt analizës së problemit, dallimit midis akteve terroriste dhe akteve të përmbushura në kuadër të luftës për vetëvendosje.

Në shtetet arabe dhe afro-aziatike, aktet e dhunshme të kryerjes nën pretendimin e luftës për vetëshpallje u kërkuar të klasifikoheshin si akte terroriste. Për sa i përket raportit midis terrorizmit dhe pavarësisë së popujve janë parashikuar shenja konvencionale ose deklarata të veçanta nga ana e shteteve afro-aziatike dhe arabe me qëllim që këto të fundit mos të aplikohen në rastet për luftërat për pavarësi. Që nga vitet '60 deri sot janë përpunuar marrëveshje të ndryshme me karakter universal me qëllim që të çojnë në një bashkëpunim ndërshtetëror për të parandaluar dhe shtypur aktivitete të veçuara të konsideruara akte të terrorizmit ndërkombëtar. Nga 12 marrëveshje të përmblyllura vetëm dy përmbajnë shprehjen "terrorizëm" dhe vetëm tre shprehin në hyrje shqetësim të thellë për aktet terroriste. Pjesa më e madhe e këtyre marrëveshjeve janë formuluar në institucione të specializuara të Kombeve të Bashkuara. Asnjë nga marrëveshjet e para të formuluar nëpër këto institucione të specializuara nuk i referohet shprehimisht terrorizmit internacional, por marrëveshjet e adaptuara së fundmi në SHBA e citojnë dukshëm këtë fenomen, dhe pikërisht në këto marrëveshje shtrohet problemi i dallimit midis akteve terroriste dhe akteve të kryera nga "freedom fighter" (që quhen ndryshe dhe luftëtarët e lirisë). Një kategori e konsideruar si shprehje e terrorizmit ndërkombëtar i përket çështjes së aviaconit civil ndërkombëtar, të cilit do i rikthehemi në paragrafët vijues.

3.6. Terrorizmi shtetëror. Debatet aktuale në Kombet e Bashkuara

Një nga elementët thelbësorë të definicionit juridik mbi terrorizmin ndërkombëtar mbi të cilin është manifestuar kontradikta më e madhe midis shteteve dhe mbi të gjitha në kontekstin e debateve të zhvilluara në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, qysh prej fillimit të viteve të para, kur çështja e terrorizmit ndërkombëtar u kthye në çështje në rend të ditës është terrorizmi dhe kuptimi i akteve terroriste. Është e nevojshme në këtë pikë të sqarojmë se çfarë përbën terrorizëm shtetëror dhe cilat janë debatet aktuale bashkëkohore në kuadër të OKB-së mbi terrorizmin. Në këtë pjesë të punimit kërkojmë të tregojmë në mënyrë sintetike se cili është kuptimi i terrorizmit shtetëror dhe çfarë përmbledh ky koncept. Debati bashkëkohor mbi përkufizimin juridik të terrorizmit bashkëkohor ka të bëjë në menyrë të veçantë me aktet që bëjnë individët ose grupe individësh, ndërsa koncepti i terrorizmit shtetëror në fakt ka marrë kuptim pikërisht në ato rrethana ku shtetet kanë një rëndësi të veçantë në këtë fushë pasi janë ato që marrin masa për t'i mbështetur ose nuk marrin masa për t'i parandaluar, pra, roli i shtetit ka një rëndësi të veçantë në këtë drejtim. Një nga elementët më të rëndësishëm në përcaktimin e terrorizmit ndërkombëtar dhe ka qenë diskordanca midis shteteve që ka të bëjë me individët që kryejnë këto akte pra bëhet fjalë vetëm për individë ose grupe individësh (në mënyrë private) apo akte që lidhen me shtetin. Në qoftë se shteti përfshihet në këto ngjarje atëherë kemi të bëjmë me një, 'state terrorism'. Në raportin e sekretarit të përgjithshëm të Asamblesë thuhej: *“ The ordinary of the meaning of the world terrorism has undergone a evolution since it first came into use at the end of eighteenth century and has been differently interpreted according to the different types of acts which were uppermost at the time in the minds of those discussing the subject.*

While at first it applied mainly to those acts and policies of governments which were designed to spread terror among a population for the purpose of ensuring its submission to and, conformity with the will of those Governments it now seems to be applied to actions by individuals or groups of individuals". Le të sjellim këtu një shembull tjetër. Marrim rastin e bombardimeve nukleare në territorin Irakien në terrorin e Izraelit në 1981⁶¹. Pjesa më e madhe e shteteve në kuadër të debateve dhe diskutimeve në Këshillin e Sigurisë së Kombeve të Bashkuara i kanë dënuar bombardimet izraeliane duke i konsideruar këto si shembull konkret i *state terrorism*. Gjithsesi shtetet arritën në përfundimin që akti i ndërmarrë në këtë rast përbën një shkelje të normave të së drejtës ndërkombëtare e *dallueshme* nga ato që dënojnë në mënyrë specifike terrorizmin ndërkombëtar. I referohemi në mënyrë të veçantë Republikës Demokratike Gjermane që përcaktoi këtë veprim të Izraelit si një ,*brutal act of aggression*“ duke mbajtur qëndrimin që : *It is evident that the aggravation of the international situation by the most aggressive circles of imperialism has encouraged the aggressor to escalate its policy of state terrorism to a dangerous extend*“. Po në të njëjtën linjë vjen edhe deklarata sudaneze sipas së cilës:“ *these developments are an ominous indication of the fact that we are on the verge of institutionalising ,state terrorism*“, duke e dënuar, *the Israel aggression and premediated violation of the nation sovereignty, territorial integrity and security of Irak*“.

Ndërkohë edhe pse terrorizmi kombëtar ekziston si një cilësim juridik, veprim i ndaluar nga e drejta ndërkombëtare, rrgullimi i tij juridik bie në regjimin kryesisht në normat ndërkombëtare që ndalojnë përdorimin e forcës ose normat që ndalojnë shtetet të ndërmarrin akte dhe veprime që kërcënojnë respektimin e të drejtave të njeriut.

⁶¹ U.N.Doc.Scor.,2282th Meet.,15 June 1991.

3.7. Dallimi ndërmjet „terrorizmit shtetëror“ dhe „State sponsorship of terrorism“

Ndryshe nga përcaktimi i terrorizmit shtetëror në të cilin shteti kryen akte terroriste nëpërmjet organe të veta. "*State sponsorship of terrorism*" kemi në ato raste kur shteti merr pjesë në kryerjen e akteve terroriste nga pikëpamja e materialeve dhe e arsenaleve. Në këtë rast aktet terroriste kryen nga grup individësh privat dhe parimisht sjellje të tilla nuk të çojnë te organet shtetërore. Shembuj të tillë janë furnizimi me materiale këtyre grupeve, kontrolli mbi kryerjen e akteve të tilla, ushtrimi dhe dhënia e direktivave për mënyrën e ushtrimit të tyre. Edhe në këtë rast debatet e fundit bashkëkohore propozojnë dallimin ndërmjet *state sponsorship* dhe *state support* pasi mendojnë se janë dy forma të ndryshme të përfshirjes së shtetit dhe nga pikëpamja juridike dy forma të ndryshme të përgjegjësisë së shtetit. *State support* përdoret në ato raste për të treguar të gjitha format e përfshirjes së shtetit në forma të ndryshme nga ato që mund të inkuadrohen në konceptin e *state sponsorship*.

State support mund të përfshijë tre situata të ndryshme. E para ka të bëjë me rastet kur shteti "*actively supports international terrorism*" dhe përgjegjësia e shtetit në të tilla rrethana logjikisht vjen nga bashkëpunimi i vetë shtetit me aktin terrorist. E dyta ka të bëjë me rastin kur shteti shkel detyrimin të parandalojë aktet terroriste ndërkombëtare dhe nuk është diligjent me qëllim që të marrë të gjitha masat e nevojshme në territorin e vet për organizimin e akteve terroriste (Malzahan 2002, 83). Rasti i fundit i referohet rrethanave në të cilat një shtet shkel detyrimin që të ndalojë dhe ekstradojë autorët e akteve terroriste detyrim ky që duket se formon përmbajtjen e një "*emerging norm*".⁶² Sa i takon këtyre dy rasteve të fundit të *state support* është e qartë që sipas kësaj doktrine

⁶² Shih ne lidhje me kete argument Malzahan, State Sponsorship and Support of International Terrorism: Customary Norms of State Responsibility, in Hasting International and Comperative law Review, 2002, fq.83.

një përgjegjësi e shtetit mund të lindë atëherë kur nuk merr masat e duhura për të parandaluar aktet terroriste ose atëherë kur refuzon të përndjekë ose ekstradojë terroristët, por kjo përgjegjësi nuk do të thotë që akti terrorist në fjalë vjen nga shteti. Me fjalë të tjera sheti nuk është përgjegjës për aktet që kanë ndërmarrë organet e tij por përkundrazi për mosmarrjen e masave në raste konkrete. Situata krejtësisht ndryshe verifikohet në rastin e parë ku mbështetja aktive dhe furnizimi i grupit terrorist nga shteti e bëjnë këtë të fundit përgjegjës për aktin terrorist. (Malzahan 2002, 83). Një shembull konkret i dy rasteve të fundit sipas doktrinës dominuese është përgjegjësia e regjimit të talebanëve për sulmet e 11 Shtatorit në SHBA nga grupi Al Kaeda (Schmitt 28). Sipas kësaj doktrine përgjegjësia e talebanëve për atentatin e 11 Shtatorit vjen pikërisht nga fakti se ata ishin në dijeni të kërcënimeve të Al Kaedës dhe nuk morrën masat e duhura për të parandaluar këto atentate. Përgjegjësia e talebanëve vjen edhe nga fakti që ata refuzuan ekstradimin e anëtarëve të organizatës *in primis Bin Laden* të cilin prej kohësh Shtetet e Bashkuara kërkonin ekstradimin me dyshimin që ai ishte i përfshirë në atentatet e 1998 në ambasadën amerikane në Nairobi dhe Dar es-Salam.

3.7.1. Praktika ndërkombëtare

Në praktikën ndërkombëtare rezulton, që të gjitha rastet në të cilat një aksion materialisht i atribuohet një shteti dhe është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, ky aksion do të jetë i dënueshëm nga ana e shteteve të tjerë si aksion terrorist. Gjithmonë u është referuar aksioneve, disiplina e të cilëve hyn tek e drejta ndërkombëtare dhe i dallon ato nga disiplina që kanë të bëjnë me terrorizmin ndërkombëtar. Në veçanti nga praktika më e hershme mund të nxjerrim disa konkluzione. Në 5 tetor 2003, forcat e aviaconit Izraelit lëshuan bomba në fshatin Ein Saheb në Siri, i cili konsiderohej si një kamp stërvitor për grupe terroriste. Në debatet e

zhvilluara në Këshillin e Sigurimit të OKB, i cili u mbledh me urgjencë në bazë të kërkesës së Sirisë pjesa më e madhe e shteteve e dënoi sulmin e Izraelit si një shkelje flagrante të së drejtës ndërkombëtare. Siria në veçanti deklaroi se *“this Israeli aggression targeting a Syrian village is a true and precise embodiment of Israeli terrorism,”* dhe që kishte të bënte me *“acts of aggression committed against the sovereignty and territorial integrity of a State member of the Security Council and of the United Nations,”* dhe *“we might now have an opportunity to stop such aggression and an aggression that has been exercising State terrorism.”* Përfaqësuesi i Lidhjes së Shteteve Arabe me cilësinë e vëzhguesit permanent pranë Kombeve të Bashkuara vëren që *“Israeli is fully responsible for all consequences that may result from such aggression. We call for the cessation of State terrorism.”*⁶³ Shtete të tjera gjatë debatit e asociuan agresionin e Izraelit kundër Sirisë me terrorizmin e shtetit. Të tilla deklarata konfigurojnë nga njëra anë dënimin e terrorizmit të shtetit dhe nga ana tjetër e identifikojnë atë me aktet e shtetit, ndalimi i këtyre akteve është i garantuar nga e drejta ndërkombëtare, të cilat dallojnë nga normat që ndalojnë aktet terroriste. Edhe në praktikën e vjetër mund të dallojmë elementë që konfirmojnë atë që u tha më lartë. Rasti i bombardimit të reaktorit nuklear Osirak në terrirtorin Irakian nga ana e Izraelit në 1981⁶⁴. Pjesa më e madhe e shteteve gjatë debatit të mbajtur në Këshillin e Sigurimit dënoi sulmin e Izraelit duke e manifestuar si *“ State Terrorism”*. Megjithatë shtetet ju përmbajtën idesë që akti në fjalë ishte një shkelje e normave të së drejtës ndërkombëtare të dallueshme këto të fundit nga grupi i normave që bëjnë fjalë për terrorizmin ndërkombëtar. Nën këtë sens mund të lexohet dhe deklarata e Republikës Demokratike Gjermane e cila e konsideroi sulmin e Izraelit si *“ A brutal act of aggression”* duke

⁶³*Ibid.*

⁶⁴ U.N. Doc. Takimi i 2282-te I dates 15 qershor 1981.

mbështetur që *“it is evident that the aggravation of the international situation by the most aggressive circles of imperialism has encouraged the aggressor to escalate its policy of State terrorism to a dangerous extent.”*⁶⁵. Në terma analog u shpreh dhe delegati sudanez që sipas të cilit *“those developments are an ominous indication of the fact that we are on the verge of institutionalising State terrorism”*, duke dënuar *“the Israeli aggression and premeditated violation of the national sovereignty, territorial integrity and security of Iraq.”*⁶⁶. Megjithatë edhe pse terrorizmi shtetëror ekziston si fakt juridik i dënueshëm nga e drejta ndërkombëtare, disiplina me normat që e rregullojnë bie nën normat që u ndalojnë shteteve aksione të ngjashme me shkeljet e respektimit të të drejtave të njeriut. Kjo konsideratë konfirmohet jo vetëm nga shtetet që kanë dënuar gjithmonë terrorizmin shtetëror dhe që kanë kërkuar që të futej brenda definicionit për terrorizmin ndërkombëtar, psh Siria nën dritën e debateve të zhvilluara në Këshillin e Sigurimit, por edhe nga shtete që i janë kundërvënë dhe e kanë mohuar si parim terrorizmin shtetëror duke pretenduar që kjo disiplinë të përmbledhë nën norma të tjera të së drejtës ndërkombëtare.

3.8. Dallimi ndërmjet akteve terroriste dhe krimeve politike.

Ky krahasim, që presupozon dhe nënkupton në një nivel abstrakt, përcaktimin e kufijeve midis konceptit të terrorizmit dhe të kriminelit politik dhe zbatimin empirik ose jo të trajtimit të veçantë të favorshëm penal të kriminelit politik, është i pamundur pa trajtimin paraprak të konceptit të kriminelit politik. Meqënëse për kriminelin politik u dhanë më lart disa sugjerime në lidhje me elementët përbërës të tipit penal, tani është

⁶⁵ *Ibidem*, p. 6.

⁶⁶ U.N. Doc. Takimi i 2280-te I dates, 12 qershor 1981, fq. 18. Si dhe deklaratat e Tunisise e Jordanise, in *ibidem*, respektivisht p. 14 e p. 19, si dhe deklaratat e Jugoslavise, Vietnam e Zambia, ne U.N. Doc. Scor., 2283-te 15 qershor 1981.

besoj momenti i duhur për t'u marrë parasysh, në aspektin teorik, marrëdhënia e varësisë së mundshme të fenomenit kriminal të "terrorizmit" dhe kriminelit politik ose, sipas pikëpamjes këtu miratuar, subjektit politik që ushtron terrorizëm dhe kriminelit politik (P.Bolle, 1977, 123). Nuk do të ishte ndoshta e pavend dhe e gabuar përsëritja e mendimit sipas të cilit, nuk ngrihet çështja e përjashtimit të anasjelltë të dy nocioneve, të krimit dhe politikës, dhe praktikisht gjetja e bashkëegzistencës së politikës dhe krimit lejon krahasimin, në kornizën e shkencës Penale, të kriminelit politik dhe terroristit. Por, pavarësisht nga fakti se koncepti i "kriminelit politik" pikërisht këtëmundësi bashkëegzistence na konfirmon, nuk janë të pakta rastet, për të cilat, në teorinë e të drejtës penale janë shprehur pikëpamje mbi papajtueshmërinë e supozuar ndërmjet krimit dhe politikës⁶⁷. Vetë, pra, natyra penale e një akti, nuk është e mjaftueshme për ta përjashtuar atë nga procesi politik. Natyrisht, autori i çdo krim dhe pretendimi nga ai, i cilësimit si një kriminel politik (*dhe në procesin penal*), është abuziv dhe nuk mund të qëndrojë. Ka një pikë përtej së cilës elementët politik të një krimi ose karakteristikat politike të autorit të tij nuk kanë interes në procesin penal. Por kjo "indiferencë" nuk duhet të jetë rezultat i formave të dhunshme të depolitizimit, por në vend të kësaj, duhet të përcaktohet qartë duke monitoruar plotësimin ose jo të elementëve që përshkruajnë kriminalitetin politik. Si shembuj klasik të përcaktimit abstrakt të kufijve të kriminalitetit politik mund të përmenden: a) mendimi i Institutit të së Drejtës Ndërkombëtare, siç shprehet në samitin e Gjenevës në 1892, dhe veçanërisht në nenin 2 të tekstit përfundimtar të miratuar, "*Nuk konsiderohen si krime politike, ato që përbëjnë, më seriozet, përsa i përket vlerave dhe parimeve të të drejtës tradicionale, krimet e*

⁶⁷ Shiko. P.Bolle, "Le droit et la répression du terrorisme", Prill-Qershor 1977, fq. 123 ku shkruan "*...terrorizmi individual politik nuk është një akt politik me kuptimin që shkencë politike e percepton, por një akt kriminal i cili intereson, pra është subjekt i të drejtës penale, dmth një akt i dënueshëm penalisht.*"

vrasjes, helmimit, gjymtimi, plagosja e rëndë me dashje, tentativa në krimet e lartëpërmendura, sulmet ndaj pronës me zjarrvënie, me shpërthime eksplozive, me përmbytje, vjedhjet me pasoja të rënda dhe grabitja”, b) mendimi i Sottile, kur në vitin 1938 ai shkroi se *"krimi politik duke mos qënë dicka tjetër vecse një shprehje e një ideologjie politike, nuk mundet, në zbatimin praktik, vetëm të trajtojë metodat ideologjike"*. "Ideologjia" sigurisht që këtu (në vitin 1938) ndoshta mund të dëshirojë të deklarojë një konotacion moral që duhet të shoqërojë aktin kriminal politik, por ndoshta mund të themelojë dhe "krimet morale" (pranimi i një ideologjie të caktuar përbën veprë penale, si për shembull sanksionimi në ligjin 509/1947 dhe në veçanti nëni 6 paragrafi 1 ose ligji i 19.03.1939-tës në Francë në lidhje me "çdo aktivitet që ka për qëllim përhapjen e vijës së Internacionales së Tretë." (Charvin R. 1968, 435). Megjithatë, si në njërin apo në rastin tjetër, kriteri bazë, sipas të cilit, politika dhe krimi të përjashtohen reciprokisht, është termi *"ideologjia"*, i cili nuk mund, vecse të jetë i përjashtuar nga një përkufizim objektiv specifik (K. Manolopoulou-Varvitsiotis 1981, 523)⁶⁸.

Termi "kriminalitet politik" për herë të parë është përdorur gjatë Revolucionit Borgjez Francez në kuptimin e përshkrimit të agjitacionit politik, i cili zhvillohej kundër Republikës së Re. Kriminaliteti politik, si aktivitet i orientuar kundër rendit ligjor ekzistues, pa dyshim që ka një motiv krejtësisht tjetër nga aktivitetet e zakonshme kriminale përkundrazi se përcmon po të njëjtat të drejta themelore si këto të fundit, si, p.sh., nga veprat penale kundër jetës dhe shëndetit, veprat penale kundër pasurisë, veprat penale kundër shëndetit të qytetarëve, veprat penale kundër sigurisë së personave dhe

⁶⁸Të njëjtin mendim përsërit K. Manolopoulou-Varvitsiotis në veprën e tij *"Terrorizmi dhe masat parandaluese ndërkombëtare"*. 1981, fq. 523), "...sot në një kohë kur parimi i përshatshmërisë është themeltar i çdo pushtetit politik ku rëndësia e termit "ideologji" është e qartë nga njëra anë dhe persekutimi i besimit është, të paktën me fjalë, i dënueshem dhe i papranueshëm".

pasurisë së tyre, etj. Kjo do të thotë se veprat penale politike, për dallim nga format e tjera të veprimit kriminal, janë të karakterizuara nga një motivimin politik krejt i ndryshëm i kryesve të tyre (Drik Blasius, 1983, 13). Motivi i kryerjes së veprave penale politike, sado që të jetë i fshehur në vendin e ngjarjes, para gjykatës paraqitet qartë se kriminelët e rëndomtë, për dallim nga ekzekutoret ose iniciatoret e veprave penale politike, zakonisht me ndihmën e gënjeshtreve, korrupsionit ose ndikimeve të ndryshme në dëshmitarë, përpiqen që t'i mohojnë veprat e tyre. Ndërkaq, autorët e veprave penale politike, parimisht, qëndrojnë pas veprave të kryera. Këta, duke e mbrojtur publikisht doktrinën e tyre politike, ideologjinë e tyre ose dhe dogmën fetare përkatëse, pra edhe para trupit gjykues, përpiqen edhe në këtë mënyrë të ndikojnë në drejtim të rritjes së simpatisë së tyre politike dhe popullaritetit të tyre, që besoj është pjesë e strategjisë së tyre, veçanërisht në rekrutimin e anëtarëve të rinj. (Drik Blasius, 1983, 13) Në bazë të motivit të kryesve të veprave penale politike, mund të konkludojmë se kriminaliteti politik në thelbin e vet, packa se prezantohet duke u distancuar nga karakteri privat, ka ngjyra të tilla, por i parë nga një këndvështrim institucional është i natyrës publike. Kjo do të thotë se këtu kemi të bëjmë me “një formë specifike të reagimit ndaj rrethanave konkrete të jetës shoqërore, respektivisht me një alternativë të caktuar politike“ (Sven Papcke 1973,26). Përveç elementit specifik të motivit, kriminaliteti politik dallohet nga të gjitha format e tjera të veprimit kriminal edhe në bazë të përkufizimit të tij. Në shkencën bashkëkohore janë të njohura këto përkufizime të kriminalitetit politik. Sipas këtij përkufizimi, me nocionin kriminalitet politik, nënkuptohen të gjitha deliktet dhe veprat penale politike të cilat, si të tilla, shprehimisht janë të parapara me ligjin penal të një shteti. Shkurtimisht, sipas shkencës së psikologjisë, për karakterizimin e një vepre penale në përgjithësi, është i një rëndësie të veçantë dhe vendimtar, motivi i autorit të

saj. Pra, pavarësisht nga vepra e kryer, në qoftë se autori i saj ka motiv politik, atëherë edhe vepra e tij duhet cilësuar si vepër penale politike. Sipas teorive të realistëve, jepet një përkufizim, i emëruar ndryshe edhe si psiko-socialdinamik, i cili e cilëson terrorizmin, si një vepër penale politike në të gjitha rastet kur autori, viktima ose ndonjë institucion i strukturuar shoqëror e cilëson atë si vepër penale politike. Që nga çasti i cilësimit të parë të veprës së caktuar penale si politike, ajo duhet trajtuar si e tillë edhe nga pjesëmarrësit e tjerë në procedurë. Çdo shoqëri, kohë dhe shtet, e ka kriminalitetin e vet politik. Kjo formë e veprimit kriminal është paraqitur gjithmonë kur forcat e caktuara politike me mjete të ndryshme kriminale, janë përpjekur për ndërrimin, alternimin ose dhe ruajtjen e rendit ekzistues shoqëroro-politik. Pra, në të gjitha kohët dhe shtetet ka ekzistuar një strukturë alternative politike, manifestimet kriminale të së cilës, në dallim nga format e tjera të aktivitetit kriminal, janë emërtuar si “kriminalitet politik⁶⁹“. Thjesht, me nocionin kriminalitet politik kuptohen të gjitha “aktivitetet kriminale të drejtuara kundër një sistemi shtetëror, regjimeve politike, përfaqësuesve shtetërorë, vendimeve si dhe orientimeve të ndryshme politike“ (Uwe Backes 1989, 110)⁷⁰. Në shumë aspekte të jetës shoqërore, kriminaliteti politik është pasqyrë reale e sistemit politik. Në dallim nga veprat e tjera penale, kriminaliteti politik zakonisht manifestohet në mënyrë kolektive. Kjo do të thotë se, shumë rrallë kryhen vepra penale politike në mënyrë individuale (L. J. Macfarlane, 1971, 12). Pra, veprat penale politike, kryhen nga organizata ose grupe të ndryshme personash, të cilët veprojnë jo me qëllim të zgjidhjes së problemeve të tyre individuale, por për ndërrimin e raporteve të caktuara politike dhe shoqërore (Klaus von Beyme 48). Veprat penale politike, kryesisht

⁶⁹Politische Kriminalität, Meyers Enzyklopädisches Lexikon, Band 14, Wien 1987, fq. 24.

⁷⁰Në literaturën bashkëkohore janë shqyrtuar shumë pak veprat penale politike të kryera nga përfaqësuesit e regjimeve demokratike. Shih për me shume Uwe Backes, Politischer Extremismus in demokratischen Verfassungsstaaten, Opladen 1989, fq. 110.

karakterizohen nga një shkallë e lartë e planifikimit, përgatitjes dhe ekzekutimit brutal të tyre. Zakonisht, ekzekutimi i veprave penale, është i karakterizuar me një stil të pazakonshëm përse i përket metodikës së përzgjedhur për organizimin, të shoqëruar me agresivitet, brutalitet dhe rrezikshmëri të lartë shoqërore (Hans J. Schneider, 1981, 17)..

Pikërisht, në bazë të këtyre elementeve synohet edhe ndikimi për të rritur nga njëra anë simpatinë dhe përkrahjen e dëshiruar të masave shoqërore dhe nga ana tjetër përhapjen e terrorit dhe rritjen e ndjenjës së pasigurisë për të ushtruar në vijim dhe shantazhin e dëshiruar në vendimmarrjen politike. Në praktikën bashkëkohore, janë të njohura këto forma të manifestimit të kriminalitetit politik (Hans J. Schneider, 1981, 17). Veprat penale politike, të kryera nga pushtetet demokratike ose në kuadër të tyre janë të drejtuara kundër qytetarëve ose sistemit shtetëror të një shteti demokratik, kundër qytetarëve të huaj ose shteteve të huaja. Karakteristikë kryesore e këtyre veprave penale është keqpërdorimi i aparatit shtetëror për interesa të ndryshme politike (I. Fetsche 1981, 17). Këtu është fjala për korrupsionin dhe keqpërdorimet e shërbimeve të ndryshme shtetërore në drejtim të spiunimit, dëmtimit dhe komprometimit të kundërshtarëve politikë. Veprat penale politike, të drejtuara kundër aparatit shtetëror ose përfaqësuesve të tij zakonisht, kryhen nga grupe të ndryshme të rebeluara politike dhe, si të tilla, janë të parapara në mënyrë të qartë dhe taksative edhe me ligjin penal të një shteti(I. Fetsche 1981, 17).. Këtu kemi të bëjmë me veprat klasike penale politike si, p.sh., atentatet, sabotimet, spiunimet, rrëmbimet, etj. Në bazë të elementit të dhunës së zbatuar politike, këto vepra penale quhen ndryshe edhe vepra terroriste. Veprat penale politike të kryera nga aparati shtetëror i një shteti diktatorial kundër shtetasve të vet. Këtu është fjala për terrorin e ushtruar shtetëror, i cili zakonisht ushtrohet me qëllim të ruajtjes së pushtetit të caktuar politik (I. Fetsche 1981, 17). Në shtetet e ndryshme

totalitare, shkelen në mënyra brutale të drejtat kushtetuese dhe të drejtat themelore të njeriut politik (Hans J. Schneider, 1981, 17). Madje, nuk janë të rralla as rastet e improvizimit të kryerjes së veprave të ndryshme penale me qëllim të dënimit të kundërshtarëve politikë ose të krijimit të preteksteve për eliminimin e tyre.

KAPITULLI IV: AKTET NË NIVEL NDËRKOMBËTAR QË JANË MIRATUAR ME QËLLIM LUFTËN NDAJ TERRORIZMIT. ANALIZË JURIDIKE.

4.1. Hyrje

Pjesë e hulumtimit tonë shkencor dhe që paraqitet me një rëndësi të veçantë janë edhe dokumente të organizatave ndërkombëtare –marrëveshje, traktate apo protokolle të ndryshme– si rezolutat e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara, të Bashkimit Europian, Këshillit të Europës, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë, etj. Këto burime dokumentojnë impaktin e terrorizmit ndërkombëtar edhe në mënyrën e funksionimit të këtyre organizatave, duke dëshmuar më tej rëndësinë që marrin edhe aktorët ndër-qeveritarë në kontekstin e përpjekjeve globale të luftës kundër terrorizmit. Por njëkohësisht përmes analizës së këtyre dokumenteve parësore del në pah edhe vështirësia që hasin organizatat ndërkombëtare kur duhet të marrin vendime që prekin sovranitetin dhe politikën e jashtme të shteteve në arenën ndërkombëtare. Pa dyshim që organizatat ndërkombëtare kanë qenë mjaft aktive në debatin akademik juridik për një përkufizim të terrorizmit. Ky term u përballua fillimisht si një çështje e veçantë e të drejtës ndërkombëtare nga komunitati ndërkombëtar pas viteve 1930, pas vrasjes së mbretit jugosllav dhe ministrit francez nga disa grupe separatist (Peterson, 2004: 175-176). Marrëveshjet ndërkombëtare mbi parandalimin dhe kontrollin e terrorizmit ndërkombëtar, janë të një natyre heterogjene përse i perket rasteve individuale të konstatuara dhe tradicionalisht të lidhura pandashmërisht me terrorizmin ndërkombëtar. Është vënë re që disa prej tyre nuk përshtaten në fakt me vetë kuptimin e terrorizmit. Le t'i analizojmë ato në vijim.

4.2. Aktet ndërkombëtare të miratuara në gjirin e Kombeve të Bashkuara që kanë të bëjnë me aspekte të veçanta të luftës ndaj terrorizmit

Përplekja e Lidhjes së Kombeve për ta përkufizuar terrorizmin i parapriu në thelb shumë prej mosmarrëveshjeve që do të përçanin përplekjet e komunitetit ndërkombëtar gjatë dekadave që do të pasonin Luftën e Dytë Botërore. Kombet e Bashkuara e trajtuan çështjen e terrorizmit për herë të parë dhe në formë embrionale nga Zyra kundër Drogës dhe Krimin të Organizuar në vitin 1963. Këto çështje në vetvete nuk kishin të bënin me përkufizimin, por me trajtimin e akteve të ndryshme që u konsideruan akte terroriste, siç ishte rrëmbimi i avionëve, sulmet kundër diplomatëve etj. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së e identifikoi për herë të dytë terrorizmin në mesin e viteve 1980 dhe miratoi Deklaratën mbi Masat për të eliminuar terrorizmin ndërkombëtar. Edhe në këtë deklaratë, qasja ishte drejt përkufizimit të terrorizmit dhe akteve me qëllime terroriste si dhe në debatin konceptual mbi terrorizmin. Ndërsa vitet 1990 e ndryshuan rrënjësisht definicionin e terrorizmit dhe qasjet ndaj tij. Në këtë kohë u themelua Komisioni i gjashtë, një komision i posaçëm, i cili do të miratonte disa rezoluta në vijim të punës së tij. Gjithsesi është arritur në përfundimin që këto rezoluta janë të një natyre të dobët pikërisht për faktin e përçarjeve dhe mosdakordësisë mes shteteve në perceptimin e tyre ndaj terrorizmit. Më tej themi se viti 1993 shënon një hap tjetër në debatin juridik mbi terrorizmin që mbyllet me miratimin në vitin 1994 të Rezolutës 49/60. Pikësynimi i kësaj rezolute ishte gjithsesi mbi respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Miratimi i rezolutave të njëpasnjëshme tregon që ky problem vazhdon që të qëndrojë në axhendën politike të saj. Ndërsa në vitin 2005 Asambleja e Përgjithshme miratoi Rezolutën 60/1 e cila theksonte nevojën për thellimin e bashkëpunimit mes vendeve anëtare në përballje me terrorizmin ndërkombëtar duke

theksuar se: [... Duke riafirmuar se aktet, metodat dhe praktikat e terrorizmit në të gjitha format dhe mënyrat e shfaqjes së tij janë aktivitete që synojnë shkatërrimin e të drejtave të njeriut, liritë fundamentale dhe demokracinë, kërcënojnë integritetin territorial të shteteve anëtare, sigurinë e tyre dhe destabilizojnë qeveritë e konstituara në mënyrë legjitime [...] komuniteti ndërkombëtar duhet të marrë hapat e duhur për të promovuar bashkëpunimin për të parandaluar dhe luftuar terrorizmin.] Vështirësia e OKB-së për të përkufizuar terrorizmin dhe për t'i dhënë drejtim dhe zgjidhje çështjeve të terrorizmit u dallua qartë në debatet mes vendeve anëtare perëndimore dhe atyre jo-perëndimore të Kombeve të Bashkuara, pas masakrës së Lojërave Olimpikë të Mynihut, ku u vranë 11 atletë izraelitë. Debati filloi me propozimin e sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Kurt Waldheim, se OKB nuk duhej të qëndronte në rolin e një spektatori të heshtur përballë akteve të dhunës terroriste që po përhapej në të gjithë botën, por duhet të ndërmerre hapa më praktikë që mund të parandalonin gjakderdhje të mëtejshme. (Hide, 2014, 56). Pas shumë viteve debat OKB-ja miratoi Konventën Ndërkombëtare për dënimin e sulmeve terroriste. Kjo Konventë⁷¹ saknsionoi kategorikisht të jashtëligjshme vendosjen dhe shpërthimin e mekanizmave eksplozive në të gjitha mjediset publike qofshin këto shtetërore ose private ose qeveritare si dhe sistemin e transportit me qëllim final shkaktimin e dëmeve njerëzore ose e atyre objekteve që kanë humbje të mëdha ekonomike dhe financiare.

Në gjirin e OKB ashtu si dhe në institucionet ndërkombëtare të specializuara janë lidhur konventa sektoriale që disiplinojnë fenomene universale të cilat tradicionalisht janë asociuar terrorizmit ndërkombëtar. Megjithatë në vitet e mëparshme janë adoptuar konventa të cilat kanë referuar tek terrorizmi ndërkombëtar me terma eksplicite dhe të

⁷¹ Kjo konventë hyri në fuqi në maj të vitit 2001, vetëm katër muaj përpara sulmeve të 11 shtatorit.

përgjithshëm. Bëhet fjalë për konventa “*Mbi parandalimin dhe eliminimin e krimeve kundër personave të mbrojtur ndërkombëtarisht përfshirë këtu dhe agentët diplomatikë*” e firmosur në New York në 14 Dhjetor 1973, dhe hyre në fuqi në 20 Shkurt 1977 (Wood, 1974 791).⁷² Konventa “*Kundër rrëmbimit të pengjeve*” e lidhur në New York në 17 Dhjetor 1979 dhe hyrë në fuqi në 3 Qershor 1983. (Note 1974, 705)⁷³ Përsa i përket këtyre dy të fundit do referojnë tek konventa ndërkombëtare “*Për parandalimin e atentateve terroriste me lëndë plasëse*” e lidhur në New York në 15 Dhjetor 1997 dhe hyrë në fuqi në 23 Maj 2001.⁷⁴ Do të referojmë në konventën ndërkombëtare “*Për parandalimin dhe financimin e terrorizmit*” e firmosur në New York në 9 Dhjetor në 1999 dhe hyrë në fuqi në 10 Prill 2002. (Panzer, 1980, 885).⁷⁵ Siç është përmendur të dy konventat janë shumë të rëndësishme përse i përket dallimit midis terrorizmit ndërkombëtar dhe vetëvendosjes së popujve, shfaqur si problem gjatë përgatitjes së teksteve përkatëse (Panzer, 1980, 885).

4.2.1. Konventat ndërkombëtare të miratuara nga institucionet e specializuara të OKB-së.

Një rëndësi të veçantë në kuadër të akteve juridike në nivel ndërkombëtar që kanë lidhje me terrorizmin dhe aktet terroriste kanë dhe ato marrëveshje që janë miratuar dhe ratifikuar në kuadër të Instituteve të Specializuara të Kombeve të

⁷² *Ibidem*, fq. 30. Mbi konventen e 1973, Wood, *The Convention on the prevention and the punishment of crimes against internationally protected persons, including diplomatic agents*, in *International and Comparative Law Quarterly*, 1974, fq. 791; Note, *The Convention on the prevention and the punishment of crimes against diplomatic agents and other internationally protected persons: an analysis*, in *Vanderbilt Journal of International Law*, 1974, fq. 705; Panzer, *La Convenzione sulla prevenzione e la repressione dei reati contro persone che godono di protezione internazionale*, in *Rivista di diritto internazionale*, 1975, fq. 80.

⁷³ *Ibidem*, fq. 38. Mbi konventen e 1979, Lambert, *Terrorism and hostages in international law*, 1990; Panzer, *Qualche considerazione in merito alla Convenzione internazionale contro la presa di ostaggi*, *Rivista di diritto internazionale*, 1980, fq. 885.

⁷⁴ *Po aty*, fq. 99.

⁷⁵ *Po aty*, fq. 113.

Bashkuara. Këtu i referohemi në mënyre të veçantë NATO-s (Wood, 1974 791). Terrorizmi nuk ka luajtur gjithnjë rol parësor në axhendën e sfidave gjeopolitike dhe të sigurisë me të cilat Organizata e Atlantikut të Veriut është përballur pas Luftës së Ftohtë (Note 1974, 705). Terrorizmit iu kushtua një vëmendje e veçantë fill pas sulmeve të 11 Shtatorit në SHBA. Në Asamblenë e NATO-s u caktua një nen-komision mbi terrorizmin. Komisioni është shprehur se identifikimi me viktimën përcakton klasifikimin e një akti të dhunshëm si terrorizëm: “vrasjet, rrëmbimet, zjarrvëniet dhe akte të tjerë të jashtëligjshme përbëjnë sjellje kriminale, por shumë kombe jo-perëndimore kanë ngurruar të dënojnë si akte terroriste ato që i shohin si beteja për çlirim kombëtar”. (Hide: 2014., 73). Pra, tipari me karakteristik nuk është vetë akti i dhunës por motivet, justifikimet dhe/ose shkaqet e tij. Që prej viteve 60 dhe deri më sot janë përpunuar disa akorde me karakter universal (Trahan, 2002, 215) . Me tendencën për të ndërtuar një kooperim ndërshtetëror, për parandalimin dhe eliminimin e aktiviteteve singulare të konsideruara shprehje të terrorizmit ndërkombëtar.⁷⁶ Për efekt të 12 konventave të nënshkruara vetëm dy prej tyre përmbajnë shprehjen terrorizëm, dhe vetëm 3 shprehin në preambulën e tyre preokupimin për aktet terroriste që janë objekt i disiplinës së konventës, ose deklarojnë gjithmonë brenda preambulës që aktet objekt të konventës janë shprehje të terrorizmit ndërkombëtar. Indikues për karakterin sektorial të konventave është gjithashtu rrethana që pjesa më e madhe e tyre janë lidhur në gjirin e institucioneve të specializuara të OKB, bëhet fjalë në veçanti për Organizatën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar, Organizatën Detare Botërore, Agjensia Ndërkombëtare për Energjinë Atomike (Trahan, 2002, 215). Do vazhdojmë me dallimin e këtyre konventave me ato të lidhura nga OKB, dhe kjo për efekt të dy motiveve.

⁷⁶ Shuh ne menyre te vecante Trahan, *Terrorism Conventions: existing gaps and different approaches*, in *New England International and Comparative Annual*, 2002, fq. 215 ss.

Motivi i Parë, asnjë nga konventat e lidhura në gjirin e institucioneve të specializuara nuk referon ekspresivisht tek terrorizmi ndërkombëtar, ndërsa konventat më të hershme të adoptuara në gjirin e OKB, përmendin në mënyrë eksplicite këtë fenomen. *Motivi i Dytë*, lidhet me kontekstin e konventave të lidhura në gjirin e OKB, ose më saktë me disa prej tyre tek të cilat është ngritur problemi i dallimit të akteve terroriste nga aktet e kryera nga *freedom fighters*. Një kategori e akteve të konsideruara si shprehje e terrorizmit ndërkombëtar, ka të bëjë me aviacionin civil ndërkombëtar. Në gjirin e ICAO janë konkluduar në veçanti konventa “mbi krime të kryera në bordin e avionëve”. Kjo është firmosur në Tokio më 14 Shtator 1963 dhe ka hyrë në fuqi më 4 Dhjetor 1969.⁷⁷ Konventa “Për parandalimin e sekuestrove të jashtëligjshme të mjeteve fluturuese”, firmosur në Hagë në Dhjetor të 1970 dhe ka hyrë në fuqi në 14 Tetor të 1971 (Guillaume 1970, 35)⁷⁸. Konventa “Për parandalimin e akteve të jashtëligjshme të kryera ndaj sigurisë së aviacionit civil”, e cila është firmosur në Montreal më 23 Shtator 1971 dhe ka hyrë në fuqi më 26 Janar të 1973⁷⁹. Të tilla konventa disiplinojnë akte të cilat mund të kompromentojnë sigurinë e aviacionit civil, të personave dhe mallrave që ndodhen në to, ato vetë parashikojnë si krim veprimin nga

⁷⁷ In *International Instruments related to the Prevention and Suppression of International Terrorism*, United Nations, New York, 2001, fq. 2.

⁷⁸ *Ibidem*, fq. 13. Mbi Konventen e 1970, shih Guillaume, *La Convention de La Haye du 16 décembre 1970 pour la répression de la capture illicite d'aéronefs*, *Annuaire Français de Droit International*, 1970, fq. 35; CARBONE, *Repressione della c.d. pirateria aerea nei rapporti internazionali*, *Rivista di diritto internazionale privato e processuale*, 1971, fq. 534; Kojanek, *Il dirottamento di aeromobili nella recente disciplina internazionale*, in *La Comunità Internazionale*, 1971, fq. 266; Glaser, *Quelques observations sur le détournement d'aéronef. En marge de la Convention du 16 décembre 1970 sur la répression de la capture illicite d'aéronefs*, in *Revue Générale de Droit International Public*, 1972, fq. 12; Emanuelli, *Etude sur les moyens de prévention et de sanction en matière d'actes d'interférence illicite dans l'aviation civile internationale*, *ibidem*, 1973, fq. 577; Abramovsky, *Multilateral Conventions for the suppression of unlawful seizure and interference with aircraft. Part: the Hague Convention*, in *Columbia Journal of Transnational Law*, 1974, fq. 381.

⁷⁹ *Ibidem* fq. 21. Mbi Konventen e 1971, shih Mankiewicz, *La Convention de Montréal (1971) pour la répression d'actes illicites dirigés contre la sécurité de l'aviation civile*, in *Annuaire Français de Droit International*, 1971, fq. 855; Thomas, Kirby, *The Convention for the suppression of unlawful acts against the safety of civil aviation*, in *International and Comparative Law Quarterly*, 1973, fq. 163; Abramovsky, *Multilateral Conventions for the suppression of unlawful seizure and interference with aircraft. Part II: the Montreal Convention*, in *Columbia Journal of Transnational Law*, 1975, fq. 268.

çdo kush “*Any Person*” të akteve që favorizojnë ose realizojnë sekuestron e jashtëligjshme të kryer me dhunë në dëm të personave që ndodhen në bordin e avionit (Neni 1 i Konventës së 1963 si dhe Neni 1 i Konventës së 1971). Është parashikuar gjithashtu dhe bashkëpunimi në komisionimin e krimit duke e kategorizuar si krim dhe të dënueshëm (Neni 1 Shkronja, b e konventës e 1970 si dhe Neni 1, Par 2, shkronja b e konventës së 1971). Në veçanti në të gjitha konventat e përmendura më sipër është cituar një dispozite që përjashton nga fusha e rregullimit të tyre, aviacionin e përdorur për qëllime ushtarake, doganore, policore (Neni 1, Par 4, I konventes se 1963 si dhe Neni 3, Par 2, I konventes se 1970, Neni 4, Par 1, I konventes se 1971). Për të qenë një tablo më e plotë disiplina e konventave kërkon si pjesë thelbësore dhe protokollin e firmosur në Montreal në 24 Shkurt 1988, i cili hyri në fuqi në 6 Gusht 1989. “ *Për parandalimin e akteve të dhunshme në aeroportet e përdorur nga aviacioni civil ndërkombëtar*”⁸⁰. Një tjetër kategori aktesh të konsideruara si shprehje e terrorizmit ndërkombëtar është disiplinuar edhe nga e drejta ndërkombëtare, më konkretisht pjesa që ka të bëjë me udhëtimin detar. Është e rëndësishme që të përmendet dhe konventa “*Për parandalimin e akteve të jashtëligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar*”, e firmosur në Romë në 10 Mars 1988 dhe ka hyrë në fuqi në 1 Mars të 1992.⁸¹ Se dhe protokollin aneks i saj “*Kundër akteve të jashtëligjshme kundër sigurisë së platformave fikse të pozicionuara në platformën kontinentale*”⁸² Edhe kjo konventë e konsideron krim komisionimin nga ana e çdokujt të akteve të drejtpërdrejtë dhe të jashtëligjshëm, të

⁸⁰ *Ibidem* p. 63

⁸¹ *Ibidem*, p. 68. Mbi konventën e Romës, cfr. ne doktrine, ALBERSTAM, *Terrorism on the high seas: the Achille Lauro, Piracy and the IMO Convention on Maritime Safety*, in *American Journal of International Law*, p. 269 ss; FRANCONI, *Maritime terrorism and international law: the Rome Convention of 1988*, in *German Yearbook of International Law*, 1988, p. 278 ss; MOMTAZ, *La Convention pour la repression d'actes illicites contre la sécurité de la navigation maritime*, in *Annuaire Français de Droit International*, 1988, p. 595 ss; PANZERA, *Gli accordi di Roma per la repressione di atti illeciti contro la sicurezza della navigazione marittima e delle installazioni fisse collocate sulla piattaforma continentale*, in *La Comunità internazionale*, 1988, p. 421 s

⁸² *Ibidem*, p. 82.

qëllimshme që synojnë zaptimin dhe rrëmbimin e anijeve, ose duke vendosur kontrollin nëpërmjet kërcenimeve, dhunes, ose duke kryer akte dhune ndaj personave që ndodhen në bordin e anijes, kur një akt i tillë është i një natyre që prek sigurinë e lundrimit të anijes. Edhe Konventa e Romës parashikon si krim bashkëpunimin në veprimtarinë e njërit prej akteve të parashikuar në nenin 3, par 2, shkronja b, dhe përjashton shprehimisht nga fushëzbatimi i saj anijet luftarake, doganore, si dhe policore (neni 2). Në fund në kontekstin e “Agjensisë Ndërkombëtare për Energjinë Atomike” është lidhur konventa mbi “Mbrojtjen Fizike të Materialeve Nukleare” e firmosur në Vjenë në 26 Tetor më 1980 dhe hyrë në fuqi në 18 Shkurt 1987.⁸³ Ajo konsideron si krim pranimin e mallrave të vjedhur, mbajtjen, përdorimin e materialeve nukleare pa patur asnjë titull , si dhe që mund të provokojnë vdekjen, plagosjen e personave si dhe shkatërimin e të mirave.

4.2.1.1. Konventat “Kundër rrëmbimit të pengjeve”, “Kundër parandalimit të krimeve, kundër personave ndërkombëtarisht të mbrojtur përfshirë agjentët diplomatik”. Çështja e lëvizjeve çlirimtare.

Gjatë përgatitjes së Konventës së vitit 1973 disa shtete propozuan që kjo konventë të mos aplikohet për Lëvizjet Çlirimtare. Delegatë të 37 shteteve propozuan futjen në tekstin e Konventës një nen në bazë të të cilit “*no provision of the present articles shall be applicable to peoples struggling against colonialism, alien domination, foreign occupation, racial discrimination and apartheid in the exercise of their legitimate rights to selfdetermination and independence.*”⁸⁴ Në realitet, Konventa nuk parashikon asnjë dispozitë të lidhur me çështje të tilla, por megjithatë është e rëndësishme të vihet re zgjidhja e kompromisit e gjetur midis shteteve të cilët propozuan përjashtimin nga

⁸³ *Po aty* fq 48.

⁸⁴ UN GAOR 28th Sess., A/9407, 10 dhjetor 1973, fq. 50.

fushëzbatimi i konventës lëvizjet nacional çlirimtare, dhe shteteve që në të kundërt pretendonin që në konventë nuk duhej të parashikohej asnjë përjashtim. Bëhet fjalë për rezolutën 3166 e miratuar me unanimitet në Asamblenë e Përgjithshme të OKB, duke deklaruar që vetë konventa aty ku është parashikuar në vetë paragrafin 4 “*the provisions of the annexed Convention could not in any way prejudice the exercise of the legitimate right to self-determination and independence... by peoples struggling against colonialism, alien domination, foreign occupation, racial discrimination and apartheid*” Në komentin e projektit të rezolutës, përgatitur nga Komiteti i 6-të, mund të lexohet se paragrafi 4 “*was proposed as a substitute for the 37-Power draft additional article.*⁸⁵” U precizua që vetë rezoluta “*whose provisions are related to the annexed Convention, shall always be published together with it*” Në gjirin e debateve të zhvilluara në Asamblenë e Përgjithshme, në vazhdim gjatë miratimit të tekstit të konventës në 1973 shtetet shprehën opinionin e tyre mbi paragrafin 4 të rezolutës 3166. Disa prej tyre mbështesnin idenë se rezoluta nuk mund dhe nuk duhej të konsiderohej si bazë legjitime për kryerjen e krimeve të disiplinuar në konventë dhe në asnjë rast përsa u përket aktiviteteve legjitime të popujve në ushtrimin e të drejtës për vetëvendosje.⁸⁶ Shtete të tjerë mbështetnin tezën që konventa nuk duhej të “*impair the struggle of peoples against colonialism, foreign domination and racist regimes*”⁸⁷ Burundi shprehu rezervë për konventën e 1973 dhe shprehu se nuk do t’i aplikonte dispozitat mbi detyrimin e shteteve për të parashikuar sanksionet e duhura për krimet e disiplinuar nga konventa (neni 2, Par. 2), si dhe të merrte në përgjegjësi dhe të ekstradonte personat e pandehur për efekt të krimeve të tilla (neni 6, Par.1), me hipotezën që këto raste ishin përmbushur nga një lëvizje nacional-çlirimtare të njohur nga Burundi, ose

⁸⁵ *Po aty*, fq 61.

⁸⁶ SHih ne vecanti deklaratat e Algjerise, Kubes e Bullgarise, *ibidem*,respektivisht fq. 27, 32 e 33.

⁸⁷ UN GAOR, 28th Sess. 2202nd takimi I dt. 14 Dhjetor 1973,respektivisht fq. 21 e. 24.

nga ndonjë organizatë ndërkombëtare në të cilën Burundi bënte pjesë. Shtetet që kundërshtuan rezervën ishin Gjermania, Anglia, Izraeli, Italia, duke pretenduar se rezerva ishte në kundërshtim me objektin dhe qëllimin e konventës, dhe se Burundi nuk do të konsiderohej si pjesëtar ratifikues i konventës deri sa rezerva të mos ishte revokuar prej Burundit. Nga njëra anë është e rëndësishme që të sqarohet se kundërshtimet nuk janë formuluar qartë dhe se konventa nuk duhej aplikuar në raport me shtetin e rezervës, dhe se shtetet kundërshtues nuk u kursyen për t'i dhënë rezervës së formuluar nga Burundi një interpretim por pretenduan se nëpërmjet termave tepër të përgjithshëm sollën vullnetin e shteteve palë të konventës duke konsideruar Burundin si shtet jo palë të konventës deri në heqjen e rezervës. Çështja e raportit midis terrorizmit dhe luftrave për vetëvendosje, u ripropozua gjatë punimeve për konventën “*Mbi parandalimin e marrjes së pengjeve*”. Në gjirin e seksionit të parë në të cilin u mblodh komiteti i ngarkuar për të ndërtuar konventën, u ngrit problemi i dallimit midis marrjes së pengjeve si krim i thjeshtë në dallim nga krimi i marrjes së pengjeve gjatë luftrave nacional-çlirimtare. Disa shtete nënvizuan që aktet e kryera nga freedom fighters janë të dallueshëm përse i përket definicionit nga aktet e kryera nga terroristët, duhet të përjashtoheshin nga fusha e zbatimit të konventës. Delegatë Sirian për shembull afirmoi që “*acts perpetrated by criminals under ordinary law could not be placet on an equal footing with the struggle of the national liberation movements which, by their very nature and their objectives, were entirelyly different*”⁸⁸. Delegati i Tanzanisë propozoi që në konventë të shtohet një klauzolë në bazë të secilës “*for the purposes of this Convention, the term taking of hostage shall not include any act or acts carried out in the process of national liberation against colonial rule, racist and foreign regimes, by*

⁸⁸ First Report of the Hostages Committee, fq. 83-84.

liberation movements recognized by the United Nations or regional organizations”⁸⁹.

Shtetet perëndimore ishin të mendimit se nuk duhej të parashikoheshin përjashtime në konventë të bazuara mbi kauza politike të pengmarrjes (arsyeja e pengmarrjes).

Përfaqësuesi i SHBA deklaroi *“the question of whether there were circumstances in which oppressed peoples could resort to force to obtain their fundamental rights, including their right to self-determination, was not at issue”*, kjo nuk ishte e mundur as në çështjet më të rëndësishme, pra të pranoheshin akte të tilla si marrja e pengjeve⁹⁰.

Kompromisi u arrit me futjen e nenit 12 të konventës falë propozimit të delegatit të Meksikës, në bazë të të cilit janë përjashtuar nga fusha e zbatimit të konventës, “Kapja e pengjeve e kryer gjatë veprimeve në luftrat e armatosura” dhe ky kompromis do të gjente të njëjtën shprehje ashtu siç qe parashikuar në konventat e Gjenevës të 12 Gushtit 1949 dhe protokollit e saj të 8 Korrikut 1977 përfshirë dhe konfliktet e armatosura për të cilat paragrafi i 4 i nenit 1 të Protokollit të Parë, në të cilët popujt luftojnë kundër dominimit kolonial, okupacionit të huaj, regjimeve raciale, në ushtrimin e të drejtës së popujve për vetëvendosje e gdhendur në kartën e OKB dhe nga Deklarata Mbi Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare në Lidhje me Marrëdhëniet Miqësore dhe Kooperimin midis Shteteve, konform Kartës së Kombeve të Bashkuara. Disa deklarata u formuluan në referim me Art.12 të konventës dhe në veçanti nga Bjellorusia, Bullgaria, Kili, Izraeli, Republika Domenikane, Jugosllavia, në sensin që rrëmbimi i pengjeve duhet të ishte gjithmonë i ndaluar edhe në hipotezat e ngritura mbi nenit 12. Është me rëndësi të vihet re se neni 12 limitohet të parashikojë që hipotezat e rrëmbimit të pengjeve të kryera gjatë konflikteve të armatosura, përfshirë luftrat e popujve për vetëvendosje, nuk janë të disiplinuar nga konventa e 1979, në masën që ato janë të aplikueshme në konventat e

⁸⁹ UN Doc. A/AC.188/L.5 (1977).

⁹⁰ First Report of the Hostages Committee, fq. 83-84.

Gjenevës dhe protokollet shtesë, por kjo nuk do të thotë se ajo synon të përjashtojë dënimin e marrjes së pengjeve të kryer gjatë konfliktit të armatosur. Megjithatë presumohet se deklaratat e shprehura në preambulën e konventës, janë të formuluar në të njëjtën mënyrë si në nenin 12, duke sjellë debate midis shteteve përsa i përket konsiderimit të marrjes së pengjeve si akt i terrorizmit ndërkombëtar, i tillë do të konsiderohet dhe rrëmbimi i pengjeve i kryer nga populli që lufton për vetëvendosje. Është domethënëse deklarata e delegatit Iranian në drejtim të nenit 12 sipas të cilit *“even the proponents of safeguards for the rights of national liberation movements had maintained that they were in no way suggesting that these movements should be granted an open license to take hostages. However, it had been pointed out that a clear distinction should be drawn in the convention between genuine activities of national liberation movements and acts of terrorists which had nothing in common with them.”*⁹¹

4.2.1.2. Konventa Ndërkombëtare “Për parandalimin e atentateve me eksploziv”, Konventa “Për parandalimin e financimit të terrorizmit”.

Ndryshe nga konventat e përmendura deri tani, për të cilat siç folëm nuk bëjnë ekspresivisht referim tek terrorizmi ndërkombëtar përveçse, në disa raste përfshirë këtu dhe regullimin e preambulës, ka dy konventa që referojnë tek terrorizmi në terma eksplicite dhe të përgjithshme. Bëhet fjalë për konventat “Për parandalimin e akteve terroriste të kryera me lëndë shpërthyesë” e firmosur në New York në 15 Dhjetor 1997 dhe hyrë në fuqi në 23 Maj 2001⁹². Neni 2 i të cilës parashikon: *“Kryen krim çdokush që qëllimisht dhe në shkelje me ligjin, dorëzon, kolaudon ose detonon një eksploziv ose*

⁹¹ Shih per me shume ne lidhje me kete argument VERWEY, *The international hostage's convention and national liberation movements*, in *American Journal of International Law*, 1981 fq. 77.

⁹² *Po aty*,, fq. 99. Per nje analize te detajuar te konventes se vitit 1997 shih WITTEN, *The International Convention for the suppression of terrorist bombings*, in *American Journal of International Law*, 1998, fq. 774.

ndonjë send tjetër shpërthyes, kundër një vendi për përdorim publik, me qëllim që të provokojë vdekjen ose dëmtime të rënda fizike”. Është interesant dhe neni 19 i të njejtës konvente i cili perjashton nga fushezbatimi i konventës nga njera ane të gjitha aktivitetet e forcave të armatosura, gjatë një konflikti të armatosur në sensin që i është atribuar këtij termi nga e drejta ndërkombëtare humanitare, dhe nga ana tjetër aktivitetet e ndërmara nga forcat e armatosura të një shteti në ushtrim të funksioneve të tyre ligjore, në masë të tillë që këto aktivitete janë të disiplinuar nga e drejta ndërkombëtare. Për këtë konventë Pakistani formuloi një deklaratë në bazë të së cilës asnjë dispozitë e saj nuk do të aplikohet ndaj luftërave për vetëvendosje, kundër pushtimit të huaj në konformitet me normat e së drejtës ndërkombëtare. Pakistani përveç kësaj deklaroi që rezerva e tij ishte në përputhje me nenin 53 të konventës së Vjenës “Mbi të drejtën e Traktateve” të 23 Majit 1969 në bazë të së cilës një traktat që është i pa përputhshëm me një normë *Jus Cogens* që në rastin në fjalë është një tip i së drejtës së popujve për vetëvendosje dhe kjo normë duhet të konsiderohet nul. Për t’u marrë në konsideratë është dhe konventa “Per parandalimin e financimit të terrorizmit” firmosur në New York në 9 Dhjetor 1999 dhe hyrë në fuqi në 10 Prill 2002⁹³, sipas së cilës neni 2, par.2 përkufizon si akte trroriste ato akte të cilat provokojnë vdekjen ose plagosjen e rëndë të çdo personi që nuk merr pjesë aktivisht në situatat e krijuara nga një konflikt i armatosur, kur qëllimi i një akti të tillë është të friksojë popullsinë ose të shtrengojë një qeveri ose një organizatë ndërkombëtare të kryejë ose të abstenojë nga kryerja e një akti përveç kësaj është konsideruar krim pjesmarrja, organizimi ose favorizimi i aktiviteteve, të cilat kanë si qëllim të komisionojnë krime për të cilat bëjnë fjalë neni 2 (neni 2, par.5, germa a,b,c)

⁹³ *Po aty* fq. 113.

4.2.2. Konventat me karakter rajonal

4.2.2.1. Konventat e miratuara në Europë

Në gjirin e Këshillit të Europës u miratua në 27 Janar 1977 Konventa europiane “Për parandalimin e terrorizmit”, e cila hyri në fuqi në 4 Gusht 1978. Kjo u miratua për efekt të krijimit të lehtësirave gjatë procedurave të ekstradimit për personat e dyshuar, duke iu krijuar mundësi shteteve për t’i parë krimet e terrorizmit si të ndara nga kategoria e krimeve politike, të cilët hasnin pengesa për t’ju nënshtruar ekstradimit. Kjo konventë nga njëra anë merr në konsideratë dhe krimet specifike të rregulluara më parë në konventat me karakter universal dhe nga ana tjetër jep përshtypjen se përmban një definicion të qartë të terrorizmit. Neni 2 parashikon fuqinë por jo detyruesisht për shtetet anëtare që të mos konsiderojnë veprimet terroriste si krime politike kur gjenden përballë ekstradimit duke mos bërë përjashtime si për krimet e parashikuara në nenin 1, ashtu edhe ndaj çdo akti dhune të drejtuar kundër jetës, integritetit personal dhe ndaj lirisë së personave si dhe ndaj çdo akti të rëndë ndaj të mirave (prones), që krijon një rrezik kolektiv për personat. Krimeve të nenit 1 u është bërë një riformulim me protokollin e 15 Janarit 2003, në sensin që një protokoll i tillë edhe pse i pa hyrë akoma në fuqi, parashikon të listuar të gjitha kategoritë universale të akteve të konsideruara si terroriste në konventa universale, pra edhe ato që nuk u miratuan në Konventën e 1977 kur Konventa Europiane hyri në fuqi. Në doktrinë është vënë re se përkufizimi i terrorizmit nga Konventa Europiane është përkufizuar në mënyrë të tillë sa që nuk arrihet të bëhet dallimi midis akteve terroriste dhe krimeve të thjeshta dhe i vetmi element dallues është shprehja “ Akte të rënda”.

4.2.2.2. Konventat e miratuara në Shtetet Amerikane

Ashtu si Europa edhe Amerika ndërmori ndërtimin e konventave rajonale. Në 2 Shkurt 1971 u miratua konventa “ Për parandalimin dhe eliminimin e akteve terroriste”. Konventa hyri në fuqi në 16 Tetor 1973 dhe i referohet ekskluzivisht krimeve të ushtruara kundër agjenteve diplomatik dhe ndaj personave të asimiluar prej tyre. Me analogji konventa inter amerikane e miratuar në 3 Qershor 2002 dhe hyrë në fuqi në 7 Tetor 2003, u ratifikua me qëllimin për të forcuar parandalimin e terrorizmit se sa për të përkufizuar terrorizmin ndërkombëtar, pra u kufizua të përmendë vetëm kategoritë e krimeve të përmendura më parë në konventat ndërkombëtare. Moment interesant gjatë ratifikimit është deklarata e Ekuadorit i cili parashtrroi një mendim kritik sipas te cilit “Shtetet nuk kanë qenë në gjendje për të arritur një konsensus mbi përkufizimin e terrorizmit dhe klasifikimin e tij si një krim kundër njerëzimit”. Pra, kjo që në thelb ishte një kritikë e cila vinte në dukje se kishte një përpjekje, kjo që jo efektive sepse po anashkalohej vetë thelbi.

4.2.2.3. Konventat Rajonale që dallojnë terrorizmin nga luftat për liri.

Në të kundërt nga konventat rajonale të trajtuara deri tani ka dhe disa konventa të tjera që e përkufizojnë terrorizmin ndërkombëtar në terma tepër të përgjithshëm dhe që dallojnë këtë fenomen nga akte të popujve të përmbushura këto në kuadër të luftës për vetëvendosje. Midis tyre është konventa arabe “ Për parandalimin e terrorizmit ndërkombëtar” e cila u adaptua në Kairo në 22 Prill 1998 dhe hyri në fuqi në 7 Maj 1999. Ajo parashikon si akte terroriste në kuptimin e neneve 1 dhe 2 “*any act or threat of violence, whatever its motives or purposes, that occurs for the advancement of an individual or collective criminal agenda, causing terror among people, causing fear by harming them, or placing their lives, liberty or security in danger, or aiming to cause damage to the environment or to public or private installations or property or to occupy*

or seize them, or aiming to jeopardize a national resource."⁹⁴ Vazhdon më pas "*all cases of struggle by whatever means, including armed struggle, against foreign occupation and aggression for liberation and self-determination, in accordance with the principles of international law, shall not be regarded as an offence.*"⁹⁵ Me analogji, këto nene janë parashikuar dhe në konventën e Organizatës Islamike "Për parandalimin e terrorizmit ndërkombëtar" të adaptuar në Ugadugu më 1 Korrik 1999 si dhe në konventën e Bashkimit të Shteteve Afrikane të miratuar në Algjeri në 14 Korrik 1999.

4.3. BE-ja dhe Terrorizmi.

Përjasja legjislative dhe kontraktuale e fenomenit kriminal të terrorizmit nga disa legjislacione kombëtare europiane dhe nga vetë BE-ja, së pari ofron një mundësi për të identifikuar çështjet që ky fenomen ofron si problematika të shkencës penale dhe së dyti përshkruan rrugën që duhet ndjekur nga çdo studim i mirëfilltë i këtij fenomeni. Zbulimi kryesor ishte, që koncepti i terrorizmit është analizuar dhe më pas përkufizuar në dimensionet e përgjithshme jashtë shkencës juridike, por megjithatë është sanksionuar vazhdimisht në tekstet ligjore me rrjedhojë ose zbatimin pa një kriter të vecantë të këtij të fundit ⁹⁶ ose në mundësinë e nënshkrimit ose të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare (*kur është fjala për marrdhëniet ndërkombëtare*⁹⁷). Kështu pra, duhet t'i

⁹⁴ *International Instruments related to the Prevention and Suppression of International Terrorism, United Nations, New York, 2001, fq. 153.*

⁹⁵ *Po aty, fq. 154.*

⁹⁶ Shih artikullin e G.Aubert, "Repression et protection des libertés individuelles: le Royaume Uni devant la Cour européenne des droits de l'homme", R.I.C. 1978, fq. 367 e ne vij., ku duke përshkruar natyrën juridike të një padie të Irlandës së Veriut në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut për shkelje të të drejtave gjatë zhvillimit të operacionit Demetrius kundër I.R.A., ku analizon dhe rezulton në mënyrën se si duhet të merren masa në luftën kundër terrorizmit.

⁹⁷ Si psh dy konventat e 1937 dhe ajo e 1977-ës. Përveç të drejtës europiane, përpjekje të ngjashme janë bërë dhe në kuadër të të drejtës më të gjerë ndërkombëtare ". Për këtë shih dhe J.-Fr. Prevost, "Les aspects nouveaux du terrorisme international", 1973 fq. 579, ku bëhet një referim i gjerë i përpjekjeve të gjithanshme për të përkufizuar 'parandalimin' e terrorizmit si objektiv kryesor, në kuadër të Kombeve të Bashkuara, Shën Glaser, "Le terrorisme international et ses divers aspects", 1973, fq. 825-837, A. Beirlaen, "Considerations sur la prevention et la répression

përkushtrohemi përafrimit të konceptit të terrorizmit në dimensione extrajuridikale. Vetëm në këtë mënyrë, si përfundim do të rezultojë gjetja e një natyre politike në themel të tij⁹⁸. Kur gjatë zhvillimit të praktikave terroriste, preken interesat e ligjshme, dmth kur ky fenomen hyn në hapësirën e interesit penal, atëherë i vetmi kusht për ruajtjen e karakterit politik, ofrohet nga krahasimi i elementëve përbërës të konceptit në ballafaqim me krimin politik përkatës ose, si këtu argumentohet, krahasimi i subjektit që ushtron terrorizëm me kriminelin politik. Nëse krahasimi i këtyre dy dimensioneve rezulton në pranimin e marrëdhënies së varësisë të subjektit që ushtron terrorizëm (*dhe akti i tij është i interesit të fushës penale*) dhe konstruimit të shkencës penale (krimineli politik) atëherë, karakteri politik i autorit të këtij akti kriminal është egzistent në të gjitha fazat e përmbushjes së aksiomës penale të shtetit ligjor, kundrejt pasojave të këtij akti kriminal dhe njëkohësisht politik. Nëse, në të kundërt, krahasimi i këtyre dimensioneve rezulton në mosgjetjen, e marrëdhënies së varësisë, atëherë justifikimi i të akuzuarit se akti i tij është një akt politik i imponuar nga bindjet e tij dhe të ideologjisë që ai përfaqon, është tërësisht pa interes për procesin penal.

Traktati themelues i Bashkimit Evropian në nenin 29 të tij (*të ndryshuar me Traktatin e Amsterdimit më 1997/02/10*), ka përcaktuar si një nga objektivat e Bashkimit Evropian për t'u siguruar qytetarëve një nivel të lartë sigurie brenda zonës së lirisë (hapësirës europiane), për t'u garantuar drejtësinë duke deklaruar se ky objektiv

du terrorisme", 1978, fq. 825-834. Megjithatë, duhet të theksohet se shumica e teksteve që trajtojnë terrorizmin, në kuadër të të drejtës penale, insistojnë më shumë në përcaktimin e parandalimit me anë të sanksioneve penale dhe jo të kërkimit shkencor për një përkufizim të koncepti-nocionit (një nga përjashtimet më të dukshme është përpjekja për t'u perqasur këtij fenomeni në kontekstin e shkencave juridike, nga Colloque të Universitetit të Lirë të Brukselit me temë: "Reflexions sur la definition du terrorisme", 1974) kështu titujt që autorët japin në botimet e tyre janë shumë të ndryshme nga përmbajtja e teksteve. Për shembull, botimi i A. Sottile "Le terrorisme international" duhet të kishte si titull "Les deux conventions du 1937".

⁹⁸Ndërsaterorizmissinga fillimet e tij historike, por edhe nëtë tashmen, bën pjesë e fenomeneve politike, megjithatë përdorimi i tij nga organizata të ndryshme kriminale që kanë si objektiv, dukshëm, dhe fitime materiale na detyron që të bëjmë një dallim të qartë me bazë subjektin qëe ushtron, në terrorizëm politik dhe terrorizëm jopolitik.

do të arrihet me anë të ndërveprimit të përbashkët mes Shteteve Anëtare në fushën përfshirëse të bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale. Në nenin 31 të Traktatit specifikohet se, një veprim i përbashkët mbi bashkëpunimin gjyqësor përfshin intergrimimin progresiv të masave parandaluese, duke sanksionuar rregulla ligjore që kanë të bëjnë me përcaktimin e elementëve përbërës të veprave penale dhe dënimeve të krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit dhe kultivimit të drogave të paligjshme. Në bazë të këtyre dispozitave, Parlamenti Europian miratoi në 2001/09/05 Rezolutën mbi rolin e Bashkimit Europian në luftën kundër terrorizmit, duke i bërë thirrje Këshillit për të përafuar dispozita legislative për themelimin e rregullave minimale në lidhje me elementët përbërës të terrorizmit dhe të dënimeve. Në ekzekutimin e rezolutës dhe nën presionin që krijoi sulmi terrorist në SHBA, Komisioni i paraqiti në 2001/09/19 propozimin (COM 2001/521) Këshillit për të përcaktuar në mënyrë të qartë konceptin-përkufizimin e terrorizmit, kërcënimin nga ky fenomen, dënimet dhe subjektet e aktivitetit terrorist dhe këtë propozim, me përmirësime të rëndësishme miratuar përfundimisht nga Këshilli në 2001/07/12, nga Vendimi Kuadër. Në vendimin e mësipërm, një numër konsiderueshem i krimeve të rënda të së drejtës penale tradicionale, si p.sh. cënimi i të drejtës së jetës me anë të një sulmi që mund të shkaktojë vdekjen, dëmtime serioze të integritetit fizik ose që shkaktojnë ose synojnë mosfunksionim normal të qeverisë së zgjedhur, dëmtime të infrastrukturës publike, sistemit të transportit, etj, përcaktohen si akte terroriste nga një element objektiv ‘‘rrethanat që mund mund të dëmtojë seriozisht një vend apo një organizatë ndërkombëtare’’ dhe një element subjektiv, qëllimi i autorit të aktit që s’është vecse a) përcjellja e ndjesisë së frikës dhe terrorit në një popullsi b) imponimi i paligjshëm kundrejt një qeverie apo një organizatë ndërkombëtare të kryejë apo të mos kryejë një

veprim c) të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat politike, të minojë rendin kushtetues, sistemin ekonomik dhe të ndryshojë renditjen e vlerave dhe antivlerave në një sistem social të një vendi apo një organizatë ndërkombëtare. Rritja e terrorizmit, duke arritur kulmin me sulmin e 11 shtatorit të 2001-it në SHBA, krijoi nevojën e domosdoshme për masa më të rrepta dhe të studiuara për efikasitetin e tyre dhe për sigurinë e qytetarëve.

Reagimi i evropianëve në sulmit të 11 shtatorit, 2001, shkaktoi mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit të Europës më 21 shtator të të njëjtit vit me temë një dialog politik të thelluar me vendet dhe rajonet në mbarë botën ku startonte tashmë terrorizmi, dhe kërkonte bashkimin e shteteve, integrimin e tyre në një sistem të drejtë sigurie, prosperiteti dhe zhvillimi⁹⁹. BE-ja iu përgjigj thirrjes për solidaritet të SHBA-ve, por e bëri në një mënyrë që fokusohet në shkaqet e lindjes së terrorizmit, bazuar në një qasje konceptuale të sigurisë që vë theksin te integrimi ekonomik, te marrëdhëniet politike dhe kulturore të popujve dhe parandalimin e konflikteve, si dhe te heqja dorë nga përdorimi i rrugës ushtarake si më të përshtatshmen apo të vetmen për arritjen e paqes së qëndrueshme dhe mbrojtjen e sigurisë kombëtare. Si pritej, shpallja e mëvonshme nga ana e amerikanëve, e luftës kundër terrorizmit dhe pushtimi i Irakut, shkaktoi mosmarrëveshje serioze brenda BE-së, në mes të atyre që e mbështetën jo vetëm politikisht pushtimin, por dhe materialisht (*Angli, Poloni, Spanjë*) dhe atyre që këmgulnin në një vendim paraprak nga OKB-ja dhe shterimit të instrumentave politikë negociatore (*Belgjikë, Francë, Gjermani*). Në mbledhjen tjetër të jashtëzakonshme të K.E, evropianët përsëritën pikëpamjen e tyre për përjashtim të ndërhyrjes ushtarake si

⁹⁹European Commission, (2001), *Proposal for a Council Framework Decision on Combating Terrorism*, COM (2001), 521 Final, Commission of the European Communities, & http://www.un.int/france/documents_anglais/010921_eu_presidence_amerique.htm Conclusions and Plan of Action of the Extraordinary European Council Meeting (9/21/2001).

zgjdhje unike të problemit të Irakut, dhe argumentuan me sfond procesin e paqes mes Izraelit dhe Palaistines¹⁰⁰. Unë nuk do të perqëndrohem te ndikimi i mundshëm amerikan në zhvillimin e debatit endoevropian mbi pjesëmarrjen apo jo të BE-së. Në anën tjetër, mungesa e miratimit të një dokumenti të ngjashëm, si të SHBA-ve për Strategjinë Kombëtare të Sigurisë, të tipologjisë së rreziqeve që kërcënojnë BE-në si dhe të procedurave, masave të duhura, dhe politikave individuale shtetërore që do të zbatohen, ishte një arsye serioze e mosmarrveshjes. Ekzistenca e një dokumenti të tillë strategjik, i cili do të përcaktojë kontekste të përgjithshme, do të specifikojë fushat e interesit dhe do të udhëzojë për propozime specifike të politikave (*teknike, industriale, ushtarake*) është një element i domosdoshëm i një organizate mbikombëtare që ka vendosur për interesat strategjike dhe qëllimet politike afatgjata. Përveç kësaj, siç pretendohet nga Betts, "pa strategji, pushteti është i humbur" [loose cannon]¹⁰¹

Mungesa e një dokumenti të tillë u diagnostikua, dhe rezultati ishte Strategjia Europiane e Sigurisë (*SES*), që u hartua nga (atëherë), Përfaqësuesi i Lartë për CS&FP, Javier Solana, dhe u miratua nga Këshilli Europian në dhjetor 2003¹⁰². SES-si njeh sfidat globale dhe kërcënimet kryesore për BE-në dhe përcakton objektivat strategjike, të tilla si konstruktimi isigurisë në zonën tonë dhe promovimi e një rendi ndërkombëtar me bazë një qasje efektive multilateraliste. Vecoria e SES-it perceptohet në kuadër të globalizimit, i cili imponon dhe përshpejton aderimin e aspekteve të jashtëm dhe të brendshëm të sigurisë. Ndërsa për disa, rrjedha e tregtisë dhe e investimeve, zhvillimit të teknologjisë dhe përhapja e sistemeve demokratike, rezultoi në një situatë mirëqënieje dhe paqe të qëndrueshme, për disa të tjerë, këto ndryshime të shpejta shkaktuan

¹⁰⁰Council of the European Union, (2003), *Extraordinary European Council*, Brussels, 17/2/2003, 6466/03, fq. 2-3

¹⁰¹Ne menyre te vecante Betts, R.K., (2000), Is Strategy an Illusion?, *International Security*, vol. 25, nr. 2, fq. 5-50

¹⁰² Këshilli Europian, (2003), Një Europë e Sigurt në një Botë më të Mirë, Strategjia Europiane e Sigurisë, Bruksel, Belgjikë

zhgënjime dhe padrejtësi. Për më tepër, varfëria, mungesa e burimeve ushqimore, kërcënimi i epidemive të tilla si SARS dhe HIV përbëjnë dhe këto çështje të sigurisë, me falimentimin ekonomik të lidhur ngushtë me polemikat politike dhe trazirat e dhunshme. Në çdo rast për SES, siguria është kusht thelbësor për arritjen e zhvillimit në të gjitha fushat pa përjashtim, dhe trajtohet në një perspektivë më të gjerë, e cila përfshin parametra ekonomik, humanitar etj., dhe përgjithësisht jo më parametra ushtarake. SES, duke qënë e “vetëdijshme” për mundësinë e reduktuar të një sulmi ushtarak të intensitetit të lartë kundër shteteve anëtare, njeh pesë (5) kërcënimet si: 1) *terrorizmi*, 2) *përhapja e armëve të shkatërrimit në masë*, 3) *konfliktet rajonale*, 4) *dështimet e shtetit*, dhe 5) *krimi i organizuar*.

Për të adresuar këto kërcënime, janë marrë disa masa, si institucionalizimi i urdhër-arrestit evropian, lufta kundër financimit të terrorizmit dhe marrëveshja e ndihmës së ndërsjellë juridike me SHBA-të, e cila u miratua pas 11 shtatorit. Për më tepër, parandalimi i krimit të organizuar, rimëkëmbja e shteteve të rrënuar ekonomikisht dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë në hapësirën gjeografike europiane, si ajo është tashmë përcaktuar¹⁰³, janë identifikuar si politikat e duhura për të forcuar sigurinë dhe prosperitetin në BE. Veçanërisht qëllimi i arritjes së marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë me kufitarët gjeografikë, lidhet me hapat specifike politiko-ushtarak të bashkëpunimit teknologjik për të krijuar dhe aktivizuar mekanizmat e përbashkët parandalues, për të menaxhuar rrezikun dhe për të parandaluar konfliktet. Së fundmi, të mirë-funksionuarit e institucioneve ndërkombëtare si OKB-ja janë elementë thelbësore të një rendi ndërkombëtar të bazuar në rregulla¹⁰⁴. Megjithatë, për funksionimin efektiv të këtyre

¹⁰³European Commission, (COM 2003). *Wider Europe - Neighbourhood: a New Framework for Relations with our Eastern and Southern Neighbours*, 104 Final, 11/03/2003

¹⁰⁴ Këshilli Europian, (2003), *Një Europë e Sigurt në një Botë më të Mirë*, Strategjia Europiane e Sigurisë, Bruksel, fq 9.

organizatave ndërkombëtare, do të na duhet të jemi të gatshëm të mbajnë qëndrim kur shkelen rregullat e tyre. Për të arritur këtë qëllim, domethënë duke reaguar sipas rastit, SES thekson nevojën për përfshirje më aktive, më eficiente dhe më të gjerë të BE-së në kohezionin e komunitetit global. Me termin *përfshirje më aktive*, konceptohet angazhimi parandalues kur është i përshtatshëm dhe i nevojshëm, si dhe zhvillimi i një kulturë-mentaliteti strategjik që promovon dhe ndërhyrjen me forcë. Me kushtin e arritjes së kapaciteve më të mëdha, që përfshin nevojën për transformimin e forcave të armatosura në më fleksibële, eficiente për t'u mundësuar atyre që të përballen me kërcënimet e reja. Gjithashtu, referenca për përdorimin efikas të burimeve financiare të shpenzimeve, lidhet me nevojën për të reduktuar marrveshjet e ndërfinancimeve të imponuara për të mbuluar gropat financiare nga shtetet anëtare të BE-së. Me kushtin e një qëndrueshmërie më të madhe, SES imponon kombinim të instrumenteve dhe aftësive diplomatike, për zhvillim dhe tregti, si dhe inkurajon politikat mjedisore të cilat duhet të vazhdojnë nëpërmjet të njëjtës direktivë. Në këtë analizë të përgjithshme dhe në këtë kuadër duhet të përfshihen dhe aktivitet e jashtme të Shteteve Anëtare të BE-së. Mutacioni i forcave të armatosura kombëtare në fuqi ushtarake koherente, fleksibële Evropiane, kërkon krijimin infrastrukturor përkatës institucional dhe operativ në një kuadër të vetëm të burimeve kombëtare. Përveç kësaj, një shumëllojshmëri instrumentesh duhet të bashkohen për t'u koordinuar në mënyrë të përshtatshme. Në fjalët e SES, në një krizë, asgjë nuk mund zëvendësojë unitetin e Hegjemonisë. Në kontekstin e përgjithshëm, SES është dokumenti i parë strategjik i BE-së, dhe është një pikë referimi jo vetëm për CS&FP (*Politikat e përbashkëta të Jashtme dhe të Mbrojtjes [Common Security & Foreign Policy]*) por dhe për marrëdhëniet e jashtme të BE-së. Opsionet e mëdha politike që gjenden në këtë dokument, mund të rregullojnë aktivitetin

ndërkombëtar të BE-së për shumë vite. Në çdo rast, SES nuk mund të injorohet edhe nga ata që dëshirojnë që BE-ja të veprojë në identifikim absolut me NATO-n. Megjithatë, sukcesi i SES nuk është i sigurt. Për të arritur këtë (suksesin), opsionet e mësipërme duhet të konkludojnë në veprime konkrete dhe të zbatohen në mënyrë efektive për realizimin e vizionit origjinal të BE-së, për të luajtur një rol të rëndësishëm ndërkombëtar. Ky proces specifikues i një dokumenti, absolutisht të karakterit politik dhe jo ligjor, mund të jetë një fushë interpretimesh për natyrën dhe përmbajtjen e tij. Është e kuptueshme që, në varësi të interpretimit, SES mund të identifikohet nga titulli i tij, domethënë si një Strategji Sigurie afatgjatë për rolin global dhe veprimeve individuale të BE-së që rrjedhin prej tij, ose të përbëjë një tekst të thjeshtë – mbledhje anetaresh (*p.sh. pushtimi i Irakut*), jo shumë e rëndësishme. Pjesërisht, përpjekjet në favor të versionit të parë, ishin shkak që shtyu KE-në të delegojë përsëri te perfaqësuesi i lartë për CS&FP (*Politikat e përbashkëta të Jashtme dhe të Mbrojtjes [Common Security & Foreign Policy]*) Javier Solana, tagrin për të hartuar një amendamet rishikimi të SES në 2008¹⁰⁵. Ndërsa shqyrtimi përfshinte një seri rreziqesh dhe kërcënimesh të reja, të tilla si: siguria e energjisë, ndryshimet klimaterike, konfliktet e pazgjidhura dhe marrëdhëniet me Rusinë, ndërsa në mënyrë implicite, tregon për nevojën për koordinim të specializuar strategjik, politikat dhe veprimet për zbatimin e tyre. Në të vërtetë, ky proces periodik amendimi i SES-it mund të konsiderohet se ka implikime institucionale, ekonomike, teknologjike dhe administrative që rrjedhin nga kuadri regullator i përgjithshëm i SES dhe duhet të zbatohen nëse evropianët duan të jenë një *forcë e mirë* në këtë botë. Për më tepër, ky proces rishikimi do të ndjekë praktikën Amerikane erishikimit kombëtar strategjik në

¹⁰⁵ Këshilli i Europës, (2008), Raporti për Zbatimin e Strategjisë Europiane të Sigurisë. *Siguria në një Botë që ndryshon*, S 407/08, Bruksel.

intervale të rregullta kohore. Në kontekstin specifik të marrëdhënieve mes SES dhe politikave të industrisë së mbrojtjes, kontrollit të armatimeve dhe politikës teknologjike për çështjet e sigurisë, kontributi i këtij dokumenti strategjik është në qendër të konceptit se politikat publike që pasuan publikimin e SES, u mbështetën në mënyrë eksplicite dhe implicite në të (SES). Është e qartë se, edhe pse në përputhje me nenin 296 të Traktatit të Romës, kompetent për hartim të politikave të industrisë së mbrojtjes është çdo shtet anëtar, një numër i konsiderueshëm dokumentash autentik ndërkombëtar, në nivel të BE-së, si dhe politikat publike të BE-së që lidhen me mbrojtjen, armatimet dhe hulumtim janë të strukturuar, në pothuajse induksion, dhe mbështetur në tipologjinë e rreziqeve dhe kërcënimeve siç paraqitet në SES. PASR-i u mbështet te tipologjia e rreziqeve dhe kërcënimeve të SES. Me identifikimin e kategorisë së kërcënimeve, dhe përcaktimin e një sërë masash zgjidhjeje, SES ofroi ndihmë të konsiderueshme në procesin e hartimit dhe zhvillimit të një politike specifike evropiane të industrisë së mbrojtjes duke legjitimuar këtë proces. Për më tepër, përdorimi i koncepteve të veçanta në dokumentin SES krijoi një klimë pozitive për industrinë, sepse ajo ishte lajmëtare e një kornize për të koordinuar aktivitetin evropian në fushën e sigurisë, dhe aktivitetet e përbashkëta për përballjen në mënyrë efektive të kërcënimeve të reja të adresuar prej saj, të tilla si terrorizmi, armët e shkatërrimit në masë, konflikteve rajonale dhe të krimit të organizuar.

4.3.1. Strategjia Evropiane e Sigurisë dhe dokumenta të tjerë publike.

Qëllimi në këtë pikë të hulumtimit është që të analizojë dokumentet e veçanta publike të cilat janë të bazuara në SES dhe të përcaktojë objektivat afatshkurtër, afatmesëm, dhe afatgjatë të teknologjisë dhe hulumtimit që kanë për qëllim promovimin e sigurisë evropiane. Shumica e tyre në shumë raste shërbyen si

amplifikatorë të pushtetit (force multipliers) për të theksuar rëndësinë e një politike hulumtimi unike të sigurisë. Reflektoi procesin e prodhimit të politikave në këtë sektor teknologjik me shumë specifika, dhe siguroi orientim të mjaftueshem teknologjik për ata që u ftuan t'i aplikojnë për menaxhimin e PASR, si dhe boshtin tematik për Siguri në kuadër të *Shtyllës së 7-të*. Analiza e tyre ndjek një rend kohor bazë, por duhet theksuar se ata qëhartojnë dhe shpallin çdo herë raporte, vendime, deklarata, megjithëse janë pjesë përbërëse formuese të një super-strukture institucionale si BE-ja, kanë një autonomi menaxheriale. Kjo nuk do të inkurajojë studiuesin, sepse ata kanë për t'u referuar vazhdimisht burimeve primare të cilat kanë pika të ndryshme referuese, ndërsa kuadri i përgjithshëm i analizës së këtyre dokumenteve është i qartë, të gjitha tentojnë drejt zhvillimit të një strategjie unike kërkimi për sigurinë, duke synuar te omogjenizimi i politikave industriale të mbrojtjes, në këtë mënyrë duke kërkuar kështu bashkimin kompleks në shtyllën e dytë të BE-së. Ky interpretim vazhdues i dokumenteve publike nxjerr në pah mënyrat e shumta të të kuptuarit të këtyre dokumenteve, por kryesisht zbulon numrin e shumëfishtë të objektivave të hartuesve të tyre. Raporti i Grupit të Personaliteteve përfundoi nga (atëherë) Komisionerët European Busquin (*Research*) dhe Liikanen në mars të 2004¹⁰⁶. Përveç dy Komisionerëve, anëtarëve të zgjedhur të Parlamentit, pjesëtarëve të Forcave të Armatosura, si dhe drejtorëve të qendrave të mëdha kërkimore, grupi përbëhej nga CEO-t e kompanive që operojnë në industrinë e mbrojtjes, por edhe në industrinë e sigurisë (*EADS, BAE Systems, Thales, Diehl, Indra, TNO*). Gjithashtu u përfshinë dhe përfaqësues të kompanive të mëdha shumëkombëshe të komunikacionit (Siemens, Ericsson), të cilat janë aktive në elektronikën ushtarake,

¹⁰⁶European Commission, (2004), *Research for a Secure Europe: Report of the Group of Personalities in the Field of Security Research*, European Communities.

duke përfshirë prodhimin e radareve dhe sistemeve të mbikqyrjes ajrore¹⁰⁷. Kjo lidhje e ngushtë, edhe pse siç e pamë më lartë, është e para në historinë e politikës teknologjike të BE-së, është prototip në atë masë që ne mund të ekzaminojmë, nëse ata që janë përfshirë në hapat e parë për përcaktimin e prioriteteve për çështjet teknologjike të sigurisë, ishin vetë të përfshirë në ndërmarrjen e programeve të tyre përkatëse kërkimore dhe teknologjike. Përfshirja e industrive të mbrojtjes në procesin e përcaktimit të politikës teknologjike me qëllim arritjen e sigurisë, është një etapë e rëndësishme. Përsa i përket historisë së teknologjisë, korrelacioni me përfshirjen e industrisë gjatë hapave fillestarë të përcaktimit të politikës teknologjike europiane, siç e pamë më lartë, është i qartë. Në pikëpamjen e inovacionit financiar, orientimi drejt ndryshimit teknologjik bashkë-përcaktohet nga nevojat mbrojtëse në masën e orientimit teknologjik të objektit të sigurisë. Në nivelin e integritit evropian, njihet roli i industrisë nga omogjenizimi prioriteteve teknologjik dhe industrial në këtë proces lart. Në çdo rast, përkufizimi i përbashkët i prioriteteve kërkimore dhe përfshirja që në fazat e para e *klientëve – përdoruesve*, është një kërkesë e përpjekjeve që shënon Raporti vetë. Raporti kufizon kërkimin dhe teknologjinë si amplifikatorë të pushtetit dhe konsideron bazën teknologjike për mbrojtjen, aplikimet komerciale dhe aplikacionet e sigurisë si një fakt të vetëm. Zbatueshmëria e bazës teknologjike ushtarake në fushën e sigurisë (*dhe anasjelltas*) bazohet në rritjen e përshtatjes funksionale dhe mundësive të objektivave civile dhe ushtarake, si mbikëqyrja e kufirit (*tokësor dhe detar*), të nevojave emergjente, të kërkimeve hapsinore dhe bioteknologjike. Raporti bazohet në pranimin e kërcënimeve, siç përcaktohet në SES. Fakti se këto kërcënime janë tashmë

¹⁰⁷European Commission, (2004), *Research for a Secure Europe: Report of the Group of Personalities in the Field of Security Research*, European Communities, fq. 4-5, http://ec.europa.eu/enterprise/policies/security/files/doc/gop_en.pdf, aksesuar në dt.30.08.2015.

ndërkombëtare, nuk kufizohen vetëm në kufijtë kombëtarë dhe përfshijnë aspektet e jashtëm dhe të brendshëm të sigurisë evropiane, është tregues i nevojës për të zhvilluar një qasje gjithëpërfshirëse të sigurisë, duke kombinuar përdorimin e mjeteve politike dhe ushtarake, dhe nuk do të kufizohet nga e vjetëruara tashmë, ndarjes midis sigurisë së brendshme dhe të jashtme. Krijimi i ESRP ishte propozimi i Grupit, për zhvillimin e një përpjekjeje të koordinuar të sigurisë, e cila do të bazohet në teknologjitë me përdorim të dyfishtë dhe arritjen e identifikimit të qëllimit të përbashkët të aplikimeve ushtarake dhe civile që do të financohen nga fondet e BE-së që do të jenë në dispozicion vetëm për këtë qëllim, do të plotësonte programet ekzistuese të kërkimit të komunitetit politik dhe ushtarak. Më gjerësisht, krijimi i këtij programi, duhet të jetë në të njëjtën linjë me objektivat e politikave të BE-së në lidhje me çështjet e politikës së jashtme dhe të mbrojtjes dhe të politikës së sigurisë dhe në përputhje me ambicien e krijimit të një zone të lirisë, sigurisë dhe sundimit të drejtësisë. Raporti argumenton se në mënyrë që të realizohet krijimi i ESRP është i nevojshëm krijimi i ESRAB (*European Security Research Advisory Board*) [*Keshilli Europian për Kërkimet për Sigurinë*], i cili, në bazë të klasifikimit të rrezikut siç përcaktohet në SES, duke përcaktuar strategjitë e veprimit për përgatitjen e procesit të kërkimit, do të këshillojë mbi mekanizmat zbatues. Ky proces i përcaktimit të prioriteteve të kërkimit dhe teknologjisë do të përcaktohet nga një komunitet teknokratësh të lartë të klientëve publikë dhe privatë - përdorues, industria dhe qarqet akademike e kërkimore. Në të vërtetë, raporti avancoi në një tipologji të llojeve të kërcënimit, të aftësive që nevojiten për përballjen me ta në kontekstin e misioneve do të ndërmerren këtej e tutje, dhe teknologjive që duhet të zhvillohen¹⁰⁸.

¹⁰⁸European Commission, (2004), *Research for a Secure Europe: Report of the Group of Personalities in the Field of Security Research*, European Communities, fq. 18-19, tabela 2.

Në të njëjtën kohë, shkon përmes të referuarit të të sapokrijuarit (atëherë) DHS-së amerikane dhe mundësinë së kryerjes së pavarur R&D, në mbështetje të pozicionimit se për krijimin i një baze endogjene konkurruese teknologjike dhe industriale, duhet të zhvillohet në kuadër të BE-së një numër i teknologjive parësore (*të cilat do të përcaktohen nga Këshilli*), edhe në qoftë se ajo nuk mund të përjashtojë përpjekjet e abuzimit financiar dhe kështu me radhë shpenzimin e parave publike. Në shkurt të 2004-ës, KE vendosi *Zbatimin e Veprimeve Përgatitore [ZVP] për Rritjen e Potencialit Industrial Evropian në Fushën e Kërkimit Shkencor për Sigurinë[RPIEFKSHS]*¹⁰⁹. Deklarata e Komisionit Evropian për ZVP-në që pasoi, është në fakt një tekst shpjegues që përcakton detajet teknike të Vendimit dhe procedurat e zbatimit¹¹⁰. Siç pritej, në një proces të hartimit të politikave në këtë nivel, *Deklarata* ishte vendosur nën kontekstin se, *‘ai u themelua nga SES, dhe përsërit qëndrimin e saj, se zhvillimi i mjeteve teknologjikisht më të plota për parandalimin e kërcënimeve të tilla, është një parakusht për arritjen e objektivave të SES’*. Nevoja për zhvillim nuk bazohet te problemet e diagnostikuara në fusha të ndryshme, në problemet e sistemeve të ndërveprimit dhe infrastrukturës dhe efikasitetit të ulët në përpjekjet e përbashkëta për R&D të industrisë së mbrojtjes dhe industrisë së sigurisë dhe sektorëve të tjerë (*shih. teknologjitë me përdorim të dyfishtë*), por dhe te nevoja për të rritur fondet për shpenzime për R&D në 3% të PBB-së në nivel evropian, në përputhje me Traktatin e Lisbonës. Projekti i PASR përfshin një seri aktivitetesh hyrëse (*programet dhe veprimet mbështetëse*), duke hapur kështu rrugën boshtit tematik për *Hulumtime të Sigurisë*, i cili

¹⁰⁹European Commission, (2004), *Commission Decision of 3 February 2004 On the Implementation of the Preparatory Action of the European Industrial Potential in the Field of Security Research*, 5.3.2004, Official Journal of the European Union, fq 68, 18-22.

¹¹⁰European Commission, (2004), *On the Implementation of the Preparatory Action of the European Industrial Potential in the Field of Security Research, Towards a Programme to Advance European Security Through Research and Technology*, COM(2004) 72, Final, Bruksel.

u implementua nga vitit 2007. Për këtë qëllim, programet e PASR vecohen në programe me mision specifik (*mission oriented*) për fushat prioritare, kërkimore para-normative (*prenormative*) në fushën e modeleve dhe standarteve dhe sistemet e ndërveprimit, si dhe kuptimin e vlerave sociale dhe morale që ndikojnë nga ana e qytetarëve në perceptim të konceptit të sigurisë. Sa për veprimet mbështetëse, theksi është vënë në krijimin e kushteve që do të lejojnë perfitimet e fruteve të realizimit të R&D nga përdoruesit, ndërlidhjen e palëve të interesuara, si dhe në rritjen e ndërveprimit me sektorët e tjerë, si aeronautika. Në bashkëpunim me autoritetet kombëtare, industrinë dhe propozimet e *Grupit të Personaliteteve, Deklarata* emërton fushat prioritare të financimit për rritjen e sigurisë në Europë: Përmirësim i Përditësimit të Situatës (*situation awareness*); Përmirësim i Sigurisë dhe Mbrojtjes të Sistemeve të Rrjetit (Networking Systems); Mbrojtja kundër terrorizmit (duke përfshirë bio-terrorizmin dhe incidentet PVRCH); Përmirësim në Menaxhimin e Krizave; Ndërfunksionim dhe Konsolidim i Sistemeve të Informatikës dhe Komunikacioneve.

Emëron gjithashtu dhe fushat e aktiviteteve mbështetëse, të tilla si kryerjen skenareve simulative për të vlerësuar kërcënimet, identifikimin e zonave kritike, raportin teknik të fizibilitetit për një sistem informatik për sigurinë paneuropiane si dhe përcaktimin e procedurave për krijimin e teknologjive të reja të dobishme për sigurinë. Në shtator të vitit 2004, Komisioni Europian njoftoi për *Hapat e Ardhshëm: [R&D] Kërkimet për Sigurinë*, duke pranuar propozimet dhe udhëzimet e Raportit të Grupit të Personaliteteve¹¹¹. Ky komunikim është i bazuar në dy shtylla kryesore: në mjedisin e kërcënimeve të reja dhe shfrytëzimin optimal të industrisë së mbrojtjes. Lidhur me të parën, KE mbështetet në tipologjinë e kërcënimeve siç është përshkruar në ESA. Në të

¹¹¹European Commission, (2004), *Communication from the Commission to the Council, the European Parliament, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions. Security Research: the Next Steps*, COM (2004) 590 Final, Bruksel.

dytën, KE thekson konceptin e teknologjive me përdorim të dyfishtë, i cili është një urë për të bashkuar përpjekjet për R&D nga sektorët komercialë dhe ushtarakë me përfitime të mëdha ekonomike për industrinë, dhe pranon (KE), se terrorizmi i ri bën këtë ndarje të paaktivizuar. Për më tepër, ekzistenca e një programi kërkimor të koordinuar të sigurisë do të shtojë një vlerë të rëndësishme këtij sektori të industrisë, ndërsa rezultatet e këtij hulumtimi do të reflektojnë në të gjitha aspektet e ekonomisë, sepse siguria është një kërkesë horizontale për shumë sektorë të tjerë vertikale të aktivitetit ekonomik. Siguria ka një ndikim në një numër të madh të politikave publike evropiane, të tilla si: Konkurrenca, Transporti, Mjedisi, Energjia, Shëndetësia, Mbrojtja e Konsumatorit, Financat, Tregtia, Hapësirës Kozmike dhe Telekomunikacionit, si dhe të Sigurisë së Jashtme të Përbashkët dhe Politikës së Mbrojtjes (SJPPM). Gjithashtu çështjeve që kanë të bëjnë me drejtësinë dhe Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm (SHKB). Duke pranuar propozimet e Raportit të Personaliteteve, KE grupoi hapat e ardhshëm. a) rekrutimi i personelit të Këshillit të Sigurisë për Kërkimet për Sigurinë duhet të përfshijë ekspertë nga të gjitha palët e interesuara (përdoruesit, të industrisë, organizatat kërkimore), si dhe të koordinohet siç duhet me procedurat e brendshme në lidhje me hulumtimet me tematika të tjera. b) Fillimi i dialogut për hartimin e programit kërkimor mbi sigurinë në Shtyllën e Dytë. c) Homogjenizimin e specifikimeve teknike, siç është përmendur në SES dhe SJPPM, kur është e mundur, dhe të zhvillojnë sinergji mes programit kërkimor për Siguri dhe punës së bërë nga EDA. d) Arritja e menaxhimit optimal të programit kërkimor të Sigurisë duke përfituar nga eksperiencia e mëparshme. Në përputhje absolute me propozimet për ngritjen e një këshill kërkimor për sigurinë, siç thuhet në *Raportin e Personaliteteve dhe Hapat e Ardhshëm: Kërkimet për Sigurinë*, Këshilli European për Kërkimet për Sigurinë (European Security Research Advisory Board,

ESRAB) u formua në prill të 2005-ës, dhe përbëhej nga anëtarë të shërbimeve të sigurisë kombëtare, të administratës (kombëtare dhe europiane) publike dhe industrisë përkatëse me qëllim për të siguruar bashkëpunimin ndërmjet të gjithë palëve të interesuara në kërkimin për sigurinë në BE, të krijojë një mjedis network (rrjet) të përdoruesve dhe ekspertëve, për të sugjeruar mënyrat për të përmirësuar bazën Europiane të teknologjisë industriale, për të hartuar strategjitë dhe aspektet operative të programeve kërkimore.

Me fjalë të tjera, pjesëmarrës në ESRAB janë subjektet e *kërkesës* dhe *ofertës* për teknologji sigurie duke përcaktuar kështu hartimin e strukturës dhe financimin e përpjekjeve studimore dhe teknologjike. Raporti i parë i ESRAB titulluar ‘‘*Duke Përballuar Sfidën*’’, botuar në Shtator të 2006-ës, deklaron se ai është vazhdimi i përpjekjeve që startuan në kuadër të SES, në të cilën u regjistruan kategoritë e reja të kërcënimeve, dhe nga *Raporti i Personaliteteve* dhe *Hapave të Ardhshëm: Kërkimet për Sigurinë*¹¹². Në përputhje të drejtpërdrejtë me procesin induksional teknologjik të identifikimit të nevojave, duke filluar nga llojet e rreziqeve (kështu me radhë dhe me misionet e nevojshme për shuarjen e tyre), funksionet dhe aftësitë e nevojshme për suksesin e këtyre misioneve dhe zgjidhjet specifike teknologjike të nevojshme për përvetësimin e këtyre aftësive, raporti ESRAB identifikon dhe përcakton llojet e misioneve si ata i patën përmendur në vendimin e Komisionit Europian për Shtyllën e 7-të (shih më poshtë)¹¹³. Më konkretisht, tipologjitë e misioneve që do të thirret të ndërmarrë BE-ja janë: 1. Siguria Kufitare 2. Mbrojtja nga Terrorizmi dhe Krimi i Organizuar 3. Siguria e Infrastrukturës Kritike 4. Rivendosja e Sigurisë në Kohë Krize.

¹¹²European Commission, (2006), *Meeting the Challenge: The European Security Research Agenda*, Report from the European Security Research Advisory Board, European Communities, fq. 14

¹¹³European Commission, (2005), *Proposal for a Decision of the European Parliament and of the Council Concerning the Seventh Framework Programme of the European Community for Research, Technological Development and Demonstration Activities (2007-2013)*, COM (2005) 119 Final, Brussels, fq. 34

Përveç këtyre akseve vertikale, janë dhe tre tema horizontale të interesit të përbashkët, të cilat ndërthuren me të mësipërmet. Ato janë: 1. Bashkimi dhe Ndërveprimi 2. Siguria e Shoqërisë 3. Sinkronizimi. Tipologjia e misioneve nga ana e saj është e specifikuar në karakteristikat dhe aftësitë, dhe këto nga ana e teknologjive. Përveç integritit grupor vertikal, raporti i ESRAB pranon se ekzistojnë potencialisht aftësitë që duhen për të mbështetur misione të tilla¹¹⁴. Në misione të tilla, siç pritej, teknologjitë e menaxhimit, mbledhja, analiza dhe përdorimi i informacionit janë mëse të nevojshme, për arsye të përdorimit të tyre. Kjo është për hartuesit e raportit dhe motivimi për një marrëdhënie më të konsoliduar me temat e tjera dhe përdoruesit në nivel industrial. Krijimi i *European Security Research and Innovation Forum* (ESRIF) në vitin 2007, ishte fryti i përpjekjeve për bashkëpunim më të qartë dhe të interkoneksionit mes të gjitha palëve të interesuara në siguri dhe në dialog mes sektorit publik dhe privat, siç është përshkruar në projektin e PASR. Ky dialog, përmes paraqitjes së strategjisë si dhe shkëmbimit të praktikave më të mira dhe përdorimit të teknologjive nga palët e interesuara, do të rezultojë në ofrimin e sigurisë të mirë të mundshme për qytetarët europianë¹¹⁵. Sipas projektit fillestar, ESRIF do funksionojë në marrëveshje me anëtarët e tij (shtetet), dhe do të organizohet nga grupet e interesit (përfaqësuesit e shteteve anëtare, drejtuesit e industrisë, përdoruesve të teknologjisë në sektorin publik, organizatat kërkimore dhe universitetet, si dhe OJQ. Roli i ESRIF nuk është të përcaktojë politikën e sigurisë, por për të siguruar informacion për hartuesit e politikave në nivel kombëtar dhe europian në lidhje me ofertën dhe kërkesën teknologjike të sigurisë. Kjo do të thotë sigurisht, se kur kërkesa nuk mund të plotësohet nga oferta aktuale e teknologjisë, përcaktimi i politikës

¹¹⁴European Commission, (2006), *Meeting the Challenge: The European Security Research Agenda*, Report from the European Security Research Advisory Board, European Communities, fq. 48.

¹¹⁵European Commission, (2007), *The European Security Research and Innovation Forum (ESRIF) – Public-Private Dialogue in Security Research*, COM (2007) 511, Brussels.

së teknologjisë ekzistuese përmes prioriteteve të saj kërkimore, mund ta kompensojë këtë mungesë. Raporti përfundimtar i ESRIF (*European Security Research and Innovation Forum*) në dhjetor të 2009-tës është propozimi për hartimin e një strategjie 20 vjecare planifikimi teknologjike që mbështet qëllimin e arritjes të një sigurie të lartë kundër kërcënimit terrorist dhe atij nga krimi i organizuar¹¹⁶. Qasja e ESRIF-it për përcaktimin e prioriteteve të teknologjisë shfytëzoi hartimin e skenarëve afatgjatë nëpërmjet teknikës së studimit prooptik teknologjik (*Technology Foresight*), ku identifikohen një seri rreziqesh (natyrorë dhe antropogjenë) dhe sfidat për përballjen e tyre. Krijimi i një baze efektive shkencore, teknologjike dhe industriale nga e cila mund të përceptohet instrumenti i nevojshëm në varësi të rrezikut konkret, përbën dhe thelbin e kësaj përpjekjeje. Grupet e punës, pasi të njihen rreziqet dhe sfidat e paraqitura në zonat e tyre të veçanta (*p.sh. Sigurimi i Infrastrukturës kritike, Menaxhimi i Krizave, Roli i Hapësirës Kozmike, Lëndët helmuese etj.*) avancuan në një vlerësim cilësor të nivelit aktual teknologjik, u njohën me mangësitë e këtij niveli dhe me nevojën absolute të përcaktohen objektivat e ardhshëm kërkimor. Kjo qasje tërësore për kërkimin dhe inovacionin për sigurinë, duhet të marrë parasysh aspektet sociale, kulturore, ligjore dhe politike. Planifikimi i ndarjes së hulumtimit nga ESRIF (*European Security Research and Innovation Forum*), duke qenë të vetëdijshëm për këtë kufizim, vë në dukje se treguesi i suksesit të kësaj përpjekjeje duhet të marrë parasysh shkallën e ndërvarësisë ndërmjet teknologjisë, dinamikës organizative, dhe kufizimeve njerëzore.

4.4. Raste praktike të aplikimit të konventave ndërkombëtare me fokus aktet terroriste

¹¹⁶European Security Research and Innovation Forum, (2009), *ESRIF Final Report*, European Security Research and Innovation Forum

Në qoftë se analizohet praktika e aplikuar nga konventat e analizuara ose me saktë të disa prej tyre, do të vihet re se asnjëherë gjyqtarët kombëtarë nuk kanë ushtruar kompetencën e tyre mbi krimet e parashikuara nga këto konventa. Të gjitha marrëveshjet për parandalimin e terrorizmit ndërkombëtar ose akteve të vecanta të terrorizmit, me përjashtim të Konventës së Tokios së 1963, parashikojnë parimin *Aut Dedere Aut Judicare*, duke imponuar shtetin ratifikues në territorin e të cilit ndodhet personi i dyshuar, ta ekstradojë tek një shtet tjetër anëtar, në bazë të kërkesës ose t'ja nënshtrojë çështjen organeve të veta gjyqësore. Traktatet në fjalë parashikojnë një ushtrim gati universal të juridiksionit penal, në sensin që shteti kontraktues që nuk pranon kërkesën e ekstradimit detyrohet që të ushtrojë juridiksionin e vetë penal kundër të pandehurit edhe në mungesë të çdo lloj lidhjeje territoriale ose shtetësie me veprimin terrorist, për të vetmin fakt që i pandehuri ndodhet në territorin e atij shteti. Nga një testim i praktikës së aplikuar nga konventat e adaptuara në nivel ndërkombëtar, vihet re tendenca për tu përballur dhe zgjidhur pozitivisht problemin e ushtrimit të juridiksionit universal, kundrejt disa krimeve të disiplinuar prej tyre dhe në veçanti ndaj atyre shteteve të cilat kërcënojnë sigurinë e aviacionit civil. Megjithatë konkluzioni që del në përfundim të diskutimit është që ushtrimi i juridiksionit universal nuk është i lidhur automatikisht me aktet e terrorizmit ndërkombëtar, por me shkeljet e sanksionuara nga konventat të cilat shpesh konfigurohen si krime të përgjithshme. I vetmi rast në të cilin gjyqtarët kombëtar janë shprehur qartë në sensin që një nga krimet e disiplinuar në konventa dhe tek i cili është referuar si akt terrorist si dhe mund të aplikohet parimi i juridiksionit universal penal është sentencë e dhënë në SHBA në 1988. Në çështjet e tjera që do të ekzaminojmë do të vërejmë që gjyqtarët kombëtarë kanë ushtruar juridiksionin e vetë

kundrejt krimeve te disiplinuar në konventat ndërkombëtare pa iu referuar kualifikimit të tyre si akte terroriste.

4.4.1. Çështja Yunis

Çështja ka të bëjë me një shtetas libanez i inkriminuar në SHBA për përfshirjen në sekuestron dhe shkatërimin e një avioni civil Jordanez në aeroportin ndërkombëtar të Beirutit në 1985. I akuzuari pretendonte se prezenca e shtetasve amerikan në avion, nuk ishte e mjaftueshme për të lejuar që SHBA të ushtronin juridiksionin. Gjykata e District of Columbia u shpreh në seancën e 12 Shkurtit 1988. Fillimisht gjykata afirmoi që parimi i ushtrimit të juridiksionit universal mbi akte te ngjashme me këtë çështje është e parashikuar në konventa ndërkombëtare dhe në veçanti në nenin 7 të Konventës “Për parandalimin e rrëmbimit të avionëve civil” firmosur në Hage në 1970, si dhe neni 7 i Konventës “Për parandalimin e akteve drejtuar kundër sigurisë së aviacionit civil” firmosur në Montreal 23 Shtator 1971. Të dy nenet parashikojnë që *“all contracting states... of which the alleged offender is found... shall be obliged, without exception whatsoever and whether or not the offence was committed in its territory, to submit the case to its competent authorities for the purpose of prosecution.”* Në vazhdim gjykata shtoi dhe më tej duke afirmuar që *“the offences of aircraft piracy and hostage taking, which had been widely condemned by a majority of states, including Lebanon, in a series of international agreements, were recognized as universal crimes over which all states should exercise jurisdiction,¹¹⁷”* si dhe shtoi që *“when another government harbours international terrorists or is unable to enforce international law, it is left to the world community to respond and prosecute the alleged terrorists,”¹¹⁸* Me prezumimin kjo që Libani nuk ka patur kapacitetin ose vullnetin që të ndëshkojë akte

¹¹⁷ *United States v. Yunis (no 2)*, in *International Law Reports*, vol. 87, fq 344.

¹¹⁸ *United States v. Yunis (no 3)*, in *International Law Reports*, vol. 88, fq 176.

terroriste të konstatuara. Është interesante po të vihet re qëndrimi i gjykatës rreth limiteve të fuqisë së shteteve në sensin që *“however, the decision to permit the government to bring charges against the defendant should not be regarded as giving the government carte blanche to act as a global police force seizing and abducting terrorists anywhere in the world. The government cannot act beyond the jurisdictional parameters set forth by principles of international law and domestic statute.”*¹¹⁹ Është e rëndësishme dhe sentenca e dhenë nga gjykata e apelit e 1991 duke konfirmuar vendimin e gjykatës së Distriktit dhe riafirmuar principin e juridiksionit universal mbi bazën e konventave ndërkombëtare lidhur me çështjen në fjalë. Gjykata e apelit në çështjen Yunis shton *“nor is jurisdiction precluded by norms of customary international law.”*¹²⁰

4.4.2. Çështja Georgesku

Në disa raste të tjera, referimi tek krimet e sanksionuara nga konventat ndërkombëtare bëhet i qartë se si shpesh krimet e parashikuara në to konfondohen shpesh me krimet e zakonshme dhe se ka vështirësi në identifikimin e tyre si krime terroriste. Po marrim një shembull në 1989 Gjykata e Distriktit të New York dënoi një shtetas Rumun për një krim të klasifikuar si përdhunin, vepër kjo që ishte kryer në bordin e një avioni skandinav të drejtuar në SHBA¹²¹. Mbi bazën e konventës së Tokios së 1963 lidhur me krimet e kryera në bordin e avionëve (këtu u mbështet gjykata në dhënien e dënimit). Në veçanti gjykata afirmoi se *“many crimes committed aboard aircraft are considered both by the United States and the international community to be offences against the law of nations,”*¹²² më pas vazhdon se *“the Tokyo convention’s*

¹¹⁹ *Po aty fq 354.*

¹²⁰ *Po aty fq 181.*

¹²¹ *United States v. Georgescu, in International Law Reports, vol. 86, p. 33 ss.*

¹²² *Po aty fq. 41*

concurrent jurisdiction provision reflect the international legal community acceptance of broad bases for jurisdiction over criminal offences on aircraft.”¹²³

4.4.3. Çështja S.H.T

Në 1974 Gjykata e Distriktit Hollandez të Haarlem, u prononcua mbi personin e një shtetasi Izraelit i akuzuar për sekuestrimin e një avioni Britanik në fluturimin nga Beirut për në Londër dhe për efekt të këtij rrëmbimi, ekuipazhi u detyrua të ulej në Schiphol në Hollandë.¹²⁴ Gjykata deklaroi kopetencën e saj për tu shprehur mbi çështjen duke referuar në nenin 7 (4) (b) të Kodit Penal Hollandez. Kodi Penal për këto kategori krimesh ishte ndërtuar mbi frymën e konventave të 1970 dhe 1971 “Për parandalimin e sekuestrove të jashtëligjshme të avionëve”, si dhe deklaroi se gjyqtarët Hollandez mund të prononcohen mbi krimet e parashikuara në konventat e ratifikuara prej Hollandës për krime të ndodhur në bordin e avioneve në fluturim, duke u ngritur, gjatë uljes si dhe jashtë territorit të shtetit të rregjistrimit, si dhe i prezumuar të ndodhet në territorin Hollandez.

4.4.4. Çështja Ekanayake.

Kjo është një çështje e cila ka lidhje me vendimin e dhënë nga gjykata e apelit të Sri Lankës, e prononcuar në vitin 1986. Mbi bazën e këtij vendimi një qytetar i Sri Lankës u akuzua dhe u ndëshkua sepse kishte kërcënuar të shpërthente një avion në fluturim¹²⁵. I pandehuri u denua mbi bazën e një akti të brendshëm të miratuar në vitin 1982 nëpërmjet të cilit Sri Lanka legjitimoi aplikueshmërinë e konventave ndërkombetare “Mbi parandalimin dhe kontrollin e akteve drejtuar kërcënimit të sigurisë të aviacionit civil” më saktë Konventat e Tokios të vitit 1963, Konventa e Hagës e vitit 1970,

¹²³ *Po aty* fq 42.

¹²⁴ Gjykata e Distriktit të Haarlem 6 Qershor 1974, *Public Prosecutor v. S. H. T.*, in *International Law Reports*, vol. 74, fq 162.

¹²⁵ *Ekanayake v. Attorney General*, in *International Law Reports*, vol. 87, fq. 296.

Montrealit e vitit 1971. I pandehuri pretendoi se akti i brendshëm hyri në fuqi në vitin 1982 dhe se nuk kishte fuqi prapavepruese, në përputhje ky parim me normat e kushtetutës. Në fakt neni 13(6) I kushtetutes së Sri Lankës parashikon që *“no person shall be held guilty of an offence on account of any act or omission which did not, at the time of such act or omission, constitute such an offence.”* Megjithatë është parashikuar edhe një përjashtim *“nothing in this Article shall prejudice the trial and punishment of any person for any act or omission which, at the time when it was committed, was criminal according to the general principles of law recognized by the community of nations.”*¹²⁶

4.5. Praktika e disa shteteve

Në qoftë se duket e kritikueshme praktika e cila çoi doktrinën në individualizimin e dy hipotezave “ State support” dhe “State Sponsor” për aktet terroriste, nuk duket gjithashtu efikase as praktika e shteteve sipas të cilëve fakti që një shtet lejonte që në territorin e tij të përgatiteshin akte të prezumuara si terroriste, legjitimonte më pas ndërhyrjen ushtarake në atë shtet. Siç do të shohim kjo lloj doktrine jo vetëm që është parcale domethënë është pranuar vetëm nga një grup shtetesh, tregon që masat e mara ndaj akteve terroriste paraqesin në fakt bindjen e përfshirjes së organeve të shtetit. Marim rastin e atentatit të dështuar kundër avionit Jumbo Izraelit të linjës EL AL në aeroportin Londinez të Heathrow më 24 Tetor 1986. Gjatë procesit në ngarkim të Hindaouit shtetas Jordanez i dyshuar si përgjegjës për ngjarjen përballë tribunalit të Old Bailey të Londrës, doli që bomba e përdorur ishte futur në Angli nëpërmjet nje valixheje diplomatike dhe më pas ishte konfeksionuar në ambasadën

¹²⁶ *Po aty*, fq. 298.

Siriane në Londër. Hindaouio ishte rekrutuar në Damask nga një agjent Sirian i cili kishte siguruar një passaporte me një emër fallco. Qeveria Britanike vendosi menjëherë pas procesit ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike me Sirinë dhe deklaroi se do të vinte dhe veton në KEE për çfarëdo lloj ndihme financiare për Sirinë. Më pas Parlamenti Europian votoi anulimin e ndihmave financiare për Sirinë. Anglia shpresoi që dhe shtete të tjera do të ndërprisnin marrëdhëniet diplomatike me Sirinë por një gjë e tillë nuk ndodhi. Por në Tetor u miratua një deklaratë në KEE të Luksemburgut të cilën vetëm Greqia refuzoi ta firmoste. Në të shprehej solidariteti ndaj masave të marra nga Anglia si dhe u vendos të mos autorizohet më shitja e armëve të Sirisë, si dhe ndërprerja e vizitave në atë shtet¹²⁷. Me analogji në Nëntor të 1986 para gjykatës penale të Moabit, filloi procesi i dy shtetasve jordanezë të akuzuar për pjesëmarrje në atentatet e 29 Marsit 1986 ndaj një shoqërie Arabo- Gjermane të Berlinit dhe më 5 Prill ndaj një diskoteke berlineze që frekuentohej nga ushtarët Amerikanë. Gjatë procesit doli që eksplozivi ishte furnizuar nga një agjent Sirian kolonel i ushtrisë pranë ambasadës siriane në Berlin. Në vijim të këtyre ngjarjeve qeveria e Republikës Federale Gjermane urdhëroi më 27 Nentor espulsin e 3 agjentëve diplomatik srianë dhe pezulloi ndihmat financiare të akorduara për Sirinë. Qeveria e Bonit, vendosi pezullimin e programeve të zhvillimit të Sirisë, si dhe refuzoi të nominonte një ambasadë në Damask. Zëdhënësi i shtypit të Kancelarisë F. Host, rreth masave të adaptuara nënvijëzoi se Qeveria Federale konsideronte si shkelje dhe dhunim të normave të së drejtës ndërkombëtare pjesëmarrjen e organeve shtetërore siriane në atentatet terroriste të përmbushura në territorin Gjerman.¹²⁸ Shtetet perëndimore (bëhet fjalë për ato vite) adoptuan një seri deklaratash në të cilat parashikohej adoptimi i masave ndaj atyre shteteve që ofronin

¹²⁷ *Revue Générale de Droit Interntional Public*, 1987 fq. 594.

¹²⁸ ZICCARDI CAPALDO, cit., p. 52.

ndihmë grupeve terroriste. Deklarata e Bonit e 17 Korrikut 1978 e firmosur në SHBA, Kanada, Rep Federale Gjermane, Japoni, France, Angli, Itali, në të cilën parashikohet një strategji e përbashkët kundër shteteve që do t'i ofronin ndihmë terroristëve. Parashikohet gjithashtu ndërpreja e fluturimeve me dhe nga shtetet që refuzonin të ekstradonin ose dënonin rrëmbyesit e avionëve duke shpresuar që dhe shtete të tjerë do të bashkoheshin me këtë iniciativë. Në samitin ekonomik të Otavës në 1981, u adoptua deklarata e Montebelos midis shteteve të industrializuara rreth të cilës u vendos aplikimi i sanksioneve kundër Afganistanit sepse ishte një shtet mbështetës dhe furnizues i terrorizmit dhe për rrjedhojë paraqitej si shtet shkelës i normave ndërkombëtare. Akti parashikonte sanksione kundrejt qeverisë së Kabulit për përfshirjen në sekuestrimin e një avioni të Pakistan International Airlines, i cili u rrëmbye nga një shtetas pakistanez dhe u ul në Kabul në Mars të 1981. Qeveria Afgane megjithëse autoritetet pakistaneze kishin kërkuar që të mos autorizonte fluturimin, kishte bërë të kundërtën. Pakistani akuzoi autoritetet Afgane për ndihma me armë si dhe ndihma të tjera për rrëmbyesit e avionit gjatë ditëve të qëndrimit. Shtetet e mbledhura në Montebelo me të konstatuar shkeljen e normave ndërkombëtare si dhe detyrimet e mara përsipër me konventën e Hages “Për eliminimin e ndalimin e sekuestros së jashtëligjeshme të aeroplanëve” të 16 Dhjetorit të 1970 vendosi të pezullonte fluturimet nga dhe për në Afganistan, deri në çastin kur shteti të merrte masat e duhura në përmbushje të detyrimeve ndërkombëtare të mara përsipër. Në Maj të 1986 u miratua deklarata e Tokios midis 7 shteteve më të industrializuara (SHBA, Kanada, Angli, Francë, Itali, Gjermani, Japoni). Në të ndëshkohej terrorizmi me të gjitha format e tij si dhe në veçanti përdorimi i tij si instrument politik i një shteti dhe sanksionohet përgjegjësia ndërkombëtare e shtetit i

cili ofronte mbështetje konkrete, si dhe propozoheshin sanksione ndaj Libisë.¹²⁹,¹³⁰. Kjo praktikë sipas mendimit tim nuk është e përshtatshme për të zbuluar një sjellje të përgjithshme të shteteve, dhe në fakt është evidente sepse bëhet fjalë për vendime të marra në kuadër të një grupi të vogël shtetesh. Praktikisht midis shteteve perëndimore mbi bazën e sulmeve të pësuara mbi ata vetë, dhe nga ata vetë të konsideruara si terroriste. Përveç të tjerave shtetet perëndimore adoptuan sanksione kundër shteteve që pretendoheshin se ishin të përfshirë akte të tilla dhe në shumicën e rasteve mbi prezumimin e provave të mjaftueshme, sqarohet përfshirja e tyre por në raste të tjera dhe mbi prova tepër të vakta dhe të përgjithshme, akuzoheshin për bashkëjetesë me terrorizmin ndërkombëtar, pa reflektuar dhe pa patur të qartë më parë se çfarë kuptohej me këtë term.

¹²⁹ *International Legal Materials*, 1981, fq. 956.

¹³⁰ *Po aty* 1986, fq. 1005.

KAPITULLI V: ASPEKTET E LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT

5.1. Hyrje

Qëllimi i këtij kapitulli është të shqyrtojë ndryshimet në perceptim të realitetit në zhvillimet aktuale në arenën ndërkombëtare, ato të ndjenjës së sigurisë në popullatën e vendeve perëndimore BE, SHBA-ve, etj., shkaktuar nga sulmet e 11 shtatorit të 2001-it, në perceptimin e sigurisë dhe terrorizmit në Evropë. Për të arritur këtë, do të fillojmë me një analizë të përgjithshme të sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare gjatë Luftës së Ftohtë, pas kësaj, dhe e shoqëruar me lindjen e konceptit të *“terrorizmit islamik”*. Koncepti i sigurisë, u riformulua përmes një ridefinimi konceptual për shkak të fenomenit të terrorizmit, dhe të vlerës së tij të lartë politike dhe ekonomike që i atribuon elita politike dhe ekonomike. Siguria është një e mirë publike, mungesa (*apo edhe ulja e ndjesisë së sigurisë*) e të cilës shpejt modifikon kontratën sociale, dhe sjell vështirësi serioze në proceset politike, ekonomike dhe teknologjike. Koncepti i terrorizmit përbën anën tjetër të konceptit të sigurisë sepse i pari është shkaku kryesor i shkeljeve të së dytit. Të dy konceptet kanë ndërlidhje të shumta mes tyre. Do të përpiqem të demonstroj ne kete kre se përpjekjet e politikës së sigurisë për të eliminuar kërcënimin terrorist lidhen ngushtesisht dhe përfshijnë edhe aspektet teknologjike. Zbatimi dhe aplikimi i teknologjisë politike duhet përfshijë dy objektiva të dallueshme midis tyre, që janë promovimi i bazës shkencore, teknologjike dhe industriale, dhe mbrojtja kundër sulmeve terroriste. Ky kapitull është një përpjekje për të sqaruar konceptualisht ose të paktën për të treguar kufijtë e koncepteve të sigurisë dhe terrorizmit në lidhje me teknologjinë. Besoj se është e nevojshme një përpjekje e tillë për dy arsye: kërcënimet terroriste në kuptimin e konkretizimit të sulmeve terroriste, mund të frenohen vetëm duke zhvilluar sisteme teknologjike të avancuara apo dhe aplikimin e sistemeve

teknologjike ekzistues në fusha të ndryshme nga ato për të cilat fillimisht u krijuan. Prandaj, një përjasje në këto koncepte mund të rezultojë të jetë një udhëzues për përcaktimin e drejtimit të progresit teknologjik. Për më tepër, si pasojë e natyrës së dyfishtë të teknologjisë, teknologjia në vetvete përdoret dhe si një mjet për kryerjen e sulmeve terroriste. Është kaq i madh depërtimi i teknologjisë në jetën tonë të përditshme *(është aq i madh sa na është krijuar një realitet varësie ndaj teknologjisë)* sa që natyrshëm na bën të mendojmë se kontrolli i sistemit teknologjik nga ana e terroristëve, mund të ndikojë drejtëpërsëdrejti në jetën e njerëzve.

5.2. Siguria Ndërkombëtare para dhe pas 11 shtatorit të 2001-it

Studimi i sigurisë ndërkombëtare ka qenë gjithmonë një fushë e mosmarrëveshjeve intensive, sepse përpiquej të ofronte zgjidhje për çështjen e përhershme të luftës dhe të paqes, çlirimit dhe nënshtrimit, pushtim okupator dhe mospërfshirjes, zgjerimit dhe parandalimit. Në pjesën më të madhe të shekullit të 20-të, studimi kishte si objekt marrëdhëniet midis dy aleancave ideologjike, ushtarake dhe ekonomike, aleancës perëndimore dhe aleancës së Paktit të Varshavës (Avant, D., 2000, 41). Që në Traktatin e Vestfalisë në 1648, ishin vendosur rregullat themelore, që domethënë se aktiviteti luftarak do të ishte ndërmarrje rreptësisht dhe vetëm e aparatit shtetëror. Këto marrëdhënie, ndonëse u zhvendosën në të gjithë spektrin e gjerë politik, gjithmonë bazoheshin në disa pozicione qeverisjes; ndërmarrësit e operacioneve luftarake janë organet shtetërore, aktivizimi i çdo lloji formacioni tjetër politik, gjithmonë është në shërbim të interesave të shtetit përkatës, shteti është autoriteti i vetëm dhe subjekt i ushtrimit të kësaj të drejte (të operacioneve ushtarake) me një ushtri

të përbërë nga qytetarë të tij (Thomson, J.E., (1994, 72). Janë miratuar me unanimitet rregulla për ushtrimin e aktivitetit luftarak por dhe respektimit për të drejtën e jetës të civilëve, mospjesmarrës në luftë si ato janë sanksionuar në marrëveshjet ndërkombëtare (Roberts, A., Guelff, R., 1999). Gjithashtu aktiviteti ushtarak ka një objektiv të përcaktuar qartë (*pushtim, nënshtrim, etj.*) dhe duhet të egzistojë një strategji dalje nga kjo situatë. Hartuesit e këtyre strategjive duhet të marrin parasysh se aktiviteti ushtarak është një aktivitet kohëshkurtër dhe se duhet të pushojë me një traktat paqe lidhur ndërmjet palëve kundërshtarë, me ndërmjetësimin, zakonisht, të një palë të tretë. Njëzet vitet e fundit, mosdakortësitë lidhur me studimin e kontekstit të nocionit kaluan përtej kuadrit institucional të përkufizimit konceptual. Ridefinimi konceptual ishte absolut i nevojshëm pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001 në New York. Sigurisht, Terrorizmi islamik, si një aktivitet kundër interesave të botës perëndimore nuk u shfaq fillimisht në 2001, përkundrazi, sulmet e 1998 në Ambasadën amerikane në Nairobi, dhe në Egjipt, dhe shpërthimi në anijen luftarake USS Cole në vitin 2000, kanë qenë shenjat paralajmëruese të një kërcënimi në zhvillim. Sulmet e 11 shtatorit 2001 shënuan dhe sulmin e parë brenda në territorin amerikan dhe u bë shkas për ndryshim të dogmës së sigurisë nga SHBA në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe rajonale, të klasifikimit të terrorizmit në nivelin më të lartë në hierarkinë e kërcënimeve, të njehësimit të sigurisë së brendshme me të jashtme, të politikave të emigracionit, dhe në lidhje me analizën e këtij kapitulli, modifikoi procesin e konfigurimit të teknologjisë politike (Gray, C., 2000). Për më tepër, për shkak të rolit udhëheqës të SHBA-ve në komunitetin botëror, sulmi terrorist ishte një alarm dhe për vendet e tjera. Në kuadër të teknologjisë politike ripërcaktimi i prioriteteve shkencorë dhe teknologjikë të qeverisë amerikane, u bë pikë reference për shumë organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, të tilla si BE-ja (Hoge,

Jr. J.F., Rose, G.,2001). Mesazhi terrorist ishte i qartë: epokës së qëndrueshme dhe paqësore të pas-Luftës së Ftohtë tashmë i kishte ardhur fundi për shkak të kërcënimit terroristit ndërkombëtar. Fytyra e terrorizmit ka ndryshuar dhe është e lidhur me aktet publike të dhunës masive, shkatërrimet në masë dhe ngjarjet dramatike publike, të cilat synojnë terrorizimin e qytetarëve dhe simbolizojnë një luftë mes të mirës dhe të keqes. Sipas Creshaw, *“Terroristët e rinj nuk duan asgjë më pak se sa të ndryshojne botën. Motivuar nga diktate fetare, shkaktojnë terror mes vëzhguesve dhe atyre që ndodhen në vendet e sulmeve, sepse ata nuk kanë asnjë lidhje tokësore dhe japin llogari vetëm një perëndie të pëртеjshme ose në një ideologji mistike*¹³¹. Terroristët tashmë, janë të gatshëm të përdorin metoda vdekjeprurëse për të shkatërruar botën e ndotur si ata e perceptojnë atë, dhe për të sjellë Apokalipsin (Kaplan, R., 2001, 68). Ky brez i terrorizmit kërkon me këmbëngulje vdekje në masë dhe për të arritur qëllimin zgjedh të përdorë sulmet vetëvrasese ose të përpiqet të përdororë armë të shkatërrimit në masë (Halliday, F., 2002). Ndryshimi i doktrinës, për rreziqet me të cilat përballet Komuniteti global, ndryshoi jo vetëm marrëdhëniet politike dhe ripërcaktoi prioritetet e shumicës së fushave akademike, duke zbuluar ndërlidhje të reja mes tyre, si dhe zgjeroi disiplinat ekzistuese në dritën e zhvillimeve¹³². Duhet të theksohet se është pranuar gjerësisht mendimi se fushat kompetente akademike nuk kanë pasur sukses në misionin e tyre, për të parashikuar ose për të informuar hartuesit e politikave në lidhje me mundësinë e një

¹³¹Crenshaw, M., (2000), Psikologjia e terrorizmit: Axihendë për shekullin 21, Psikologji Politike, Issue. 21, nr. 2, fq. 405-420

¹³²Shih per me shume ne lidhje me ekte argument Kaplan, R., (2001), Looking the World in the Eye, *Atlantic Monthly*, vepra. 288, nr. 5, fq. 68-82, & Halliday, F., (2002), *Two Days that Shock the World: September 11, 2001: Causes and Consequences*, Al Saki Books, & Waltz, K.N., (2002), *The Continuity of International Politics*, ne Booth, Dunne, (botimi.), *Worlds in Collision: Terror and the Future of World Order*, Palgrave.

sulmi të këtyre dimensioneve (Czwarno, M., (2006, 657) ¹³³. Shkenca ekonomike provon ta analizoje fenomenin (*terrorizmin*) dhe ta integroje në kërkime dhe studime ekonomike, duke studiuar informacionet ekonomike të sigurisë (Johnson, M.E., 2008), financimin e terrorizmit¹³⁴, zhvillimin ekonomik të terrorizmit¹³⁵, ndikimi i sulmit terrorist në ekonominë kombëtare¹³⁶, dhe në teorinë e terrorizmit dhe politikave të lojës¹³⁷. Teoria është e angazhuar në kërkime në fushat e procesit zgjedhor¹³⁸ dhe të institucioneve¹³⁹, në marrëdhëniet në mes stabilitetit qeverisës dhe shfaqjes së terrorizmit¹⁴⁰, në mbartjen e terrorizmit nga një vend në tjetrin si dhe në imitimimin e mënyrave të ushtrimit të dhunës terroriste¹⁴¹, në marrëdhëniet mes identitetit dhe ideologjisë¹⁴², në marrëdhëniet mes lirisë së lëvizjes dhe masave parandaluese për sulmet terroriste¹⁴³, në marrëdhëniet midis politikave arsimore dhe terrorizmit¹⁴⁴,

¹³³Po ashtu, Czwarno, M., (2006), Misjudging Islamic Terrorism: The Academic Community's Failure to Predict 9/11, *Studies in Conflict and Terrorism*, botimi. 29, nr. 7, fq. 657-678, & Hoge, Jr. J.F., Rose, G., (botimi.), (2001), *How Did This Happen? Terrorism and the New War*, Council on Foreign Affairs

¹³⁴Per reference shiko: Lluss, F., Tavares, J., (2007), The Economics of Terrorism: A Synopsis, *The Economics of Peace and Security*, botimi. 2, nr. 1, fq. 62-64, gjithashtu, Krueger, A.B., (2007), *What Makes a Terrorist: Economics and the Root of Terrorism*, Cambridge University Press, επίσης, Schneider, F., Bruck, T., Meierrieks, D., The Economics of Terrorism and Anti-Terrorism: A Survey, *American Economic Association*, 14/12/2009

¹³⁵Gaibullov, K., Sandler, T., (2008), Growth Consequences of Terrorism in Western Europe, *Kyklos*, botimi. 61, nr. 3, fq. 411-424

¹³⁶Bruck, T., (2004), An Economic Analyses of Security Policies, *Defence and Peace Economics*, botimi. 16, nr. 5, fq. 375-389

¹³⁷Caplan, B., (2006), Terrorism: The Relevance of Rational Choice Model, *Public Choice*, botimi. 128, fq. 91-107

¹³⁸Gassebner, M., Jong-A-Pin, R., Mierau, J.O., (2008), Terrorism and Electoral Accountability: One Strike, You're Out!, *Economic Letters*, botim. 100, fq. 126-129

¹³⁹Kurrild-Klitgaard, P., Justesen, M.K., Klemmensen, P., (2006), The Political Economy of Freedom, Democracy and Transnational Terrorism, *Public Choice*, botimi. 128, fq. 289-315

¹⁴⁰Rotberg, R.I., (2002), The New Nature of Nation-State Failure, *Washington Quarterly*, botimi. 25, nr. 3, fq. 85-96

¹⁴¹Midlarsky, M., Crenshaw, M., Yoshida, F., (1980), Why Violence Spreads: The Contagion of International Terrorism, *International Studies Quarterly*, botimi. 24, nr. 2, fq. 262-298

¹⁴²Arce, D.G., Sandler, T., (2003), An Evolutionary Game Approach to Fundamentalism and Conflict, *Journal of Institutional and Evolutionary Economics*, botimi. 159, fq. 132-154

¹⁴³Mirza, D.T., Verdier, T., (2008), International Trade, Security and Transnational Terrorism: Theory and a Survey of Empirics, *Journal of Comparative Economics*, botimi. 36, fq. 179-194

emigracionit¹⁴⁵, gjeografisë dhe gjeopolitikës¹⁴⁶, me sociologjinë¹⁴⁷, me sigurinë energjitike¹⁴⁸, me energjinë dhe marrëdhëniet e saj me sigurinë detare¹⁴⁹, me zhvillimin urban¹⁵⁰, me sigurinë në infrastrukturë¹⁵¹, me psikologjinë sociologjike¹⁵², me antropologjinë¹⁵³, me demografinë¹⁵⁴ dhe shkencën juridike¹⁵⁵.

Drejtimi i përgjithshëm i shkencave juridike në studimin e fenomenit të terrorizmit përmes hulumtimeve empirike dhe teorike, ka si qëllim krijimin e njohurive të reja dhe verifikimin e realitetit juridiko-social dhe juridiko-politik, me qëllim

¹⁴⁴Krueger, A.B., (2008), What Makes a Homegrown Terrorist? Human Capital and Participation in Domestic Islamic Terrorist Groups in the USA, *Economic Letters*, botimi. 101, fq. 293-296

¹⁴⁵Givens, T., Freeman, G., Leal, D.L., (2008), *Immigration Policy and Security. US, European and Commonwealth Perspectives*, Routledge

¹⁴⁶Sparke, M., (2007), Geopolitical Fears, Geoeconomic Hopes, and the Responsibilities of Geography, *Annals of the Association of American Geographers*, botimi. 97, nr. 2, fq. 338-349, & Cutter, S.I., Richardson, D.B., Wilbanks, T.J., (2003), *The Geographical Dimensions of Terrorism*, Routledge

¹⁴⁷Blain, M., (2009), *The Sociology of Terrorism: Studies in Power, Subjection and Victimhood Ritual*, Universal Publishers

¹⁴⁸Kalicki, J., Goldwyn, D., (2005), *Energy and Security: Toward a New Foreign Policy Strategy*, Woodrow Wilson Centre Press, & Ness, L., (2006), *Securing Utility and Energy Infrastructures*, Wiley, & Luft, G., Korin, A., (botimi.), (2009), *Energy Security Challenges for the 21st Century: A Reference Handbook*, Greenwood

¹⁴⁹Nincic, D., (2009), Troubled Waters: Energy Security as Maritime Security, Luft, G., Korin, A., (botimi.), (2009), *Energy Security Challenges for the 21st Century: A Reference Handbook*, Greenwood

¹⁵⁰Coaffee, J., (2003), *Terrorism, Risk and the City. The Making of a Contemporary Urban Landscape*, Ashgate, & Graham, S., (botimi.), (2004), *Cities, War and Terrorism: Towards an Urban Geopolitics*, Wiley, & Graham, S., (2008), *Cities Under Siege: The War on Terror as Anti-Urban Crusade*, Routledge

¹⁵¹Lewis, T.G., (2006), *Critical Infrastructure Protection in Homeland Security*, Wiley, & Forest, J.F., (botimi.), (2006), *Homeland Security: Protecting America's Targets*, vepra 3: Critical Infrastructure, Praeger

¹⁵²Morgan, M.J., (botimi.), (2009), *The Impact of 9/11 on Psychology and Education*, vepra 5: The Day that Changed Everything?, Palgrave Macmillan

¹⁵³Jackson, R., (2005), *Writing the War on Terror: Language, Politics, Counter-Terrorism. New Approaches to Conflict Analysis*, Manchester University Press, & Sluka, J.A., (2009), The Contribution of Anthropology to Critical Terrorism Studies, te Jackson, R., Smyth, M.B., Gunning, J., (botimi.), *Critical Terrorism Studies. A New Research Agenda*, Routledge

¹⁵⁴Wiener, M., Stanton-Russel, S., (botimi.), (2001), *Demography and National Security*, Berghahn, & Ehrlich, P.R., Liu, J., (2002), Some Roots of Terrorism, *Population and Environment*, botimi. 24, nr. 2, fq. 183-192

¹⁵⁵Morgan, M.J., Graham, B., (botimi.), (2009), *The Impact of 9/11 and the New Legal Landscape: The Day That Changed Everything?*, Palgrave, & Gray, C., (2003), The Use of Force and the International Legal Order, te Evans, M., (botimi.), *International Law*, Oxford University Press

përmirësimin e informacionit për hartuesit e politikave dhe procesin e hartimit të ligjeve.

Në mënyrë të veçantë, studimi i kësaj teme, përtej diskutimeve teorike, ka shumë aplikime specifike në praktikë. Ajo është një nga lëndët e pakta ku e përditshmja me politikën publike lidhen ngushtë. Në një theks të dytë, vlen të përmendet se mutacioni i objektit gnostik në drejtim të inkorporimit të konceptit të sigurisë, pas sulmit terrorist të 11 Shtatorit 2001, është më shumë karakteristike e një realiteti ku akademikët ndjekin zhvillimet në politikë dhe në fushën ushtarake dhe *ex post* janë të detyruar të modifikojnë teoritë e tyre me qëllim rritjen e fuqisë interpretuese të këtyre të fundit.

Kjo është e qartë në rastin e shkencës juridike, ku interpretimi pragmatik i përjasjes të konventave ndërkombëtare nga ana e politikëbërësve amerikanë, u bazua në përdorimin selektiv të rregullave ligjore, me qëllim realizimin e hartimit të politikave që ndikuan në ndryshimin e doktrinave të sigurisë (Farrell, T., 2005, 18). Paaftësinë dhe pamundësinë e kuadrit ligjor për t'u përgjigjur kushteve të reja të sigurisë pohoi Kryeministri Australian, pas goditjes terroriste në Kuta, Bali në vitin 2002, si dhe Kryeministri rus pas masakrës në Beslan, Rusi, në vitin 2004. Kjo mospërputhje mes rritimit të zhvillimit të teknologjisë dhe shkencës juridike është, në një kuptim, shkaku i këtij përdorimi pragmatik apo utilitar të së dytës (*shkencës juridike*) për të arsyetuar vendimet e marra *ex post*. Ndërsa zhvillimet e praktikës ligjore janë të ngadalta, praktika ushtarake ka evoluar në shumë mënyra, veçanërisht gjatë shekullit të kaluar. Rritet e shumta teknologjike kanë shkaktuar dhe revolucion në ushtrimin e operacioneve ushtarake (*Revolutions in Military Affairs*) dhe operacionet e sigurisë. Kjo mospërputhje është komentuar nga shume juristë të njohur (Reisman, W.M., (2003; 82),

¹⁵⁶. Reisman në mënyrë karakteristike vëren se në lidhje me ligjin (që rregullon risitë e procesit), për shkak të karakteristikave para-projektuese deliberative të metodave të tij(të ligjit) të matura[measured], shpesh herë mbetet pas risive, duke lënë boshllëqe ligjore ku për shkak të tyre pushteti bëhet i diskutueshme [uncertain] (Reisman, W.M., 2003; 82).

5.3. Koncepti i Sigurisë

Përveç qasjeve të teorive akademike, ose më mirë si pasojë e tyre(*duke supozuar që hartuesit e politikave të kenë marrë parasysh gjetjet dhe propozimet akademike*), trajtimi i përkufizimit konceptual ka rëndësi të madhe (*praktike*) dhe në mënyrën e funksionimit të sistemit ndërkombëtar, pasi ajo ndikon dhe ndryshon objektivat e çdo shteti anëtar të Aleancës. Rëndësia e kornizës ideologjike të pikëpamjeve politike dhe të paparashikueshmërisë së historisë në hapësirën kombëtare dhe ndërkombëtare, bashkë me trajtimin konceptual, shërben si plotësues në aktivitetin politik. Sidomos për BE-në në momentin kur kjo renditet në krah të zgjedhjeve opsionale të SHBA-ve, shoku strategjik që pësoi për shkak të sulmeve terroriste përcaktoi dhe mënyrën e perceptimit të mjedisit ndërkombëtar. SHBA-të analizojnë të gjithë kërcënimet e mundshme të reja në prizmin e luftës kundër terrorizmit, rendisin shtete si anëtarë të boshtit të së keqes që favorizojnë dhe prodhojnë terroristë, destabilizojnë rendin ndërkombëtar dhe kërcënojnë hegjemoninë e SHBA-ve. Në fakt, ndërsa është koherent një numër i konsiderueshëm i çështjeve të sigurisë ndërkombëtare, si: potenciali ekonomik-financiar dhe ushtarak në rritje i Kinës, mundësina e konfliktit bërthamor ndërmjet Indisë dhe Pakistanit, kërkimet

¹⁵⁶Po ashtu edhe Lowe, V., (2005), Clear and Present Danger: Responses to Terrorism, *International and Comparative Law Quarterly*, vol. 54, fq. 185-196.

bërthamore në Korenë e Veriut dhe zhvillimet bërthamore të Iranit (*prioritet tashmë i SHBA-ve dhe BE-së trajtimi i kësaj çështje*), zgjerimi drejt vendeve të Europës Lindore i NATO, si dhe një seri çështjesh të reja, të tilla si pandemitë globale, degradimi i vazhdueshëm mjedisor, emigrimi masiv. SHBA-të duke zgjedhur t'i interpretojnë ato përmes pikëpamjes së sigurisë, si në të vërtetë ato e perceptojnë vetë atë, shkaktuan një polarizim mes aleatëve të tyre tradicionalë, veçanërisht gjatë mandatit të dytë të G.W. Bush. Në të vërtetë, ndërsa kjo strategji e sigurisë shprehet nga instikte konservative (*ruajtja e hegjemonisë amerikane përmes ruajtjes së status quo-së*), për ta zbatuar atë u përdorën një sërë masash pothuajse antiligjore drejt këtij qëllimi. Imponimi i ndryshimit të regjimit, veçanërisht në Irak dhe Afganistan pse jo dhe në Siri, do conte, supozohet, në struktura më të qëndrueshme shtetërore dhe për rrjedhojë në një sistem më të qëndrueshëm ndërkombëtar. Hipoteza-supozimi i mësipërm, në kohën e tashme (2017), është qartazi përgënjeshtuar. Ka shembuj përkatës në vende të tilla si Rusia, e cila nxitoi për të ndihmuar në luftën kundër terrorizmit, vetëm e vetëm për të legjitimuar operacionet e saj të spastrimit të brendshëm në Kaukaz, dhe Azinë Perëndimore. Konsistenca me interesat e SHBA-ve, siguroi një politikë të sigurisë të brendshme pa kritika për shtypjen e të drejtave të njeriut apo të konsistimit të ndërhyrjes nga jashtë në punët e brendshme. Në këtë pikë duhet t'i kthehemi konceptit të "sigurisë" që të mund të kuptojmë pasojat e mbështetjes së tij në skenën ndërkombëtare që kanë bërë liderët kombëtarë. Koncepti i sigurisë është një pjesë integrale e teorisë politike dhe shumë filozofë dhe politikanë e kanë analizuar atë. Në të vërtetë, shumë nga këto elementë përbërës që i janë atribuar këtij koncepti në të kaluarën, janë krejtësisht të vlefshëm dhe tani. Nivelet e ndryshme të sigurisë, niveli ndërkombëtar, kombëtar dhe individual, dallimi midis sigurisë subjektive (*ndjenja e sigurisë*) dhe objektive, ideja e ofrimit të

mbrojtjes dhe sigurisë, marrëdhënia mes sigurisë dhe besimit në të, si dhe gama e gjerë e interesave, të tilla, si interesi social, që mund të lidhet me sigurinë, kanë përbërë disa aspekte të konceptit për të cilat është reflektuar frytshëm. Siguria është objekt i kënaqësisë supreme, është ajo që lejon vazhdimësinë e lumtur të jetës¹⁵⁷. Për Smith, siguria kuptohet si mungesa e sulmeve të dhunshëm kundër personit ose pasurisë së tij prej njerëzve të të njëjtës shoqëri¹⁵⁸. Për Hobbes, siguria përfshin mbrojtjen nga kërcënimet e huaja dhe është thelbësore për zhvillimin e shoqërisë në cdo aspekt¹⁵⁹. Ky perceptim i Hobbes ishte vendimtar për fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, dhe sidomos për një shkollë shumë e rëndësishme të mendimit, atë të *realistëve*, të cilët zhvilluan idenë e një shteti të fortë si një kundërpërgjigje e një situatë të mundshme ndërkombëtare anarkie¹⁶⁰. Për Locke, koncepti është i nevojshëm për mbrojtjen fizike të shoqërisë, si dhe krijimin e kushteve të cilat do të lejojnë gëzimin e pronës private nga individët e shoqërisë¹⁶¹. Ai gjithashtu vë në dukje mundësinë që shteti të rrezikojë qytetarët për shkak të keqpërdorimit të fuqisë së pushtetit. Ky i fundit është dhe thelbi i argumentit të atyreve që besojnë se masat e mëtejshme të sigurisë, në vend që të maksimizojnë ndjenjën e sigurisë, ndjellin pasiguri. Në të vërtetë kjo mund të thuhet në rastet që përfshijnë situata brenda shtetit, dhe në skenën ndërkombëtare¹⁶². Për Bentham, qëllimi i qeverisjes dhe legjislacionit, është kërkimi i lumturisë për numrin më

¹⁵⁷Rothchild, E., (1995), What is Security, *Daedalus*, vol. 124, nr. 3, fq. 53-99, fq. 61

¹⁵⁸Smith, A., (1976), *An Inquiry Into the Nature and Causes of the Wealth of Nations*, Clarendon, Oxford University Press, kap. 4, & Smith, A., (1978), *Lectures on Jurisprudence*, 'Of Jurisprudence' December 24, 1762], Oxford University Press

¹⁵⁹Hobbes, T., (1998), *Leviathan*, Oxford University Press, pjesa 2, kap. 18

¹⁶⁰Hough, P., (2004), Security and Securitization, te Hough, P., *Understanding Global Security*, Routledge

¹⁶¹Locke, J., (2000), *Two Treatises on Government*, Cambridge University Press, kap. 9

¹⁶²McSweeney, B., (1999), Too Much Security?, te McSweeney, B., *Security, Identity and Interests: A Sociology of International Relations*, Cambridge University Press, fq. 13-22, fq. 13

të madh të qytetarëve¹⁶³, dhe kuptohet siguria. Ky është një koncept ligjor dhe fokuson në mbrojtjen e ofruar nga ligji, pavarësisht kërcënimeve të brendshme apo të jashtme. E njëjta shumëllojshmëri interpretuese e qasjes së konceptit vazhdon në shekullin e 20-të. Fushat që trajtuan konceptin, janë ato të kriminologjisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Ekziston edhe një diskutim i kufizuar i konceptit në literaturën e filozofisë morale në lidhje me drejtësinë sociale, dhe shtetin e përkujdesjes¹⁶⁴, dhe të drejtën e pronës¹⁶⁵. Sektori i Kriminologjisë trajton marrëdhëniet e sigurisë, demokracisë dhe kontrollin e veprave kriminale tradicionale duke theksuar rëndësinë e sigurisë të brendshme të një shoqërie¹⁶⁶. Në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare përkufizimi i konceptit ndryshonte në varësi të shkollave individuale të mendimit si dhe të situatave të ndryshme gjeopolitike (*Lufta e Ftohtë, fundi i Luftës së Ftohtë, sistemet multi-polare, terrorizmi islamik etj.*). Megjithatë, pika e referencë ka qenë gjithmonë shteti dhe mbrojtje e tij e nevojshme kundër konflikteve të armatosura ose kërcënimeve të cdo lloji. Duhet të theksohet se këto variacione konceptuale ishin më shumë të ndikuara nga programimet politike sesa një konceptualizëm real nga këndvështrime të ndryshme. Me fjalë të tjera, procesi i përkufizimit të konceptit varej mbi prioritetet politike përkatëse në vend të definimit të tij. Kjo vë në dukje nevojën e definimit dhe Buzan thotë se: koncepti është aq pak i zhvilluar sa që arrin të jetë i papërshtatshëm për

¹⁶³Bentham, J., (1970), *An Introduction to the Principles of Morals and Legislation*, Athlone, London, kap. 3, 5, 7

¹⁶⁴Elster, J., (1989), *The Empirical Study of Justice*, te Barry, B.M., (botimi.), *Theories of Justice*, University of California Press, & Walzer, M., (1983), *Security and Welfare*, te Walzer, M., *Spheres of Justice: A Defense of Pluralism and Equality*, Robertson

¹⁶⁵Getzler, J., (2006), *Use of Force in Protecting Property*, *Theoretical Inquiries in Law*, vepra. 7, nr. 1, fq. 131-166, & Riley, J., (1989), *Justice Under Capitalism*, te Chapman, J., (botimi.), *Nomos: Markets and Justice*, New York University Press

¹⁶⁶Loader, I., Walker, N., (2007), *Civilizing Security*, Cambridge University Press, & Zadner, L., (2000), *The Pursuit of Security*, te Hope, T., Sparks, R., (botimi.), *Crime, Risk and Insecurity: Law and Order in Everyday Life and Political Discourse*, Routledge

të kryer funksionin e tij¹⁶⁷ ose Tuchmann Matthews kur kërkon ripërkufizimin e fushës së definimit¹⁶⁸. Natyrisht që janë propozuar shumë përkufizime të konceptit nga shkencëtarët socialë. Për Freedman, siguria është përcaktuar si *niveli i besimit që një shtet ka në aftësitë e tij për të përballuar një sulm të mundësuar nga një shtet tjetër*¹⁶⁹. Morgenthau përkufizoi sigurinë (kombëtare) me kushtin e ruajtjes së tërësisë territoriale dhe infrastrukturës përkatëse institucionale¹⁷⁰, ndërsa në një analizë të mëvonshme ndërthuri konceptin e interkonjeksionit të sigurisë me kulturën, duke argumentuar se mbijetesa e një subjekti politik me identitetin e vet përbën kërkesën minimale, dhe elementin thelbësor të interesave të tij në kuadër të bashkëjetesës me subjekte të tjera¹⁷¹. Vlen të theksohet se Laswell dhe Kaplan definojnë sigurinë si *pritshmëri me vlerë të lartë*(*high value expectancy*), ku pritshmëria thekson natyrën subjektive të konceptit, dhe karakteri i lartë i tij, edhe pse nuk është një pikë referimi objektive, tregon pritshmërinë e lartë të subjektit për të arritur objektivat e tij¹⁷². Wolfers dha përkufizim më të plotë të konceptit duke pretenduar se: *siguria, sipas qasjes objektive, mat mungesën e kërcënimeve ndaj vlerave tradicionale, dhe sipas qasjes subjektive [mat] mungesën e frikës se vlera të tilla do të jenë objektiv i një sulmi të ardhshëm*¹⁷³. Pra shfaqen këtu, të dy aspektet e konceptit (*dhe subjektiv dhe objektiv*) dhe se arritja e tij

¹⁶⁷Buzan, B., (1991), *People, State and Fear: An Agenda for International Security Studies in the Post-Cold War Era*, http://www.academia.edu/4780500/People_States_and_Fear_An_Agenda_For_International_Security_Studies_in_the_Post-Cold_War_Era_-_Barry_Buzan, aksesuar në datë 2.07.2014.

¹⁶⁸Tuchmann-Matthews, J., (1989), Redefining Security, *Foreign Affairs*, vepra. 68, nr. 2, fq. 162-177

¹⁶⁹Freedman, L., (2003), The Concept of Security, te Hawkesworth, M.E., Kogan, M., (botimi.), *Encyclopedia of Government and Politics*, Routledge, fq. 730-741, fq. 732

¹⁷⁰Morgenthau, H.J., (1960), *Politics Among Nations. The Struggle Among Power and Peace*, Alfred A. Knopf

¹⁷¹Morgenthau, H.J., (1971), The Problem of National Interest, te Morgenthau, H.J., *Politics in the Twentieth Century*, University of Chicago Press, fq. 204-237, fq. 219

¹⁷²Laswell, H.D., Kaplan, A., (1950), *Power and Society. A Framework for Political Inquiry*, Yale University Press

¹⁷³Wolfers, A., (1962), National Security as an Ambiguous Symbol, *Political Science Quarterly*, vepra. 67, nr. 4, fq. 481-502.

është një qëllim i ligjshëm i politikave koherente shtetërore. Dallimi është i rëndësishëm, sepse politikat për të arritur siguri maksimale, projektohen për kërcënimet aktuale ose potenciale. Për më tepër, për Wolfers, siguria, si pasuria dhe pushteti, pëson shkallëzime sasiore, sepse koncepti është një vazhdueshmëri dhe jo një nocion absolut, dhe siguria nuk është se u arrit dikur dhe do zgjasë përgjithmonë¹⁷⁴. Tendanca e arritjes së sigurisë maksimale të një shteti, mundet, për Wolfers, të fshehë politika armiqësore ofensive që një shtet harton kundër një tjetri, kjo, sipas një interpretimi subjektiv të shkallës së sigurisë në këtë status quo dhe pakënaqësive të lindura nga kjo, gjithashtu, sipas realistëve, dhe nga vetë natyra e sigurisë. Arritja e nivelit maksimal të sigurisë për A nënkupton më pak siguri për B. Shkollat e mendimit, duke zgjedhur për të përkufizuar ndryshe këtë koncept, vendosen në një konfrontim ku realistët e vërtetë fokusohen te kërcënimet shtetërore, si dhe forca e pushtetit dhe liria nga kërcënimet, neoliberalët, edhe pse fokusohen te shteti, theksojnë rastet bashkëpunuese në sistemin ndërkombëtar. Konstruktivistët përqëndrohen te institucionet, veçanërisht te ato që mundësojnë marrëdhëniet ndërshtetërore. Ka shkolla mendimesh që identifikohen nga vendndodhja e tyre gjeografike. Shkolla e Kopenhagës shqyrton proceset nëpërmjet të cilave, çështje të ndryshme lidhen me sigurinë. Në përgjithësi, bëhen përpjekje për të zgjeruar fushën dhe përtej çështjeve ushtarake të përfshihen dhe ato politike, ekonomike dhe çështjet mjedisore në koncept¹⁷⁵. Fokusi mbetet te shteti, si ofruesin e sigurisë, dhe te përdorimi i dhunës si mekanizëm përgjigjeje primare ndaj kërcënimeve kundrejt sigurisë. Siguria, në shkollën e Kopenhagenit, ka të bëjë dhe lidhet ngushtë me mbijetesën nga kërcënimet. Shkolla e Uellsit, çështjet e sigurisë i trajton nga aspekti i

¹⁷⁵Buzan, B., Waever, O., de Wilde, J., (1998), *Security: A New Framework for Analysis*, Lynne Rienner, fq.28.

keqpërdorimit të mundshëm të tyre¹⁷⁶. Konceptin e trajton si diçka më shumë se mbijetesa e thjeshtë, por si një temë që përfshin ndryshimin të të dhënave sociale dhe lirive themelore. Siguria është thelbësore për ndjekjen e politikave të veçanta dhe ambiciet sociale. Booth, si anëtar i kësaj shkolle, argumenton se nocioni i sigurisë ka pësuar shume ndryshime konceptuale. Në të kundërt, praktikatat e sigurisë publike janë ato që mbeten të paprekura, dhe nuk kanë qenë objekt i kritikës¹⁷⁷. Për të, procesi politik i përfshirë në përcaktimin e rëndësisë së konceptit të sigurisë është shumë konservator, gjë që mund të shpjegojë përdorimin instrumental të të dytës për të mbuluar zgjedhjet e politikave shtetërore. Shkolla e Parisit fokusohet te ndërtimi i natyrës së jetës tonë sociale, dhe e analizon nga këndvështrimi i Foucault. Sigurisht këto qëndrime pasqyrojnë një problematikë më të gjerë në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, atë se ku janë kufijtë e fushës dhe deri te cila pikë humbasin fuqinë shpjeguese teoritë e shumta¹⁷⁸. Argumenti kryesor në këtë diskutim ka të bëjë me zgjerimin e kufijve konceptuale dhe respektimin e koherencës intelektuale për konceptin e sigurisë. Për disa, ky konflikt reflekton një refuzim për të pranuar se çështjet ushtarake do të humbasin rolin udhëheqës dhe do të trajtohen si të barabarta me çështje të tjera jo ushtarake, dhe kjo do shkaktojë pasoja jo produktive në gjithë fushën e marrëdhënieve sociale dhe ndërkombëtare¹⁷⁹. Për më tepër, përpjekja e integritit të çdo aktivitetit social, ekonomik, mjedisor dhe teknologjik në sferën e sigurisë na shtyn në një mjedis politik, i cili dominohet nga struktura institucionale të sigurisë, të cilat ishin projektuar

¹⁷⁶Hough, P., (2004), *Security and Securitization*, te Hough, P., *Understanding Global Security*, Routledge, fq. 197.

¹⁷⁷Booth, K., (2007), *Theory of World Security*, Cambridge University Press, fq. 101

¹⁷⁸Buzan, B., Waever, O., de Wilde, J., (1998), *Security: A New Framework for Analysis*, Lynne Rienner. Burimi https://www.uni-erfurt.de/fileadmin/public-docs/Internationale_Beziehungen/BA_Einfuehrung_in_die_IB/BUZAN%20+%20WAEVER+%20WILDE_%201998_Security_CH%201+2.pdf, aksesuar në datë 15.08.2014. fq 28.

¹⁷⁹Ben Saul, *Defining Terrorism in International Law* (New York: Oxford University Press, 2008), 408 faqe, fq.39.

për nevoja të tjera dhe nuk përshtaten në aktualitetin politik e social¹⁸⁰. Rindërtimi konceptual preku dhe vetë emërtimin e fushës, i cili nga studimi i sigurisë ndërkombëtare u ripagëzua në Studime të Sigurisë. Ky riemërim për shkak të fshirjes së dallimit klasik mes sigurisë së brendshme dhe sigurisë së jashtme, rritjen e rrezikut me të cilin përballet popullata civile dhe kryesisht në pamundësinë e përcaktimit definitiv të konceptit të sigurisë. Koncepti duhet zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme për të përfshirë mënyrat me të cilat dhuna është transformuar, shfaqjen e kërcënimeve të reja dhe mënyrat e reja që kundërshtarët e përbashkët zgjedhin për të shprehur rivalitetin e tyre. Në të vërtetë, shumë organizata dhe traktate ndërkombëtare janë ideuar e zhvilluar nga ideja e balancimit të pushtetit, drejt një qasjeje të unifikuar të sigurisë që përfshin aspektet njerëzore, ekonomike, mjedisore dhe ushtarake në këtë kontekst. Për shembull, Traktati Evropian i Maastricht përdor konceptin e sigurisë në nivelin pro-qeveritar. Për Evropianët, koncepti i sigurisë bazohet në sigurinë njerëzore dhe se qytetarët kanë zëvendësuar shtetin, si subjektin që kishte të drejtën për siguri. Ky koncept gjithëpërfshirës i sigurisë, ka qenë një pikë qendrore e zhvillimeve konceptuale të hulumtuesve dhe zhvillimeve teknologjike sipas udhëzimeve të BE-së. Me fjalë të tjera, çështja tani nuk është vendosur vetëm në bazën e sigurisë kolektive kundër një armiku të përbashkët të jashtëm, por gama e aspekteve të sigurisë është e tillë sa që aspekti ushtarak mbrojtës është vetëm një prej tyre. Sa i përket sigurisë njerëzore, ka dy shkolla mendimi (*rryma mendimi*): Qendra Kanadeze e Sigurisë Njerëzore (*Canadian Human Security Centre*)¹⁸¹, dhe United Nations Human Security Unit¹⁸². Të dyja pranojnë se

¹⁸⁰ Shiko për rëndësinë dhe kontributin që japin dhe kanë detyrimim të japin shkencat e të gjitha fushave në luftën kundër terrorizmit të modernizuar te Magnus Ranstorp, editor, *Mapping Terrorism Research: State of the Art, Gaps and Future Direction* (New York: Routledge, 2007), 352 faqe, fq 278-289.

¹⁸¹ Human Security Centre, (2005), *Human Security Report: War and Peace in the 21st Century*, Oxford University Press

siguria njerëzore ka të bëjë me mbrojtjen e individit, por nuk pajtohen me rangun e kërcënimeve ndaj të cilëve duhet të mbrohen. Qasja kanadeze thekson kërcënimet e dhunshme nga brenda dhe jashtë vendit, ndërsa në diagnozën më të gjerë të OKB-së përfshihen kërcënime të tilla si varfëria, sëmundjet, fatkeqësitë natyrore etj.. Në çdo rast, dallimet mes dy këtyre perceptimeve janë të dobishëm për identifikimin e rëndësisë së elementëve të caktuar të konceptit, por për shkak se ato nuk riprezantojnë konceptin por vetëm procesojnë në një thellim tematik, është ka shumë të ngjarë që këto dy qasje të jenë të homogjenizuara. Nevojat institucionale dhe sociale bënë që koncepti i Sigurisë të përvetësojë dimensionet horizontale dhe demokratike dhe të përfshijë konceptin e parandalimit pas Luftës së Ftohtë. Kjo përpjekje për inovim teorik u mbështet në analiza sporadike specifike të cilat argumentuan për rëndësinë e çështjeve jo-ushtarake në përparësitë politike¹⁸³. Theksi mbi imperativët ushtarakë dhe politikë rrëshkasin drejt një qasjeje sociale, në të cilën koncepti i fatit të përbashkët (*njerëzor*) ndryshon marrëdhëniet mes periferisë dhe qendrës. Varfëria, sëmundjet, konfliktet e brendshme, përkeqësimi i jetës urbane dhe periferike, krimi në hapësirën kybernetike etj, degradojnë sigurinë e komuniteteve dhe janë kërcënime për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat duhet natyrisht të adresohen. Për më tepër, Koncepti i sigurisë është i fekonduar nga koncepti i sigurisë njerëzore, ku kërcënimet vijnë nga ritmi i përkeqësimit të papritur i jetës së përditshme. Ky theks mbi individualitetin është tregues i perceptimit të shkallës së lartë të ndërlidhjes së bashkësisë mbarëbotërore. Varfëria, degradimi i mjedisit dhe kërcënimet e terrorizmit zgjeruan zonat tradicionale të politikës së lartë të Shtetit dhe ndërlidhen me çështjet e zhvillimit. Vetëm për shkak të

¹⁸²Human Security Unit, (2006), *Human Security for All. Integrated Responses to Protect and Empower People and Communities: A Look at Nine Promising Efforts*, United Nations

¹⁸³Baldwin, D.A., (1997), The Concept of Security, *Review of International Studies*, vepra. 23, fq. 5-26, fq. 6-8

shkallës së lartë të ndërlidhjes mes këtyre sektorëve, çdo shtet mund (*gjë që nuk është në interes të tij*) zgjedhe një shkallë të lartë izolimi. Si rrjedhojë, siguria e tij (*shtetit*), si dhe e qytetarëve të tij, varet nga mundësia e garantimit të sigurisë të tjerëve. Duffield thekson marrëdhëniet e ndihmave humanitare, zhvillimit ekonomik dhe operacioneve ushtarake të Luftës së Ftohtë¹⁸⁴. Argumentohet se shfaqja e një modeli liberal të qeverisjes globale ripërcaktoi konceptin e zhvillimit dhe mënyrën se si ai është i lidhur, me të drejtë, me konceptin e zgjeruar të sigurisë. Të njëjtën linjë mendimi ndjek dhe Thomas, e cila ndërlidh sigurinë njerëzore me zhvillimin dhe varfërinë, dhe nxjerr në pah marrëdhëniet mes rritjes ekonomike, sigurisë dhe qëndrueshmërisë¹⁸⁵. Maclean analizon pasojat e shfaqjes të konceptit të sigurisë njerëzore në skenën e politikës ndërkombëtare¹⁸⁶. Këto linja mendimi theksojnë shkallën e lartë të interkoneksionit mes organizatave private, publike, qeveritare dhe ndërkombëtare. Shteti përbën vetëm një faktor të qeverisjes globale. Shoqëria sociale ndërkombëtare, aleancat shkencore, ekonomike dhe politike janë gjithashtu faktorë. ‘Përmbysja’ e të drejtës ndërkombëtare dhe humbja nga shteti e mundësisë ekskluzive për të reaguuar, është për Beck-un, një burim problematikash¹⁸⁷. Sipas autorit, shekulli i 21-të, për shkak të dallimeve cilësore të rrezikut dhe për shkak të perceptimeve të ndryshme për të, është modifikuar vetvetiu dhe *modeli i sigurisë*¹⁸⁸. Gjithashtu, ky shembull ndërkombëtar i sigurisë ka mangësi nga ana e analizës korresponduese konceptuale, si gramatikës sociale dhe politike¹⁸⁹.

¹⁸⁴Duffield, M., (2001), *Global Governance and the New Wars: The Merging of Development and Security*, Zed

¹⁸⁵Thomas, C., (2000), *Global Governance, Development and Human Security: The Challenge of Poverty and Inequality*, Pluto

¹⁸⁶Maclean, S., *et al.*, (botimi), (2006), *A Decade of Human Security: Global Governance and New Multilateralisms*, Ashgate

¹⁸⁷Beck, U., Beck-Gernsheim, E., (2001), *Individualization: Institutionalized Individualism and Its Social and Political Consequences*, Sage.

¹⁸⁸Beck, U., (2009), *World at Risk*, Polity Press, fq. 39.

¹⁸⁹Kaldor, M., (2007), *Human Security: Reflections on Globalization and Intervention*, Polity Press.

Kjo dykuptimësi konceptuale është drejtpërdrejt e lidhur me natyrën e terrorizmit, sepse kërcënimi terrorist nuk mund të jetë i lidhur në mënyrë shkakësore me subjekte të përcaktuar specifikisht, kohor ose territoriale, apo nga ndonjë tjetër kërcënim ushtarak të përcaktuar qartë. Rreziku tani është i tërthortë dhe i paqartë, dmth i mungon parashikueshmëria ushtarake. Një tjetër burim shqetësimesh, për Beck-un, është se: gjetja e vetëshpalljes së pushtetit hegjemonist, si mbrojtës i të drejtave të njeriut, automatikisht i jep të drejtë (*këtij shteti*) për të vlerësuar se cilat vende janë miqësore dhe cilat janë burim rreziku për sigurinë e tij dhe të aleatëve të tij. Shumë më tepër dhe përtej shteteve, pushteti hegjemonike ka të drejtë të vendosë se çfarë përbën rrezik, cili është niveli i pranueshëm i rrezikut, si parandalohet ky rrezik, dhe për rrjedhojë, çka përbën një zgjidhje optimale teknologjike për kufizimin e këtyre rreziqeve. Ky rikonstruksion konceptual është i bazuar, sipas Beck-ut, në marrëdhëniet definitive konceptuale (*relations of definitions*)¹⁹⁰. Kjo shprehje korrespondon me pozicionin që ka prodhimi, në një ekonomi kapitaliste sipas Karl Marksit. Tregon marrëdhëniet hierarkike të dijes, sepse, grupe të veçanta sociale, përmes rregullave të institucionalizuara, kanë fuqinë për të imponuar *përkufizimin* mbi grupet e tjera sociale, sipas interesave të tyre dhe duke u mbështetur në njohuritë e tyre të specializuara teknike. Kjo marrëdhënie pushteti, për autorin, është veçanërisht e dukshme në fushën e shkencave natyrore. Fizikanët, për shkak të kontratës sociale, kanë e drejte për të vendosur, bazuar te prototipet e tyre, se cili është niveli i pranueshëm i rrezikut. Sipas kësaj kontrate sociale, e cila përbën dhe përcakton kuadrin ligjor referues, shoqata të ndryshme shkencore dhe teknike vendosin se cili është niveli i pranueshëm dhe i papranueshëm i rrezikut.

¹⁹⁰Beck, U., (2009), *World at Risk*, Polity Press, kap. 2.

5.4. Teknologjia, aleate e Sigurisë dhe e luftës kundër Terrorizmit

Terrorizmi ndërlidhet me teknologjinë me të paktën tre mënyra, dhe kjo marrëdhënie transformohet me kalimin e kohës: a) teknologjia ofron potencial aplikacionesh dhe ky potencial përdoret nga terroristët, b) teknologjitë e transportit përcaktojnë shpejtësinë, distancën dhe intensitetin e sulmeve terroriste, c) teknologjitë e komunikimit ndikojnë për të përcaktuar shkallën e impaktit në nivelin politik dhe ideologjik. Për sa i përket pikës (a), duhet theksuar se terroristet përdorin armë ose sisteme armatimesh që janë të përdorimit në masë të gjerë (*psh., pistoleta, bomba të thjeshta për t'u instaluar, etj*). Përdorimi i tyre parapëlqehet pasi është i përshtatshëm për shkak se është i thjeshtë, këto armë janë lehtësisht të disponueshme, kanë përmasa të vogla, jetëgjatësi, dhe nuk kërkojnë njohuri të larta teknike nga ana e përdoruesit, ose janë të teknologjive me përdorim të dyfishtë. Këto teknologji për shkak se ata janë të pranishme në jetën tonë të përditshme dhe të lidhura ngushtë me të, nuk janë objekt i hetimit nga ana organeve të sigurisë publike, kështu që ata mund t'i shpëtojnë në shumë raste vëmendjes së nevojshme. Njohuritë teknike të përdoruesit, e shoqëruar kjo me pamundësinë tonë për të parashikuar shumëllojshmërinë e përdorimeve të mundshme të këtyre sistemeve të përdorura gjerësisht, mund të krijojnë hapësirat e nevojshme për sulme terroriste të rënda. Duhet të theksohet se përdorimi i dyfishtë i teknologjisë për realizimin e akteve terroriste nuk i anketohet vetëm objekteve të përfshira, si mjete për realizimin e akteve terroriste (në rastin e 11 shtatorit 2001, të aeroplanëve), por edhe mbështetjes suportuese të teknologjisë (psh., përdorimi i internetit për dërgimin e mesazheve të koduara, të transferimit të parave, njohuri navigacioni të avionëve civilë, shpërndarje teknike në mënyrë të përsosur të ekzekutorëve, për të vepruar para sulmit dhe pas tij për të parandaluar arrestimin e tyre, etj). Për sa i përket pikës (b), duhet të

theksohet se vetë zhvillimi i teknologjive të transportit bën që të zgjidhet mënyra e ndërmarrjes të sulmeve terroriste. Tradicionalisht, terrorizmi ishte lokal, pikat e sulmeve, ishin zakonisht, të njëjtat dhe me pikat e kontaktit mes pushtetit dhe terroristëve. Në këto pika, në kuptim të venddodhjes nga ana gjeografike, terroristët zgjidhnin normalisht të kryenin dhe sulmet e tyre. Megjithatë, përparimet teknologjike që ndikuan dhe në shpejtësinë e transportit, lehtësuan përdorimin gjeografikisht të gjerë të terrorizmit. Në parim tashmë, një terrorist modern mund të udhëtojë mijëra kilometra, të përfundojë misionin që i është ngarkuar dhe të kthehet në bazë, dhe e gjithë kjo, në më pak se një ditë. Sigurisht, kjo vlen kryesisht për transportin e njerëzve dhe jo për transportimin e armëve, të cilat duhet të jenë afër objektivit të synuar, ose të transportohen atje në rrugë tokësore ose detare. Ky kufizim teknologjik përcakton përzgjedhjen e sistemeve të armatimeve të terroristëve dhe ndikon në prirjen për përdorimin e armëve të lehta (*të vogla nga madhësia*) dhe eksplozivëve, të cilat mund të ndërtohen dhe të furnizohen nga burime lokale, si dhe gjithashtu është përcaktues në zgjedhjen e teknologjive me përdorim të dyfishtë. Sa për (3), duhet theksuar se teknologjitë e komunikimit janë të rëndësishme në nivele taktike dhe strategjike të ushtrimit të terrorizmit. Në nivel taktik, komunikimi mes terroristëve është thelbësor për suksesin e misionit. Kjo është veçanërisht e vërtetë në rastet kur sulmi terrorist është projektuar të jetë larg nga pika e kontaktit e terroristëve me pushtetin që kundërshtojnë (si në rastin e 11 shtatorit, 2001) dhe duhet të bëhet duke përdorur teknologji të lartë për të deshifruar kode ose për t'i fshehur ato ose për të dyja. Ka ndihmuar gjithashtu së fundmi, për një metodikë tjetër të përzgjedhur nga një organizatë tjetër terroriste, ajo e Shtetit Islamik. Duke shfrytëzuar teknologjitë e komunikacionit, rrjetin e internetit, kjo organizatë ka dhe një model tjetër luftimi dhe veprimtarie terroriste. Pasi kryen

rëmbime personash, që janë pjesë e një komuniteti psh të krishterë, shtetas të një vendi që i ka shpallur luftë terrorizmit, kryen ekzekutimet e tyre duke zgjedhur mënyra shumë makabre¹⁹¹, ose dhe shpërndan ideologjinë e saj dhe për të përhapur terror dhe për të treguar fuqinë, përdorin internetin për të postuar video ku tregojnë taktikat e tyre dhe stërvitjen e rekruteve¹⁹². Kjo e fundit nuk mund të zbatohet vetëm aty ku kanë qenë të paramenduar dhe të siguruar plotësisht të gjitha hollësitë e sulmit deri në detaje, gjë që përsëri tregon për aftësi të përparuara teknike dhe teknologjike. Në nivel strategjik, komunikimi është thelbësor për qëllimet politike të sulmit. Aktet e dhunshme duhet të përhapen dhe të bëhen të ditur përtej pikës së sulmit për të përhapur mesazhin e terroristëve. Pa përhapjen e rezultateve të sulmeve, nuk është e mundur ruajtja dhe zgjerimi i lëvizjes, e cila mbështetet nga faktorët politik, ekonomik dhe moral. Ky përparim i teknologjive të komunikimit dhe shpërndarja e tyre konsekuente në publik, ka shkaktuar ardhjen e pasojave të dëshiruara komplekse dhe të shumta të sulmeve terroriste, të cilat për arsye praktike ishte e pamundur që të arriheshin më parë. Rol të rëndësishëm në hartimin e sulmeve të tilla dhe përzgjedhjen e metodave të terroristëve, kanë dhe mediat, sepse nëpërmjet tyre do të përhapet dhe mesazhi politik ose ideologjik i sulmit. Kështu, sulmi si të zhvillohet pranë pikave të konfliktit ose si të zhvillohet në një qytet të madh të botës perëndimore do të ketë të njëjtin rezultat terrorizues mes popullsisë në nivel global. Marrëdhënia simbiotike mes medias dhe terroristëve lejon,

¹⁹¹ Burimi <http://lajmifundit.al/2015/03/>, aksesuar në datë.25.04.2015. Publikohet një video nga grupi ekstremist IS që tregon vrasjen me prerje kokash të 8 vetëve të cilët ishin myslimanë Shiite. Në këtë video, që u publikua në mediat sociale, thuhet se vrasja u krye në provincë Hama në Siri. Observatori sirian me seli në Londër, deklaroi se, pas verifikimeve, videoja ishte origjinale. Militantët e Shtetit Islamik kanë vrarë me prerje kokash me dhjetra njerëz dhe kanë okupuar territore të gjera në Irak dhe në Siri në vitin 2014.

¹⁹² ISIS tani është përqëndruar në rekrutimin e anëtarëve të rinj, në veçanti fëmijët. Ata kanë publikuar në internet video me fëmijë, në fakt djelmosha, të cilët gjuajnë me automatik si të rriturit. Edukimi i kuadrove dhe përhapja e ideologjisë tek ata është njëri nga qëllimet themelore ku mbështetet rrjeti ekstremist që po zgjerohet nga Siria në Irak. Aksesuar më 28.04.2015 <http://www.lajmeonline.eu>.

veçanërisht pas zhvillimit të internetit dhe televizionit satelitor, pasqyrimin e drejtpërdrejtë dhe global të lajmit (Nacos, B., 1994, 150). Në shumë mënyra, ndikimi global i ngjarjes, shpërndarë kjo e fundit nëpërmjet teknologjive të komunikimit, përcakton vetë natyrën ndërkombëtare të terrorizmit. Përkatësisht, kërcënimi terrorist si i modeluar pas 11 shtatorit të 2001, bazohet në asimetrinë në mes kriminelëve dhe viktimave. Të mësipërmet janë të lidhura me një tjetër karakteristikë të terrorizmit, që është pasiguria e cila rezulton nga paaftësia për të parashikuar gjeografikisht dhe saktësisht kohën dhe vendin ku do ndodhë sulmi. Pasiguria e rrit nivelin e kërcënimit të terrorizmit shumë më tepër nga vetë dëmet aktuale që do të rrjedhin si pasojë e tij, dhe gjithashtu ka efekte serioze anësore, të tilla si: barrë ose kosto financiare të lartë për të ofruar siguri për një numër të madh të objektivave të mundshme, mungesës së investimeve për shkak të pasigurive që shkakton kjo situatë, reduktimin e marrdhënieve të transportit reduktimin e turizmit për vendet që ekonominë e tyre e bazojnë kryesisht te turizmi i jashtëm etj.,. Ka pasoja psikologjike dhe në ndryshimet në stilin e jetës së përditshme (*reduktim i ndjenjës së privatësisë së mbrojtur me ligj, duke rritur ndjenjën e pasigurisë, shmangje e përqendrimeve masive në formën e pjesëmarrjes në festa, mitingje, koncerte, etj, shmangie e përdorimit të transportit publik etj.*). Kjo nga ana tjetër është e lidhur me vështirësinë e parandalimit të sulmeve. Njerëzit të cilët do të zbatojnë këto sulme nuk janë vetëm të gatshëm të vdesin për të arritur qëllimin e tyre, por e kanë pranuar dhe këtë si sukses të misionit të caktuar për to, vetëvrasjen, martirizimin e thënë ndryshe nga terroristët. Duhet të theksohet se ekziston një dallim i madh mes vendimit që dikush të realizojë një sulm, gjatë të cilit ka ngjasa që ky person të ngelet i vrarë për arsye të rrethanave të rastit ose mos përgatitjes eficiente para sulmit por që gjithsesi nuk ka si qëllim të vritet por të kthehet i gjallë, dhe të planit fillestar për

të kryer një sulm vetëvrases si pjesë e pandarë dhe metodë e paramiruar sulmi. Sa përmendëm më sipër, përbëjnë një përmirësim cilësor në krahasim me rreziqet tradicionale me të cilat përballen shtetet. Kundërmasat teknologjike që janë zhvilluar për kërcënime të tilla nuk janë të efektshme në prizëm të kërcënimeve të reja, sepse vlera parandaluese e fuqisë ushtarake nuk mund të jetë efiçente në një situatë të vazhdueshme gatishmërie të jashtëzakonshme, gatishmëri kundër armiqve, të cilët synojnë të godasin prapa linjave tradicionale të frontit të luftës (*ka mundësi të mos ekzistojë fare front lufte, si ai konceptohet tradicionalisht nga e drejta ndërkombëtare e luftës*), dhe që synojnë si objektiv popullsinë civile, dhe që për këtë dhe janë të bindur për drejtësinë e veprimeve të tyre bazuar në dogma teologjike. Për më tepër, përpjekja e arritjes së një fitore të qartë dhe vendimtare kundër kërcënimit terrorist, gjë e cila është një objektiv kryesor në formulimin e politikave të teknologjisë për përballjen me kërcënimet tradicionale, nuk mund të rezultojë absolutisht e suksesshme në rrethanat e tanishme, edhe në rast të vdekjes së udhëheqësve të grupeve terroriste. Plegma e lartpërmendur e ndryshimeve të rëndësishme në krahasim me kërcënimet tradicionale, për qeveritë e zgjedhura, ishte dhe shkaku i konvertimit të politikës teknologjike dhe pse jo përfshirjen e sigurisë si një fushë diskrete të zhvillimit teknologjik.

Teknologjia nga ana tjetër përbën për Bashkimin Evropian, një instrument shumë të rëndësishëm për të realizuar rritje ekonomike, rinovimin industrial dhe inovacion teknologjik. Deri në fillim të dekadës së parë të shekullit të 21-të, përparësi, me pak përjashtime, jepej në hartimin e politikave dhe financimeve rreth aksit në qëndër të tematikave që kanë kontribuar në teknologjitë komerciale (*civilian technologies*). Sulmi mbi Kullat Binjake në 2001 dhe përqëndrimi i vëmendjes tashmë, mbi politikat e sigurisë, e shoqëruar me një seri të të dhënave ekonomike, të cilat vendosën një realitet

të ri për industrinë europiane të mbrojtjes, çoi në procesin e institucionalizimit të politikës teknologjike të sigurisë. Institucionalizimi i një politike të tillë publike, besoj se është një hap vendimtar drejt transformimit të politikës për teknologjinë e BE-së, për arsye se, absolutisht, i përket sferës së ushtrimit të politikës kombëtare. Njëkohësisht, ndërgjegjësimi për rolin e rëndësishëm të industrisë së mbrojtjes në risitë inovative dhe ofrimit të teknologjisë, nxjerrin në pah një sërë interpretimesh për lindjen dhe zhvillimin e politikës teknologjike të sigurisë. Në kapitullin aktual, pasqyrohet lidhja e ngushtë e rolit të industrisë së mbrojtjes së BE-së dhe të përdoruesve të teknologjive. Por bashkërendohet me ndikimin që ushtruan në proces orientimet specifike të procesit teknologjik, si ato për teknologjitë me përdorim të dyfishtë. Ndërkohë, këtu do tentoj një prezantim cilësor dhe sasior të projektit të parë përkatës kërkimor evropian. Ky prezantim është i bazuar në vlerësimin ekonomik të programeve dhe mbledhjen përkatëse të të dhënave dhe analizat e koordinatorëve të përfshirë në konsorciumet kërkimore.

5.4.1. Siguria, Terrorizmi dhe Politika Teknologjike.

Në nivelin e BE-së, sulmet ndaj Kullave Binjake në SHBA ishin dhe shkaktoresh të ndryshimeve sistematike. Menjëherë u miratua autorizimi i misioneve të sigurisë në harmoni me kërkesat e SHBA-ve. Pas 11 shtatorit të 2001-shit, ka pasur një thellim të KEPPAA, pasojë e së cilës ishte ndërmarrja e një numri të madh të misioneve politike ose ushtarako-civile nga BE globalisht. I tillë ishte intensiteti i sulmit, sa që nxiti reagimin e BE-së, e cila mori përsipër menaxhimin e krizave dhe riorganizimin institucional të pas luftës të Afganistanit, disa vendeve të Ballkanit perëndimor (*si Kosovës, Bosnjë-Hercegovinës, pranimin si vend anëtar të Kroacisë, negociatat me Serbinë për anëtarësim të saj me të drejta të plota në BE, Shqipërisë gjithashtu etj.*),

Lindjes së Mesme, Afrikës nën-Sahariane, dhe së fundmi dhe Ukrainës, të Moldavisë dhe Azisë Jugore. Kjo prezencë e shtuar e BE-së në pjesë të ndryshme të botës ishte e mundur për dy arsye. E para ka të bëjë me forcimin e bashkëpunimit të BE-së me organizatat të tjera globale apo rajonale si NATO, OKB, OECD, Bashkimi Afrikan. E dyta ka të bëjë me konstatimin se disa fusha të politikave publike nuk janë objekte diskrete, dhe të vecuara nga ajo. Marrëdhëniet mes sigurisë së brendshme dhe të jashtme, dhe marrëdhënia mes sigurisë dhe zhvillimit janë disa nga këto fusha. Edhe pse, zyrtarisht të paktën, BE-ja është e themeluar mbi parimet e multilateralizmit, ka filluar të vihet re një përjasje më pragmatike e aspekteve të caktuara të strategjisë evropiane për reformimin e sistemit ndërkombëtar dhe mbarëvajtjen e legjislacionit dhe jurisprudencës së pranuar tashmë. Kjo ishte një mundësi e shkëlqyer për përpjekjet e disave për të arritur qëllimin për thellimin politik të BE-së me anë të miratimit të objektivave të përbashkëta të jashtëm dhe të mbrojtjes, siç është definuar në Shtyllen e 2-të BE-së. Nëse këto objektiva janë komplementare ose zëvendësojnë objektivat individuale kombëtare, kjo është një pyetje interesante. Kjo pyetje është shumëdimensionale dhe dinamike. Shumëdimensionale për shkak se për përgjigjen e saj nevojiten njohuri të mira të politikave evropiane, por kryesisht të të kuptuarit të vendimmarrjes në nivelin e përditshëm, si dhe të jetë dikush mbartës i njohurive financiare dhe njohurive ekonomike dhe teknologjike në fushën e integritit dhe inovacionit industrial. Fakti që vendimet politike në nivel të BE-së duhet të marrin parasysh çështjet specifike ekonomike, teknologjike dhe industriale është karakteristikë e vështirësisë së evidentuar. Kjo vështirësi bëhet më e qartë për hartuesit e politikave, në qoftë se dikush merr parasysh faktin se vendimet për politikën përkatëse kombëtare, në parim, merren në nivel kombëtar dhe me pas në nivel të bashkimit evropian. Duke u

kthyer pas, në nivelet e studimeve dhe teknologjisë, çështjet e sigurisë dhe terrorizmit kanë qenë objektiva të veçanta. Mbështetja financiare e kompanive të industrisë dhe të industrisë ushtarake në Evropë, në një kohë vazhdimisht në rënie të investimeve në mbrojtje, qoftë për shkak të racionalizimit apo zvogëlimin e kërcënimeve tradicionale, ka luajtur një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave publike me këtë temë. Sigurisht, vetëm për këtë arsye u pranua dhe pozitivisht ndërmarrja e këtyre përpjekjeve. Për më tepër, miratimi i hulumtimit të përbashkët dhe të prioriteteve teknologjike të industrive kombëtare, si dhe rritja e shkallës së ndërlidhjes së industrive me institucionet akademike në nivel evropian, shtruan terrenin e nevojshëm në përpjekjen e homogjenizimit të industrisë. Hartimi i politikave publike u bazua te disa të vërteta të pashmangshme ekonomike, teknologjike dhe industriale. Nga ana ekonomike, racionalizimi i industrive kombëtare dhe garantimi i ekonomive të shkallës së lartë ndikoi. Nga ana industriale, infrastruktura ekzistuese industriale nuk mund të mbijetonte duke prodhuar sisteme ushtarake për t'u mbrojtur nga kërcënimet tradicionale (*siç thamë këto kërcënime kanë tendencë të zhduken për BE-në*). Duhej të ripërcaktohej qëllimi i egzistencës së tyre përmes kërkesave të politikës së re publike. Në këtë fazë të tezës, do të analizojmë objektivat e politikës teknologjike pas ripërcaktimit të natyrës së kërcënimeve, si analizuam në kapitullin e mëparshëm. Kjo përpjekje për analizë, do të zhvillohet fillimisht në përgjithësi, dhe do të fokusohet në nivelin evropian, dhe më pas do t'i referohemi dhe përvojës së SHBA-ve¹⁹³. SHBA-të, për shkak të ndikimit të pas 11 Shtatorit, por edhe për shkak të dinamikës së famshme si shoqëri dhe për të gjitha arsyet

¹⁹³Brian Michael Jenkins and John Paul Godges, editors, *The Long Shadow of 9/11: America's Response to Terrorism* RAND, 2011, faqe 38.

e mësipërme, ishin të parët që e ndryshuan politikën publike përkatëse. Në nivelin e BE-së, procesi i kthesës mund të paraqitet përmes leximit të dokumenteve publike. Padyshim, hartimi dhe miratimi i *Strategjisë së Sigurisë Evropiane* është në qendër të këtij procesi, sepse ajo përcakton superstrukturën në lidhje me pozitën e Europës në rang botëor dhe theksoi nevojën për zhvillimin e mjeteve teknologjike nëpërmjet të cilave kjo e fundit do të sigurojë këtë pozicion. Rëndësia e këtij dokumenti publik si një kornizë të përgjithshme reference, është kaq e madhe sa që çdo dokument i mëvonshëm që lidhet me R&D referohet te ai. Për më tepër, në harmoni me politikën teknologjike të sigurisë, unë do të shqyrtojë objektet përkatëse të politikave industriale. Lidhur me çështjen e sigurisë, përkufizimi i politikës teknologjike nëpërmjet programeve shkencore të kërkimit, si dhe konsolidimi i industrisë ushtarake janë dy aspekte të së njëjtës çështje. Kjo për shkak se industria tashmë ekzistuese ushtarake, ka zbatuar një pjesë të madhe të *Strategjisë së Sigurisë Evropiane* meqenese ky projekt hulumtimi kishte për qëllim modernizimin e teknologjisë ekzistuese dhe infrastrukturës industriale. Ky kapitull është një bosht i rëndësishëm i tezës, sepse skicon ndryshimet e shkaktuara nga sulmi terrorist i 11 shtatorit të 2001-shit, në formulimin e politikave publike të BE-së dhe çoi në hartimin e tyre nga e para¹⁹⁴. Zbatimi i një politike të përbashkët të sigurisë, duhet të përshtaste dhe të përmbante aspekte të ndryshme të procesit politikbërës të tilla si gjyqësori, aspekti ekonomik, dhe në rastin tonë, ai teknologjik dhe industrial. Dy të fundit kanë si objektiv modernizimin, dhe në mënyrë të tërthortë, të konvergojnë drejt bashkëpunimit evropian, si dhe për t'u ofruar evropianëve mjetet teknologjike për të perballur kërcënimin terrorist. Për shkrimin e këtij kapitulli janë përdorur burime parësore të politikës publike për R&D për sigurinë, dhe dokumente publike që

¹⁹⁴Michael B. Kraft and Edward Marks, *U.S. Government Counterterrorism: A Guide to Who Does What* (Boca Raton, FL: CRC Press, 2012), faqe 201.

imponuan ndryshimet e nevojshme në prioritetet teknologjike dhe industriale. Kjo vlen jo vetëm për rastin amerikan, por shumë më shumë për Europën.

Ripërcaktimi i rreziqeve për stabilitetin global¹⁹⁵ në shekullin e 21-të, nuk transformoi një tjetër faktor kyç si është rëndësia e teknologjisë në interes të sigurisë kombëtare. Gjatë gjithë historisë, ushtrimi i aktiviteteve ushtarake është bazuar pjesërisht, në nivelin e teknologjisë egzistuese dhe ndikonte, në shumë herë, përparësinë e zhvillimit teknologjik. Ndërsa instinktet e njeriut mbeten të paprekura, teknologjia shumëfishon kapacitetet njerëzore për shkatërrim, si dhe rrit nivelin e sigurisë së mbartësit të saj dhe mirëmban marrdhënien superioritet - inferioriteti nga aksesimi selektiv ofruar të tjerëve. Shtetet, si qeniet njerëzore, konkurrojnë me njëri-tjetrin për të arritur ose për të parandaluar efikasitetin optimal tekno-ekonomik. Rritja e terrorizmit në kërcënim serioz të sistemit ndërkombëtar, ka çuar në një rivlerësim të rëndësishëm të teknologjisë duke kuptuar me këtë se zhvillimi teknologjik duhet të përqëndrohet te një kategori e ndryshme kërcënimesh dhe të ndryshojë qëllimi i saj kryesor që ishte zhvillimi i sistemeve të armatimeve të rënda: të tilla si armë bërthamore dhe mekanizmat e dorëzimit të tyre, si dhe sistemet e raketave dhe të bombarduesve strategjikë të cilët plotësonin vijën mbrojtëse kundër kërcënimit sovjetik (dhe anasjelltas) dhe ishin fryt i një projektimi, i cili u bazua në koncepte të tilla si, c'armatimi bërthamor (*nuclear rollback*), ndëshkimi shkatërrimtar reciprok (*mutual assured destruction*), monitorimi i shkallës së kërcënimit (*escalation dominance*), strategjitë e mbrojtjes (*strategic defense*) dhe kontrolli i armatimeve (*arms control*). Vlen të përmendet se ky ndryshim zbatohet pjesërisht pasi në Azi, diplomacia

¹⁹⁵Nadav Morag, *Comparative Homeland Security: Global Lessons* (Hoboken, NJ: John Wiley & Sons, 2011), faqe 239.

bërthamor dhe zhvillimi përkatës teknologjik është në lulëzim të plotë. India dhe Pakistani kanë zhvilluar armë bërthamore dhe janë në procesin e zhvillimit të një marrëdhënie bërthamore komplekse të bazuar në shumë tipare të përbashkëta me ato të Luftës së Ftohtë. Nuk përbën më sekret se Irani po kënaq ambiciet e tij bërthamore dhe se është në fazën përfundimtare të pasurimit të uraniumit. Korea e Veriut ka raketa balistike që janë të afta të mbajnë në to mbushje bërthamore. Të gjitha këto kanë ndryshuar balancën e sigurisë në Europë dhe në Azi. Në realitet, modeli dominant konceptual i sigurisë në shekullin 21-të duhet të përfshijë kërcënimet tradicionale (*të tilla si Irani, Korea e Veriut, marrëdhëniet mes Indisë dhe Pakistanit*) dhe kërcënimet e reja si terrorizmi islamik dhe jo vetëm. Në mënyrë të ngjashme, hulumtimi kombëtar dhe aktivitetet teknologjike duhet të ndjekin, deri në masën që udhëheqësit e tyre politike vendosin, të dy drejtimet. Kjo dualitet politik ishte shkak i domosdoshmërisë së NATO-s vetë. Në të vërtetë, zgjerimi konceptual i sigurisë për të përfshirë aspekte të tilla si menaxhimi i krizave, terrorizmit, shtet-kërcënimet, siguria energjitike është kuadri operacional referues në shekullin e 21-të. Tani, NATO ka përqafuar një qasje gjithëpërfshirëse për konceptin e sigurisë, tejkalimin e paragjyqimeve ideologjike të Luftës së Ftohtë, dhe vazhdoi më tej me themelimin e institucioneve përkatëse për trajtimin e këtij koncepti. Botimi i vëllimeve shkencore si, *Science and Technology Policies in the Anti-Terrorism Era*, kontributet e të cilës i kemi parë në kapitujt e mëparshëm, si dhe krijimin e ESCD në NATO, janë pjesë e përgjigjes për të ndihmuar në përcaktimin e nevojave të reja teknologjike, menaxheriale dhe financiare¹⁹⁶. Nga kjo pikë e tutje, do të rishikojmë çështjen e politikës teknologjike, vetëm që tani ajo do të jetë në pozicionin kohor të kornizës së post-Luftës së Ftohtë, veçanërisht në linjën e

¹⁹⁶http://www.nato.int/cps/en/SID-6E5092631BF11962/natolive/news_65107.htm?selectedLocale=en, aksesuar ne dt.09.05.2015

SHBA-ve të pas 11 shtatorit, të cilat dhe përcaktuan dhe prioritetet përkatëse kërkimore dhe teknologjike. Surpriza që shkaktoi sulmi terrorist ishte një kombinim i goditjes japoneze në Pearl Harbor dhe lëshimit raketor sovjetik të Sputnik. Sulmi i papritur me mijëra viktimave, manifestimi në një shkallë të lartë i dobësisë së tyre dhe rënies së mitit amerikan të paprekshmërisë në territorin e tyre, lindja e një kërcënimi të ri kundër sigurisë kombëtare, dhe paaftësia e infrastrukturës ekzistuese teknologjike për të përballuar dhe parandaluar keto sulme, ishin dhe evidentimet e pasojave tëgoditjes. Kjo e fundit veçanërisht është çelësi për zhvillimin e një plani të integruar për politikën teknologjike të mbrojtjes, e cila duhet të synojë në mënyrë të qartë në zhvillimin e saj për të trajtuar fenomenin e terrorizmit. Përballja me kërcënime si terrorizmi, janë një sfidë e madhe për strukturën ekzistuese ushtarake, forcat e sigurisë dhe sektoret e inteligjencës, institucionet demokratike, si dhe për infrastrukturën shkencore dhe teknologjike që ka për detyrë të sigurojë mjetet e duhura teknologjike për adresimin e rrezikut. Konsistimi korrekt, i besueshëm (shkencor) i politikës teknologjike duhet të bazohet në një analizë sistematike të natyrës së kërcënimit (si ne u përpoqem ta bëjmë më parë), nga e cila do të dalin karakteristikat e tij, dhe duhet të ndikojë (drejtpërdrejt ose tërthorazi) në formulimin e politikave të teknologjisë. Sulmi terrorist bëri që të rishikohet buxheti kombëtar për shpenzime ushtarake, që ishte tkurrur shumë në shumë vende të BE-së dhe në SHBA natyrisht, për arsye të fundit të epokës së Luftës së Ftohtë, politikë shpenzimesh ushtarake që vazhdoi të ndiqej deri në fillimet e shekullit të 21-të.

Çdo vend, bën një vlerësim të ndryshëm, dhe rendit kështu kërcënimet terroriste kundër tij, dhe përllogarit shumat që do të shpenzohë për këtë politikë dhe burimet financiare. Nuk ka dyshim se rritjet e mëdha të financimit janë bërë në shërbimet e informacionit dhe në sektorët e antiterrorizmit për zbulimin dhe parandalimin e tij.

Megjithatë financimi për rritjen maksimale të sigurisë detare, duke përmirësuar kohën e reagimit në kohë krizash, përballja me kërcënime nga Sulme Kimike si dhe për mbrojtjen e infrastrukturës përkatëse, vështirë të përcaktohet sakte sepse kompetencat lëndore për këto çështje, janë të ndara mes institucioneve të shumta, financimi i tyre është kompetence e disa ministrive dhe nuk është gjithmonë e qartë se cilat programe duhet të integrohen nën titujt e sigurisë dhe luftës kundër terrorizmit, të survejimit të kufijve detarë dhe tokësorë, etj¹⁹⁷ „.

Tabela 1

Viti	Kina	Franca	Gjermania	Rusia	Mb.Bashkuar	SHBA
1989	2.6	3.5	2.8	14.2	4	5.5
1990	2.6	3.4	2.8	12.3	3.9	5.3
1991	2.4	3.4	2.2	4.1	4.7
1992	2.5	3.3	2	5.5	3.8	4.8
1993	2	3.3	1.9	5.3	3.5	4.5
1994	1.7	3.3	1.7	5.9	3.3	4.1
1995	1.7	3	1.6	4.4	3	3.8
1996	1.7	2.9	1.6	4.1	2.8	3.5
1997	1.6	2.9	1.5	4.5	2.6	3.3
1998	1.7	2.7	1.5	3.3	2.5	3.1
1999	1.9	2.7	1.5	3.4	2.4	3
2000	1.8	2.5	1.5	3.7	2.4	3.1

¹⁹⁷Kosiak, S., (2003), Funding for Defense, Homeland Security and Combating Terrorism Since 9/11, te *Security after 9/11. Strategy Choices and Budget Tradeoffs*, (Briefing Book), Center for Defense Information, fq. 9

2001	2	2.5	1.5	4.1	2.4	3.1
------	---	-----	-----	-----	-----	-----

**= vlerësim nga SIPRI*

Tabela 1. Përqindje e shpenzimeve ushtarake / PBB 1989-2001

Burimi : SIPRI Database on Military Expenditure (09.06.2015)

Tabela 2

Viti	Kina	Franca	Gjermania	Rusia	Mb.Bashkuar	SHBA
1989	16.300	71.899	69.168	314.400	70.176	528.140
1990	17.500	71.581	72.902	266.000	68.669	504.534
1991	18.200	72.047	68.989	...	70.539	443.129
1992	22.000	69.781	65.611	66.000	66.253	468.216
1993	20.400	69.008	58.985	58.300	63.802	443.598
1994	19.400	69.363	55.007	56.800	61.750	416.580
1995	19.900	65.929	54.104	33.700	57.494	393.996
1996	22.000	64.347	53.046	29.700	57.195	372.569
1997	22.600	64.568	51.122	33.000	54.618	370.627
1998	25.900	62.881	51.284	21.000	53.957	362.277
1999	29.400	63.434	52.331	21.800	53.788	363.170
2000	31.200	62.707	51.487	29.700	54.055	380.271
2001	38.400	62.496	50.646	33.000	59.509	380.271

Tabela 2. Shuma e Shpenzimeve Ushtarake 1989-2001, në miliona \$-vazhdimësi e tab.

1.

Burimi: SIPRI Database on Military Expenditure (10.06.2015) Shtetet e mëdha, ose shtuan shpenzimet ushtarake, ose i shtuan ato për R&D, ose për të dyja bashkë¹⁹⁸.

Tabelat 3

Viti	Kina	Franca	Gjermania	Rusia	Mb.Bashkuar	SHBA
2001	2	2.5	1.5	4.1	2.4	3.1
2002	2.1	2.5	1.5	4.4	2.5	3.4
2003	2.1	2.6	1.4	4.3	2.5	3.8
2004	2	2.6	1.4	3.8	2.5	4
2005	2	2.5	1.4	3.7	2.4	4
2006	2	2.4	1.3	3.6	2.4	3.9
2007	2	2.3	1.3	3.5	2.4	4
2008	2	2.3	1.3	3.5	2.5	4.3

*= vlerësimi SIPRI

Tabela 3. Përqindje e Shpenzimeve Ushtarake / PBB 2001-2008, (%)

Burimi: SIPRI Database on Military Expenditure (09/06/2015)

Tabela 4

Viti	Kina	Franca	Gjermania	Rusia	Mb.Bashkuar	SHBA
2001	38.400	62.496	50.646	33.000	55.909	380.271
2002	44.400	63.779	50.790	36.600	59.310	426.982

¹⁹⁸510 James, A.D., (2006), The Transatlantic Defence R&D Gap: Causes, Consequences and Controversies, *Defence and Peace Economics*, vol. 17, fq. 223-238

2003	48.500	75.716	50.095	39.000	62.618	485.975
2004	53.100	67.520	48.557	40.600	62.352	529.673
2005	59.000	66.096	47.798	44.200	62.397	554.930
2006	68.800	66.449	46.695	48.400	62.274	563.549
2007	77.900	66.673	46.740	52.500	63.042	578.340
2008	86.200	66.009	46.759	58.300	65.615	616.073
2009	98.800	67.316	48.002	61.000	69.271	663.255

Tabela 4. Shuma e Shpenzimeve Ushtarake 2001-2009, në miliona \$-vazhdimësi e tab.

3.

Burimi: SIPRI Database on Military Expenditure (10.06.2015)

Tabela 5

Viti	Mb.Bashkuar	Rusia	Franca	Gjermania	SHBA
1989	2,133	...	4,726	1,546	40,665
1990	2,155	...	5,641	1,730	39,925
1991	2,209	...	5,122	1,654	39,328
1992	2,071	...	4,902	1,596	40,083
1993	2,269	...	4,541	1,367	41,249
1994	2,022	1,243	4,510	1,354	37,764
1995	2,062	3,468	3,955	1,465	37,204
1996	2,144	3,964	3,897	1,638	37,801
1997	2,312	7,232	3,163	1,533	39,951
1998	2,100	3,040	2,970	1,403	39,823

1999	2,347	9,576	2,931	1,359	41,306
2000	2,348	13,101	2,963	1,267	43,161
2001	2,063	21,412	3,385	1,214	46,202

Tabela 5. Shuma nga Buxheti i Shtetit për Shpenzime Ushtarake për R&D për vitet 1989-2001, në miliona.(stërlina, rubla, euro, dollarë)

Burimi: OECD, Main Science and Technology Indicators, Dataset: Government Budget Appropriations or Outlays for R&D, NABS_2007_14, (19/7/2015)

Tabela 6

Viti	Mb.Bashuar	Rusia	Franca	Gjermania	SHBA
2002	2,740	29,678	3,559	913	53,731
2003	2,682	49,271	3,619	1,116	63,048
2004	2,583	...	3,531	990	70,344
2005	2,011	...	3,480	991	74,641
2006	2,132	...	4,078	1,141	78,737
2007	2,150	...	4,065	1,131	82,001
2008	2,002	...	4,063	1,187	80,639
2009	1,183	...

Tabela 6. Shuma nga Buxheti i Shtetit për Shpenzime Ushtarake për R&D për vitet 1989-2001, në miliona.(stërlina, rubla, euro, dollarë). Vazhdimesi e tab. 5.

Burimi: OECD, Main Science and Technology Indicators, Dataset: Government Budget Appropriations or Outlays for R&D, NABS_2007_14, (19/7/2015).

5.4.2. Mekanizmat e furnizimit dhe prokurimeve, Specifikimet teknike, teknologjike dhe Politika industriale

Në mbyllje të këtij kreu, vlen të përqëndrohemi gjithashtu edhe në aspektin e politikës së sigurisë industriale. Një aspekt, i cili nuk është trajtuar si një pikënisje për çështjet e politikës teknologjike. Natyrisht, siç tashmë është parë në disa raste në këtë tezë kjo nuk qëndron për një sërë arsyesh. Këto kanë të bëjnë me përvetësimin e teknologjisë nga industria duke integruar këtë të fundit në linjën e prodhimit, me ndikimin e industrisë në drejtim të politikës teknologjike për zgjidhjen e problemeve të cilat vështirësojnë produktivitetin e të parës, ose për të fituar një avantazh konkurrues. Gjithashtu arsyet lidhen me rritjen e prodhimit industrial nëpërmjet procedurave më efikase, ose sigurimin e teknologjive inovative që do të japin përparësi monopoliste (*edhe pse për një kohë të kufizuar*) në poseduesin e njohurive teknognotike, apo qasje në një burim europian financimi. Në çdo rast, lidhja mes industrisë dhe R&D është multishtrësore dhe interaktive. Praktikisht e para bazohet te e dyta për të përmirësuar procesin e prodhimit, dhe e dyta është e bazuar në të parën për të absorbuar humbjet. Roli i shtetit është ndërmjetësues, kryesisht në mbrojtje të interesit publik duke forcuar R&D në zonat ku industria nuk është e interesuar për të investuar, sepse ai e njih natyrën e dobishme të saj (industrisë). Me këtë mënyrë, ushtron politikat shtetërore, të biznesit, shkencës dhe teknologjisë, duke përzgjedhur (*në bashkëpunim me grupet e interesit*), objektivat afatmesme dhe objektivat afatgjata. Në nivelin e politikave të sigurisë publike, BE-ja njih dhe vështirësinë e krijimit të politikave shkencore, teknologjike dhe industriale, duke pranuar natyrën e vecantë të konceptit të sigurisë¹⁹⁹. Kjo vështirësi në definicion të perceptimit konceptual, siç e pamë në kreun e

¹⁹⁹http://ec.europa.eu/enterprise/policies/security/industrial-policy/index_en.htm, aksesuar 6/9/2015.

mëparshëm, është për Drejtorinë e përgjithshme të Ndërmarrjes dhe Industrisë të BE-së, dhe arsyeja kryesore për mungesën e vëmendjes ndaj sektorit të sigurisë nga pikëpamja e perspektivës së konkurrencës ekonomike dhe politikës industriale. Forcimi i bazës industriale europiane për sigurinë, fillon nga përpjekja për të përcaktuar sektorin konkret, identifikimin e të implikuarve, dhe njohjen e parametrave të këtij sektori industrial. Në këtë kontekst, duhet të përcaktohet dhe përmasa e stereotipit të ndërmarrjes (*pattern*) i pajisjeve të ofruara dhe shërbimeve të industrisë së sigurisë që është zhvilluar brenda dhe jashtë Evropës. Për më tepër, përcaktohet si nevojë e domosdoshme, bërja e propozimeve specifike për politikën industriale në lidhje me konsolidimin dhe impaksimin e kompanive, të potencialit njerëzor dhe për konkurrencën e industrisë në nivel global. Në drejtim të hartimit të politikave industriale të sigurisë BE-ja nuk ka ndërmarrë veprime të veçanta dhe konkrete për arsyet e mësipërme. Megjithatë, kjo tezë tregon se mungesa e politikave të veçanta industriale të sigurisë, nuk përbën realisht inegzistencë totale të saj (politikës). Projektim i politikës industriale të sigurisë realizohet nëpërmjet formulimit të politikave industriale të mbrojtjes. Dy arsye kryesore na bëjnë të arrijmë në këtë konkluzion: a) teknologjitë e përdorimit të dyfishtë, të cilat lejojnë firmat industriale të mbrojtjes të zhvillohen në fushën e sigurisë, pa ndryshime të konsiderueshme në linjat e prodhimit, (*për më tepër, kjo është diçka që shkon për shtat në anën tjetër të Atlantikut, SHBA-ve*) dhe b) pranuesit kryesore të PASR (*Preparatory Action on the Enhancement of the European Industrial Potential in the Field of Security*) janë të njëjta kompani (*institucionet kërkimore dhe qendrat akademike*), aktive në sektorin e mbrojtjes. Politika industriale të mbrojtjes evropiane përbëhet nga nën-politika specifike, siç janë mekanizmat e furnizimit (ose krijimin tyre), përcaktimin e procedurave teknike në nivel kombëtar dhe

homogjenizimit të tyre. Mekanizmat e furnizimit, si dhe procedurave teknike janë të nevojshme dhe elemente plotësuese të secilës përpjekje, e cila ka për qëllim të mundësojë realizimin e misioneve që do të thirren të ndërmarrin forcat ushtarake europiane për qëllim të SES. Debati mbi këto objekte të politikës teknologjike evropiane është mjaft i vjetër por për mendimin tim, akoma i pazezauruar. Njoftimi i parë i KE për furnizime u komunikua në vitin 1996²⁰⁰ dhe u shoqërua me një pasues në 1997²⁰¹.

Tentativa e homogjenizimit të procedurave dhe mekanizmave kombëtarë për furnizimet nga BE-ja, është një element kyç i një politike teknologjike industrilale mbrojtjeje specifike për të arritur dhe për të ruajtur të tilla kapacitete teknologjike dhe industriale, të cilat ndikojnë pozitivisht në marrdhënien kosto - përfitim dhe për të siguruar cilësinë dhe gatishmërinë ushtarake. Në këtë kuptim, çështjet që nxisin rritjen e aftësive ushtarake për të përmbushur me sukses misionet e sigurisë, janë të lidhura ngushtë me mbrojtjes industriale dhe politikat teknologjike. Infrastruktura konkurruese industriale dhe menaxhimi i sistemeve, të cilat marrin parasysh marrëdhëniet kosto-efektivitet (*cost-effective*) është e nevojshme për pajisjen adekuate të forcave të armatosura të shtetit anëtar. Në përputhje me sa më lart, konkurrenca e industrisë europiane të mbrojtjes dhe bazës teknologjike dhe aftësia e BE-së për të përcaktuar një kornizë më homogjene mbrojtje - ekonomike, e cila do të çojë në një treg të vetëm të armatimeve të mbrojtjes, është vendimtare. Trajtuam SES-in si dokumentin strategjik që përcaktoi qartë vijat kryesore të një politike tjetër industriale. Me fjalë të tjera, vlerësimi i SES ishte ai i një dokumenti gjithëpërfshirës të politikave të sigurisë (*top-down policy*

²⁰⁰European Commission, (1996), *The Challenges Facing the European Defense-Related Industry, a Contribution for Action at European Level*, COM (1996) 10 Final, 24/1/1996

²⁰¹European Commission, (1997), *Implementing European Union Strategy on Defense-Related Industries*, COM (1997) 583 Final, 12/1/1997

document), i cili bëri thirrje për krijimin e një procesi financiar për R&D për sigurinë, duke arritur kështu, homogjenizimin e programeve individuale kërkimore kombëtare për sigurinë, zhvillimin i një kulture të përbashkët të bashkëpunimit të industrive të ndryshme, të sektorëve shkencorë-kërkimorë, si dhe të shërbimeve publike (si përdorues) në këtë fushë të ndjeshme si dhe në renditjen e prioriteteve të përbashkëta industriale. Perceptimi dhe implementimi i një sistemi të unifikuar furnizimi për armatime mbrojtëse është një pjesë e pazëllit të vështirë të politikës teknologjike-industriale. Kështu industria e mbrojtjes evropiane do të ftohet të mbulojë këtë fushë që lartëson sigurinë si një çështje politike prioritare tashmë për arsye të kërcenimit terrorist. Ftohet të mbulojë nevojat në fushën e teknologjive me përdorim të dyfishtë, në linjat egzistuese të prodhimit duke u përballur dhe me një buxhet në rënie. Miratimi nga ana e KE-së në vitin 2004, të Kartës Jeshile për Furnizime Armatimesh për Mbrojtjen, sugjeroi mënyra alternative për përmirësimin e transparencës dhe hapjen e tregjeve për produkte të tilla mes anëtarëve të BE-së²⁰². Dokumenti nxiste rritjen e konkurrencën ndërmjet industrive të mbrojtjes, përmirësimin e shpërndarjes së burimeve financiare, dhe përmirësimin e aftësive ushtarake në përputhje me CS&FP (*Common Security & Foreign Policy*). Për më tepër, ishte në vazhdimësi korrekte me një tjetër vendim të KE-së që përcaktoi 7 hapat e parë për rregullatorin e një Tregu të vetëm të Armatimeve në 2003-shin²⁰³. Në këtë Vendim, KE-ja theksoi se dështimi i përpjekjes së hapjes së tregut dhe mungesa e investimeve në R&D do të ketë pasoja negative për konkurrencën mes korporatave të teknologjisë së lartë. Më tepër, në përputhje me nenin pesë (5) të vendimit, propozohet nevoja një aktiviteti përgatitor për kërkime të avancuara në fushën

²⁰²European Commission, (2004), *Green Paper. Defense Procurement*, COM (2004) 608 Final, 23/09/2004

²⁰³Komisioni Europian, (2003), *Mbrojtja Evropiane – Tema Industriale dhe Tema Tregu, Per Hartimin e nje Politike te BE-se ne Fushen e Armatimeve Mbrojtese*, COM (2003) 113 Final, 11/3/2003

e sigurisë globale. Kuptohet, kjo është një tjetër kthesë që përbën dhe urën lidhëse mes industrisë së mbrojtjes në realizim të R&D për sigurinë. Në të vërtetë, mund të supozohet se qëllimi i këtij vendimi nuk ishte vetëm siguri i mbijetesës dhe zhvillimi i industrisë së mbrojtjes, por nxitja e konkurrencës globale, e bazës teknologjike-industriale evropiane, veçanërisht ato sektorë të aktivitetit teknologjik intensiv.

Miratimi i *Kartës Jeshile për Furnizime Armatimesh* emëroi dy mënyra të zgjidhjes së problemeve që lindin nga mbivendosja (*overlapping*) e programeve përkatëse në nivel kombëtar (*të cdo shteti anëtar*), si dhe proteksionizmin e industrive kombëtare të mbrojtjes vendase²⁰⁴: a) interpretim shpjegues i termave që përcaktojnë kuptimin e nenit 296 të Traktatit të Romës, dhe b) një Direktive të Re mbi produktet që nuk mbulohen sipas nenit 296 (*shih. produktet me përdorim të dyfishtë*). Gjithashtu u ngarkua EDA me hartimin e Kodit të Sjelljes (*Code of Conduct*) për të rritur konkurrencën brenda Evropës. IRECEDEM u aktivizua nga EDA në 2006-ën²⁰⁵. Përbën një institucion vullnetar, i cili është i bazuar në kodin e sjelljes për prokurimin e furnizimit të armatimeve të mbrojtjes (*Code of Conduct on Defense Procurement*), për të mbuluar blerjet e pajisjeve ushtarake, kur ato janë objekt nga neni 296. Deklarata e KE-së për një strategji të një konkurrence më të fortë në Industrinë Evropiane të Mbrojtjes në vitin 2007-të, ishte një nga deklaratat e fundit të politikës evropiane në lidhje me fushën e industrisë së mbrojtjes²⁰⁶. Edhe pse në mënyrë implicite pranon SES-in si një dokument strategjik që përcakton kornizën referuese të CS&FP deklaroi se një teknologji mbrojtëse dhe një bazë industriale janë elementët thelbësor për zbatimin e saj.

²⁰⁴European Commission, (2004), *Green Paper. Defense Procurement*, COM (2004) 608 Final, 23/09/2004, fq. 9-11

²⁰⁵<http://www.eda.europa.eu/genericitem.aspx?id=153>, aksesuar në dt.09.02.2015

²⁰⁶European Commission, (2007), *A Strategy for a Stronger and More Competitive European Defense Industry*, Final (2007) 764, 5/12/2007

Në një përpjekje për të përmirësuar konkurrencën e industrisë së mbrojtjes në plan afatgjatë është promovuar një seri propozimesh të cilat u miratuan, si: Direktiva për transferimin e armatimeve të mbrojtjes brenda komunitetit evropian²⁰⁷, Direktiva për prokurimin e produkteve të mbrojtjes²⁰⁸, përdorimi i standarteve të unifikuara²⁰⁹, një proces i vazhdueshëm i shkëmbimit të ideve mbi planifikimin e mbrojtjes nga terrorizmi dhe kërcënime të tjera për sigurinë dhe investimet e nevojshme, si dhe bashkëpunimi për programet R&D. Siç kuptohet lehtë, ky propozim i fundit bazohet në zbatimin e PASR, dhe i referohet fillimit (atëherë) të programit të sigurisë sipas Shtyllës së 7-të. Miratimi i këtyre udhëzimeve dhe direktivave është pjesë e të ashtuquajturës *Paketës së Mbrojtjes të BE-së nga terrorizmi dhe kërcënime të tjera*, dhe është pjesë e përpjekjes të përballimit të aspekteve të shumta të ndërlidhura në procesin e përcaktimit të politikës europiane teknologjike dhe industriale për çështjen e sigurisë dhe të mbrojtjes²¹⁰.

5.5. Një vështrim krahasues i kuadrit ligjor të mbrojtjes nga terrorizmi në shtete të ndryshme

5.5.1. Rasti i SHBA-ve.

Strategjia e Sigurisë Kombëtare në mënyrë të qartë theksoi faktin se infrastruktura institucionale ishte projektuar për një epokë të kaluar tashmë dhe nevojat

²⁰⁷ Per kete direktive [shiko. European Parliament, (2009), *Simplifying Terms and Conditions of Transfers of Defence-Related Products Within the Community*, Directive 2009/43/EC of the European Parliament and of the Council, 6 Maj 2009].

²⁰⁸ Per propozimin e hartimit te kesaj direktive [shiko European Commission, (2007), *On the Coordination of Procedures for the Award of Certain Public Works Contracts, Public Supply Contracts and Public Service Contracts in the Fields of Defence and Security*, Proposal for a Directive of the European Parliament and of the Council, COM (2007) 766 Final].

²⁰⁹ [shiko European Committee for Standardization, (2008), *European Handbook for Defence Procurement*, botimi 2-te, <http://www.defense-handbook.org/index.php?enregistrement=1>].

²¹⁰ European Parliament, (2006), *The Cost of Non-Europe in the Area of Security and Defense*, Directorate General for External Policies of the Union, Bonn International Centre for Conversion

nuk korrespondojnë me realitetin e ri. Strukturat e sigurisë, të cilat ishin zhvilluar për t'u përballur bllokun rival ideologjik, nuk janë në gjendje t'i përgjigjen rolit të ri të luftës kundër terrorizmit fetar si fenomen ndërkombëtar, sidomos kur grupet terroriste nën mbulesën e fesë kundërmorën sulmet terroriste brenda territorit të SHBA-ve²¹¹. Për të mirëmenaxhuar këtë realitet, përveç modernizimin të infrastrukturës ekzistuese të sigurisë institucionale dhe krijimin e të tjerave nqs vlerësohen si të nevojshme, financimi për sigurinë e brendshme u rrit me 61% nga 2002 deri në vitin 2010.

Tabela 7

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	Përqin (%)
										dje Rrit
										mbi je
										totalin nga
										për 200
										2010 2
										deri
										201
										0
DHS	17,3	23,0	22,9	24,5	26,5	29,5	32,4	38,9	32,8	46%
	81	63	23	49	71	54	86	88	07	
DOD*	16,1	8,44	7,02	17,1	17,5	16,5	18,0	19,4	19,0	27%
	26	2	4	88	10	38	32	83	41	

²¹¹President of the United States of America, (2002), *The National Security Strategy of The United States of America*, White House, Washington, fq. 29

HHS	1,91	4,14	4,06	4,22	4,35	4,32	4,30	4,67	7,22	10.3%
	3	4	2	9	2	7	1	7	8	
DOJ	2,14	2,34	2,18	2,76	3,02	3,51	3,52	3,71	4,10	5.8%
	3	9	0	7	7	8	8	5	7	
DOE	1,22	1,40	1,36	1,56	1,70	1,71	1,82	1,93	2,01	2.9%
	0	8	4	2	2	9	7	9	8	
DOS	477	634	696	824	1,10	1,24	1,71	1,80	1,76	2.5%
					8	2	9	9	7	
AG	553	410	411	596	597	541	575	513	599	0.9%
NSF	260	285	340	342	344	385	365	407	390	0.6%
VA	49	154	271	249	298	260	309	310	427	0.6%
DOC	116	112	125	167	181	205	207	272	254	0.4%
Sherbi	3,61	1,44	1,43	1,91	1,42	1,54	1,75	1,88	1,82	2.6%
me te	3	5	7	0	9	5	1	3	4	
tjera.										
Total	43,8	42,4	40,8	54,3	57,1	59,8	65,1	73,9	70,4	100%
	51	46	33	83	18	34	00	96	62	%

* = financimi i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2002 deri në vitin 2004 nuk përmban ato që kanë të bëjnë me financimin e shpenzimeve për sigurinë e brendshme brenda Min.Mbrojtjes²¹².

²¹²Tabela 7. Parashikimi Buxhetor Federal për Sigurinë e Brendshme për çdo ministri, institucion tjetër apo këshill të vecantë, për vitet 2002-2010, në \$.Burimi: CRS, (2010), Homeland Security Department FY2011 Appropriations, Congressional Research Service, R 41189, tabela B-1, fq. 79, <http://www.fas.org/sgp/crs/homsec/R41189.pdf>

Sulmi në territorin e SHBA-ve, tregoi nevojën absolute për eliminimin e vijës ndarëse mes sigurisë së jashtme dhe të brendshme, dhe gati imponoi te strukturat e sigurisë kapërcimin e kapricove administrative të rivalitetit, siç identifikohen këto të fundit nga modeli i burokracisë politike dhe grafiokratike, si dhe korrigjoi mangësitë në komunikimin mes shërbimeve të sigurisë, si ato që paraqiten në raport²¹³. Rezultati i këtij ristrukturimi administrativ, ishte krijimi i Drejtorisë Kombëtare të Inteligjencës [*National Intelligence (NI)*] si administratoren e gjashtëmbëdhjetë (16) shërbimeve të sigurisë²¹⁴, dhe krijimi i Departamentit të Sigurisë Kombëtare (DHS), i cila u themelua në vitin 2002 me qëllim të arritjes koordinim më të mirë ndërmjet shërbimeve dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Përgjegjësia për koordinimin dhe menaxhimin optimal të programeve kërkimore mbi aspekte të rëndësishme të sigurisë së brendshme të SHBA-ve në mënyrë që institucionet e përfshira të shfrytëzojnë frytet e R & D, i kaloi Drejtorisë Kombëtare të Inteligjencës (NI)²¹⁵. Krijimi i Drejtorisë së NI-së përtej zgjidhjeve që ofroi si një organ institucional përgjegjës për koordinimin e shërbimeve të sigurisë brenda në SHBA, rezultoi dhe një shembull që duhej të ndiqej dhe jashtë vendit. Kjo ndodhi me të paktën dy në mënyra. Njëra ka të bëjë me interkoneksionin dhe shkëmbimin e informacionit midis shërbimeve të sigurisë. Tejkalimi i pengesave midis sigurisë së brendshme dhe të jashtme ishte një kriter i rëndësishëm, nga momenti që dështimi i kesaj ndarje institucionale ishte pranuar tashmë nga të gjitha shërbimet e sigurimit. Mënyra e dytë ka të bëjë me përcaktimin e prioriteteve kërkimore. E rëndësishme në këtë drejtim, është arsyetimi që dha (atëherë) Drejtori i R & D të

²¹³National Commission on Terrorist Attacks Upon the United States, (2001), *The 9/11 Commission Report*, US Government Printing Office

²¹⁴Office of the Director of National Intelligence, (2009), *National Intelligence. A Consumer's Guide, Strategy*, Office of the Director of National Intelligence, fq. 21

²¹⁵Homeland Security Act of 2002, Pub. L. No. 107-296, (25 Nentor 2002)

Shtëpisë së Bardhë, përgjegjës për planifikimin e R & D të DHS, Penrose Albright, i cili deklaroi se mungesa e dakortësisë të kuptimit të rëndësisë të kërcënimit terrorist mes shteteve perëndimore, solli si pasojë nevojën imediate të krijimit të një institucioni, i cili do të vlerësonte rrezikun në mënyrë të koordinuar, si dhe një qasje strategjike ndaj standardeve për R & D në zonat e interesit²¹⁶. Me fjalë të tjera, drejtoria e R & D brenda DHS do të përcaktonte karakteristikat teknike, përparësitë teknologjike si dhe standardet në përputhje me të cilat strukturat përkatëse administrative të vendeve mike duhet të veprojnë ose të paktën të marrin parasysh interesat e përputhshmërisë teknologjike. Konstatimi i mësipërm është i rëndësishëm në atë që mund të hedhë dritë mbi presionin që u ushtrua për të zbatuar PASR. Megjithatë, siç e pamë në kapitullin e dytë, duhet të sqarohet se presioni është një aksiomë legjitime nga momenti që dhe përputhshmëria teknologjike e BE-së me SHBA përbënte kriter gjithmonë dominant në përcaktimin e politikës së teknologjisë evropiane. Ndjekje e ndryshimit të paradigmave teknologjik ishte dhe është një objektiv programor i DHS-se që risitë e zhvilluara të sigurojnë platformat e teknologjisë që do të miratohen nga shërbimet e sigurisë²¹⁷. Në shërbim të fuqizimit teknologjik, rritja e financimit të shpenzimeve për R&D në fushën e sigurisë së brendshme është një faktor kyç.

Tabela 8

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
AG	175	155	40	161	105	100	82	84
DOC	20	16	23	59	62	68	65	70

²¹⁶<http://www.aps.org/publications/apsnews/200605/international.cfm>, aksesuar në datë 2.06.2014.

²¹⁷US Department of Homeland Security, (2009), Basic Research Focus Areas, US Department of Homeland Security, fq. 2

DOD	259	212	267	1,079	1,270	1,175	1,398	1,670
DOE	50	48	47	67	68	71	70	81
DHS	317	861	1,171	1,368	1,387	1,016	1,010	1,096
EPA	95	70	52	33	52	92	54	64
HHS	15	1,020	21	21	0	104	103	285
NIH	162	1,633	1,703	1,774	1,827	1,828	1,837	1,885
NASA	73	73	88	89	93	83	102	108
NSF	229	271	321	326	329	371	351	358
DOT	106	7	3	2	3	1	2	2
Sherbime	48	47	32	42	41	47	20	21

te tjera

Krijimi i një Drejtorie të pavarur R&D, i shërben nevojave kërkimore të sigurimit të mjeteve të nevojshme për të arritur nivelin mbrojtës së lartpërmendur, jo vetëm për DHS dhe agjencive të tjera, veçanërisht DOE, të DoAg, DOC²¹⁸. Drejtoria R & D financon agjencitë e tjera qeveritare, universitetet dhe biznese në fushat e sigurisë detare dhe ndërkufitare, në fushat e kërcënimeve kimike dhe biologjike, në fushat e kontrollit dhe ndërveprimit të sistemeve të komunikimit, eksplozivëve, sjelljes njerëzore, si dhe në kontrollin e infrastrukturës. Buxhet për R&D për sigurinë, siç e pamë, nuk kanë vetëm shërbimet në rang ministrisht etj, të lidhura me njëra tjetrën konceptualisht, të tilla si DOD, ADSh, dhe DOE, por edhe shërbime si DoAg, DOC, HF-ve, DOT dhe organizata kombëtare të kërkimit, të tilla si NIH, NSF. Veçanërisht në shkencat e

²¹⁸Shea, D., Morgan, D., (2009), *The DHS Directorate of Science and Technology: Key Issues for Congress*, CRS Report for Congress, Congressional Research Service

shëndetit, Institutet Kombëtare të Shëndetit (NIH), rriti në mënyrë drastike financimin me objektiv bioterrorizmin nga 162 milion dollarë në vitin 2002, në gati 2 miliard në 2009. Me theks në hulumtimet translationale (*translational research*), trajtimi i patogjenëve të rrezikshëm dhe ngritja e qendrave rajonale të ekselencës për biodefencë dhe epidemitë²¹⁹. Duhet gjithashtu të theksohet krijimi, në përputhje me Ministrinë e Mbrojtjes, të HSARRA të DHS-së, e cila është komplementare e Drejtorisë së R&D, dhe qëllimi i saj është të zgjerojë kufijtë shkencorë për të siguruar zgjidhje në zonat ku teknologjitë aktuale dhe R&D nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat teknologjike²²⁰. Kuptohet natyrisht se krijimi i DHS-së për realizimin përkatës të R&D ka për objektiv atë pjesë të prioriteteve kërkimore që mbetën të paprekura nga prioritetet ushtarake dhe do të mund të bazohej në teknologjitë me përdorim të dyfishtë. Orientimi kryesor i DHS është kërkimi i aplikueshëm me theks në teknologjitë e konsoliduara dhe sistemet e teknologjive për përdorim të menjëhershëm operacional. Shuma e fondeve për kërkime të aplikueshme dhe të zhvillimit 2003-2009 është pothuajse gjashtë herë se financimi për kërkimet bazë²²¹. Kjo shpjegon faktin se DHS-ja u thirr për të trajtuar një realitet të ndryshëm teknologjik se sa ai që ishte krijuar tashmë. Për më tepër, DHS-ja ka ndërmarrë përgatitjen e pesë (5) sektorëve të sigurisë kombëtare²²²:

²¹⁹National Research Council, (2007), *Science and Security in a Post 9/11 World. A Report Based on Regional Discussions Between The Science and Security Communities*, National Academies Press, fq. 72

²²⁰http://www.dhs.gov/xabout/structure/editorial_0530.shtm, aksesuar ne date 19/7/2015

²²¹ Shih burimi CRS, (2009), *The DHS Directorate of Science and Technology: Key Issues for Congress*, Congressional Research Service, RL 34356, tabela 1, fq. 22, <http://www.fas.org/sgp/crs/homesecc/RL34356.pdf>. Aksesuar 20.07.2015

²²²US Department of Homeland Security, (2008), *One Team, One Mission, Securing Our Homeland, US Department of Homeland Security Strategic Plan Fiscal Years 2008-2013*, US Department of Homeland Security

a) mbrojtje nga terroristët përmes kontrollit efektiv të kufijve, zbatimi i ligjeve të emigracionit, rritjen e nivelit të kontrollit të udhëtarëve, b) mbrojtje nga materie të rrezikshme duke parandaluar sulmet Kimike, dhe nga tregtia e paligjshme,

c) mbrojtje e infrastrukturës kryesore duke e forcuar e përmirësuar atë, duke siguruar komunikimin e strukturës së qeverisë, përmirësimin e sigurisë kibernetike, përmirësimin e infrastrukturës së transportit,

d) rritje e efikasitetit të përballjes së emergjencave me anë të përgatitjes dhe kthimit të kapaciteteve në kushte normale (*recovery*),

e) integrimi i proceseve të menaxhimit brenda DHS-së përmes shkëmbimit të zgjeruar të informacionit midis departamentëve, dhe integrimi i politikave, planifikimit dhe operimit. Përmbledhja përshkruese nga fushat në të cilat DHS është ftuar të kontribuojë, specifikohet përballë kërcënimeve teknologjike dhe prioriteteve të R&D që do të adresojnë këto kërcënime²²³.

Aktivizimi i infrastrukturës institucionale në nivel federal, shtetëror dhe lokal në përgatitjen qeveritare për mbrojtjen kundër kërcënimeve terroriste dhe fatkeqësive natyrore (*psh, Uragane, rrjedhjet e naftës në det e në tokë*) është karakteristikë e një përpjekje të unifikuar për t'u përballur me këto kërcënime. Në të vërtetë, ky ridefinimi i përgjithshëm është një proces kompleks, i cili nuk mund të ndodhë brenda natës. Përkundrazi, kërkon një ndryshim në shembullin konceptual, që ky i fundit nuk është dhe i mirëqënë, dhe ndërsa i referohet diçkaje që ka ndodhur në 2001-shin, madje në fund të 2014-ës, hartuesit e QDDR theksojnë nevojën e njënacioni unifik të konceptit të

²²³US Department of Homeland Security, (2009), Basic Research Focus Areas, US Department of Homeland Security, fq. 6-7, http://www.dhs.gov/xlibrary/assets/st_basic_research_focus_areas_may_2009.pdf

sigurisë, dhe kërkojnë ndërprerjen e përdorimi të këtij koncepti ekskluzivisht në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes²²⁴. Kjo qasje e tërësishme nuk është e kufizuar vetëm në shumatorin e kërcënimeve, por dhe në përdorimin e produkte komerciale të tanishme (*Commercial-off-the-raft, COTS*) për qëllime të politikave sigurisë, sic mund të përmendim Crisis Mapping dhe Google Map për katastrofa humanitare²²⁵, si dhe një përballje ndërqeveritare (*whole-of-government*) për këto sfida të reja. Në përgjithësi, ky trajtim ndërinstitucional, dhe në nivel të teknologjisë përmes përdorimit të COTS për qëllime të sigurisë, dhe në nivel të institucioneve përmes një qasjeje ndërqeveritare, përbën në vetvete dhe shembullin dominant konceptual në përpjekjet e maksimizimit të sigurisë. Aktivizimi i pothuajse gjithë strukturës institucionale të R & D me objektiv arritjen e sigurisë, ofrohet për shumë diskutime. Unë do të qëndrojë në tre prej tyre: 1) siguria është një koncept që mund të interpretohet shumëfish, kështu që çdo strukturë institucionale në varësi të qëllimit themeltar të saj predispozohet të ketë përfaqshen e saj si dhe të rezervojë resurse financiare të vecanta për të realizuar projektet për R&D. Kjo do ishte dhe korrekte dhe në përputhje me modelin e burokracisë politike, sepse ajo ka treguar deri tani se pavarësia e infrastrukturës institucionale nuk mund të rekrutohet gjatë krizës në emër të unitetit kundër armikut të përbashkët, por përkundrazi zyrtarët qeveritarë dhe shërbimet shtetërore bëhen më të përkushtuar në sfond të mundësisë së humbjes së pushtetit dhe të influencës së tyre²²⁶, 2) Intensiteti i përpjekjeve, tregues i aktivizimit të pothuajse të gjithë infrastrukturës institucionale të SHBA-ve për të adresuar rrezikun, është tregues i qartë i karakterit dominues të kërcënimit, si ky

²²⁴Goodman, S., Edelman, E., (2010), *Security Can't Stop with DoD*, Defense News, 20/12/2010, fq. 21, (<http://www.defensenews.com/story.php?i=5274256>), aksesuar në datë 4.09.2014.

²²⁵ Shih termetet në Haiti, cunami në Azinë Juglindore, tërmeti i fundit në Nepal etj.,

²²⁶Rosenthal, U.Hart, P., Kouzmin, A., (1991), *The Bureau – Politics of Crisis Management*, *Public Administration*, vol. 69, fq. 211-233

perceptohet nga hartuesit amerikanë të politikave. 3) Përdorimi i teknologjisë është mjeti më i përshtatshëm në përpjekjet për parandalimin dhe çrrënjosjen e rrezikut terrorist. Gjithashtu është e qartë se kjo politikë teknologjike e SHBA-ve tregon shumë ngjashmëri me politikat teknologjike të ndjekura gjatë Luftës së Ftohtë, pra financimi për R&D për prodhim të produkteve të teknologjisë së lartë për të trajtuar kërcënimin. Prodhimi i këtyre produkteve teknologjike u promovua përmes një indii të komplikuar institucional. Përsa i përket këtij evidentimi, studimi dy vjeçar i gazetës Washington Post, tregoi se 45 agjensi qeveritare dhe 2000 kompani në 10.000 vende gjeografikisht të ndryshme janë të përfshira në programet që lidhen me antiterrorizmin dhe sigurinë e brendshme, fakt që bën pothuajse të drejta dy vërejtjet e mëposhtme a) pamundësinë e arritjes të konkluzionit përsa i përket efikasitetit të kësaj ndërmarrje ose me thjesht politike të zgjedhur. Cila është kostoja dhe cili është përfitimi? Paratë e taksapaguesve janë shpenzuar në mënyrën me efektive të mundshme? Shpenzimet për R&D kanë siguruar nivelin e dëshiruar të sigurisë? U arrit zhvillimi industrial dhe teknologjik i vendit përmes kësaj politike të teknologjisë dhe integritit të produkteve të reja teknologjike? b) ligjërimi funksional i departamenteve përkatëse, dhe shpenzimet e parave²²⁷. Ndryshimi i vetëm i rëndësishëm i periudhës të cilës i referohem nga ajo e Luftës së Ftohtë, është tipologjia e rrezikut që duhet të adresohet, nga kërcënimi i atëhershëm sovjetik tek kërcënimi terrorist²²⁸. Sipas një studimi të Kongresit amerikan, ndërsa buxheti i përgjithshëm për operacionet ushtarake pas fundit të Luftës së Dytë

²²⁷Top Secret America, *A Washington Post Investigation*, <http://projects.washingtonpost.com/top-secret-america/>, 19/8/2015

²²⁸ Tashmë dhe kjo po ndryshon përsëri në prioritetet për Sigurinë Kombëtare dhe ndërkombëtare. Zhvillimet e fundit në Krime të Ukrainës si dhe furnizimi me armë i separatistëve rusë në territorin Ukrainas, politikat e energjisë të ndjekura nga Rusia kundrejt Europës dhe SHBA-ve, zhvillimet politike në Bjellorusi etj, kanë provokuar reagimin e BE-së dhe SHBA-ve, me anë të sanksioneve në nivel ekonomik e tregtar kundër Rusisë. Mund të përmendim embargon e produkteve ruse si dhe kontrollin e kapitaleve financiare të kompanive më të fuqishme ruse në institucionet financiare perëndimore etj,.

Botërore arrinte në 1.1 miliardë dollarë (*duke numëruar Luftën Koreane, 1950-1953, dhe në Vietnam, 1965-1975*), përkatësisht lufta kundër terrorizmit, pas 11 shtatorit e në vijim deri në fund të vitit 2014 kalon 1.5 miliardë dollarë (*Irak 2003-2010, Afghanistan nga viti 2001 në vitin 2010, Filipinet, Kepi i Afrikës, Somalia, Siri, Liban, lufta kundër IS etj*²²⁹).

5.5.2. Rasti i Mbretërisë së Spanjës.

Karakteristikë e asaj cka është thënë më lart, është rasti i përballjes ligjore të "terrorizmit", në Spanjë. Që përpara luftës së dytë botërore, ligji penal spanjoll, favorizonte kryerësit e krimeve politike dhe sociale. Pra, sipas Kodit Penal të rishikuar në 1944-ën, krimet "terroriste" trajtohen si një kategori e veçantë e krimeve pasi një mundësi e përfshirjes së tyre në kategorinë e "krimeve sociale" në fund të fundit, padrejtësisht do t'i jepte kryerësit, statusin e privilegjuar të kriminelit politik. Dekreti legjislativ i 1975/9/28, i cili ishte titulluar "anti-terror", dekreti legjislativ 2/76 i datës 18 shkurt, të cilët përcaktuan juridiksionin nën të cilin do të ishte subjekt "krimi terrorist", dekreti legjislativ 21/78 i 30 qershorit në lidhje me krime të cilat janë konsumuar nga grupe të armatosura dhe, ligji 56/78 i 4 Dhjetorit të vitit 1978 i cili parashikonte dhe ndëshkonte manifestimin e "veprave terroriste" përbënin atëherë, sipas rregullave përpjekjet e para të pasluftës për të përballuar këtë fenomen. Por ligji 82/1978 ndryshon drejtimin, përjasjen e legjislacionit spanjoll kundrejt fenomenit të terrorizmit. Terrorizmi pushon se trajtuari si një krim i të drejtës tradicionale penale dhe merr pozitën që i takon (sipas meje e drejtë për atë kohë) në përputhje me perceptimin bashkëkohor dhe konceptimin psiokologjiko-ligjor, që është shtjelluar më lart në këtë tezë, që nuk është gjë tjetër vecse një metodë ushtrimi (dhe) praktikës politike me anë të

²²⁹Daggett, S., (2010), *Costs of Major U.S. Wars*, CRS Report for Congress, Congressional Research Service, fq. 2, tabela 1

akteve kriminale kundër jetës dhe pasurisë. Me bazë dmth, të kësaj llogjike të re të legjislacionit spanjoll, dënohet krimet e kryera vetëm për t'i shërbyer interesave terroriste. Por përfundimisht, kodi i ri penal spanjoll ndryshon përsëri orientimin dogmatik kur në nenet 560-564 parashikon dhe dënon përsëri "krimet terroriste". Në shkencën e Ligjit Penal spanjoll është theksuar se arsytet që çuan në realizimin e kthesës së parë të ligjit penal dhe braktisjen e teorisë për "*veprën terroriste*" dhe ishte si vijon:

a) pamundësia e një përcaktimi dogmatik, b) çështjet e "*teknikës penale*", që bënin të pamundur bashkimin në legjislacionin penal të kategorisë së vecantë të "*krimeve të tilla*",

c) dhe së fundi, fakti që kjo kategori "krimesh", nuk është asgjë me teper, por një sajese konstruktive bazuar ne elemente te paqendrueshem dhe lehtesisht te ndryshueshem. Shembulli spanjoll pohon se, ndërsa logjika e brendshme e Ligjit Penal kërkon sa më sipër, rikthimi te koncepti i "krimit terrorist" nuk mund të nenkuptoje vecse nga një ane braktisjen e kësaj logjike të brendshme penale që passjell detyrimisht dhe vetëkufizimin e ligjvënësit penal, dhe nga ana tjetër, gjithashtu ri-adoptimin e një kategorie krimesh jo-ekzistente (*sipas shkencës penale të zhvilluar deri në vitet 1980*), por në të njëjtën kohë duke qënë dhe nevojë epiktaktike ndaj teorive më kontradiktore nga ana e observatorëve të sundimit të ligjit, lejon në mënyrë të qartë zbatimin nga gjyqësori i zgjedhjeve politike të ekzekutivit i cili në këtë rast riorganizohet në përpjekjet që të rezultojnë eficente në luftën kundër terrorizmit.

KAPITULLI VI. SHQIPËRIA DHE TERRORIZMI

6.1. Hyrje

Edhe pse shumë besojnë se në Shqipëri nuk prekemi drejtëpërdrejtë nga terrorizmi, unë besoj se dhe ne nuk jemi të paprekshëm ndaj këtij fenomeni, sidomos në këto vitet e fundit. Toleranca dhe bashkëjetesa fetare ashtu dhe si e paraqesin mediat e huaja dhe shqiptarë²³⁰, janë të lidhura ngushtë me interesa individuale dhe të pranuar nga vetë ne si pjesë e kësaj shoqërie.

Toleranca fetare ishte e detyrueshme që të ndodhte pasi ishte jetike për vetë egzistencën e kombit shqiptar dhe si produkt evolucionar i historisë shqiptare. Pra, atë gjithmonë e kemi patur të pranishme në bashkëjetesën tonë, si për një apo për tjetrën arsye, si të mendohet se jemi si popull aq indiferent sa që nuk na ngjall kurrfarë interesi besimi fetar i tjetrit, si të besohet se jemi popull shumë liridashës, aq sa, e respektojmë lirinë si vlerë, pa parë se kujt i përket ajo, vetëm e vetëm se duam dhe kërkojmë që dhe ai të respektojë lirinë e tjetrit pa kufizime.

Ne vitin 1992 Shqipëria u bë vend anetar i Konferencës Islamike, një organizatë nderkombetare me natyrë islamike. Po në të njëjtin vit, qeveria e asaj kohe nënshkroi një marrëveshje me natyrë ushtarake rreth mundësive të krijimit të një aksi islamik që shtrihej nga Stambolli deri në Sarajevë. Por, në fakt, interesat e vendit tone ishin të një natyre thjesht pragmatiste dhe ekonomike, pa shume ngjyresa fetare. Edhe arsyeja

²³⁰ Ky mendim sa vjen e zbehet tashmë dhe në vendin tonë ku deri dje kënaqeshim me tolerancë fetare. Arrestimet në Tiranë dhe Kosovë të personave që rekrutojnë luftëtarë drejt Sirisë që të luftojnë për ISIS, janë bërë lajm i parë. Sipas një shkrimi mediatik (*portal online Lajmpress.com*), grupe terroriste janë krijuar në jug të Shqipërisë për çlirimin e Himarës, Sarandës, Dervicëanit, Dropullit, Jargucatit, Dhërmiut, Qeparoit dhe disa fshatrave.

kryesore për të cilën SHqipëria vendosi të anëtarsohej në Konferencën Islamike dhe për të forcuar marrëdhëniet me botën islamike ishin burimet e mëdha financiare që mund të kanalizoheshin në Shqipëri nëpërmjet investimeve në infrastrukturë, energji etj. Abu Omar, terroristi që ka qënë për disa vite në Shqipëri, në vitin 1995 ka pohuar: “Për ne anëtarët e Jamaat, Shqipëria ishte një hotel i sigurtë, një vend ku fundamentalistët islamikë besonin se mund të jetojnë pa frikë...” (Cituar nga gazeta “Chicago Tribune” e datës 3 Korrik 2005). Shqiptarët njihen dhe janë të informuar për këtë fenomen kaq të rrezikshëm që kërcënon në mënyrë direkte dhe indirekte shoqërinë tonë. Shumë klerikë të moderuar të fesë islame janë distancuar nga çdo akt dhune kundër jetës, pronës dhe rendit kushtetues, besimit fetar dhe të drejtave të pakicave komunitare duke mbajtur një qëndrim që përkon në mendimin se fundamentalizmi dhe terrorizmi në emër të Allahut është në fakt mohimi dhe largim nga vetë feja e vërtetë Islame²³¹. Terrorizmi nuk kursen askënd, madje as fëmijët muslimanë. Pra terrorizmi kërcënon të gjithë pa dallim, dhe atë duhet ta luftojmë të gjithë pa dallim. Ashtu sic ka deklaruar dhe ish Kryeministri Britanik Tony Blair në një intervistë në BBC “... terrori duhet të shkullet me rrënjë duke krijuar kushtet për një kuptim më të drejtë mes njerëzve

²³¹Shejkh Salih el-Feuzan, një prej anëtarëve të Komisionit të Dijetarëve të Përhershëm në Arabinë Saudite, u pyet: “A është e lejuar që të njoftohen autoritetet përkatëse në lidhje me disa individë për të cilët kemi dijeni se ata po i nxisin të rinjtë që të shkojnë (të luftojnë) në Xhihad dhe i furnizojnë ata me të holla pa lejen e prijësve; dhe çfarë këshille do t’u jepnit këtyre njerëzve?” Përgjigja që u dha ishte: “Së pari, ata duhen këshilluar. Nëse e pranojnë këtë këshillë dhe u japin fund këtyre aktiviteteve, atëherë elhamdulillah, e gjithë lavdia i takon vetëm Allahut. Nëse ata nuk e pranojnë këtë (këshillë), me qëllim që ata të parandalohen nga dëmtimi i Muslimanëve dhe fëmijëve të Muslimanëve, duhet të njoftohen (për sjelljen e tyre) ata që janë në krye të detyrës në mënyrë që t’i arrestojnë. Ky person i dërgon fëmijët Muslimanë në luftëra dhe në shkatërrim pa asnjë arsye të mirëqenë, kurse vet ulet këmbëkryq. Është e habitshme që disa prej tyre mbajnë hytbe në të cilat ndizen nga emocionet e tyre dhe i shtyjnë të rinjtë Muslimanë (për të shkuar në Xhihad) ndërkohë që vet ulen në shtëpi duke ngrënë e duke pirë për shtatë palë qejfe. E gjithë kjo është e papranueshme dhe e refuzuar, por kjo është veç një shembull nga paqëndrueshmëria e tyre.” Autor: Shejkh Salih el-Feuzan. Burimi: ‘*el-Ixhabaat el-Muhimmeh fil-Meshaakil el-Mulimmeh*’ (2/163), Marrë nga *Troid.org*, Perkthyer nga Alban Malaj.

të besimeve të ndryshme....”. Pra, duhet të kuptojmë se ekstremizmi fondamentalist i ka dhënë një emër të keq fesë islame në të njëjtën mënyrë si fanatikët gjatë fushatave të Kryqëzatave që luftuan dhe kryen krime kundër popullatave të përkatësive etnike dhe fetare të ndryshme në Europë dhe me gjere duke perdorur imazhin e krishtërimin në të kaluarën dhe duke interpretuar sipas interesave të ngushtë politike apo ekonomik personal (*të mbretërve, klerikëve e princave të ndryshëm*) atë cka përfaqëson krishtërimi. Nga ky këndvështrim, është e rëndësishme që elementët e moderuar të përballen me ekstremistët dhe të distancohen nga ata.

Në vendin tonë, nga ana tjetër, diversiteti fetar (i përfaqësuar nga myslimanët sunitë dhe ata bektashinj nga njëra anë, si dhe të krishterët ortodoksë e katolikë nga ana tjetër) ka parandaluar sipërmarrjen e projekteve kombëtare mbi baza fetare. Qytetarët shqiptarë të besimit mysliman e ri-zbuluan besimin e tyre fetar pas fundit të regjimit komunist, edhe pse nuk u vërejt një ri-islamizim i vendit. Gjatë viteve 1990-të, por edhe pas tyre, konflikti mes shqiptarëve dhe serbëve u ka ofruar terren të favorshëm penetrimit të elementëve ekstremistë islamikë në Ballkanin Perëndimor. Ngjarjet e luftës së vitit 1999 dëshmuuan përfshirjen e vullnetarëve muxhahedinë në radhët e UÇK-së, gjë e cila u përsërit edhe dy vite më vonë, në ngjarjet e vitit 2001 në Tetovë, në përplasjes me shqiptarëve dhe ushtrisë maqedonase. Nga ana tjetër, zhvillimet e fundit tepër interesante që janë zbuluar në Ballkan gjatë gjysmës së dytë të viteve 2000 kanë të bëjnë me përfshirjen e Hizbullahut në trafikun e armëve në Shqipëri dhe me rolin e Shqipërisë në një rrjet mjaft të ndërlikuar e të dendur të kësaj tregtie ndërkombëtare të jashtëligjshme, duke i dhënë përmasa tepër të rëndësishme gjeopolitike ndërlidhjes mes terrorizmit, krimin të organizuar, trafikut ndërkombëtar të armëve dhe përdorimit të këtyre elementëve nga shtete të ndryshëm për interesa gjeopolitike. Dalja në pah e

këtyre lidhjeve, bashkë me një sërë deklaratash të tjera që nënvizojnë ekzistencën e një çështjeje sigurie në lidhje me sa më sipër, ngjallën interesin e mediave të shumë vendeve ballkanike. Si dhe në rastin e Bosnjës, popullsia myslimane e Shqipërisë (rreth 70 %), rezulton një lloj magneti për thithjen e islamistëve që synojnë të fitojnë terren në Evropë. Kushtet nga të cilat Shqipëria u çlirua nga regjimi komunist në fillim të viteve 1990-të, dëshmuar ekzistencën e një vendi dikur totalisht të izoluar, një version Evropian i Koresë së Veriut sot. (Hide, 2015, 209). Tranzicioni nga një shtet i centralizuar drejt tregut të lirë dhe kapitalizmit ka qenë mjaft i vështirë, madje ende i papërfunduar. Nëse kësaj panorame i shtojmë edhe ringjalljen e fesë dhe doktrinafe fetare të mbytura për mbi gjysmë shekulli, atëherë kjo e bënte vendin lehtësisht të penetrueshëm edhe nga grupe të huaja fetare radikale.

6.2. Trajtimi ligjor sipas të drejtës penale shqiptare

Shqipëria, ndër detyrimet e saj në kuadër marrvëshjeve ndërkombëtare që ka nënshkruar, ka avancuar me një kuadër ligjor, të përshtatshëm dhe efikas për angazhimet e saj në luftën kundër terrorizmit dhe parandalimit të tij. Gjithashtu lufta kundër terrorizmit ka vendosur në një front Shqipërinë dhe vendet e rajonit, si Italinë, si iniciatore të ngritjes së një Task Force të përbashkët mes dy vendeve. Dy ministrat e Brendshëm, S. T. dhe A. A. kanë ndarë opinionin për të forcuar luftën kundër terrorizmit deri në ndërtimin e ekipeve të hetimit mes dy vendeve. Marrëveshja u arrit gjatë vizitës së ministrit Italian në 2015 në Tiranë. U adresua një çështje që tashmë është prioritare për mbarë rajonin, lufta e përbashkët kundër terrorizmit. Pas ngjarjeve në Paris sollën në qendër të vëmendjes çështjen e bashkëpunimit mes palëve (*shteteve të*

rajonit) por edhe me BE-në. Shqipëria ka një axhendë të ngjeshur në këtë pikëpamje, përse i përket radikalizmit fetar, apo dhe varfërisë dhe pakënaqësive sociale që detyrojnë qytetarët e saj të rekrutohen e tu bashkohen organizata terroriste në luftën në Siri, në krah të xhihadistëve të ISIS. U arrit marrvëshje për të përforcuar kapacitetet në këtë luftë të shpallur tashmë ngatë dy palët²³². Ndryshimet që vijuan në kodin penal, si ndryshimet dhe shtesat me ligjet 9086 dt. 19.06.2003, ligjin 9275 dt.16.09.2004, ligjin 9686 dt 26.02.2007 paten një rëndësi të vecante në luftën ndaj terrorizmit. Qeveria shqiptare miratoi me vendim Nr.1140, datë 30.7.2008 Strategjinë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve dhe terrorizmit. Hartimi i kësaj strategjie ishte jo vetëm një detyrim që rrjedh nga prioriteti që ka përcaktuar Shqipëria për të luftuar

²³² Shqipëria vazhdon të jetë një mbështetëse e fortë e përpjekjeve anti-terroriste dhe gjatë vitit 2014 u bë pjesë e Koalicionit Global kundër grupit të Shteti Islamik. Shqipëria i dhuroi një sasi të madhe armatimi dhe municioni luftëtarëve Peshmerga në veri të Irakut. Por gjithashtu, sipas raportit të DASH për vitin 2014, është një vend burim për luftëtarë të huaj terroristë që shkojnë në Siri dhe Irak. Legjislacioni shqiptar i dënon aktet terroriste, financimin e terrorizmit, transferimin e fondeve që financojnë terrorizmin, rekrutimin dhe trajnimin e individëve për të kryer akte terroriste, nxitjen, krjimin dhe pjesëmarrjen në organizata terroriste. Ndërsa organet e rendit në Shqipëri punojnë aktivisht për të zbuluar dhe penguar aktivitete të paligjshme që lidhen me drogat dhe trafiqet, ato ende nuk kanë të njëjtën qasje agresive për të përballuar kërcënimet e mundshme terroriste. Policia e Shtetit njoftoi plane në tetor të vitit 2014, për të zgjeruar ndjeshëm njësinë anti-terroriste. Trajnimi dhe pajisja e kësaj njësie do të ketë nevojë për përpjekje të konsiderueshme që ajo të arrijë nivelin e duhur të kapacitetit për të përballuar me efektivitet terrorizmin. Por vendi yne nuk ka kapacitetet për të grumbulluar të dhëna biometrike veç atyre të kartave të identitetit dhe pasaportave që paraqiten në pikat e kalimit kufitar. SHBA-te i kanë dhënë Shqipërisë një sistem të ri, i cili u jep mundësi autoriteteve të inkorporojnë funksionet e identifikimit on-line të shenjave të gishtave. Po ashtu Shqipëria është duke marrë teknologji për të përpunuar shenjat e gishtave në të 26 pikat e kalimit kufitar. Teknologjia e kontrollit në kufi do t'i lejojë autoritetet të grumbullojnë të dhëna gjatë hyrjeve dhe daljeve të udhëtarëve. Ka miratuar nisma kundër personave dhe organizatave të përfshira në listën e OKB-së si financuese të terrorizmit dhe ka krijuar një sistem parandalues kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që e detyron atë të raportojë transaksione të dyshimta. Është anëtare e Grupit të Punës për Veprimet Financiare (FATF), një nismë rajonale. Aktualisht ky grup e rendit Shqipërinë si një vend me rrezik të lartë dhe jo-kooperues. Shqipëria po bashkëpunon me me FATF-in, për të përmirësuar këto dobësi. Qeveria e Shqipërisë i jep ndihmë financiare Bashkësisë Islame dhe bashkëpunon me të aktivisht për të diskutuar rreth radikalizimit dhe rekrutimit të individëve për synime terroriste. Burimi: <http://botasot.info/shqiperia/418312/pjese-nga-raporti-i-dash-it-per-terrorizmin/>, aksesuar në datë 29.06.2015.

krimin e organizuar dhe gjithë format e shfaqjes së tij dhe terrorizmin, por edhe nga nevoja e implementimit të detyrimeve që dalin nga strategjia rajonale e miratuar në Brijuni, pra, për të harmonizuar e koordinuar më mirë gjithë strategjitë e veçanta të miratuara apo që janë në proces miratimi deri tani. Kjo strategji përcaktoi prioritetet strategjike të luftës kundër krimit të organizuar, objektivat e gjithë institucioneve që marrin detyrime në luftën kundër krimit të organizuar si dhe harmonizimin e veprimeve ndërinstucionale për arritjen e objektivave. Objektivat kryesore që mund të përmendim këtu janë: të identifikojë gjerësisht fenomenin e krimit të organizuar dhe fenomenet e tjera pjesë e kësaj strategjie, duke bërë një analizë thelbësore të shkaqeve e faktorëve të zhvillimit; të pasqyrojë veprimtarinë institucionale të gjithë aktorëve që marrin detyrime për luftën kundër krimit të organizuar; të diagnostifikojë gjendjen në të cilën ndodhet vendi ynë, kryesisht nëpërmjet dokumenteve, medias apo informacioneve të institucioneve ndërkombëtare; të përcaktojë prioritetet e objektivat që do të arrihen në minimizimin e krimit të organizuar, duke përmendur format kryesore të shfaqjes së krimit të organizuar; të përcaktojë masat që duhet të merren nga institucionet e ndryshme për arritjen e objektivave; të përcaktojë rrugët e monitorimit të implementimit të strategjisë; të përcaktojë nevojat financiare apo burimet e mundshme financiare për realizimin e aktiviteteve në funksion të implementimit të kësaj strategjie apo strategjive të tjera sektoriale.

Po ashtu, është miratuar në vitin 2013 Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të paligjshme dhe Terrorizmit për vitet 2013-2020. Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit nuk duhet parë dhe kuptuar thjesht si përgjegjësi vetëm e policisë së shtetit. Partneriteti midis aktorësh të ndryshëm është element shumë i domosdoshëm i efikasitetit të kësaj lufte. Prandaj dhe strategjia merr

përsipër të bëjë ndarjen e detyrave e masave që do të merren nga institucionet e ndryshme. Natyrisht pesha më e madhe e përgjegjësisë dhe e veprimtarisë sinjikative për treguesit e luftës i mbetet Policisë së Shtetit, e cila duhet të realizojë edhe përqëndrimin e informacionit dhe shpërndarjen e saj sipas objektivit të punës së secilit aktor. Aktualisht, Shqipëria është pjestare në një sërë nismash rajonale e më gjerë si dhe është anetare e organizatës SECI, Interpol; gjithashtu ka ratifikuar e nënshkruar një sërë konventash e marrëveshjesh ndërkombëtare²³³.

Lufta kundër krimit të organizuar mbetet një ndër prioritetet më kryesore të veprimtarisë së institucioneve që kanë detyrime, ashtu dhe Policisë së Shtetit. Kjo e lidhur me vetë pasojat dhe rrezikshmërinë e lartë shoqërore që ka ky fenomen. Krimi i organizuar në vetvete përmbledh shumë aspekte të veprimtarisë kriminale dhe kjo strategji do të bëjë të mundur të vlerësojë situatën, identifikimin e problemeve, si dhe përcaktimin e masave dhe formave të reja që do të përdorin gjithë institucionet kundër këtij fenomeni.

Prioritet e këtij dokumenti u identifikuan duke marrë në konsideratë prioritet qeverisëse, detyrimet që rrjedhin nga strategjia sektoriale e Policisë së Shtetit, detyrimet që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Zbatimit të MSA-se dhe Plani i Veprimit për Anëtarësim në NATO, detyrimet e strategjive të tjera që janë në fazën e implementimit dhe që janë hartuar për luftën kundër formave të veçanta të shfaqjes së krimit të organizuar, si ajo kundër drogës, kundër trafikëve të qënieve njerëzore, strategjia

²³³ Nisur nga sa më sipër dhe nga analiza e faktorëve politiko-socialë, ekonomike, ligjore e teknologjike, si prioritete kryesore të policisë së shtetit në luftë kundër krimit të organizuar do të jenë: 1. Lufta kundër drogave; Lufta kundër trafikëve të paligjshme dhe konkretisht; Lufta kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe kontrabandimit të njerëzve; Lufta kundër trafikimit të armëve; Lufta kundër trafikimit të makinave të vjedhura; Lufta kundër trafikimit të veprave të artit; Lufta kundër pastrimit të parave dhe korrupsionit. **Lufta kundër terrorizmit.**

antiterror etj., si dhe nisur nga impakti që kanë këto dukuri dhe lufta kundër tyre mbi shoqërinë shqiptare dhe në imazhin e vendit tonë tek partnerët ndërkombëtarë.

Është e rëndësishme që të theksojmë që në pjesën hyrëse të këtij dokumenti, se lufta kundër krimit të organizuar kërkon vizion, përcaktim objektivash dhe burimesh të nevojshme si dhe aftësi për të trajtuar këtë fenomen. Kjo strategji sjell metoda dhe modele të reja në menaxhimin e këtyre burimeve si dhe rritje të aftësive të punojësve të policisë që merren me luftën ndaj këtij fenomeni.

Si konkluzion, ambicia e organizatës së policisë dhe e gjithë institucioneve të tjera që kanë detyrime në këtë drejtim, është dhe do të mbetet, që nëpërmjet implementimit të këtyre objektivave e zbatimit të masave të parashikuara në këtë strategji si dhe në strategjitë e tjera sektoriale, ta bëjë Shqipërinë një vend të sigurt dhe tërheqës, si dhe të përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve. Paska se në këtë dokument përcaktohen objektiva të shumtë dhe ndër të tjera dhe lufta kundër terrorizmit, kjo nuk e bën atë (terrorizmin) aspak një prioritet dytësor. Ndërlidhja e veprimtarisë kriminale shumë herë bëhet për të arritur një objektiv të caktuar, përvec përfitimeve ekonomike, dhe atë të presionit të ushtruar ekzekutivit të një shteti apo organizate (si mund të jetë BE-ja). Dihet që dhe organizatat terroriste, për të realizuar operacione luftarake, të organizojnë sulme vetëvrasëse, sulme me armë biologjike²³⁴ etj duhet që të kenë burime

²³⁴ Një raport i ri i publikuar në Washington në vitin 2010, analizon reagimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj kërcënimit të bio-terrorizmit, pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit. Sipas raportit, vendi ka përparuar, por ka ende shumë punë për të bërë. Në fakt, armët biologjike janë përdorur shumë rrallë. Por menjëherë pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001, letra që përmbanin antraks iu dërguan 5 organeve amerikane të mediave dhe zyrave të dy senatorëve amerikanë. 5 persona humbën jetën nga infektimet me antraks dhe 22 të tjerë patën infeksione nga kontakti i antraksit me lëkurën. Nuk është përcaktuar përfundimisht se cili ishte personi përgjegjës, apo nëse ishte vepër e një terroristi, ose grupi terrorist. Një grup terrorist ishte përgjegjës për një sulme me armë kimike në Tokio në vitin 1995. 12 persona u vranë dhe mijëra të tjerë u plagosën kur një grup budist japonez, Aum Shinrikyo lëshoi gaz nervor sarin në një metro. Sulmi shkaktoi shumë dëme dhe një traumë psikologjike në Japoni. Por megjithëse ka patur disa incidente të rënda, ato janë përjashtime. Që pas sulmeve të 11 shtatorit,

financiare të qëndrueshme dhe relativisht të mëdha. Kjo arrihet duke u përfshirë këto organizata në veprimtari të tjera kriminale, përveç terrorizmit²³⁵, për të financuar logjikisht këtë të fundit. Trafiku i drogës, rrëmbimet e personave dhe kërkesa kolosale për shpërblim²³⁶, trafikimi i qenieve njerëzore, vecanërisht grave²³⁷, vënia nën kontroll e burimeve të naftës me anë të pushtimit të tyre²³⁸, kontrabanda e mallrave etj, janë disa

Shtetet e Bashkuara kanë intensifikuar përpjekjet për të përmirësuar aftësitë për zbulimin e armëve kimike dhe biologjike dhe për t'u mbrojtur ndaj tyre. Por kjo është një sfidë. Objektet e përdorura për prodhimin e agentëve përbërës së armëve kimike dhe biologjike, mund të përdoren edhe për veprimtari të ligjshme. Në vitin 1998 Shtetet e Bashkuara hodhën në erë këtë kompleks farmaceutik në Sudan, pasi besonin se po prodhonte një përbërës të një gazi nervor dhe ishte e lidhur në një farë mënyre me projektet për armë kimike të Irakut, diçka që nuk u provua kurrë. Shumë ekspertë armësh thonë se kërcënimi që paraqesin armët kimike, apo biologjike është shumë më i vogël se ai i armëve bërthamore, ose armëve të lehta, të cilat përcaktohen përgjithësisht si armë që mund të mbahen nga një ose dy njerëz. Këto armë vrasin shumë më tepër njerëz sesa ato që ngjallin më shumë frikë, armët kimike dhe biologjike të shkatërrimit në masë. Burimi <http://www.zeriamerikes.com/content/a-30-a-2005-01-02-2-1-85599982/421457.html>, aksesuar në datë 2.12.2014.

²³⁵ Për këtë arsye dhe në perceptim të drejtë të këtij realiteti, parlamenti shqiptar, në kuadër të obligacioneve të shtetit shqiptar në luftën kundër terrorizmit, miraton ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008, 'Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit'.

²³⁶ Ekspertja e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Yotsna Lalji, që i monitoron sanksionet kundër organizatave terroriste, ka deklaruar se grupi terrorist "Shteti Islamik" ka përfiturar deri në 45 milionë dollarë amerikanë si haraç gjatë vitit të kaluar. Lalji raportoi para Komitetit të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Antiterrorizëm. Ajo raporton se vlerësohet se 120 milionë dollarë haraç u janë paguar grupeve terroriste në periudhën 2004-2012, për lirim të personave të rrëmbyer. Ajo theksoi se në vitet e fundit, Al-Qaeda dhe grupet e afërta me të, rrëmbimin e njerëzve e kanë bërë bazë të taktikës për krijimin e të ardhurave. Raportuesja Lalji ka përmendur një rast të tetorit të vitit 2012, të incizuar ku dëgjohej lideri i Al-Qaedas, Ayman al-Zaëahri, duke nxitur militantët në gjithë botën për rrëmbimin e perëndimorëve. Burimi http://lajmpress.com/lajme/bota_rajoni/42945.html, aksesuar ne date 5.08.2015.

²³⁷ Gjatë muajve të fundit Shteti Islamik ka rrëmbyer me qindra gra e vajza. Shumë pak prej tyre kanë arritur të shpëtojnë ndërsa kanë treguar sesi përdhunohen prej militantëve të ISIS, sesi janë shtrënguar në martesë të padëshiruara dhe një pjesë janë kthyer në skllave seksuale. Duke sjelle rastin e një 15-vjeçare te komunitetit jazidi, të rrëmbyer në Irakun verior, "Zëri i Amerikës" tregon se adoleshenti e kanë detyruar të martohej me luftëtarë të ndryshëm. Vajza arriti t'i shpëtonte ferrit të përjetuar pasi drogoi rrëmbyesit me substanca që gjeti në banesën ku e mbanin të burgosur. Ajo rrëfen se e kanë shitur bashkë me dy vajza të tjera, të cilat më vonë i kanë dërguar në Mosul. Burimi <http://www.lapsi.al/lajme/2014/11/01/skllavet-e-isis-rr%C3%ABfejn%C3%AB-tmerrin>, aksesuar në datë 3.09.2014.

²³⁸ Shteti Islamik i Irakut dhe Levantit, ose siç njihet nga e gjithë bota, ISIS, është organizata terroriste më e pasur dhe më e madhe e historisë. Është një sipërmarrje e vetfinancuar, e cila ka arritur në vlerën e 2 miliardë dollarëve dhe për nga sofistikimi financiar mund të konkuronte edhe Wall Street-in. Të ardhurat e jashtëzakonshme të ISIS janë mbledhur falë zhatjeve, rrjeteve të krimit, rrëmbimeve, naftës dhe

nga veprimtaritë e tyre. Goditja dhe lufta kundër këtyre fenomeneve kriminale, sigurisht që do të rezultonte eficiente në përballjen me terrorizmin, si strategji në parandalim të tij. Pamundësia e grupeve terroriste për likuiditet financiar, do të conte dhe në pamundësi për rekrutim mercenarësh, pajisje me armatime, akses dhe përdorim i teknologjive inovative etj.

6.2.1. Analize e dispozitave të Kodit Penal shqiptar.

Në përshatje të situatës aktuale ku jetojmë dhe nevojës së imponuar nga zhvillimet globale, ishte absolutisht e nevojshme edhe rishikimi i dispozitave të Kodit Penal me qëllim sanksionimin e veprave penale që lidhen me terrorizmin. Dispozitat në fjale janë të grupuara në Kreun VII - Vepra me qëllime terroriste (Ndryshuar titulli me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 14) Neni 230 i K.P sanksionon shprehimisht: “Kryerja e veprave të mëposhtme, me qëllim përhapjen e panikut në popullatë ose për të detyruar organe shtetërore, shqiptare ose të huaja, të kryejnë ose të mos kryejnë një akt të caktuar, ose për të shkatërruar apo destabilizuar, në mënyrë serioze, struktura thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të shtetit shqiptar, të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.” Sipas legjislacionit shqiptar veprat me qëllime terroriste përfshijnë: a) veprat kundër personit, të cilat mund të shkaktojnë vdekjen ose plagosjen e rëndë; b) rrëmbimin e avionëve, të anijeve, të mjeteve të tjera të transportit apo të platformave fikse ose ushtrimin e paligjshëm të kontrollit mbi to, me

donacioneve të ndryshme. Organizata kontrollon disa nga qytetet më të mëdha të Irakut, të cilin e ka pushtuar vetëm brenda tre ditësh. Ndërkohë që mban nën kontroll shumë qytete të tjera dhe vazhdon të kërcënojë një pjesë të mirë të Irakut dhe të Sirisë. Organizata ka krijuar një ushtri të vogël me një përzjerje luftëtarësh të huaj dhe të vendit, ka ngritur operacione të rafinimit dhe trafikimit të naftës, madje mbledh edhe taksat. Burimi http://www.rilindjademokratike.com/index.php?option=com_content&view=article&id=15560:2015-01-24-22-52-12&catid=48:culture&Itemid=108, aksesuar në datë 07.07.2015.

dhunë ose nëpërmjet kanosjes për përdorimin e dhunës apo me anë të çdo forme tjetër kanosjeje; c) kryerjen e akteve të dhunës kundër një personi në bordin e një avioni në fluturim, në bordin e një anijeje ose në bordin e një platforme fikse, kur këto akte mund të rrezikojnë sigurinë e avionit, të mjetit të lundrimit ose të platformës fikse; ç) shkatërrimin e një avioni në funksionim, të një anijeje apo të një platforme fikse ose shkaktimin e dëmeve të tilla avionit, anijes a ngarkesës së saj ose platformës fikse, që e bëjnë të pamundur ose rrezikojnë a mund të rrezikojnë sigurinë e fluturimit, të lundrimit ose të platformës fikse; d) vendosjen, me çdo mjet, në një avion në shërbim, në një anije ose në një platformë fikse, të një pajisjeje a substance që mund të shkatërrojë avionin, anijen a platformën fikse ose që mund t'i shkaktojë dëme avionit, anijes a ngarkesës së saj ose platformës fikse dhe që rrezikon a mund të rrezikojë sigurinë e fluturimit, lundrimit të anijes ose të platformës fikse; dh) shkatërrimin ose dëmtimin e pajisjeve të fluturimit apo të pajisjeve të lundrimit detar ose ndërhyrjen në funksionimin e tyre, kur nga një akt i tillë mund të rrezikohet siguria e avionit apo e anijes; e) përhapjen e informacioneve që dihet se janë të pavërteta, duke rrezikuar sigurinë e një avioni në fluturim apo të anijes në lundrim; ë) vrasjen ose rrëmbimin e një personi të mbrojtur ndërkombëtarisht, sipas nenit 9 të këtij Kodi, ose çdo sulm tjetër ndaj tij ose lirisë së tij; f) sulmin e dhunshëm ndaj zyrës, banesës private ose mjetit të transportit të personit të mbrojtur ndërkombëtarisht, sipas nenit 9 të këtij Kodi, kur prej këtij sulmi rrezikohet personi ose liria e tij; g) pengmarrjen ose rrëmbimin e personit dhe kanosjen për të vrarë, për të plagosur ose për të vazhduar mbajtjen e tij peng; gj) marrjen në dorëzim, posedimin, përdorimin, transferimin, tjetërsimin, disponimin ose përhapjen e materialit bërthamor, me dashje dhe pa qenë i autorizuar ligjërisht, kur i shkaktohet ose mund t'i shkaktohet vdekja ose dëmtime të rënda çdo personi ose të

dëmtohet rëndë prona; h) vjedhjen, përvetësimin ose përfitimin nëpërmjet mashtrimit të materialeve bërthamore; i) kërkimin e materialeve bërthamore, duke përdorur shtrëngimin, dhunën ose çdo formë tjetër kanosjeje; j) prodhimin, mbajtjen, blerjen, transportin apo tregtimin e lëndëve plasëse, të armëve të zjarrit, biologjike, kimike apo bërthamore, si dhe kërkimin shkencor për prodhimin e armëve të shkatërrimit në masë; k) kryerjen e akteve të dhunës, duke përdorur çdo pajisje, substancë ose armë, kundër një personi në një aeroport të aviacionit civil ndërkombëtar, kur këto akte shkaktojnë ose mund të shkaktojnë dëmtime të rënda ose vdekjen e personave; l) shkatërrimin ose dëmtimin e rëndë të mjediseve apo të pajisjeve në një aeroport të aviacionit civil ndërkombëtar ose në një avion të vendosur në këtë aeroport që nuk është në fluturim ose ndërprerjen e shërbimeve të aeroportit, duke përdorur çdo pajisje ose armë, kur nga ky akt rrezikohet a mund të rrezikohet siguria e aeroportit; ll) përhapjen, vendosjen, shkarkimin ose shpërthimin e lëndëve plasëse ose të pajisjeve të tjera vdekjeprurëse, në mjedise publike, në zyrat e një shteti ose qeverie, sistemin e transportit publik ose në infrastrukturën publike, si dhe shpërndarjen në mjedis të substancave të rrezikshme, shkaktimin e zjarreve, të përmytjeve, shpërthimeve, me qëllim shkaktimin e vdekjes ose dëmtimeve të rënda trupore ose me qëllim shkaktimin e shkatërrimeve masive të vendeve, mjediseve ose sistemeve të lartpërmendura, kur ky shkatërrim sjell a mund të sjellë humbje të mëdha ekonomike; m) shkatërrimin e rëndë dhe në përmasa të mëdha të pronës publike, të infrastrukturës publike, të sistemit të transportit, të sistemit të informacionit e të pronës private, duke rrezikuar jetën e personave; n) shkaktimin e ndërprerjes së furnizimit me ujë, energji elektrike ose çdo burim tjetër të rëndësishëm, apo çdo vepër tjetër që synon të shkaktojë vdekjen ose plagosjen e rëndë të civilëve ose të çdo personi tjetër që nuk merr pjesë aktive në veprimet luftarake në një situatë

konflikti të armatosur, e kryer për qëllimet e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni. Veprimet që shkaktojnë ndërprerjen e një shërbimi të rëndësishëm, një sistemi, një veprimtarie publike ose private, si rezultat i protestës, i mosbindjes civile, ose i grevës, nuk do të konsiderohen vepra me qëllime terroriste në kuptimin e këtij neni. Ligjvënësi penal shqiptar, në Kodin Penal, sanksionon disa vepra penale, atë që për thjeshtësi këtu do e përmendim si ‘‘veprën penale të terrorizmit’’. Kjo duke dalë nga korniza e traditës penale shqiptare, nga momenti që nuk kemi të bëjmë me një vepër penale ‘‘tradicionale’’. Ajo që duhet patur parasysh, është se gjatëfazës së zbatimit të këtyre dispozitave, në rastet konkrete por dhe në praktikën e strategjitë e parandalimit të fenomenit, duhen të respektohen me rigorozitet të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të sanksionuara në kushtetutën shqiptare dhe në Konventën të Drejtave të Njeriut dhe Protokollin që pasojnë atë²³⁹.

²³⁹ Neni 230/a Financimi i terrorizmit (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012)_Dhënia ose grumbullimi i fondeve, me çdo mjet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me qëllimin që ato të përdoren ose duke ditur se ato do të përdoren, plotësisht ose pjesërisht:_a) për të kryer vepra me qëllime terroriste;_b) nga një organizatë terroriste;_c) nga një terrorist i vetëm dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dhe me gjobë nga pesë milionë lekë gjer në dhjetë milionë lekë._Dispozitat e këtij neni zbatohen:_a) për të gjitha fondet, ku përfshihen pasuri të çdo lloji, të trupëzuara ose të patrupëzuara, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht nga mënyra e fitimit të tyre, dhe dokumente ligjore ose instrumente të çdo lloji, edhe në formë elektronike ose digjitale, që tregojnë të drejta ose interesa mbi pasuri të tilla, përfshirë kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, bonot, çeqet e garantuara bankare, letrat e kreditit, si dhe çdo instrument tjetër financiar, të ngjashëm me to;_b) pavarësisht nëse personi që kryen një nga veprat e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, ndodhet në të njëjtin shtet a në një shtet të ndryshëm nga ai, në të cilin ndodhet organizata terroriste a terroristi i vetëm ose nga shteti në të cilin është kryer a do të kryhet vepra me qëllime terroriste;_c) në rastin e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni, pavarësisht nëse fondet janë përdorur në fakt për të kryer veprën ose veprat, për të cilat ishin dhënë ose grumbulluar, apo nëse mund të vendoset një lidhje mes fondeve dhe një apo më shumë veprave konkrete me qëllime terroriste. Dijenja dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive._Neni 230/b_Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin_(Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 16)_Transferimi, konvertimi, fshehja, lëvizja ose tjetërsimi i fondeve dhe i pasurive të tjera, ndaj të cilave zbatohen masat kundër financimit të terrorizmit, për të shmangur zbulimin dhe vendndodhjen e tyre, dënohen me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtëqind mijë deri në gjashtë milionë lekë._Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në tetë milionë lekë, ndërsa kur kryerja e kësaj vepre

ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga pesë milionë deri në dhjetë milionë lekë. *Neni 230/c Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit* (Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 16) Vënia në dijeni e personave të shpallur ose e personave të tjerë për të dhënat për verifikimin ose hetimin e fondeve dhe pasurive të tjera, ndaj të cilave zbatohen masa kundër financimit të terrorizmit, nga persona që ushtrojnë funksione publike ose që janë në ushtrim të detyrës a profesionit, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në pesë milionë lekë. *Neni 230/ç Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur* (Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 16) Dhënia e fondeve dhe pasurive të tjera, kryerja e shërbimeve financiare, si dhe e transaksioneve të tjera me persona të shpallur, ndaj të cilëve zbatohen masa kundër financimit të terrorizmit, dënohen me burgim nga katër deri në dhjetë vjet dhe me gjobë nga katërqind mijë deri në pesë milionë lekë. *Neni 230/d Grumbullimi i fondeve për financimin e terrorizmit* (Shtuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 16) (Shfuqizuar me ligjin nr. 23/2012)_Grumbullimi i mjeteve financiare të çdo lloji, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për financimin e organizatave ose kryerjen e veprave me qëllime terroriste, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtëqind mijë deri në gjashtë milionë lekë.

Neni 231_Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllimeve terroriste ose të financimit të terrorizmit (Ndryshuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 17)_Rekrutimi i një ose më shumë personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit, edhe kur këto vepra drejtohen kundër një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim jo më pak se dhjetë vjet. *Neni 232_Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste* (Ndryshuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 18)_Përgatitja, stërvitja dhe dhënia në çdo formë e udhëzimeve edhe në mënyrë anonime ose në rrugë elektronike, për prodhimin ose përdorimin e lëndëve eksplozive, armëve të zjarrit dhe municioneve luftarake, të armëve të tjera dhe lëndëve kimike, bakteriologjike apo bërthamore ose të çdo natyre tjetër, të dëmshme dhe të rrezikshme për njerëzit dhe pasurinë, si dhe të teknikave e të metodave të tjera për kryerjen e veprave me qëllime terroriste dhe pjesëmarrja në veprimtari të tilla, edhe kur këto vepra drejtohen kundër një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohen me burgim jo më pak se shtatë vjet.

Neni 232/a Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste (Shtuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 19) Nxitja, thirrja publike, shpërndarja e shkrimeve ose propaganda në forma të tjera, që synon mbështetjen ose kryerjen e një apo më shumë veprave për qëllime terroriste dhe për financimin e terrorizmit, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet. *Neni 232/b Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste* (Shtuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 19)

Kanosja serioze për kryerjen e veprave për qëllime terroriste, që i bëhet një autoriteti publik, edhe të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, dënohet me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet. *Neni 233 Krijimi i turmave të armatosura* Krijimi i turmave të armatosura për t'iu kundërvënë rendit publik me anë të veprimeve të dhunshme ndaj jetës, shëndetit, lirisë vetjake të personit, pasurisë, me qëllim ngjalljen e frikës e të pasigurisë në masë, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet. *Neni 234 Prodhimi i armëve luftarake* Prodhimi, mbajtja, transportimi i armëve luftarake, kimike, biologjike, bërthamore, me bazë helmuese ose eksplozive, me qëllim për të kryer vepra terrori, dënohen me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. *Neni 234/a Organizata terroriste* (Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 17) Krijimi, organizimi, drejtimi dhe financimi i organizatës terroriste dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet. Pjesëmarrja në organizata terroriste dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 234/b Banda e armatosur (Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 17) Krijimi, organizimi, drejtimi dhe financimi i bandës së armatosur dënohen me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Pjesëmarrja në bandën e armatosur dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Qe nga hyrja në fuqi e Kodit Penal të vitit 1995, vepra penale e parashikuar nga neni 230 i K.Penal, “Vepra me qëllime terroriste” ka pësuar dy ndryshime, përkatësisht me anë të nenit 15 të ligjit nr. 9686, datë 26.02.2007 “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, si dhe me anë të nenit 27 të ligjit nr.23/2012, datë 01.03.2012 “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Në një rast, në momentin e kryerjes së veprës penale nga i gjykuari D. (data 30.12.2011), ligji i aplikueshëm i kohës ishte K.Penal me ndryshimet e vitit 2007. Ligji penal i kohës, ndërkohë që listonte llojet e veprave me qëllime terroriste, me shprehjen ‘Veprat me qëllime terroriste përfshijnë, por nuk kufizohen në [...]’ e linte të hapur mundësinë që vepra të tjera të mund cilësoheshin si me qëllime terroriste sipas nenit 230, por gjithmonë nëse kushtet e tjera të përcaktuara në lidhje me qëllimin e veprës penale do të plotësoheshin. Ky formulim ishte transpozimi pothuajse i plotë i Vendimit Kuadër të Këshillit të BE-së i 13 Qershorit mbi Luftimin e Terrorizmit,²⁴⁰ si dhe i Konventës Ndërkombëtare për Shtypjen e Financimit të Terrorizmit.²⁴¹ Me ndryshimet e vitit 2012, lista e mësipërme e veprave të cilësuar si me qëllime terroriste do të mbyllej dhe do të shtohet me shumë raste të tjera. Tani me, si masa e dënimit, ashtu edhe dispozita përkatëse, psh., germa “e” e nenit 230 e K.Penal (shkaktimin e ndërprerjes së furnizimit me ujë, energji elektrike ose çdo burim tjetër të rëndësishëm) gjendet tanimë në germën “n” të nenit 230 të K.Penal.

Elementet e anës objektive (*actus reus*) dhe të anës subjektive (*mens rea*) përbërës të figurës kriminale të veprës me qëllime terroriste kanë mbetur të pandryshuar.

²⁴⁰ 2002/475/JHA, e disponueshme në <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32002F0475>

²⁴¹ United Nations, Treaty Series, vol. 2178, p. 197.

Në lidhje me anën objektive, vepra me qëllime terroriste kërkon praninë e të paktën njëres prej veprave të parashikuara nga germa a – n (apo nga germa a – e, por jo vetëm, për sa i përket ligjit të kohës së veprës penale të kryer nga i pandehuri) të nenit 230 të K.Penal. Pra, sipas dhe jurisprudences shqiptare²⁴², një vepër me qëllime terroriste mund të shfaqet në forma të ndryshme, që nga veprat kundër personit, në rrëmbimin e avionit, anijeve apo mjeteve të tjera të transportit, e deri në shkatërrimin apo dëmtimin e objekteve me rëndësi strategjike për sigurinë e një shteti. Nga pikëpamja e teknikës legislative, ligjvënësi ka paraprirë llojet e ndryshme të veprave penale që mund të kryhen në kuadrin e një *qëllimi terrorist* të autorit të veprës penale apo të organizatës terroriste. Kuptohet lehtë, në fakt, se çdonjëra nga këto vepra përmban rrezikshmëri të lartë shoqërore, jo vetëm të kryera në kuadrin e qëllimit terrorist, por edhe si vepra penale më vete. *Pra, elementet objektive në veprat me qëllime terroriste, janë të gjitha, në vetvete, sjellje të ndaluara nga legjislacioni penal shqiptar.* Megjithatë, një sjellje apo aktivitet mund të jetë në vetvete e ligjshme, por e ndaluar nëse kryhet për qëllime terroriste. Tipik është rasti i financimit të terrorizmit, parashikuar nga neni 230/a i K.Penal, ku ndonëse elementi i dhënies apo grumbullimit të fondeve është në vetvete një aktivitet i ligjshëm, ai kthehet në të paligjshëm në rast se vihet në funksion të i) kryerjes së një vepre terroriste; ii) të një organizate terroriste; apo iii) nga një terrorist i vetëm. Në lidhje me anën subjektive, mund të themi se vepra penale e parashikuar nga neni 230 i K.Penal është një vepër me anë subjektive të dyfishtë. Për t'u ndeshur përpara një vepre me qëllime terroriste, i pandehuri duhet jo vetëm të kryejë me dashje një nga veprat e listuara në nenin 230 të K.Penal, (*dolus generalis*), por duhet gjithashtu që ta ketë kryer me *qëllime terroriste (dolus specialis)*. *Dolus specialis* në veprën me

²⁴² Vendimi nr. 71 i datës 13.05.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

qëllime terroriste gjendet në paragrafin e parë të nenit 230 të K.Penal. Këto vepra duhet të jenë kryer me qëllim:

- a) përhapjen e panikut në popullatë; ose
- b) për të detyruar organe shtetërore, shqiptare ose të huaja, të kryejnë ose të mos kryejnë një akt të caktuar; ose
- c) për të shkatërruar apo destabilizuar, në mënyrë serioze, struktura thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të shtetit shqiptar, të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare

Prania e lidhëses “ose” për të tri llojet e qëllimeve të parashikuara nga paragrafi i parë i nenit 230 i K.Penal, çon në përfundimin se për t’u konsideruar një vepër si e kryer me qëllime terroriste mjafton që vepra e listuar në nenin 230 të K.Penal të jetë kryer me dashje, dhe me të paktën një nga qëllimet e parashikuara nga paragrafi i parë i atij neni, pra me qëllim përhapjen e panikut në popullsinë vendase ose jo, për të detyruar organe shtetërore ose të huaja për të kryer apo mos kryer një akt të caktuar; apo për të shkatërruar apo destabilizuar, në mënyrë serioze, struktura thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të shtetit shqiptar, të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare. Në fakt, qëllimi kryesor i terrorizmit lidhet pikërisht me detyrimin e organeve shtetërore për të kryer apo mos kryer një akt të caktuar. Si përhapja e panikut në popullatë, ashtu edhe shkatërrimi apo destabilizimi në mënyrë serioze i strukturave thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të një shteti apo organizate ndërkombëtare janë veçse mjete të përdorura nga terroristët për të arritur qëllimin e tyre final. Kështu, nëpërmjet vendosjes së bombave në ambiente publike, marrja peng e civilëve, shkatërrimi i ndërtesave të institucioneve të qeverisjes qendrore a lokale, apo i objekteve të rëndësisë së veçantë, nuk bën gjë tjetër, veçse shtrëngon

organet shtetërore për të kryer apo mos kryer një akt të caktuar. Duhet te pranojme se ne rastet e evidentuara ne Shqiperi, psh., vendosja e eksplozivit neper makina subjektsh (vrasja e gjyqtarit S.K. ne Vlore), ne shtyllat e tensionit te larte, neper dyqane etj., elementi i qëllimit terrorist mund të mos jetë lehtësisht i dukshëm në praktikë. Kjo sepse jo gjithnjë një terrorist apo organizatë terroriste e shoqëron shprehimisht kryerjen e një vepre terroriste me kërkesën drejtuar organeve shtetërore. Për më tepër, edhe vetë provueshmëria në gjykatë e këtyre veprave do të rezultonte pothuajse e pamundur. Për këtë arsye, ligjvënësi shqiptar, ashtu siç edhe mjaft ligjvënës në shtete të tjera, në përputhje me shumë instrumente ndërkombëtarë në lidhje me terrorizmin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, kanë parashikuar, *për efekt të provueshmërisë së elementit të dolus eventualis në veprat me qëllime terroriste, praninë, në mënyrë alternative, të qëllimit për i)* përhapjen e panikut në popullatë; ii) me detyrimin e organeve shtetërore për të kryer apo mos kryer një akt të caktuar; apo iii) shkatërrimin apo destabilizimin në mënyrë serioze të strukturave thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të një shteti apo organizate ndërkombëtare.

Formulimi në paragrafin e parë të nenit 230 të K.Penal i tre qëllimeve të veprave penale të terrorizmit, lejon një interpretim mjaft të gjerë për gjykatat shqiptare, për të përfshirë të gjitha llojet e mundshme të veprave me qëllime terroriste. Natyrisht, provueshmëria e elementit subjektiv do të duhet te shqyrtohej rast pas rasti nga gjykatat.

E rëndesishme është që te analizojme dallimin mes *qëllimit* dhe *motivit* të kryerjes së veprës penale “me qëllime” terroriste. Parimisht, është i konsoliduar qëndrimi në doktrinë, por edhe në praktikën gjyqësore se motivi i autorit të veprës penale është i parëndësishëm për sa i përket konsumimit të elementit subjektiv të veprës penale. Për shembull, persona të ndryshëm mund të kenë motivime të ndryshme për të kryer vrasje

(dikush për motive të dobëta; dikush për hakmarrje; dikush për interes), por të gjithë ndajnë të njëjtën element subjekti, pra dijeninë dhe dëshirën për ardhjen e pasojës, vdekjes. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se motivi nuk është i rëndësishëm. Ndërkohë që motivi nuk është në vetvete element përbërës i veprës penale, egzistenca e tij është me rëndësi për efekt të provueshmërisë së elementit subjektiv të veprës. Gjithashtu, në legjislacionin penal shqiptar, motivi shërben si rrethanë (rënduese apo lehtësuese) e veprës penale, si dhe në raste të caktuara, edhe si pjesë përbërëse e veprës.²⁴³

Në rastin e veprave penale me qëllime terroriste, motivi i autorëve të këtyre veprave është zakonisht i) ideologjik; ii) politik; ose iii) fetar. Element i përbashkët i këtyre motiveve është *përjashtimi i përfitimit personal (interes moral apo ekonomik)*. Autori i veprës me qëllime terroriste identifikohet me një ideal, apo një platformë politike apo fetare të caktuar. Pra, shtysa e brendshme për të kryer një nga veprat e listuara nga germa a – n e paragrafit të dytë të nenit 230 të K.Penal, me qëllim të paktën një nga ato të parashikuara nga paragrafi i parë i po atij neni, është me bazë ideologjike, politike, ose fetare. Provueshmëria e motivit shërben natyrisht edhe për dallimin në të kundërt, nëse rezulton se në kryerjen e veprave të parashikuara nga neni 230 i K.Penal, motivimi ka qenë i ndryshëm, dhe jo ideologjik, politik apo fetar, atëherë lehtësisht mund të arrihet në përfundimin se *edhe* elementi subjektiv do të mungojë. Kjo nuk do të thotë se mos provueshmëria e motivit do të rezultojë automatikisht në mosprovueshmërinë e elementit subjektiv. Përkundrazi, kjo thjesht do të thotë se dijenia e motivit do të ndihmojë në provueshmërinë e elementit subjektiv të veprës penale të parashikuar nga neni 230 i K.Penal.

²⁴³ Për shembull, në rastin e “vrasjes për gjakmarrje”, parashikuar nga neni 78/a i K.Penal.

Ketu do te analizojme domosdoshmerisht ngjashmerine e figures se vepres penale te nenit 230 në lidhje me veprën penale të “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”, neni 152/2 te K.Penal. Interesi i mbrojtur në këtë rast është e drejta e pronës, e jetës dhe shëndetit të shtetasve. Kryerja e kësaj vepre penale bëhet me dashje dhe nuk është e nevojshme prania e një qëllimi të caktuar. (Ky është një ndryshim thelbesor) Gjithashtu, motivet e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 152 i K.Penal mund të jenë dhe të çdo lloj natyre. Motivi i kryerjes së veprës penale me elementin subjektiv të saj nuk duhet ngaterruar. Përveç kësaj, duhet analizimi i formës së përgjegjshmërisë penale sipas rastit, te ekzekutorit, i cili, me dashje indirekte (*dolus eventualis*) i parashikon pasojat e veprës penale dhe me megjithëse mund të mos t’i ketë dëshiruar, me ndërgjegje lejon ardhjen e tyre. Gjykatat shqiptare²⁴⁴ janë limituar në disa raste vetëm me faktin pranimit nga ana e të pandehurit se e ka kryer veprën penale, vendosjen e eksplozivit në shtyllat e tensionit të lartë, *i shtyrë vetëm nga motivi i përfitimit ekonomik*. Për këtë arsye, sipas gjykatave, në këtë rast mungon elementi subjektiv i nenit 230 i K.Penal. Siç u shpjegua më sipër, duhen analizuar në mënyrë të strukturuar dhe sistematike elementët përbërës të nenit 230 të K.Penal, përpara se të arrijme në mënyrë të menjëhershme në cilësimin juridik të aktit kriminal. Si shembull marrim parashikimet e gërmes “e” e nenit 230 të K.Penal²⁴⁵ që sipas ligjit të kohës, parashikon “shkaktimin e ndërprerjes së furnizimit me ujë, energji elektrike ose çdo burim tjetër të rëndësishëm”. Kjo mund të arrihet në forma të ndryshme, që nga sabotimi i linjave shpërndarëse të furnizimit me ujë apo me

²⁴⁴ Shiko përsëri te Vendimi nr. 71 i datës 13.05.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

²⁴⁵ Rasti më i hasur në Shqipëri, vendosja e eksploziveve në shtyllat e tensionit të lartë në zonat veriore të vendit.

energji elektrike, e deri tek shkatërimi i tyre. Në rastin e përmendur, është tentuar shkatërimi i linjave të tensionit të lartë me anë të eksplozivit²⁴⁶.

Në lidhje me motivin, i një rëndësie të vecantë është shtypsa e brendshme e ekzekutorit të veprës penale. Në rastet kur akti kriminal kryhet nga ekzekutor, i cili paguhet për aktin, duhet të mbahet parasysh qëllimi i porositësit. Pra, analiza, për efekt të motivit të kryerjes së veprës penale, duhet të nisë pikërisht nga porositësi (që mund të jetë dhe person i paidentifikuar). Kjo pasi, (siç do të shpjegohet më poshtë) elementi subjektiv i ekzekutorit të veprës penale nuk është i pavarur, por i lidhur me atë të urdhëruesit apo planifikuesit të saj. Në këtë këndvështrim, merret në konsideratë se urdhëruesi – porositësi (i paidentifikuar) ka plotësuar plotësisht elementin subjektiv të veprave me qëllime terroriste. Qëllimi i tij terrorist dhe motivi jo ekonomik do të rezultonte jo vetëm nga objekti i kërkuar për t'u shkatërruar, por edhe nga mënyra dhe rrethanat te tjera. Këto elementë konsiderohen si të mjaftueshëm nga Gjykata për të dalë në përfundimin se vepra me qëllime terroriste e parashikuar nga neni 230 i K.Penal

²⁴⁶ Në këtë rast, sipas gjykatës ishte e provuar nga aktet e ekspertimit tekniko-vlerësues se 'nga dëmtimi dhe rrëzimi i këtyre dy shtyllave, në sistemin energjetik shqiptar do të dilnin jashtë funksionit katër linja 22kv [...] janë katër linjat kryesore nga gjashtë gjithsej, që lidhin hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin (HEC-et Vau u Dejës, Koman dhe Fierzë) me qendrat kryesore të konsumit (Tiranë, Elbasan, Durrës, etj). Stakimi i menjëhershëm i tyre e çon sistemin elektroenergjitik në një *black out* total dhe në një situatë menaxhimi mjaft problematike për kohën e riparimit të tyre [...]'. Gjykata nënvizon se, edhe vetë koha e zgjedhur për të kryer veprën penale, pikërisht në datën 30 Dhjetor, pra shumë pranë Festës së Ndërrimit të Viteve, provon qëllimin për të realizuar qëllimin terrorist të përhapjes së panikut në popullatë, por edhe të destabilizimit në mënyrë serioze strukturat ekonomike të shtetit. Dhe vazhdon me aryetimin e saj se: Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se është e qartë se nga rrethanat specifike të ngjarjes dhe pasojave që mund të vinin nëse shtyllat e tensionit të lartë do të ishin shkatërruar plotësisht, rezulton e provuar jo vetëm kryerja e veprës së parashikuar nga germa "e" e nenit 230 të K.Penal (pra ndërprerja e energjisë elektrike), por edhe qëllimi terrorist i saj. Në rastin objekt gjykimi, Gjykata vlerëson se provohet gjithashtu jo vetëm qëllimi për të shkatërruar apo destabilizuar, në mënyrë serioze, struktura thelbësore ekonomike ose sociale të shtetit shqiptar, por edhe përhapjen e panikut në popullatë, në këndvështrim kjo të mjetit të përdorur, (eksploziv) si dhe efektin e errësirës në mbarë vendin. Gjykata thekson se çdokush, edhe me nivel të ulët arsimor, është i vetëdijshëm për rëndësinë strategjike (gati jetike) të elektricitetit për një shoqëri, si dhe faktin se shkatërimi i linjave të tensionit të lartë do të sillte një shkatërronte apo destabilizonte në mënyrë serioze këtë strukturë thelbësore ekonomike të shtetit.

është konsumuar në rastin konkret. Tentativa për të shkatërruar dy shtylla tensioni të lartë duhej klasifikuar si vepër me qëllime terroriste, e mbetur në tentativë.

Në lidhje me elementin subjektiv, motivi ekonomik në vetvete nuk është vendimtar në provimin e elementit subjektiv dhe ky motiv, pra ai ekonomik, mund të jetë ose jo i pranishëm në mens rea-n e autorit të veprës penale me qëllime terroriste. Pra për ligjvënuesin shqiptar, nuk ka rëndësi fakti se i pandehuri (ekzekutori²⁴⁷) mund të mos ketë vlerësuar rëndësinë e veprës që po kryente dhe pasojat e saj. Në këto kushte, duhet të vlerësohet se “mens rea” e urdhëruesit të veprës penale me qëllime terroriste, është transferuar tek ekzekutori, ose të paktën është pranuar me ndërgjegje nga ky i fundit. Forma e përgjegjësisë në çdo rast (për ekzekutorin) është ajo e *dolus eventualis* (dashje indirekte). Pra, parashikon pasojat e veprës penale dhe me megjithëse mund të mos t'i ketë dëshiruar, me ndërgjegje lejon ardhjen e tyre.

6.2.2. Analize e Ligjit Nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”

Ligji Nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit” përcakton masat kundër financimit të terrorizmit, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara për propozimin, miratimin, kontrollin dhe zbatimin e tyre. Ky ligj ka një rëndësi të veçantë në kuadër të këtij studimit dhe në veçanti në këtë Kre. Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja e veprimtarive të terroristëve dhe e atyre që mbështesin dhe financojnë terrorizmin, apo të atyre, për të cilët ka dyshime të bazuara që kanë kryer, po kryejnë ose kanë qëllim të kryejnë veprimtari të tilla, nëpërmjet bllokimit²⁴⁸, sekuestrimit²⁴⁹, të fondeve e pasurive të tyre²⁵⁰ në zbatim të rezolutave

²⁴⁷ Marrim si shembull rastin kur si i pandehur i njohur për organet proceduese të jetë vetëm ekzekutori i cili dhe pretendon se është i tillë, dhe se ka vepruar nën urdherat e porositesit (urdheruesit). Në rastin e urdheruesit motivi dhe qëllimi janë shumë të qarta dhe permbushja e elementeve të figurës penale është i padiskutueshem.

²⁴⁸ “Bllokimi i përkohshëm” është ndalimi i çdo transaksioni ose pjesëmarrjeje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve dhe të pasurive të tjera, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së

përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare apo marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.²⁵¹

Sipas këtij ligji “Terrorist” është çdo person, shtetas shqiptar, i huaj ose pa shtetësi, person fizik apo juridik, që dyshohet se ka kryer ose ka tentuar të kryejë një apo disa nga veprat e parashikuara në nenin 230 të Kodit Penal. 5. “Person që financon terrorizmin” është çdo person, shtetas shqiptar, i huaj ose pa shtetësi, person fizik apo juridik, i çdo lloj forme apo emërtimi të regjistruar ose jo, që dyshohet se ka kryer ose ka tentuar të kryejë një apo disa nga veprat e parashikuara në nenet 230/a dhe 230/b të Kodit Penal. 6. “Person i shpallur” është çdo person, shtetas shqiptar, i huaj ose pa shtetësi, person fizik apo juridik, i çdo lloj forme apo emërtimi të regjistruar ose jo: a) që është cilësuar dhe është përfshirë në listë si terrorist a person që financon terrorizmin, me vendim të Këshillit të Ministrave, në mbështetje të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të akteve përkatëse të organizatave ndërkombëtare ose të marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë; b) i cili shpallet i tillë me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të Rezolutës 1373 (2001) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, rezolutave të tjera të nxjerra në zbatim

vlefshmërisë të veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse, në përputhje me këtë ligj. Fondet dhe pasuritë e tjera, të bllokuara përkohësisht mbeten në pronësi të personave që kanë të drejtë pronësie mbi to në çastin e vendosjes së masës të bllokimit të përkohshëm

²⁴⁹ “Sekuestrim” është ndalimi i çdo transaksioni ose pjesëmarrjeje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve dhe të pasurive të tjera, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë të veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse, në përputhje me këtë ligj. Fondet ose pasuritë e sekuestruara mbeten në pronësi të personave që kanë të drejtë pronësie mbi to në çastin e vendosjes së masës së sekuestrimit.

²⁵⁰ “Fonde dhe pasuri të tjera” janë pasuritë financiare, depozitat monetare dhe pronat e çdo lloji, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht nga mënyra e fitimit, si dhe dokumentet ligjore apo instrumentet e çdo lloji, përfshirë ato elektronike ose digjitale, që provojnë pronësinë ose interesat në këto fonde dhe pasuri të tjera. Këtu përfshihen, por pa u 2 kufizuar vetëm në to, kreditë bankare, çeqet bankare ose të udhëtarëve, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, bonot, pagesat, letërkreditet dhe çfarëdo interesi, dividendi ose të ardhurat e tjera, si dhe vlerat që grumbullohen a gjenerohen nga fonde ose pasuri të tjera.

²⁵¹ Shih nenin 2 të Ligjit.

të saj ose rezolutave të tjera të ngjashme, që lidhen me luftën kundër financimit të terrorizmit, në përputhje me procedurat e brendshme të parashikuara në këtë ligj.

Hartimi i listës së personave të shpallur dhe marrja e masave kundër fondeve dhe pasurive të tjera është një element i rëndësishëm për diskutim. Ai është i sanksionuar në Kreun III. Ministri i Punëve të Jashtme, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, i propozon Këshillit të Ministrave përfshirjen në listën e personave të shpallur, duke njoftuar njëkohësisht organet përgjegjëse, organet e zbatimit të ligjit, shërbimet informative dhe Ministrin e Financave, i cili mund të vendosë bllokimin e përkohshëm për fondet dhe pasuritë e tjera të këtyre personave. 2. Përcaktimet e rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara përbëjnë të dhëna të bazuara se personi është terrorist ose person që financon terrorizmin. 3. Këshilli i Ministrave, brenda 15 ditëve nga marrja e propozimit nga Ministri i Punëve të Jashtme, vendos për përfshirjen e tyre në listën e personave të shpallur. Organet përgjegjëse, organet e zbatimit të ligjit, shërbimet informative, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave që, gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të tyre, kanë marrë dijeni ose kanë dyshime të bazuara në indicie për përfshirje personash, në çdo formë, në vepra të terrorizmit dhe të financimit të tij, të kryera apo që tentohet të kryhen, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara t'i propozojnë menjëherë Ministrin e Financave përfshirjen e tyre në listën e personave të shpallur, si dhe marrjen e masave të parashikuara në këtë ligj.

6.2.3. Analizë e Projekt Ligjit Nr. "Për kontrollin kufitar"

Projektligji "Për kontrollin kufitar" përcakton rregullat për regjimin e kontrollit kufitar të personave që kalojnë kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë. Në

momentin e shkrimit te kesaj teme projektligji ne fjale ka kaluar në parim në Komisionin e Sigurisë dhe në Komisionin e Integritimit ne Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Projektligji “Për kontrollin kufitar”, ndihmon lëvizjen e qytetarëve të Shqipërisë dhe të Kosovës, hapjen e pikave të përbashkëta të përkohshme kufitare dhe mosvendosjen e vulave në pasaporta. Por, nga ana tjetër projektligji forcon shumë luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar. Synimi i ligjit te ri, përfshin si për Shqipërinë ashtu dhe për Kosovën, luftën kundër terrorizmit dhe krimit dhe kalimin pa vulë në pasaportë. Projektligji mendohet që ka ndikim gjithashtu për lehtësitë në ekonomi, dhe ishte i domosdoshëm pas miratimit të “Kodit të Kufijve të “Shengenit” në mars 2016. Një ndër avantazhet që ka ligji i ri është edhe mosvendosja e vulave në pasaporta për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe shtetasit e vendeve të Bashkimit Europian dhe për shtetasit e Zonës Ekonomike të Bashkimit Europian, pra që janë katër shtete: Zvicra, San Marino dhe dy shtete të tjera.

Për shtetasit shqiptarë kur ka një regjistrim elektronik dhe kur ka një data base të rregullt të mbajtur për të gjitha daljet që ndodhin jashtë Shqipërisë, t’i bëjmë këto që të mos mbushet pasaporta me vula në dogana. Pra, vendoset kjo. Pra, edhe siç thashë që janë edhe të gjithë shtetasit e Bashkimit Europian dhe për ata të Zonës Ekonomike të Bashkimit Europian”. Kontrolli kufitar është nën jurisdikcionin administrativ të Ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike. Detyrat e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes kufitare kryhen nga Policia Kufitare dhe e Migracionit, e cila vepron në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore²⁵².

²⁵² Shih në menyre specifike nënin 2 të Projektligjit.

SIpas projektligjit ne fjale në hyrje dhe në dalje, të gjithë personat janë subjekt i verifikimit kufitar minimal, i cili përbëhet nga: a) Verifikimi i identitetit dhe shtetësisë së personit, si dhe i vlefshmërisë dhe origjinalitetit të dokumentit të udhëtimit, duke përdorur pajisje teknike dhe duke u konsultuar me bazat përkatëse të të dhënave, e veçanërisht me: i. bazat kombëtare të të dhënave që përmbajnë informacion mbi dokumentet e vjedhura, përvetësuar, humbura dhe zhvleftësuar të udhëtimit; ii. bazën e të dhënave të Interpol për dokumentet e vjedhura dhe të humbura të udhëtimit; iii. bazat ndërkombëtare të të dhënave, të njohura nga Republika e Shqipërisë. b) verifikimi që personi, mjeti i tij i transportit dhe sendet që ai transporton, nuk përbëjnë rrezik për rendin dhe sigurinë publike, shëndetin publik dhe marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera, duke u konsultuar me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse.

6.3. Subjekti që ushtron terrorizëm dhe dallimi nga kriminelit politik

Element kryesor i dy përpjekjeve të identifikimit të marrëdhënieve mes terrorizmit dhe krimit politik (*krimet sociale dhe depolitizimi i përgjithshëm dhe i veçantë*) është pranimi si dimensione të krahasueshme të terrorizmit nga njëra anë dhe të krimit politik nga ana tjetër. Si një sugjerim për të zëvendësuar metodën dominuese sot të përcaktimit të kufijve mes terrorizmit dhe kriminalitetit politik mund të formulohet ai që do të kontestojë supozimin e përpjekjeve të mëparshme, dhe duke u mbështetur në gjetjen se e vetmja rrugëdalje nga qorrrokaku ku të drejton teoria e kriminalitetit politik është teoria e kriminelit politik, do të rekomandoja të përcaktohen si dimensione të krahasueshme ato të terroristit dhe të kriminelit politik. Në përjashtjen ndaj fenomenit të terrorizmit mund të nxirren si tiparet karakteristike të subjektit që e ushtron atë(*terrorizmin*) sa më poshtë: a) Ai/ajo, është gjithmonë një anëtar i një lloj grupimi me

bazë ideologjike politike ose dogmë fetare²⁵³. b) në zhvillimin e taktikave vepruese, çënojnë të drejta themeltare, çënime që rrjedhin si nevojë e domosdoshme e realizimit të programit të këtyre organizatave. c) shumëllojshmëria e krimeve, por edhe ngjashmëria me njëri-tjetrin, ose motivi, që ngre si një element karakteristik të identitetit terrorist atë të "vazhdimësisë" në zhvillimin e praktikës kriminale. Më saktë efektet e sulmeve terroriste janë shkaktare të çënimeve të interesave dhe të drejtave të shumta dhe të ndryshme themeltare të njeriut në intervale të ndryshme kohore, dhe përshkruhen nga vullneti i përgjithshëm që kërkon arritjen e objektivit të synuar.d) bën të pamundurën për të zbatuar objektivat e përgjithshme të politikës programore të organizatës apo grupimit në të cilin bën pjesë. Vihet në dukje këtu se disa nga karakteristikat e terroristit (a, b, d) në parim përmbushin dy kërkesat formale të kriminelit politik. aa) përfshirja në një formacion politik (*të cfarë do lloji*) me baza ideologjike ekstreme: bb) zbatimin, përmes akteve kriminale të programit politik të tyre. Pavarësisht nga vështirësitë e veçanta që lindin, gjatë dhe nga krahasimi i terroristit me kriminelin politik, në radhë të pare, kjo përputhje në parim e karakteristikave të tyre, siç përshkruhet këtu, të çon në përfundimin vijues: në masën që praktika e kriminelit politik është potencialisht pika konvergjente e politikës dhe njëkohësisht e kriminalitetit (kriminalitetit), që do të thotë se këto dy koncepte nuk janë domosdoshmërisht vetëpërrjashtuese (*përrjashtojnë njëra-tjetrën*), dhe në vijim dhe një terrorist (subjekt politik dhe ai), ka edhe të drejtën dhe mundësitë e tjera të pretendojë të ruaje statusin e tij politik dhe në hapësirën e Ligjit Penal.

²⁵³ Shiko rastin Brewik në Norvegji. Paqka se asnjë organizatë kriminale terroriste apo ndonjë organizatë tjetër me aktivitet të dyshimtë ideologjik apo fetar ekstremistë nuk mori përsipër sulmin e përgjakshëm terrorist, prapë ky konsiderohet si i tillë, nisur nga motivi, dogma ideologjike-fetare e agresorit dhe organizimi i tij. Shkrim nga burimi <http://gazeta55.al/terror-ne-norvegji-autori-i-sulmit-eshte-nje-ekstremist-dhe-fundamentalist-i-krishtere>. Aksesuar në datë 11.06.2015.

Por dhe në Shqipëri, mbështetet një mendim tjetër, në aspektin e së drejtës penale, kombëtare dhe të drejtës ndërkombëtare që lidhet me fenomenin e terrorizmit, i cili propozoi krijimin e një tjetër tipi të ri kriminel, atë të ‘terroristit’²⁵⁴. Ky propozim hipotetik dikur, mishërohet në Kodin Penal shqiptar dhe në të drejtën kombëtare të vendeve anëtare të BE-së si dhe në Konvetat Ndërkombëtare, duke sanksionuar ndëshkime të rënda për ata që ushtrojnë terrorizëm dhe gjithashtu parashikohen dhe shumë masa parandaluese. Ndonëse meqënëse dhe aktet terroriste janë akte kriminale të cilat kryen në kuadër të një organizate apo dhe nga një individ, por me qëllim (*shkurtimisht këtu*) të përhapin terror në popullsinë e një vendi të caktuar, këto mund të mbuloheshin dhe nga nenet 333²⁵⁵ të Kodit Penal, ku ky i fundit parashikon ndëshkimin për krijimin dhe organizimin e organizatave kriminale (*ku pa dyshim dhe organizatat terroriste të tilla janë*) pasi këto dispozita nuk përjashtojnë dhe dispozitat përkatëse referuese, që janë ato që mbrojnë të drejtën përkatëse (*psh të drejtën e jetës në nenet 76 e vijues të Kodit Penal*). Por në kuadër të angazhimeve të shtetit shqiptar në luftën e

²⁵⁴ Shiko KREU VII i Kodit Penal, nenet 230-232.

²⁵⁵ KREU XI - Vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale. Neni 333 – Organizata kriminale (Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 32) Krijimi, organizimi ose drejtimi i organizatave kriminale dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Pjesëmarrja në një organizatë kriminale dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet. Nëse organizata kriminale është e armatosur dhe pjesëtarët e saj zotërojnë armë dhe lëndë shpërthyesë për qëllime të përmbushjes së veprimtarisë së saj kriminale, edhe nëse ato janë të fshehura ose të mbajtura në vende të veçanta, dënimi me burgim shtohet me një të tretën. Kur veprimtaritë ekonomike, të ndërmarra ose të kontrolluara nga pjesëtarë të organizatës kriminale, financohen tërësisht ose pjesërisht me produkte të veprave penale, masa e dënimit, sipas paragrafëve të sipërpërmendur në këtë nen, shtohet me një të tretën deri në një të dytën e tij. Neni 333/a-Grupi i strukturuar kriminal. (Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 33) Krijimi, organizimi ose drejtimi i një grupi të strukturuar kriminal për kryerjen e veprave penale dënohen me burgim nga tre deri në tetë vjet. Pjesëmarrja në grupin e strukturuar kriminal dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Neni 334-Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal. (Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 79; ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 34) 1. Kryerja e veprave penale nga pjesëtarë të organizatës kriminale dhe të grupit të strukturuar kriminal dënohet sipas dispozitave penale përkatëse, duke i shtuar dënimit për veprën penale të kryer edhe pesë vjet burgim, si dhe gjobën në masën një të tretën, por pa kaluar kufirin maksimal të dënimit me burgim. 2. Kur dispozita përkatëse referuese përmban dënim me burgim apo me burgim të përjetshëm, dënohet me njëzet e pesë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm. 3. Kur dispozita përkatëse referuese përmban vetëm dënim me burgim të përjetshëm, dënohet me burgim të përjetshëm.

përbashkët kundër terrorizmit, dhe aktet terroriste, janë bërë pjesë e legjislacionit penal shqiptar, nenet 230-232 K.Penal. Të gjitha aktet kriminale, ndëshkohen nga këto dispozita të cilat plotësohen nga dispozitat referuese për të mirën që çënohet (*si më lart*). Është theksuar më parë se duke qenë se të dyja, nenet 230-232 të Kodit Penal dhe 333-334 të tij mbivendosen dhe mbulojnë rastin e “terroristit” duke dhënë mbrojtjen e nevojshme nga aktet terroriste, nuk ishte nevoja për të futur një lloj të ri tipologjie kriminel, atë të terroristit. Krahasimi i terroristit dhe kriminelit politik nuk është përfunduar, tashmë vështirësitë e para hasen në lidhje me specifikat me të cilat shfaqen karakteristikat e terroristit, gjithmonë në lidhje me ato të kriminelit politik, përkatësisht:

a) elementi i anëtarësisë në një grupim politik apo ideologjik i cili është i përbashkët dhe njëkohësisht e vecon në lidhje me karakterizimin fillestar si kriminel politik, me pak fjalë anëtarësimi në një parti politike ose në një grupim politik u atribuohet këtyre të fundit. Në një tentim interpretimi të nenit 46 të Kushtetutës, pranohet në dallim të parë, seleksionimi i partive apo grupimeve a shoqatave politike (*këtu nuk do bëhet fjalë për sektet fetare dhe bashkësitë përkatëse-pra për grupime apo shoqata me bazë dogmatike dhe bindje fetare*) në të ligjshme dhe të paligjshme, në ato që veprimtaria e tyre në bazë të programit politik mund të konsiderohet antikushtetuese apo jo. Në rastin e grupimit politik që ushtron terrorizëm vërehet si më poshtë: aa) nuk mundet, në shumicën e rasteve të jetë një parti apo grupim politik që promovon dhe pranon funksionimin normal të regjimit aktual qeverisës (*pra nuk mund të jetë e ligjshme*)²⁵⁶ dhe kjo për

²⁵⁶ Përjashtim nga ky rregull përbën partia politike e “Agimit të Artë” në Greqi. Kjo parti politike arriti që të futej në parlamentin grek (paska se dihej botërisht veprimtaria e tyre dhe bindjet naziste që promovonte programi propagandesk) duke shfrytëzuar dhe gjendjen e vështirë dhe krizën ekonomike që përfshiu vendin fqinj. Kjo duke propaganduar ideologji ekstremiste djathtë me anë të identifikimit të politikave të gabuara të emigracionit dhe me anë të viktimizimit të popullit grek nga ana e politikave të imponuara nga fuqitë perëndimore dhe me armik të dukshëm emigrantët. Por drejtësia greke është duke hetuar rastet e dhunës dhe veprimtarisë antikushtetuese të këtij grupimi politik dhe ka dërguar në bankinën e të akuzuarve mbi 10 pjesëtarë të kësaj partie, mes tyre dhe kryetarin e tyre.

shkak se procedura dhe praktika që synon është vecse sabotimi i politikave shtetërore, sistemit social-ekonomik apo i realitetit, në përgjithësi ekonomik-politio-social që kushtetuta mishëron, bb) në teori, egziston mundësia, e formimit politik (*parti apo cdo lloj formimi tjetër*) që përzgjedh aplikimin e luftës frontale (*për disa të akteve terroriste-për tu diskutuar ky koncept pasi nga kundërshtarët do të klasifikohet si organizatë terroriste kurse nga përkrahësit si mbrojtësit e rendit ligjor dhe të drejtave legjitime të atyre që përfaqësojnë*)²⁵⁷ për të përmbysur një qeveri që shkel të drejtat dhe liritë themeltare të zgjedhësve të saj dhe që shkel në mënyrë flagrante kushtetutën e vendit. Kështu, pra, “*grupimi terrorist*” në cdo lloj forme, dhe të asaj të një partie politike, nuk mund zakonisht, të jetë palë me regjimin operativ ekzistues (*me përjashtim të rastit të mohimit aformal të legjitimitetit kushtetues nga ana e ekzekutivit*), por përkundrazi, themelohet me qëllim për ta rrëzuar këtë sistem ose ta ndryshojë atë. Këtu, vërehet dhe ndryshimi i parë në krahasim me kushtin e parë në përcaktimin e kriminelit politik, i cili është i përgjithshëm, nga momenti që përfshin edhe rastet e anëtarëve të një partie apo grupimi, të cilët veprojnë në mbrojtje të kushtetutës - gjithmonë bazuar në interpretimin

²⁵⁷ Rast i ngjashëm në luftën e popullit Kosovar për tu mbrojtur nga regjimi i Miloshevicit. Bashkimi i shqiptarëve të Kosovës në mbrojtje të jetës së tyre, u definua me anë të krijimit të UCK, e cila u cilësua më pa të drejtë si një organizatë terroriste nga regjimi i atëhershëm serb por dhe nga një pjesë e madhe e bashkësisë ndërkombëtare, kjo për interesa të tjera gjeopolitike që kanë të bëjnë me konflikte të brendshme politike brenda këtyre shteteve. Kongresmeni demokrat Eliot Engel i ka paraqitur Kongresit Amerikan nismën ligjore për heqjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga lista e organizatave terroriste, si dhe për qëllime të tjera. Propozimi që mban numrin HR 2203 i është paraqitur Komisionit të Ligjeve të Kongresit Amerikan më datë 1 maj nga kongresmeni Eliot Engel si sponsorues kryesor, derisa bashkësponsorues është edhe kongresmeni republikan i Alabama's, Robert B. Aderholt. Teksti i këtij projektligji nuk është bërë ende publik, mbasi nisma sapo është prezentuar në Komisionin e Ligjeve, mirëpo website popvox.com, në të cilin kryhen sondazhe online edhe mbi projektligje që i paraqiten Kongresit, ky propozim ka marrë deri tani vetëm 4 vota, nga të cilat, 3 janë kundër, e vetëm 1, në Distriktin 47 të shtetit Carolina, është pro. UÇK është konsideruar si organizatë terroriste nga SHBA nga presidenca e Bill Clinton-it në vitin 1998, mirëpo që prej asaj kohe republikanët e kritikuan ashpër bashkëpunimin amerikan me këtë organizatë terroriste" gjatë luftës në Kosovë, derisa aktualisht ajo nuk figuron në asnjë listë zyrtare amerikane mbi organizatat terroriste, e madje as ndër organizata e çlistuara nga Departamenti i Shtetit.

përkatës të nenit 46 të kushtetutës. Dhe pse megjithatë, për shumicën e rasteve të shfaqjes së terrorizmit, përmbushja e kushtit të parë të kriminelit politik ishte i qartë (*p.sh. ETA në Spanjë ose Brigatte Rosse në Itali*), çfarë mund të thuhet për rastet kur terrorizmi praktikohet nga një "grup presioni". Bazuar në supozimin se një kusht përcaktues për karakterizimin e një krimineli si kriminel politik, është pjesëmarrja e tij në një parti politike apo formimi (*nëse ajo e quan veten një lëvizje, organizatë, etj*) përjashtohet trajtimi juridik favorizues për ata që kryejnë akte terroriste dhe janë anëtarë të një "grupi presioni". Në nivel teorik kufijtë mes partisë politike dhe grupit të presionit janë të qartë, ndryshe, në kuadër të rregullatorit ligjor, transformimi i ngadalshëm dhe nëpërmjet një periudhe tranzicioni, në kushte të caktuara, nga një grup presioni në një parti politike, krijon vështirësi të mëtejshme dhe në kërkimin për marrëdhënie mbivendosjeje të terrorizmit mbi kriminel politik. Këto janë rastet, psh kur një "lëvizje ekologjike", konvertohet në një çështje dominuese politike ose një grup presioni qëpromovon kërkesën për tashndërruar atë në një çështje dominuese politike. Këtu shumica e raporteve të "grupit të presion" dalin përtej kornizës së objektivave të pjesshme që thjesht përputhen me udhëzimet specifike të qeverisë aktuale (*duke përjashtuar natyrisht në këtë rastklubet dhe organizatat sportive*) dhe kërkojnë një zgjidhje politike gjithëpërfshirëse duke transformuar grupin e presionit-lëvizjen sociale (*ekologjike psh si më lart në shëmbullin tonë*) në një parti politike. Në Shqipëri, ky transformim mund të realizohet vetëm në rrugë formale ligjore, pasi krijimi i partive politike rregullohet me ligjin Nr. 8580, datë 17.2.2000.

6.4. Depolitizimi i terrorizmit

Depolitizimi është procesi, nëpërmjet të cilit, një akt politik duke pretenduar të mbajë karakterin e tij politik dhe në hapësirën e ligjit penal, kur cënon të drejta themelore, bëhet një akt kriminal, dhe duhet detyrimisht të krahasohet me konceptin e krimit politik, dhe në qoftë se nga ky krahasim, shfaqet superior karakteri i tij politik, me ndërhyrjen autoritare të depolitizimit, zhvishet "dhunshëm" nga ky karakter politik ose 1) nga e mira ligjore (e drejta që cënohet), ose nga 2) motivi dhe qëllimi i autorit të krimit (në varësi të teorisë për krimin politik që ndiqet në cdo rast). Mendimi që paraprind dhe çon drejt e në depolitizim, mund të përmbledhet në frazën e mëposhtme, "Dëshira dhe qëllimi i konferencës është që të privojnë terrorizmin nga privilegjet e krimit politik dhe për të ndëshkuar më rëndë autorët e krimit dhe më saktë, të akteve kriminale terroriste më rëndë se autorët e krimeve politike²⁵⁸. Eksperienca e deritanishme në kuadër të të drejtës ndërkombëtare ka treguar dy metoda nëpërmjet të cilave ndërmerret procesi i depolitizimit: e para është) Depolitizimi i një akti të veçantë kriminal, i cili përfshin se nuk konsumon të gjithë elementet e terrorizmit, zakonisht me anë të këtij akti ushtrohet terrorizëm (rasti i depolitizimit specifik) dhe e dyta) depolitizimi i një fenomeni politik (depolitizimin e përgjithshme²⁵⁹. Megjithatë, depolitizimi i përgjithshëm dhe specifik nuk mbështetet përmes një arsytimi të integruar dogmatik në të drejtën penale, por vetëm tjesht është shprehja e vullnetit politik të ekzekutivit të një shteti, në kuadër të përpjekjeve të parandalimit të terrorizmit. Për të shmangur, për shembull, një përkufizim të përgjithshëm të terrorizmit jo-politik, i cili do të ishte i diskutueshëm në cdo rast, preferohet ose vecantia e përcaktimit të krimit përkatës që nuk mund të konsiderohet politik ose përgjithësimi i

²⁵⁸ Shiko KE "Conférence, pour la defense", ÓTC.TC., relacion i Calamandrei, tekste hyr. 4688, fq. 8.

²⁵⁹ Shiko neni 13 I Kushtetutës së Mbretërisë së Spanjës 1976, dhe marrveshja e KE për parandalimin e terrorizmit në nenin 1 të saj, që përbëjnë metodën e depolitizimit të përgjithshëm, kurse pikat a,g të këtij neni atë të depolitizimit specifik. Shiko faqet përkatëse të kësaj teze

depolitizimit të një fenomeni politik. Si në njërin ashtu dhe në rastin tjetër, injorohet në mënyrë të qartë ambienti i përgjithshëm politik në të cilin kryhet ky krim dhe llojin e të mirës ligjore, të drejtave themelore që çënon akti si dhe motivin e autorit (*përsa i përket teorisë së krimit politik*) si dhe nuk merret parasysh statusi politik i kriminelit (*element kyç në lidhje me perceptimin e kriminelëve politikë*).

6.4.1. Depolitizimi i përgjithshëm

Nënkuptohet për në shkallë të gjerë, depolitizimin e një fenomeni të tërë. Si një akt karakteristik, në terma të përgjithshme, që përpiqet arritjen e depolitizimit të përgjithshëm, mund të përmendet Kodi Penal Rumun i vitit 1927 sipas të cilit: "Aktet terroriste nuk mund të konsiderohen si krime të rënda penale apo krime²⁶⁰. Me këtë proces depolitizimi, ndërhyrja në krahasimin e terrorizmit me krimin politik nuk merr parasysh as ndonjë logjikë dogmatike dhe as një kriter tipik të paktën, por me pranimin e përfundimeve të një analize të njëanshme të të dhënave social-politike të fenomenit të terrorizmit, të cilin duan ta konsiderojnë gjithmonë fenomen jo-politik, imponohet në legjislacionin penal ose konvencional, një rol transportuesi të këtyre konkluzioneve. Si shembuj modernë të Depolitizimit të Përgjithshëm mund të përmendim legjislacionin e Republikës së Italisë, Mbretërisë së Bashkuar (me veçantinë e vet, Shqipërisë, më parë të Greqisë, ku në mënyrë të tërthortë, kur cilësohet si akt kriminal organizata terroriste, duke zgjedhur ato elementë të konceptit të terrorizmi, çka është *sine qua non* i ushtrimit të saj, duke pasur parasysh kriminalizimin e aktit në këtë mënyrë arrin depolitizimin e përgjithshëm, dhe jashtë kësaj, depolitizimin e fenomenit të terrorizmit.

6.4.2. Depolitizimi specifik

²⁶⁰ Shiko Sottile A., "Le terrorisme" fq 100, shiko gjithashtu dhe metodën e depolitizimit të përgjithshëm që ndjek Marrveshja e KE e 1977.

Një shembull klasik për këtë metodë të procesit të depolitizimit është, rasti i famshëm i Clause Belge. Sigurisht, një krim i veçantë, si ai t'i kundërvihet jetës së liderit të një shteti të huaj apo anëtarëve të familjes së tij (*një krim për të cilin referohet*) si të behet fjalë për një pirati ajrore etj, nuk mund të supozohet se ushtrohen brenda kuadrit të një politike terroriste, pasi si një element kyç në përcaktimin e karakterit të aktit kriminal, është intensiteti, përsëritja e krimit ose vullneti për vazhdimësi në të njëjtën mënyrë(*përsëritje të akteve kriminale me këtë qëllim dhe në zbatim të një programi të miratuar nga organizatat që ushtrojnë terrorizëm*). Meqënëse, eksperiencia ndërkombëtare na tregon se zakonisht terrorizmi praktikohet nga kryerja e krimeve të tilla (*si aeropiratia-sulmet në SHBA në 2001-in, në Gjermani etj*), mund të thuhet se legjislacioni kombëtar ose marrveshjet ndërkombëtare duke përdorur si instrument ligjor "Depolitizimin Specifik" ndërhyjnë me këtë metodë, në marrdhenien e terrorizmit dhe krimit politik. Megjithatë krahasuar me Depolitizimin e Përgjithshëm, ai specifik ka avantazhin e fleksibilitetit brenda kornizës rreptësisht të kufizuar nga ligji penal të një krimi të caktuar dhe nuk përpiqet të mbulojë te gjithë fazen e shfaqjes se fenomenit të terrorizmit²⁶¹.

6.5. Aktet terroriste në Shqipëri, një realitet apo propagandë mediatike? Raste studimore të përfshirjes së shtetasve shqiptarë në aktet terroriste

²⁶¹ Megjithatë, metoda e depolitizimit, injoron të gjitha ato që nuk merr parasysh. Prof.Doc. N. Androulakis, e cilëson këtë metodë si të papërshtatshme dhe citon "...mjafton që dikush të analizojë aktet kriminale të depolitizuara si psh., përdorimi i eksplozivëve në eksperiencën greke. Akoma dhe rrëmbimi i një avioni-aeropiratia, është abuzim logjik që në cdo rast të konsiderohet akt terrorist dhe shembull jep rastin e rrëmbyesit bullgar Gagov që kreu vetvrasje në burgjet greke kur mësoi se do të ekstradohej në Bullgari. Në të njëjtin drejtim është dhe St.Glaser, "Le terrorisme international..." fq 840-841 ku referohet se "është gabim të perceptojmë me të njëjtën logjikë një rrëmbim avioni psh., pa viktima si rezultat i tij dhe vrasjen e një të pafajshmi. Gjithashtu shiko dhe aktet ligjore të depolitizimit specifik si mund të mërohen, Manoglou K.-Varvicioti fq 530-532.

Në këtë pjesë të studimit mendoj që është e rëndësishme të fokusohemi në pyetjen kryesore nëse ka akte terroriste edhe në Shqipëri. Do të sjellim në këto paragrafe disa raste vetëm me qëllim studimi. Fundamentalisti dhe terroristi egjiptian, Osama Moustafa Hassan Nasr, i njohur me emrin Abu Omar, për të cilin në Itali u përfol aq shumë lidhur me marrjen e tij nga CIA dhe dërgimin në Egjipt është martuar me shqiptaren M. G.. Autorët e këtyre dy artikujve në një gazete të përditshme, Crewdson dhe Hundley, citojnë edhe ish drejtues dhe oficerë të SHIKU-t të Shqipërisë, A. N. e F. Gj.. Të dhënat që jepen në këto artikuj janë prova të tjera të së vërtetës së hidhur se në Shqipëri, që nga viti 1991 e deri më sot, ka pasur e ka baza të terroristëve dhe fundamentalistëve islamike të cilët përbëjnë një rrezik të madh jo vetëm për Shqipërinë, por për gjithë Europën. Sipas artikullit, fundamentalisti egjiptian Abu Omar ka jetuar për disa vite në Shqipëri (*që prej vitit 1991*) dhe ka punuar për agjensinë bamirëse “Human Relief and Construction Agency”. Në vitin 1993 ai u martua. Abu Omar ishte anëtar i organizatave terroriste egjiptiane Jamat al Islamiya (*The Islamic Group*) që më vonë u bashkua me Al Qaedën dhe kërkohet edhe nga shteti egjiptian. Sipas Abu Omar kjo organizate kishte në Shqipëri rreth 10 vetë që punonin për tre shoqata bamirësie islamike përfshirë këtu “Al-Haramain Islamic Foundation” dhe “Rivival of Islamic Heritage Society”. Sipas artikujve të gazetës, në Gusht 1995 kur në Shqipëri erdhi një delegacion zyrtar nga Egjipti, përfshirë edhe Ministrin e Jashtëm Amr Moussa, me kërkesë të qeverisë egjiptiane, për arsye frike nga ndonjë atentat i këtyre ndaj delegacionit egjiptian, disa egjiptianë që jetonin në Shqipëri, mes të cilëve dhe Abu Omar, si masë parandaluese, u ndaluan nga SHIKU për rreth një javë dhe pastaj u lanë të lirë. Pas pak kohe Omar me gjithë familjen u larguan papritur nga Shqipëria për në

drejtim të Europës. Në vitin 1997 Abu Omar përfiton në Romë statusin e refugjatit politik²⁶².

Nje tjetër rast vlen te permendet. Me 12 shkurt, 2014 një grua mbërriti në Komisarjatin nr 3 në Tiranë dhe denoncoi zhdukjen e dy fëmijëve të saj, 6 dhe 8 vjeç. Ajo i tregoi policisë se fëmijët janë nisur në drejtim të Turqisë me të atin e tyre, Sh. D., më 31 janar dhe, që prej asaj dite, ajo nuk kishte mundur të vinte asnjë lloj kontakti me bashkëshortin dhe as më dy fëmijët. Gruaja, M. D., 40 vjeçe, me origjinë nga Dibra, teksa ka rrëfyer rrethanat, ka vënë nën akuzë se fëmijët iu kishin rrëmbyer nga bashkëshorti i saj. Policia e Tiranës referoi rastin në prokurori, duke e shpallur 38-vjeçarin Sh. D. në kërkim për rrëmbim personi. Hetimet vijuan, ndërsa zhdukja e gjurmëve të burrit ngriti dyshimin se ai duhej të ishte larguar në drejtim të Sirisë.

Menjëherë Interpoli i shpalli të kërkuar dy fëmijët, ndërsa strukturat e hetimit dhe zbulimit në vend dhe jashtë tij, nisen verifikimet e aktivitetit të 38- vjeçarit. Sinjalet dhe informacionet çuan në faktin tronditës se dy fëmijët mbërriten në Siri dhe gjenden atje me të atin e tyre. Hetimet u shtrinë në të gjitha lidhjet dhe njohjet e dibranit, ndërkohë që Shërbimet Inteligjente, më në fund, u bënë pjesë e një superinvestimi informativ, duke zbuluar ‘brigadën e celulave’ terroriste në vendin tonë. Rreth 22 mjete policore nga Drejtoria e Policisë së Tiranës moren pjese ne kete operacion duke bërë të

²⁶² Një e dhënë tjetër me shumë interes që lidhet me Shqipërinë është ajo që shkruhet në artikull lidhur me një bisedë të Abu Omar në Itali në vitin 2002 me një burrë të paidentifikuar nga Afrika e Jugut, bisedë që është përgjuar nga organet e specializuara për luftën kundër terrorizmit. Në këtë bisedë flitet për makina me bomba. Abu Omar pyet afrikanin: “Kush, kush i ka bërë bombat?” Afrikanin i përgjigjet: “Një nga vëllezërit tanë Palestinezë....Një nga ata që e therrasin Makineri...ai që është në Shqipëri...” Sipas kësaj bisede të përgjuar në Itali midis dy anëtarëve të organizatave terroriste rezultoi se edhe në vitin 2002 në Shqipëri kishte terroriste të ardhur nga vende arabe dhe që merreshin edhe me prodhimin e bombave, edhe me dërgimin e tyre për misionet terroriste në vende të ndryshme. Ky detaj besoj se u ka shërbyer e po u shërben edhe institucioneve shtetërore shqiptare e Perëndimore në luftën e tyre kundër terrorizmit. Burimi <https://www.shqiperia.com/shqip/opinionart/aID/63/titulli/A-rrezikohet-edhe-Shqiperia-nga-Terrorizmi>. Autor Zef Broci, dt. 25.04.2015.

mundur arrestimin e shtatë personave dhe shpalljen në kërkim të 5 të tjerëve. Mes të kërkuarve ishte edhe babai që rrëmbeu dy fëmijët dhe i çoi në Siri. Operacioni G. B., nga Librazhdi, i vetëshpallur si imam i Xhamisë në ‘Unazën e Re’, 35 vjeç, nga Librazhdi dhe B. H. , 43 vjeç, nga Tirana, i vetëshpallur imam i Xhamisë së Mëzezit, nga prokuroria dhe policia, u konsideruan edhe si organizatorët kryesor të “Rekrutimit të personave me qëllim kryerjen e veprimeve terroriste”; të “Nxitjes, thirrjes publike dhe propaganda për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste”, dhe të “Nxitjes së urrejtjes ose e grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve”. B. H, sipas të dhënave të hetimit ishte mësues në shkollën që kishte hapur B. brenda xhamisë në “Unazën e Re”, ndërsa pesë personat e tjerë të vënë në pranga janë të gjithë lidhje e dy imamëve, persona që, sipas hetimeve, rezultojnë të jenë organizatorë, financues dhe ndihmës të organizatës. Referuar të dhënave zyrtare të Prokurorisë bëhet me dije se grupi ka nisur të funksionojë që para një viti ndërsa rekrutonin besimtarë dhe i nisnin në drejtim të Sirisë duke shfrytëzuar Turqinë. Aty, mësohet se ekzistojnë dy-tri baza në të cilat kryhen edhe stërvitjet e duhura dhe më pas shqiptarët niseshin në drejtim të Sirisë për të marrë pjesë në luftë. Gjatë operacioneve janë zbuluar armë dhe armatime, veshje kamuflazhi si dhe dy radio-marrëse. Akuzat Sipas prokurorisë personat e arrestuar dhe të kërkuar u akuzuan për veprat penale të “*Rekrutimit të personave me qëllim kryerjen e veprimeve terroriste*”; të “*Nxitjes, thirrjes publike dhe propaganda për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste*”, dhe të “*Nxitjes së urrejtjes ose e grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve*” të parashikuar nga neni 231, 232/a dhe 265 të Kodit Penal Shqiptar. Shtetasit G. B. dhe B. H., të cilët ushtronin aktivitet fetar ilegal, në zonën e Unazës së Re dhe në fshatin Mëzez, Tiranë, dyshohet se kanë kryer veprime aktive për indoktrinuar persona të ndryshëm me ideologji radikale, për t’u angazhuar më

pas në luftime në përbërje të grupeve terroriste ekstremiste që janë nën sanksione nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. E. B.dhe V. M. dyshohet se kryenin veprime konkrete për rekrutimin dhe dërgimin e disa shtetasve shqiptarë në Siri. Ndërsa shtetasit F.M., Z. I.dhe A. T. dyshohet se kanë kryer veprime aktive për të ndihmuar organizatorët në rekrutimin dhe më pas dërgimin e disa shtetasve shqiptarë në Siri. Gjithashtu, nga forcat e Policisë së Shtetit, në bazë të autorizimit të gjykatës, u ushtrua kontroll në disa ambiente në Tiranë dhe Pogradec, ku ushtronin veprimtarinë e tyre këta persona. Ndërkohë, në kuadër të këtij hetimi, janë caktuar masat e sigurimit edhe për gjashtë persona të tjerë, të përfshirë në të njëjtën veprimtari kriminale, si edhe po vijojnë hetimet nga Prokuroria për Krime të Rënda dhe oficerët e policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit. Në vijim të operacionit të zhvilluar u bë i mundur arrestimi i 7 personave, si të dyshuar që rekrutonin shtetas shqiptarë për të luftuar në Siri, si dhe arrestimi i shtetasit O. S. R., 37 vjec, lindur në Zodjan të Peshkopisë dhe banues në Tiranë. Ky person ishte në rolin e ndihmësit në këtë grup ndërsa ishte në ndjekje nga strukturat e policisë dhe kapja e tij u bë e mundur në afërsi të banesës së tij, pikërisht në Tiranë. Për te dyshuarin tjetër O. R., Gjykata për Krimet e Rënda caktoi masën e sigurisë arrest me burg, si i dyshuar për të njëjtat vepra penale që akuzohen edhe të gjithë të arrestuarit e tjerë. Sipas të dhënave priten edhe arrestime të tjera në Tiranë dhe disa rrethe të tjera të vendit, ndërkohë që personat që janë shpallur në kërkim, dyshohet se kanë kryer të njëjtin aktivitet në Kosovë dhe Maqedoni, vende ku tashmë do të nisnin hetimet për të zbuluar se cili ka qenë roli i këtyre personave.

Po ashtu, edhe vrasja me lëndë shpërthyesë e gjyqtarit të gjykatës së Vlorës, S. K., përtej veprimeve procedurale dhe qëndrimit të prokurorisë, nuk mund të konsiderohet si një akt i mirëfilltë terrorist, si në aplikim të neneve 230 e vijim të Kodit

Penal ashtu dhe të përkufizimit që i japin këtij akti dokumentet dhe aktet ndërkombëtare. As një organizatë apo qoftë dhe individ nuk mori përsipër aktin criminal, ku gjatë deklaratës do të bënte publik dhe qëllimin e tij. Dhe pas hetimeve intensive nuk rezultoi se kishim të bënim me një akt terrorist. Duke u nisur nga sa më lart nuk përmbush ky akt (*vrasje*) elementët përbërës të veprës penale tashmë, të nenit 230 K.Penal. Dhe pse ngeli pa autor (*deri më tani*), gjë që vështirëson analizën e veprës pasi mungon një deklaratë e autorit dhe hetimi nuk mund të jetë i plotë pa një vlerësim psikologjik të tij (*që do të ishte i mundur vetëm nëqsky kapej, dorëzohej, kishte informacion për të dyshuar ose kishte bërë të ditur identitetin e tij*) ne mund të themi se “qëllimi” i kërkuar nga neni 230, jo thjesht nuk provohet por sipas gjasave nuk egziston. Motivi i këtij akti besoj është krejtësisht tjetër nga ato që kërkon një akt terrorist, dhe me të drejtë nga organet e hetimit, politika dhe vetë nga radhët e gjyqësorit, nuk është bërë fjalë në kuptim të plotë për një akt terrorist, përveç retorikës metaforike të përdorur²⁶³ për t’i dhënë, me të drejtë, rëndësinë e vecantë lajmit të tmerrshëm. Gjithashtu, e njëjta gjë mund të thuhet dhe për sulmin me tritol në farmacinë, në zotërim të babait të Ministrit të Brendshëm S.T. dhe njëkohësisht vendosja e lëndëve shpërthyesë në një stacion autobuzi në Tiranë. Këtu situata, përse i

²⁶³ Nënkrjetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë Kreshnik Spahiu e ka cilësuar atentatin ndaj gjyqtarit në Vlorë si një ekzekutim terrorist që i bëhet një funksionari publik. Në një konferencë për shtyp Spahiu me tone mjaft të ashpra e cilësoi vrasjen e gjyqtarit si një rast të paprecedentë dhe ka theksuar se ky akt i shëmtuar është një vazhden e disa ngjarjeve dhe atentateve të njëpasnjëshme që janë bërë kundër gjyqësorit. "Është akt në vazhden e atentateve të gjyqësorit, duke përbërë një rast të paprecedentë ndaj drejtësisë që nga koha e Ismail Qemalit. Shqipëria synon të jetë në rrugën e integritit evropian dhe nuk tenton të jetë si Siçilia e 50 viteve më parë. Një shtet gjyqësor që nuk mund të garantojë jetën e gjyqtarëve, nuk jep garanci për jetën e qytetarëve", tha ai. Gjithashtu Spahiu ka kërkuar që kjo çështje të trajtohet me prioritet maksimal nga organet e hetimit dhe autorët të vihen përpara drejtësisë. "Ky është një akt terrorist që i bëhet sistemit të drejtësisë. Është një sulm i drejtpërdrejtë që duhet të sjellë reflektim të menjëhershëm të shtetit për veprimet që duhet të ndërmerren në të ardhem për sigurinë e qytetarëve" ka përfunduar Spahiu <http://www.albeu.com>, aksesuar në datën 28.06.2015.

përket vlerësimit dhe përkufizimit të aktit është më e ndërlikuar, jo sepse objektivi ishte i një të afërmi të një funksionari të lartë, ministrit (funksionar i lartë ishte dhe gjyqtari Konomi) por për faktin se lidhet dhe me objektivin tjetër, që ishte një stacion autobuzi. Analiza këtu duhet të jetë më e rafinuar, dhe konkluzione më të sakta duhen dalë pas përfundimit të hetimeve (*mos harrojmë se autorët janë identifikuar dhe ndaluar nga organet e drejtësisë*), por unë do tentoj të jap mendimin tim pas pasqyrimin dhe tjesht të lajmit në median shqiptare duke e trajtuar si një kazus shkollor.

Pas ndalimit që u bë nga policia e shtetit, e një grupi prej tre vetësh, të cilët dyshohen fillimisht për kryerjen e aktit, u deklarua nga kjo e fundit se kishim të bënim me një grup të strukturuar, por nuk u përmend kurre motivi i aktit nga grupi si dhe nuk u definua si akt terrorist nga prokuroria. Dyshimet ngre vendosja e lëndës shpërthyesë në stacionin e autobuzit. Në një vend të hapur publik, ku gjithkush nga ne mund të ishte i pranishëm në momentin e realizimit të shpërthimit. Deri këtu, të gjitha të drejtojnë drejt një tentative për një akt terrorist, me rrezik potencial jetën e të pafajshmëve dhe të të papërfshirëve në asnjë konflikt me agresorët (*ngjashmëri me aktet që deri tani praktika terroriste na ka "mësuar"*). Por megjithatë, besoj se jo, qëllimi i shprehur qartë nga ligjvënësi penal shqiptar, nuk është element përbërës i anës subjektive të veprës penale këtu. Nuk vërtetohet dhe as nuk u bë, me të drejtë, fjalë për, një akt terrorist dhe citoj nenin 230 K.Penal, vepra kriminale *me qëllim përhapjen e panikut në popullatë ose për të detyruar organe shtetërore, shqiptare ose të huaja, të kryejnë ose të mos kryejnë një akt të caktuar, ose për të shkatërruar apo destabilizuar, në mënyrë serioze, struktura thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të shtetit shqiptar, të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm. Më shumë besoj, vendosja e*

eksplozivit në stacionin e autobuzit nga të njëjtit persona, mund të jetë zgjedhur si strategji për të ngatërruar dhe hedhur mjegull mbi hetimet mbi shpërthimin në farmacinë e babait të ministrit, dhe vetë shpërthimi i realizuar, një krim i cili nuk dënohet nga 230 e K.Penal, por nga dispozitat përkatëse e kreut XI të K.Penal për kryerjen e veprave penale nga banda të armatosura dhe organizata kriminale (333, 333 a ose 334 K.Penal). Këto, ndër të tjera, të cojnë në konkluzionin se në territorin e Shqipërisë deri më tani nuk janë kryer akte terroriste në kuptimin e mirefillte të fjalës dhe për të ndëshkuar këto të fundit do të gjeje aplikim nën 230 pikat a,b,c,d,c,dh,e. i Kodit Penal

KAPITULLI VII KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

7.1. Konkluzione

Lufta kundër terrorizmit në këto kohët e fundit po konsiderohet një nga sfidat më të mëdha, me të cilat përballlet rendi ligjor. Terrorizmi është një ndër krimet të rënda dhe aktet terroriste janë veprime kriminale dhe rrjedhimisht, janë pjesë e tagrit të sistemit të drejtësisë penale. Standardet e të drejtave të njeriut do të zbatohen pavarësisht nëse një incident i caktuar konsiderohet si akt terrorist apo një veprë tjetër që hyn në kategorinë e krimeve të rënda. Ndonëse ende bashkësia ndërkombëtare nuk ka mundur të gjejë konsensus mbi definicionin e terrorizmit, është rënë dakord që disa akte përbëjnë akte terroriste si vepra penale kundër civilëve, të kryera me synimin e shkakimit të vdekjes apo dëmtimeve të rënda trupore, apo rrëmbimet e personave. Pavarësisht nëse është i motivuar nga konsiderata politike, filozofike, ideologjike, racore, etnike, fetare apo të ndonjë natyre të ngjashme, me qëllimin e provokimit të një gjendjeje terrori tek publiku i gjerë, tek një grup individësh, apo individë të vecantë, frikësimin e popullatës apo duke detyruar një qeveri apo organizatë ndërkombëtare të kryejë apo të mos kryejë një veprim; dhe vepra që përbëjnë krime nën dritën dhe sipas përshkrimit të konventave dhe protokolleve ndërkombëtare në lidhje me terrorizmin.

Një konkluzion i pare ka të bëjë me problemin kyesor juridik dmth me përkufizimin e saktë të "terrorizmit ndërkombëtar". Pikërisht për këtë arsye ngrihen disa çështje të së drejtës që parimisht duhet të gjejnë zgjidhje në përkufizimin juridik të këtij fenomeni. Sa i takon të drejtës ndërkombëtare kjo problematike është thelbësore pasi duhet të përcaktohet termi terrorizëm dhe kufijtë e fenomenit, pra dallimin nga vepra penale të tilla si vrasja, sekuestër, sekuestrim personi etj por mbi të gjitha me ato që njihen tashmë në të drejtën kombëtare dhe pikërisht nga e drejta kombëtare humanitare.

Debati juridik ditët e sotme në gjirin e Kombeve të Bashkuara lidhur me përkufizimin juridik përqëndrohet në mënyrë esenciale te individët që i kryejnë këto akte. Shtetet arabe dhe afro-aziatike kanë ngritur pretendimin që duhet të përjashtohen nga ky përkufizim ato akte të dhunshme që bëhen me qëllim të luftës për vetëvendosje ligjitimiteti i së cilës njihet nga e drejta ndërkombëtare. Aktualisht të gjithë vendet e botës dënojnë terrorizmin dhe të gjitha llojet e akteve me qëllim terrorizmin dhe në kuadër të përkufizimit të saktë juridik të mirëpranuar në nivel botëror kanë pranuar të quajnë terrorizëm: *akte që kanosin ose janë rrezik për jetën, shëndetin ose pronën e individit ose përpjekjet për minimin e qëllimshëm të rendit kushtetues dhe qeverisjes demokratike, kryesisht përmes përpjekjeve për influencimin e politikave dhe hartuesve të ligjeve pa dallim ndaj përzgjedhjes së objektivave, me qëllim mbjelljen e frikës dhe terrorit në popullatë.* Analiza e të drejtës në fushën e terrorizmit ndërkombëtar ka për qëllim gjithashtu që të tregojë se ekziston një dallim ndërmjet akteve terroristeve dhe akteve të ndërmara nga *freedom fighters* në kuadër të luftës për vetëvendosje. Nga ana tjetër janë miratuar edhe akte me karakter rajonal të cilat edhe pse japin një përkufizim të fenomenit të linja të përgjithshme këto janë të kufizuara për sa i përket shtrirjes dhe pasojave juridike. Pra në lidhje me raportin që ekziston ndërmjet terrorizmit dhe luftës për vetëvendosje të popujve praktikrat dhe zakonet ndërkombëtare përfshijnë konventa me karakter universal të cilat janë pranuar me rezarva ose nuk janë mirëpritur nga shtetet arabe e afro aziatike. Në këto raste konventa të tilla nuk duhen të respektohen në rastet e luftës së vetëvendosjes së popujve. Edhe në rastet e konventave me karakter rajonal shtetet e sipërpërmendura edhe pse e dënojnë terrorizmin ndërkombëtar e dallojnë nga lufta për lirinë ndërkombëtare. Rezoluta 1566 ofron një përkufizim për terrorizmin dhe shpall ndërkombëtarisht se në asnjë rrethanë aktet terroriste nuk mund

të justifikohen me qëllime politike ose ideologjike. Praktika e aplikuar e konventave ndrkombetare tregon se si gjyqtaret kombetare janë limituar duke bërë referim tek krimet e disiplinuarat prej konventave pa i shkuar thellë problemit në identifikimin e këtyre krimeve si akte të terrorizmit nderkombetar. Në përfundim në vëmë re që e drejta e traktateve dhe e konventave tradicionalisht e marrë me termin e terrorizmit përveç se nuk zgjidh siç pame dhe me lartë problemin e përkufizimit të përgjithshëm por të jep dhe përshtypjen se nuk ofron gjë, nuk ofron kritere të vlefshme si dhe të krijoj përshtypjen se nuk bë gjë tjetër veçse sanksionojnë krime të cilat kanë ngjashmëri dhe janë pothuajse identike me krimet e thjeshta. Pra deri tani nuk kanë dhënë elementet e duhur në bazë të të cilëve të ngrihet analiza e rasteve konkrete dhe të klasifikohen si vepra të terrorizmit nderkombetar. Organizata e Kombeve të Bashkuara nuk ia ka dalë ende mbanë të arrijë një konsensus mbi përmbajtjen dhe përkufizimin e terrorizmit. Në këtë kuadër, veçanërisht problematik ka rezultuar barazimi i terrorizmit me dhunën politike. Ekzistojnë shumë forma dhe lloje të dhunës politike, të cilat shpeshherë, për arsye edhe propagandë të brendshme apo ndërkombëtare, i kanë shtyrë qeveritë e shteteve të ndryshëm të përdorin nocionin e terrorizmit për të përkufizuar kundërshtarët e tyre, të tilla si greva e urisë, internimet, shtypja e dhunshme e demonstratave paqësore, krimet e urrejtjes, tortura, spastrimet etnike, rebelimet (urbane ose jo-urbane), etj.

Edhe pse janë dhënë të gjitha pikëpamjet dhe kuptimi i terrorizmit ndërkombëtar përsëri janë konventa dhe akte të cilat nuk e zgjidhin çështjen e përkufizimit juridik të terrorizmit ndërkombetar të pranuar nga të gjithë shtetet. Këshilli i Sigurimit i OKB-se ka bërë që nepermjet vendimeve dhe analizave teorike në doktrinë të flitet për një fuqi legjislative të Këshillit. Këshilli i Sigurimit gjithsesi mund të legjitimohet të marrë masa

ligjore dhe praktike (konkrete) për parandalimin dhe frenimin autoreve dhe akteve terroriste.

Nje konkluzion i dyte ka të bëjë me rendin juridik të Bashkimit Europian. Sulmet e njëpasnjëshme të disa nga vendet e Bashkimit Europian (Belgjike, France, Itali) ka bërë edhe BE-ne që t'i rimendojë politikën e luftës dhe mbrojtjes nga aktet terroriste. Vetë BE-ja sot po përballë me shumë se kurrë me sulmet terroriste dhe thirrjet e liderave të Bashkimit Europian i mësojnë me tepër çështjeve të sigurisë sesa trajtimin juridik të fenomenit. Siç rezulton nga ky studim, mënyra sesi organizatat ndërkombëtare i janë përgjigjur sfidave të sigurisë nga terrorizmi ndërkombëtar dëshmon se ato vijojnë të mbeten variabla të varura nga vullneti i shteteve që bëjnë pjesë në to. Në këtë kuptim rezulton se organizatat ndërkombëtare e kanë më të lehtë të nxisin bashkëpunimin midis shteteve në përballimin e sfidave në fusha të tjera me rëndësi relative, sesa në fushat e sigurisë, të cilat prekin drejtpërdrejt sovranitetin e vendeve anëtare. Vetëm strategjia dhe akte juridike pa dyshim që nuk do të jenë zgjidhje efektive në luftën ndaj terrorizmit. Çështjet e sigurisë aktualisht janë ato që po marrin hov në BE. Kjo, siç kuptohet, përbën një proces politik, dhe të udhëzon drejt në propozimet konkrete të politikave në fusha të veçanta. Zgjerimi i konceptit të sigurisë, për të përfshirë dhe *kërcënimin terrorist*, ndërmjet të tjerëve si varfërinë, zhvillimin ekonomik, degradimin mjedisor, përtej kërcënimeve më tradicionale ushtarake, është në vetvete një përballje politike në një proces vertikal, i cili kthehet dhe çon në një zgjerim të kategorive të rrezikut, dhe në këtë mënyrë në kundërmasat teknologjike për t'u përballur dhe shmangur këto rreziqe ndër to dhe kërcënimin terrorist. Në rastin e BE-së, jemi përballë një procesi institucional ku bie në sy mosegzistenca e një përballjeje institucionale për një sfidë të tillë të madhe. Po ashtu dhe të asnjë precedenti historik përfshirjeje Evropiane të

industriisë së mbrojtjes kombëtare deri tani përmes përcaktimit të prioriteteve të trajtimit të sigurisë kombëtare dhe në rang të BE-së, nga sulmet dhe kërcënimet terroriste. Ky proces filloi duke miratuar në një dokument qëndror Strategjinë Europiane të Sigurisë. Në këtë u kategorizuan llojet e kërcënimeve ndaj BE-së, veprimet e duhura, dhe politikat publike të veçanta të tilla. SES-i është dokumenti i parë dhe kryesor i BE-së në procesin e klasifikimit të sigurisë dhe legjitimitit të saj si çështje e rëndësisë të veçantë. Si për vendosjen e prioriteteve kërkimore, SES ka përbërë pikën e referimit për një shumicë të dokumenteve publike, të cilat përcaktojnë këtë politikë për teknologjinë. Për më tepër, qëllimi tjetër i BE-së, i cila është homogjenizimi dhe përforcimi i konkurrencën mes industrive të mbrojtjes, arrihet përmes miratimit të hulumtimit të përbashkët shkencor dhe përcaktimit të prioriteteve teknologjike dhe industriale. Për qëllimin e përvetësimit të tyre, si instrumenta, njihen dhe programet kërkimore shkencore. Europianët e kuptuan nevojën dhe rëndësinë e teknologjisë në luftën kundër kërcënimeve që i kanosen BE-së, dhe gjithashtu të zhvillimit dhe prodhimit të kësaj të fundit nga industria dhe qarqet shkencore. Përdorimi dhe i këtij instrumenti në luftën kundër terrorizmit u konsiderua i domosdoshëm, por produkti, pra suksesi mbetet për tu parë akoma. Përdorimi i teknologjive me përdorim të dyfishtë, si nevojë jetike për suksesin dhe pritshmëritë, duhet miratuar njëzëri dhe nga vendi yne dhe nga komuniteti ndërkombëtar. Klasifikimi i kërcënimit terrorist për mendimin tim, duke e renditur atë në një vend të veçantë në listën e kërcënimeve, ishte, besoj, shumë i pikasur, pasi lehtëson vendimarrjen për sa i përket shkallëzimit të prioriteteve të politikës për zgjidhjen e problematikave të cilat thirret rregullisht të përballojë.

Nje konkluzion i trete ka te beje me progresin teknologjik qe është varësia e madhe e botës perëndimore. Çdo ndërprerje e progresit teknologjik apo shërbimeve të

saj do të kishte efekte të pakëndshme mbi mënyrën e jetesës sonë. Varësia jonë nga sistemet kompjuterike për menaxhimin e shërbimeve publike, të rrjeteve të komunikimit dhe tregjeve të aksioneve, si dhe varësia jonë nga energjia e centraleve bërthamore, u jep terroristëve alternativën e zgjedhjes së objektivave dhe aftësinë të mundësojnë paralizimin e qendrave nervalgjike të rendit tonë shoqëror. Ky është objektivi i luftës. Në mënyrë të ngjashme, përparimet në teknologji lejuan grupet e trajnuara mbi teknologjinë, të cilat nuk kanë mjete të tjera për të arritur qëllimet e tyre, të jenë terroristë jashtëzakonisht efektivë. Teknologjia siguron mjetet, armët dhe *çelësin* për të arritur suksesin. Avionët komercialë transportojnë pasagjerë (po ashtu dhe terroristët) në mbarë botën, por në të njëjtën kohë mund të rezultojnë dhe një mjet-armë vdekjeprurëse. Digat e Rezervuarve të ujit janë zona të akumulimit të ujit, për përdorim në të ardhmen, por mund të ndryshohet destinacioni funksional i tyre në një mjet shkatërrimi duke i hapur dhe shkaktuar përmytje të madha në zona urbane. Centralet bërthamore sigurojnë energji elektrike me kosto të lirë, por mund të rezultojnë dhe burim rreziku radioaktiv për dekada të tëra. Lista e përdorimeve të mundshme negative të sistemeve ekzistuese të teknologjisë është pothuajse e pakufizuar, dhe bazohet në dualitetin e përdorimit të teknologjisë. Terrorizmi ndërlidhet me teknologjinë me disa mënyra, dhe kjo marrëdhënie transformohet me kalimin e kohës. Teknologjia ofron potencial aplikacionesh dhe ky potencial përdoret nga terroristët. Teknologjitë e transportit përcaktojnë shpejtësinë, distancën dhe intensitetin e sulmeve terroriste. Teknologjitë e komunikimit ndikojnë për të përcaktuar shkallën e impaktit në nivelin politik dhe ideologjik. Kështu që në fakt, nëse teknologjia do të konsiderohet efektivisht aleate, sigurisht që ajo është aleate e përhapjes dhe mbështetjes së terrorizmit dhe jo e sigurisë.

Kuptohet qe *konkluzioni i katert*, lidhet edhe me sa me siper, me vete shtetet qe ne disa raste e favorizojne dhe e sponsorizojne terrorizmin. Në analizë të dimensionit ekstrajuridik të fenomenit "terrorizëm", por dhe në kuadër të shkencës juridike është argumentuar shpesh, dhe u identifikua (*si themeltar*) dallimi midis terrorizmit shtetëror (*në lidhje me marrëdhëniet ndërkombëtare, shteti "terrorist" në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në rendin e brendshëm ligjor, shtet "terrorist" në hapësirën territoriale sovrane*) dhe terrorizmit që inicion dhe udhëzon shoqërinë kundër shtetit. Por në praktikë ka një anësi të përdorim të termit. Rregullimet ligjore i referohen terrorizmit të drejtuar kundër shtetit ligjor, duke injoruar tërësisht terrorizmin shtetëror. Për këtë të fundit, vëmë re se ligji themelor i çdo shteti modern, kushtetuta e tij, specifikohen procedurat qe kanë tendencë të përjashtojne ligjshmërinë e atyre akteve të pushtetit ekzekutiv që i afrohen kufijve te terrorizmit shtetëror. Vete ekzekutivi zakonisht mbështet "*terrorizmin e ushtruar prej tij*" në sundimin ekzistues te rendit ligjor te paracaktuar. Nuk duhet sigurisht të mohohet se ka raste të tilla, si për shembull "zhdukjet e personave" në Argjentinë gjatë diktaturës së fundit ushtarake, ku terrorizmi shtetëror është nuk ushtrohet vetem duke përdorur rendin ligjor egzistues, por gjithashtu dhe ne shkelje të ketij te fundit, duke percmuar totalisht ligjin e miratuar nga vete ajo. Prandaj në këto raste, terrorizmi shtetëror mund të jetë me interes për te drejten penale te kohes, por zakonisht krimet e kryera gjatë zhvillimit të praktikave të terrorizmit shtetëror, ndiqen penalisht dhe dënohen pas rënies së regjimit qe i ushtroi, brenda një rendi të ri moduluar apo ne tranzicion, politik dhe juridik. Prandaj, kryesisht të interesuar këtu jemi per terrorizmin qe ushtrohet kunder shtetit te te drejtes.

Konkluzioni i peste dhe i fundit ka te beje me vendin tone dhe qasjen e tij ndaj fenomeni te terrorizmit. Duhet theksuar roli mbështetës i Shqipërisë në luftën kundër

terrorizimit dhe kundër ISIS. Në kuadër të kësaj kauze, Shqipëria ka ndihmuar luftëtarët kurdë Peshmerga në Veri të Irakut, të cilëve u ka dhuruar një sasi të madhe armësh dhe municioni. Por nga ana tjetër e monedhës, Shqipëria është një vend burim rekrutësh të destinuar të bashkohen me ISIS që shkojnë në Siri dhe Irak. Dhe pse vendi ynë e ka legjislacionin e nevojshëm që dënon aktet terroriste, financimin, transfertat e fondeve, rekrutimin, trajnimin, nxitjen, krijimin dhe pjesëmarrjen në organizata terroriste, duhet bërë më shumë përpjekje për zbatimin më efikas të tij. Ndërsa organet e rendit në Shqipëri punojnë aktivisht për të zbuluar dhe penguar aktivitete të paligjshme që lidhen me drogat dhe trafiqet, ato ende nuk kanë të njëjtën qasje agresive për të përballuar kërcënimet e mundshme terroriste. Ministri i Brendshëm dhe vetë Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit njoftuan për plane në tetor të vitit 2014 që synojnë zgjerimin e njësisë antiterroriste. Trajnimi dhe pajisja e kësaj njësie do të ketë nevojë për përpjekje të konsiderueshme që ajo të arrijë nivelin e duhur të kapacitetit për të përballuar me efektivitetet terrorizmin. Shqipëria në këtë kohë nuk ka kapacitete teknologjike për të grumbulluar të dhëna biometrike veç atyre të kartave të identitetit dhe pasaportave që paraqiten në pikat e kalimit kufitar por, si u analizua në këtë tezë, këto kapacitete, që përkojnë me teknologjitë e aplikueshme dhe trajnimet përkatëse të burimeve njerëzore, mund të mbushen nga momenti që disponohen tashmë nga partnerët tanë në BE dhe nga SHBA. Në këtë kuadër veprimtarie Shqipëria duhet të përvetësojë teknologjitë e nevojshme, si psh atë të mundësisë për të përpunuar shenjat e gishtave në të gjitha pikat e kalimit kufitar. Financimi nga Buxheti i Shtetit për këto teknologji është në këto momente i detyrueshem, pasi kërcënimi terrorist dhe në Shqipëri është real dhe i pranishëm. Por dhe korrupsioni i kombinuar me një sistem të dobët drejtësie, vecse minojnë përpjekjet e organeve proceduese për zbatimin e ligjit.

Shqipëria duhet të miratojë (në shumë raste e ka realizuar) nisma kundër personave dhe organizatave të përfshira në listën e OKB-së si financuese të terrorizmit, duke pasur parasysh se për këtë ka ngritur, bazuar në legjislacionin e vecantë, një sistem parandalues kundër fenomenit të pastrimit të parave dhe atë të financimit të terrorizmit që ndërlidhen me njëri tjetrin. Gjithashtu duhet promovuar dhe bashkëpunimi qeveritar me Komunitetet fetare dhe vecanërisht me atë mysliman ku identifikohen dhe problematikat më të shumta. Ndihma financiare e tyre, që është shumë e nevojshme për të siguruar mosvarësinë e tyre nga joshja e organizatave terroriste dhe bashkëpunimi me intensiv, duhet të synojë parandalimin dhe luftën në tërësi të radikalizimit që si rrjedhojë ka cuar në rekrutimin e shtetasve shqiptarë në organizata terroriste.

7.2. Rekomandime

Lidhur me këto teme nuk ka qene e lehte te jap rekomandimet e mia gjithsesi mendoj se disa rekomandime jane te nevojshme.

1. Mendoj se ekziston mundesia per te konstatuar dhe per te gjetur nje konsensus te pergjithshem midis shteteve mbi nje definicion te debatuar prej kohesh mbi terrorizimin nderkombetar, dhe ne vecanti mbi nje nocion qe kapercen objektivin e akteve terroriste te cilet tradicionalisht jane identifikuar si sulme kunder popullsise civile. Ndaj Keshilli i Sigurimit dhe gjykatat kombetare duhet te jene me te rrepta dhe insistuese ne percaktimin juridik te terrorizmit dhe akteve terroiste. Qellimi final mbetet gjithsesi parandalimi i tyre.

2. E drejta nderkombetare ofron pa dyshim zgjidhje, por mendoj se organizatat rajonale jane ato qe duhet te japin me shume kontribut ne kete drejtim. Jane rajonet ato qe jane me shume te perfshira ne nje moment te caktuar ndaj nje kercenimi terrorist, dhe nuk duhet te lihet ne rang me te larte, pasi zgjidhja nuk do te jete e shpejte dhe efektive.
3. Bashkimi European duhet te rrise nxitjen dhe bashkepunimin ndermjet shteteve anetare per parandalimin e akteve terroriste dhe kercenimin aktual terrorist.
4. Duhet te merren masa te tjera dhe urgjente per parandalimin dhe frenimin e autoreve dhe akteve terroriste.
5. Ne vijim te rekomandimit te mesiperm, Shtetet duhet te arrijne nepermjet sigurise te dallojne terrorizmin e individeve te sponsorizuar nga shtetet e tjera dhe te rrisin sigurine e qytetareve te tyre sepse civilet jane personat e pambrojtur.
6. Shtetet duhet patjeter qe te marrin masa shtrenguese mbi lirite personale te personave te dyshuar se jane te implikuar ne qarqet qe perbejne kercenime terroriste edhe duke bere keshtu derogim prej detyrimeve te mara persiper ne kuader te se drejtes nderkombetare dhe te drejtave te njeriut. Kjo duhet te behet per te rritur sigurine nderkombetare perballe nje emergjence qe e shkakton fenomenin e terrorizmit nderkombetar.
7. Duke konstatuar karakterin perjashtues te masave te marra, te cilat ne raste te tjera nuk mundet te meren per efekt te pengesave qe krijohen nga e drejta nderkombetare, shikohet se jane lejuar te meren masa drastike per vete rendesine qe paraqet ky fenomen per kercenimin serioz qe mbart ne vetvete.

Vetem per te frenuar kete fenomen shtetet duhet te vazhdojne perpjekjet edhe duke shkelur shpesh te drejta nderkombetare dhe te drejtat e njeriut.

8. Sa I takon vendit tone, Shqiperia duhet te vazhdoje bashkepunimin efektiv edhe me shtetet e tjera si te Bashkimit European ashtu edhe te rajonit me qellim forcimin e luftes kunder terrorizmit.
9. Shqiperia duhet me patjeter te rrise sigurine brenda territorit me qellim eleminimin e fenomenit te rekrurimit te adoleshenteve dhe te miturve ne keto rrjete.

BIBLIOGRAFIA

- Abbate, J., (1999), Cold War and White Heat, te MacKenzie, D. Wajman, J. (bot.), *The Social Shaping of Technology*, Open University Press.
- Abbate, J., (1999), *Inventing the Internet*, MIT Press actes de terrorisme", Strasburg 1983.
- Adam Dolnik, Understanding Terrorist Innovation: Technology, Tactics and Global Trends (New York: Routledge, 2007).
- Adrian Guelke, The New Age of Terrorism and the International Political System (London and -New York: I.B. Tauris, 2009).
- Agulhon M., "Plaidoyer pour les Jacobins", Le Débat nr 13, qershor 1981, Gallimard.
- Aigrain, P., Allen, G., Oliviera, E., Colombo, U., Mark, H., Ruscoe, J., (1989), *The Report of the Framework Review Board*, DG XII, Brussels
- Aked, N., Gummett, P., (1976), Science and Technology in the European Communities: the History of the Cost Projects, *Research Policy*, vol. 5, fq. 294
- Alex P. Schmid, editor, The Routledge Handbook of Terrorism Research (New York: Routledge, 2011).
- Alic, J., Branscomb, L., Brooks, H., Carter, A., Epstein, G., (1992), Microelectronics: Two Industries, One Technology, te Alic, J., Branscomb, L., Brooks, H., Carter, A., Epstein, G., *Beyond Spinoff: Military and Commercial Technologies in a Changing World*, Harvard Business School Press
- Allison, G., Morris, F., (1975), Armaments and Arms Control: Exploring the Determinants of Military Weapons, *Daedalus*, vol. 104 (3), fq. 99-129
- Ancel M., "Le crime politique et le droit pénal au 20 siècle, R.H.P..C. , 1938.
- Andrulaki N., Revolucioni, Grushti i Shtetit dhe e Drejta Penale, nr.2/ 23 (1975).

- Anthopulo M., Te drejatat e njeriut, Kushtetuta dhe Bashkesia e shtetasve, vol. 8, qershor-shtator 1984.
- Anthopulo N., Teoria e partizanit dhe Carl Schmit", vol. 10, janar-mars 1985, fq. 81.
- Arce, D.G., Sandler, T., (2003), An Evolutionary Game Approach to Fundamentalism and Conflict, *Journal of Institutional and Evolutionary Economics*, vol. 159, fq.154
- Armacost, M., (1969), *The Politics of Weapons Innovation: The Thor – Jupiter Controversy*, Columbia University Press
- Aron R., "Histoire et dialectique de la violence", Gallimard 1973.
- Arrow, K., (1962), Economic Welfare and the Allocation of Resources for Invention, te Nelson, R., (bot.), *The Rate and Direction of Inventive Activity: Economic and Social Factors*, Princeton University Press
- Arrow, K., (1962), The Economic Implications of Learning by Doing, *Review of Economic Studies*, vol. 29, nr. 3, fq. 155-173
- Arrow, K., Debreu, G., (1954), The Existence of an Equilibrium for a Competitive Economy, *Econometrica*, vol. XXII, fq. 265-90
- Assembly of the Western European Union, (1994), *The European Armaments Agency – Reply to the Thirty-Ninth Annual Report of the Council*, teksti 1419, Assembly of the Western European Union
- Atkinson, S.E., Sandler, T., Tschirart, J.T., (1987), Terrorism in a Bargaining Framework, *Journal of Law and Economics*, vol. 30, nr. 1, fq. 1-21
- Aubert G., "Répression du terrorisme et protection des libertés individuels: le Royaume, Uni devant la Cour européenne des droits de l'homme", 1978.
- Audretsch, D., Feldman, M., (1996), R&D Spillovers and the Geography of Innovation and Production, *American Economic Review*, vol. 86, nr. 3, fq. 630-640

- Avant, D., (2000), From Mercenary to Citizen Armies: Explaining Change in the Practice of War, *International Organization*, vol. 54, fq. 90
- Aymond P., "Délit politique", Encyclopédie de droit pénal, Dalloz, vol. D-I. Babeuf G., "Le tribun du peuple", Union générale des éditions, 1969.
- Bainbridge, W.S., (2003), The Future in Social Sciences, *Futures*, vol. 35, nr. 633-650
- Baldwin, D.A., (1997), The Concept of Security, *Review of International Studies*, vol. 23.
- Balzat, M., (2006), *An Economic Analysis of Innovation. Extending the Concept of National Innovation Systems*, Edward Elgar Publishing
- Barth, K.H., (2003), The Politics of Seismology: Nuclear Testing, Arms Control and the Transformation of a Discipline, *Social Studies of Science*, vol. 33, nr. 5, fq. 743-781
- Basalla, G., (1988), *The Evolution of Technology*, Cambridge University Press
- Bascio, P., (2007), *Defeating Islamic Terrorism: The Wahhabi Factor*, Branden
- Bass G., Jenkins B., Ronfeldt K., "Options for U.S. Policy on terrorism", Rand Corporation, qershor 1981.
- Bassiouni C., "An appraisal of the grow thand developing tends of international criminal law", 1974.
- Beck, U., (2009), *World at Risk*, Polity Press
- Beck, U., Beck-Gernsheim, E., (2001), *Individualization: Institutionalized Individualism and Its Social and Political Consequences*.
- Beirlaen A., "Considerations sur la prévention et la répression du terrorisme", 978.
- Bentham, J., (1970), *An Introduction to the Principles of Morals and Legislation*, Athlone, London

- Berman, E., (1990), 'The Economic Impact of Industry-funded University R&D', *Research Policy*, fq. 349
- Bertini B., Franchi P., Spagnoli U., Bufalini P., "Terrorisme et démocratie", Editions Sociales, Paris 1978.
- Bertsch, G., (1988), (bot.), *Controlling East West Trade and Technology Transfer*, Duke University Press
- Betts, R.K., (2000), Is Strategy an Illusion?, *International Security*, vol. 25, nr. 2, fq. 5-50
- Bijker, W., (1997), *Of Bicycles, Bakelites, and Bulb*, MIT Press
- Bijker, W., Law, J., (bot.), (1995), *Shaping Technology / Building Society*, MIT Press
- Blain, M., (2009), *The Sociology of Terrorism: Studies in Power, Subjection and Victimage Ritual*, Universal Publishers
- Blume, S., (1992), *Insight and Industry – On the Dynamics of Technological Change in Medicine*, MIT Press
- Bolle P.-H., "Le droit et la répression du terrorisme", prill-qershor 1977, fq.121.
- Bondi, H., (1973), International Cooperation in Advanced Technology, *The World Today*, vol. 29, nr. 1, nr. 16-23
- Booth, K., (2007), *Theory of World Security*, Cambridge University Press
- Borricand J., "L'extradition des terroristes", R.S.C.D.P.C., vol.3., qershor-shtator 1980, fq. 663
- Bouzat P. Pinatel J."Traité de droit pénal et de criminologie",fq.123, Libraire Dalloz, Paris 1953.
- Bower, A., (1994), *Essays in the Economics of Procurement*, Rand, Santa Monica

- Bowker, G., Star, S., (1999), *Sorting Things Out: Classification and its Consequences*, MIT Press
- Bozeman, B., Dietz, J.S., (2001), *Research Policy Trends in the United States* te Laredo, P., Mustar, P., (bot.), *Research and Innovation Policies in the New Global Economy*, Edward Elgar Publishing
- Brigitte L. Nacos, *Terrorism and Counterterrorism [Fourth Edition]* (Boston, MA: Longman, 2011), 352 faqe.
- British Eureka Chairmanship, (1986), *Procedures for EUREKA Projects: Note by Chairman of the Ministerial Conference*, DTI
- Bronk, D., (1974), *The National Science Foundation: Origins, Hopes and Aspirations*, *Science*, vol. 188, fq. 409-414
- Browne, L., (1988), *Defense Spending and High Technology Development: National and State Issues*, *New England Economic Review*, vol. 1, nr. 1, fq. 3-22
- Bruce Bongar, et al., editors, *Psychology of Terrorism* (New York: Oxford University Press, 2007), 512 faqe.
- Bruce Hoffman, *Inside Terrorism [Second and Expanded Edition]* (New York: Columbia -University Press, 2006), 456 faqe
- Bruck, T., (2004), *An Economic Analyses of Security Policies*, *Defence and Peace Economics*, vol. 16, nr. 5, fq. 375-389
- Bruza M., "Le délit politique et l'extradition", 1882, fq. 403.
- Bulletin of the European Communities, Supplement 14/73, (1973), *Scientific and Technological Policy Programme*, COM (73) 1250 Parts I & II
- Bush, V., (1945), *Science: the Endless Frontier. Report to the President on a Program for Postwar Scientific Research*, GPO

- Buzan, B., (1991), *People, State and Fear: An Agenda for International Security Studies in the Post-Cold War Era*, Harvester Wheatsheaf
- Buzan, B., Herring E., (1998), *The Arms Dynamic in World Politics*, Lynne Rienner
- Buzan, B., Waever, O., de Wilde, J., (1998), *Security: A New Framework for Analysis*, Lynne Rienner
- Caloghirou, Y., Vonortas, N., Ioannides, S., (εκδ.), (2004), *European Collaboration in Research and Development. Business Strategy and Public Policy*, Edward ElgarPublishing
- Caloyanni M., "Deux conventions: Prevention et repression du terrorisme, Création d'une Cour Internationale", 1938, fq. 403.
- Caplan, B., (2006), Terrorism: The Relevance of Rational Choice Model, *Public Choice*, vol. 128, fq. 107
- Capt A., "Les crimes politiques", qershor 1994, fq. 659.
- Carlsson, B., (bot.), (1995), *Technological Systems and Economic Performance: The Case of Factory Automation*, Kluwer Academic Publishers
- Casablanca P., "Les tribunaux d'exception des Etats totalitaires", 1936, fq. 235.
- Centre for Strategy and Evaluation Services, (2011), *Ex-Post Evaluation of the Preparatory Action on Security Research (PASR), Interim Evaluation of FP7 Security Research*, Final Report, Centre for Strategy and Evaluation Services
- Challiand G., "Terrorisme et politique", Le Monde, maj 1973, fq. 24.
- Chapard F., "La répression des crimes de guerre dans le pays occupés par l'Allemagne au cours
- Charving R., "Justice et politique", Paris 1968, fq. 38.
- Chopra, V.D. Global challenge of terrorism, 2002,

- Cloud, J., (2001), *Imaging the World from a Barrel: CORONA and the Clandestine*
- Cloud, J., (2003), Special Guest-Edited Issue on the Earth Sciences in the Cold War (Introduction), *Social Studies of Science*, vol. 33, nr. 5, fq. 629-633
- Clutterback, R., (1994), *Terrorism in an Unstable World*, Routledge
- Coaffee, J., (2003), *Terrorism, Risk and the City. The Making of a Contemporary Urban Landscape*, Ashgate
- Coase, R.H., (1966), The Economics of Broadcasting and Government Policy, *American Economic Review*, vol. 56, nr. 1/2, fq. 440-447
- Coase, R.H., (1978), Economics and Biology: A Comment, *American Economic Review*, vol. 68, nr. 2, fq. 244-245
- Cohen, M., March, J., Olsen, J., (1972), A Garbage Can Model of Organizational Choice, *Administrative Science Quarterly*, vol. 17, fq. 1-25
- Cole, A., (2001), *Franco – German Relations*, Pearson Educated Limited
- Collins, H., (1974), The TEA Set, *Science Studies*, vol. 4, fq. 165-186
- Collins, H., Pinch, T., (1998), *The Golem at Large. What You Should Know About Technology*, Cambridge University Press
- Commission of the European Communities, (1972), *Objectives and Instruments of a*
- Commission of the European Communities, (1973), *Working Program in the Field of 'Research, Science and Education*, SEC (73), 2000/2
- Commission of the European Communities, (1974), *Information, CCR Research Programme, Commission Proposes Revision of the Multiannual Research Programme*, 64/74
- Common Policy for Scientific Research and Technological Development*, COM (72), 700

- Conceicao, P., (2001), *Beyond the Digital Economy: a Perspective on Innovation for*
- Conseil de l'Europe, " V. Conference de directeurs d'instituts de recherches criminologiques",
- Conseil de l'Europe, "Conférence sur la défense de la démocratie contre le terrorisme en Europe taxes et problèmes", Strasbourg 1981.
- Conseil de l'Europe, "Coopération international en matière de poursuite et de répression des
- Conseil de l'Europe, "Rapport explicatif sur la convention européenne pour la répression du terrorisme", Strasbourg 1977.
- Constant, E.W., (1980), *The Origins of Turbojet Revolution*, Johns Hopkins University Press
- Convention for the Establishment of a European Space Agency*, artikulli 2, 30 Maj 1975.
- Convergence of the Earth Sciences, *Social Studies of Science*, vol. 31, nr. 2, fq. 231-251
- Coombs, R., Saviotti, P., Walsh, V., (1992), *Technology and the Firm: the Convergence of Economic and Sociological Approaches?*, te Coombs, R., Saviotti, P., Walsh, V., (bot.), *Technological Change and Company Strategies: Economic and Sociological Perspectives*, Harcourt Brace Jovanovich Publishers
- Council of the European Union, (1998), *Code of Conduct on Arms Exports*, 8675/2/1998 Rev2
- Council of the European Union, (2003), *EU Strategy Against Proliferation of Weapons of Mass Destruction*, Council of the European Union, 15708
- Council of the European Union, (2003), *Extraordinary European Council*, Brussels, 17/2/2003, 6466/03

- Cowan, R., Foray, D., (1995), Quandaries in the Economics of Dual Technologies and Spillovers from Military to Civilian Research and Development, *Research Policy*, vol. 24, fq. 851-868
- Cowan, R., Jonard, N., Ozman, M., (2004), Knowledge Dynamics in a Network Industry, *Technological Forecasting and Social Change*, vol. 71, fq. 469-484
- Cowles, M., (1995), Setting the Agenda for a New Europe: the ERT and EC 1992, *Journal of Common Market Studies*, vol. 33, nr. 4, fq. 501-26
- Cox, D., Gummett, P., Barker, K., (bot.), (2001), *Government Laboratories. Transition and Transformation*, NATO SCIENCE Series, Science and Technology Policy, IOS Press
- Crenshaw, M., (2000), The Psychology of Terrorism: An Agenda for the 21st Century, *Political Psychology*, vol. 21, nr. 2, fq. 405-420
- Crenshaw, M., (bot.), (1995), *Terrorism in Context*, PennState University Press
- Current news, vol.933, botim i vecante, "Terrorisme", 30.11.1982.
- Cutter, S.I., Richardson, D.B., Wilbanks, T.J., (2003), *The Geographical Dimensions*
- Czwarno, M., (2006), Misjudging Islamic Terrorism: The Academic Community's
- Daggett, S., (2010), *Costs of Major U.S. Wars*, CRS Report for Congress, Congressional Research Service
- Dando, M., (2002), *Preventing Biological Warfare: the Failure of American Leadership*, Palgrave
- Dang Nyugen, G., (1985), Telecommunications: A Challenge to the Old Order, te Sharp, M., (bot.), *Europe and New Technologies*, Pinter
- David E., "Les détournements d'avions et le droit international", 1979, fq. 246.

- Davis, V., (1974), *Levee en Masse, C' est Finie: The Deterioration of Popular Willingness to Serve*, te Lovell, J.P., Kronenberg, P.S., (bot.), *New Civil-Military Relations*, Transaction Books
- De Grasse, R.,(1983), *Military Expansion, Economic Decline: The Impact of Military Spending on U.S. Economic Performance*, Sharpe Press
- de la guerre 1939-45", R.D.P.C. 1948, fq. 793.
- De Lauer, R., (1984), *Technology Development and Transfer*, te Kuhn, R.L., (bot.), *Commercializing Defence-Related Technology*, Praeger
- De Ryckere R., "Les attentats et les complots contre la forme du gouvernement", fq 123 e vijim.
- De Schutter B., "La convention européenne pour la répression du terrorisme", 1977, fq. 217.
- de Solla Price, D., (1963), *Little Science, Big Science*, Columbia University Press
- de Syon, G., (2003), *Consuming Concorde, Technology and Culture*, vol. 44, nr. 3, fq. 650-654
- De Vabres D., "Les principes modernes du droit penal international", 1928.
- De Vabres D., "Traite de droit criminel", Librairie Recueil Sirey, 1947.
- Debrai R., "Révolution dans la révolution", Maspero 1969.
- Debreu, G., (1959), *Theory of Value*, Wiley
- Defense Science Board, (2008), *Creating an Effective National Security Industrial Base for the 21st Century: An Action Plan to Address the Coming Crisis*, U.S.Department of Defense
- dello stato", bot.Pellicano 1979.

- Denison, E., (1962), *The Sources of Economic Growth in the United States and the Alternatives Before Us*, Committee for Economic Development
- Denison, E., (1969), *Why Growth Rates Differ: Post-War Experience in Nine Western Countries*, Brookings Institute
- Dennis, A.-M., (2003), Earthly Matters: on the Cold War and the Earth Sciences (Postscript), *Social Studies of Science*, vol. 33, nr. 5, fq. 819
- Dershowitz, M. A. *Why Terrorism Works: Understanding the Threat, Responding to the Challenge*, 2002.
- Dilip K. Das, Peter C. Kratcoski, *Meeting the Challenges of Global Terrorism: Prevention, Control, and Recovery*, 2003.
- Dockes, P., Rosier, B., (1991), Histoire 'Raisonnée' et économie Historique, *Revue économique*, vol. 42, nr. 2, fq. 181-202
- Dosi, G., (1983), Semi-Conductors: Europe's Precarious Survival in High Technology, te Shepherd, G., Duchene, F., Saunders, C., (bot.), *Europe's Industries: Public and Private Strategies for Change*, Pinter
- Dosi, G., Egidi, M., (1991), Substantive and Procedural Uncertainty: An Exploration of Economic Behaviours in Changing Environments, *Journal of Evolutionary Economics*, vol. 1, nr. 2, fq. 145-168
- Duffield, M., (2001), *Global Governance and the New Wars: The Merging of Development and Security*, Zed
- Durodie, B., (2006), What Can the Science and Technology Community Contribute?, te James, A., (bot.), *Science and Technology Policies in the Anti-Terrorism Era*, NATO Science Series, IOS Press

- Eads, G., Nelson, R., (1971), Government Support of Advanced Civilian Technology, *Public Policy*, vol. 19, fq. 405-432
- Earle, E., (1986), Adam Smith, Alexander Hamilton, Friedrich List: the Economic Foundations of Military Power, Paretz, P., (bot.), *Makers of Modern Strategy*, Princeton University Press
- Ed Moloney, A Secret History of the IRA (New York: W.W. Norton & Company, 2003), 640 faqe
- Efstatiades K., "La Cour pénale internationale pour la répression du terrorisme", 1936, fq. 385.
- Ehrlich, P.R., Liu, J., (2002), Some Roots of Terrorism, *Population and Environment*, vol. 24, nr. 2, fq. 183-192
- Elster, J., (1989), The Empirical Study of Justice, te Barry, B.M., (bot.), *Theories of Justice*, University of California Press
- Ely Karmon's Coalitions Between Terrorist Organizations: Revolutionaries, Nationalists, and Islamists (Leiden: Martinus Nijhoff Publishers, 2005) 426 faqe.
- Enders, W., Sandler, T., (1995), Terrorism. Theory and Application, te Hartley, K.,
- Enders, W., Sandler, T., (1999), Transnational Terrorism in the Post-Cold War Era, *International Studies Quarterly*, vol. 43, nr. 1, fq. 145-167
- Enders, W., Sandler, T., (2000), Is Transnational Terrorism Becoming More Threatening, *Journal of Conflict Resolution*, vol. 44, nr. 3, fq. 307-332
- Engels F., "Le rôle de la violence dans l'histoire", te Marx-Engels, Oeuvres choisies, fq. 399.
- Ergas, H., (1987), Does Technology Policy Matter?, te Guile, B.R., Brooks, H.,

- Eureka Secretariat, (1996), *Communiqué of the XIV-th Session of the Eureka Ministerial Conference*, Document Eureka 14 MC 8
- Europe Economics, (2009), *Study on the Competitiveness of European Small and*
- European Commission, (2007), *A Strategy for a Stronger and More Competitive European Defense Industry*, Final (2007) 764, 5/12/2007
- European Commission, (2009), *Council Regulation 428/2009, Setting Up a Community Regime for the Control of Exports, Transfer, Brokering and Transit of Dual – Use Items (Recast)*, L 134, 29.5.2009
- Failure to Predict 9/11, *Studies in Conflict and Terrorism*, vol. 29, nr. 7, fq. 657-678
- Faure C., "Terre, terreur, liberté", Maspèro, Paris 1979.
- Fella V., "Etudes relatives au droit pénal universel" 1950, fq 600.
- Fella V., "Fonctions pacificatrices du droit penal supranational et fin du système traditionnel des
- Frayse-Druesne G., "La convention européenne pour la répression du terrorisme", 1978, fq. 469.
- Furet F., "La révolution sans la terreur", Le Débat, Gallimard, qershor 1981, fq. 40.
- Furet F.-Riebet D., "La révolution française", Marabout, 1973.
- Giroux, A. H. *Beyond the Spectacle of Terrorism: Global Uncertainty and the Challenge of the New Media*, 2006.
- Glaser S., "Droit international pénal conventionnel", vol.1, Société anonyme d'éditions juridiques et scientifiques, Bruksel 1970,, vol.1, 1978.
- Gus Martin, editor, *The SAGE Encyclopedia of Terrorism [Second Edition]* (Los Angeles, CA: SAGE Reference, 2011), 720 faqe.

- James Ciment, editor, World Terrorism: An Encyclopedia of Political Violence from Ancient -Times to the Post-9/11 Era [Three Volumes] [Second Edition] (Armonk, NY: Sharpe Reference, 2011), 1016 faqe.
- John Horgan and Kurt Braddock, editors, *Terrorism Studies: A Reader* (New York: Routledge, 2011), 504 faqe.
- John Horgan, *The Psychology of Terrorism* (New York: Routledge, 2005), 224 faqe.
- Lutaud O., "Des révolutions d'Angleterre à la revolution française", 1973.
- Magistratura Democratica, "Il terrorismo, il quadro politico", te " il giudice le istituzioni, la crisi
- Magnus Ranstorp, editor, *Mapping Terrorism Research: State of the Art, Gaps and Future Direction* (New York: Routledge, 2007), 352 faqe, fq 278-289.
- Martha Crenshaw, *Explaining Terrorism: Causes, Processes and Consequences* (New York: Routledge, 2011), 268 faqe.
- Medium Enterprises (SMES) in the Defence Sector*, Final Report, European Commission
- Michael Burleigh, *Blood & Rage: A Cultural History of Terrorism* (New York: Harper Collins Publishers, 2009), 592 faqe.
- Motley J., "Us strategy to counter domestic political terrorism", National Defense University,
- Mouvement d'action, "L'affaire Croissant", Maspèro 1977.
- of Terrorism*, Routledge
- Oschinsky S., "Espace judiciaire européen et terrorisme", J.Tr. e 3.5.1980.
- Panier C., "La déliquescence de la notion de délit politique", *Contradictions*, vol. 2, prill 1977.

- Pankov Y. κ.ά., "Le terrorisme politique. L'impérialisme mis en accusation", Progrés, Moske 1983.
- Paul K. Davis, et al, *Social Science for Counterterrorism: Putting the Pieces Together* (Santa Monica, CA: RAND, 2009), 540 faqe, fq.78.
- Peter R. Neumann, *Old & New Terrorism* (Malden, MA: Polity Press, 2009), 204 faqe. Press, Washington 1983.
- Prévost J.-Fr., "Les aspects nouveaux du terrorisme international", 1973, fq. 579.
- Richard Jackson and Samuel Justin Sinclair, editors. *Contemporary Debates on Terrorism* (New York: Routledge, 2012), 240 faqe
- Saldana Q.M. , "Sur le terrorisme", 1936, fq. 24.
- Salmon J., "La Convention européenne pour la repression du terrorisme", 1977, fq. 497 e vijim.
- Sandler, T., (bot.), *Handbook of Defense Economics*, vol. 1, Elsevier, fq. 213-249
- Serath S., "Un evenement historique dans l'évolution du droit contemporaine (sur le terrorisme)", 1937, fq. 1241. Strasburg, Vol. II, 27.3.1968.
- The Learning Society, *Technological Forecasting & Social Change*, vol. 67, fq. 115–142 traités de paix", A.Pedone, Paris 1947.
- Walter Enders and Todd Sandler, *The Political Economy of Terrorism* (New York: Cambridge University Press, 2006), 294.